DAP

DEPARTAMENTI
I ADMINISTRATËS
PUBLIKE

# 100 VJET ADMINISTRATË

Nr. 12, 13,14

2012

100 Vjet Pavarësi

1912 - 2012

DAP

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

# 100 VJET ADMINISTRATË

Nr. 12,13,14
2012

*100 Vjet Pavarësi*

**1912 - 2012**

**Punoi për përgatitjen e materialeve të revistës:**
Eriona Rusmali
Milena Sauku
Evis Taska-Pano
Laert Kraja

**Paraqitja grafike:**
Elvis Bejtja

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
MINISTRIA E BRENDSHME
Sheshi "Skënderbej", Nr. 3, Tiranë; Kutia postare Nr. 1751
Tel: +355 4 2235937; Tel/Fax: +355 4 2251241
www.pad.gov.al

**Layout & Shypi:**

**BOTIME**

pegi

**Shtypur: Shtypshkronja Pegi**
**Shtypshkronja Pegi**: cel: +355/(0)69 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

# Përmbledhje dokumentesh lidhur me organizimin dhe funksionimin e Administratës Shqiptare nga viti 1912-2012



Blerta Selenica

Drejtor
Departamenti i Administratës Publike
Ministria e Brendshme

Në vigjiljen e ndërrimit të shekullit të parë të shtetit të pavarur shqiptar, ndihem vërtetë e privilegjuar të jem në krye të institucionit që drejton reformën në administratën publike.

Ky moment i veçantë historik na jep mundësinë të reflektojmë mbi arritjet, sukseset, mangësitë dhe sfidat e administratës publike shqiptare, jo vetëm në 100 vitet që sapo u mbyllën, por edhe për vitet në vazhdim.

Që nga dita e Shpalljes së Pavarësisë, në 28 nëntor 1912, nëpunësit e administratës shtetërore kanë luajtur një rol thelbësor në ndërtimin e shtetit, duke marrë përsipër kryerjen e detyrave të rëndësishme shtetërore, duke sfiduar prapambetjen e kohës dhe duke aspiruar modelet evropiane të administrimit shtetëror.

Sot, ne kemi një kuadër të plotë ligjor dhe praktika administrative bashkëkohore, që bëjnë të mundur zbatimin e reformave të rëndësishme në të gjitha fushat e veprimtarisë shtetërore.

Le të na shërbejë ky botim i Departamentit të Administratës Publike për të hedhur një vështrim retrospektiv në krijimin dhe zhvillimin e administratës shqiptare në 100 vitet e para të shtetit të pavarur.

Gëzuar 100-vjetorin!

Në kuadër të 100 Vjetorit të Pavarësisë, Departamenti i Administratës Publike realizoi botimin e kësaj përmbledhjeje dokumentash ilustruese të veprimtarisë së administratës shtetërore në 100 vite, me ide të z. Roland Bejko Këshilltar për Administratën Publike i Ministrit të Brendshëm.

Falenderojmë përzemërsisht stafin e Departamentit të Administratës Publike, Arkivit Qendror të Shtetit dhe Bibliotekës Kombëtare për punën disamujore me përkushtim në mbledhjen dhe përzgjedhjen e dokumentave të publikuara këtu.

Një falenderim të veçantë përcjellim për:

Prof. Dr. Nevila Nika - Drejtor, Arkivi Qendror i Shtetit

Dr. Ivan Loli – Drejtor i Inspektimit pranë Arkivit Qendror të Shtetit

Prof. Dr. Aurel Plasari - Drejtor, Biblioteka Kombëtare

Dr. Etleva Domi - Zv. Drejtor, Biblioteka Kombëtare



Në Vlonë më 15/28 të Vjeshtës së tretë 1328/1912.

Pas fjalëvet që tha Z. Kryetari Ismail Kemal Beu, me të cilat tregoi rrezikun e madh në të cilin ndodhet sot Shqipëria të gjithë delegatët me një zâ venduan që Shqipëria me sot të bâhet në vehte, e lirë e e mosvarme.

DEKLARATA E SHPALLJES SE PAVARESISE

# QEVERIA E PËRKOHËSHME E VLORËS DHE VEPRIMTARIA E SAJ

## NËNDOR 1912 – JANAR 1914

Përpunuar e redaktuar nga
DHIMITËR KOTINI, XHAVIT STRUGA FANE VEIZI,
MEDIHA SHUTERIQI, KLEANTHI DEDI,

BIBLIOTEKA E
A.Q.SH.
NR INV.

BOTIM I DREJTORISË SË PËRGJITHËSHME TË ARKIVAVE
SHTETËRORE TË R.P.SH.
TIRANË, 1963

Nr. 343

*Kanuni i përtashëm i administratës civile të Shqipërisë nxjerrë nga ana e Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës, dhe botuar në gazetën «Përlindja e Shqypniës»*

*22 nëndor 1913*

Për ta ndihmue dëshirën e atyne që duen ta kenë të tanë këtë nom në pak numura të gazetës, po i botojmë përsëri në këtë faqe ata 4 artikuj të shtypun në numurin e fundit.

**Ndamja Administrative**

Artikulli I. Shqipënia asht ndamë në prefektura, prefektura në nënprefektura dhe n/Prefektura në krahina. Qytetet dhe fshatet janë të ndamë në nji e ma shumë qarqe katundarie edhe cilido qark numërohet nji krahinë.

Art. 2. Kufinjtë e prefekturave dhe qenorat qeveritare caktohen dhe shenjojnë numurin e n/prefekturave, numurin e fshatevet që do të ketë cilado prej nënprefekturavet dhe numurin e krahinavet që do të përmbledhë nënprefektura. Këshilli i përgjithshëm i prefekturës i shqyrton këto ndamje dhe i konfirmon, ashtu si janë a me ndryshime, e ja dërgon administratës qendrore, e cila i konfirmon përfundimisht.

Art. 3. Krahinat do të përbahen prej fshatevet që janë afër njani tjetrit e populli i të cilavet ka marrëdhanie të bashkëta nga pikëpamja shoqënore e bujqësore. Cilado krahinë do të ketë që prej 3000 e der më 7000 banorë dhe fshatet që e përbajnë, nuk do të jenë ma larg se tri orë njeri me tjetrin.

Art. 4. Si të vendosen në këtë mënyrë ndamjet administratore të prefekturavet, nënprefekturavet dhe krahinavet, vetëm me nji kanun të ri do të mund të ndrrohen kufinjtë e tyne.

**Administrata e Prefekturës**

Art. 5. Prefekti asht në prefekturë ma i madhi nëpunës i pushtetit përmaronjës dhe ka të drejtë të rjeshtojë dhe të shpallë urdhënime administratore, të cilat do të sigurojnë përparimin e komuneve.

Art. 6. Prefekti asht përgjegjësh'ëm për përparimin e detyrave që i janë ngarkue, kundrejt Ministrisë së Punëve të Brendëshme e cila asht kryesia natyrore për kanunet e shtetit dhe për punët administrative, për punët e tjera asht i përgjegjëshëm kundrejtë qarqeve kompetente të Qeverisë Qendrore.

Art. 7. Kur s'ndodhet prefekti, administratën e prefekturës ja lë këshillonjësit të vet.

Art. 8. Prefekti duke qenë kryetar i pushtetit përmaronjës, *) vëzhgon dhe përkujdeset për të vumë në përmarim gjithë kanunet, urdhënimet dhe rregullimet që i përkasin administratës, emnon nëpunësit që ka të drejtë të emnojë, por nuk mund të krijojë një nëpunësi të re, e cila s'mbështetet më ndonjë kanun. Gjithë nëpunësit e prefekturës dhe ca ma tepër gjindarmëria dhe policia, janë në urdhënin dhe vëzhgimin e prefektit.

Art. 9. Prefekti shton zgjedhësit e antarëve të këshillit të përgjith-

*) Ekzekutiv.

shëm të këshillave administrative të nënprefekturave, të krahinave dhe të katundarive dhe i ve të bajnë zgjedhjet; çel mbledhjen e këshillës të përgjithshme. Mbasi të marrë fund shikimi i çështjeve që përmbledh urdhënin e ditës, vendos mbylljen e mbledhjes në kohën e shënueme.

Art. 10. Prefekti i parashtron këshillës së përgjithshme bugjetin e të ardhunave dhe të prishunave të prefekturës dhe veprimin financiar të vitit të shkuem, përmaron ato vendime që dha këshilli i përgjithshëm dhe që janë të kompetencës së tij, vendimet e tjera të këshillit të përgjithshëm, që kanë nevojë për urdhër dhe vërtetim nga ana e administratës qendrore, ja parashtron qarqeve që përkasin.

Art. 11. Prefekti përmaron urdhënat që do të epen nga cilado ministri për renget që i përkasin qarkut të saj, kqyr dhe kritikon veprimin e kryetarëve të nëpunësve të qendrës së prefekturës dhe të nënprefektave të nënprefekturave dhe me mjetet e këtyne këqyr sjelljen e nëpunsave të gjithë degëve të administratës.

Në qoftë se ndodhen nëpunës, të cilët me gabimet e tyne që bajnë mund të shkaktojnë trubullim në administratën e atjeshme dhe dam për vendin, ahere, në janë prej atyne nëpunsave që ka të drejtë prefekti t'i pushojë dhe t'i emënojë, i shterngon të heqin dorë drejt për drejt; për ata, që pushohen dhe emënohen nga administrata qendrore, drejtohet në qarqet që u përkasin këta nëpunës. Në qoftë se shkaku i pushimit asht nji delikt, a nji krim shëmtim, fajtorët i shtie në gjyq.

Art. 12. Prefekti asht i detyruem të vozitë dhe të kqyrë vendet që përmbledh prefektura e tij, të paktën dy a tri herë në mot.

Art. 13. Prefekti meqë asht përgjegjshëm bashkë me drejtorin e financave për renget financiare dhe për veprimin e llogarive, ban të këqyret, gjithmonë, mënyra e të mbledhunit të gjithë ngarkesave dhe të ardhunave të prefekturës, si dhe sjelljen dhe veprimin e mbledhësve.

Art. 14. Prefekti meqë asht i detyruem të vejë në veprim me mjeten e drejtorit të arsimit, urdhënimet e arësimit publik, do të mbarojë mënyrat që sigurojnë shpalljen dhe përhapjen e arësimit, do të mirësojë shkollat që ndodhen, dhe do të themelojë përsërisht shkolla.

Art. 15. Meqë detyra e parë e prefektit asht të përmbajtunit e qetësisë dhe të sigurisë publike, në qoftë se do të çfaqet në qarkun e prefekturës ndonjë lëvizje e shëmtueme, e madhe a e vogël, dhe siguria si dhe të drejtat e popullit do të shkelen, prefekti tue lajmërue sakaq kryesinë e tij nga dolli, ç'formë dhe ç'rëndësi ka lëvizja dhe tue marrë përsipër përgjegjësinë, pa humbun nji minutë, asht i lejuem të marrë masat e nevojshme dhe mbas punës të përdorë akoma dhe të prishunat e jashtëzakonshme që s'janë mbrënda në buxhet; po doemos, asht i detyruem t'i parashtrojë ministrisë së financavet, shkakun e nevojshëm e të prishunave.

Art. 16. Prefekti asndonjëherë nuk do të mund të përzjehet në punët e drejtësisë dhe të përdorë influencën e tij mbi gjyqet që po vështrohen në gjykatoret; po në qoftë se tjaton ndonjë paudhësi në sjelljen dhe në veprimin e gjykatësve, ose kupton pavleftësinë a keqpërdorjet e nëpunësve të drejtësisë, ahere me anën e drejtorit të drejtësisë a të inspektorit ose drejt për drejt lajmëron ministrin e drejtësisë.

Art. 17. Prefekti do të ndihmojë dhe do të përkrahë prokurorin kur t'i kërkojë ndihmë për të përmarue urdhënimet e gjyqësave *) të gjykatorive. **)

*) gjyqtarve.
**) gjykatave.

Art. 18. Veç këtyne detyrave të përgjithshme, që u treguan në artikujt e sipërm, prefekti ka dhe detyra të veçanta që pasojnë ma poshtë:

Do të urdhënojë të bahet projekti i kqyrjes, defteri i ngarkimeve dhe bugjeti i gjithë godinave, ndërtimeve, udhëve dhe ujnave.

Do të caktojë si mund të bahen dhe të mbarohen shosetë *) dhe urat me pages, sikundër dhe kohën e mbarimit dhe të preligjies së tyne

Do të caktojë të hollat që do mjaftojnë për të ble veglat gjeometrike dhe sendet e tjera që duhen për të ba shosetë.

Do të japë leje për të krijue tregje dhe panaire dhe do të sigurojë qetësinë e këtyre, si dhe të limaneve, të skelave dhe të vendeve të tjera ku bahen mbledhje të përgjithshme.

Do t'i japë nji tjetri me të shitun e me të këmbyem dhenat dhe trollet që teprojnë, pasi të caktohet vendi për të shkue udhët e përgjithshme a të veçanta të prefekturës. Do të japë me qira, atyne që kërkojnë për t'u përdorun hë-për-hë, godinat e shtetit, që gjenden të ngeshme në qarkun e prefekturës.

Do të nxjerrë ujë me makinë nga lumenjtë e anieshëm **), dhe do të ngrejë godina hë për hë, në buzët e tyne, sa për lumenjtë e mosanieshëm dhe do të godisë mullinj fabrika dhe shtrate, do të punojë tulumba, do të hapë jaze mullini dhe do të japë leje për të ba gjithë këto; do mirësojë lumenjtë e mosanieshëm.

Do të bahet shkak për të formue sindikata prej zotënve të tokave të lidhun njeni me tjetrin, të cilët pranojnë që të marrin përsipër të prishunat e ndërtesave që themelohen për të largue damin që vjen nga lumenjtë, përrenjtë dhe jazet***), afër të cilëve kanë tokat e tyne.

Për këto gjana prefekti do të marrë doemos mendimin e drejtorit kompetent dhe do të përdorë ndërmjetësinë e tij.

## Administrata Qendrore e Prefekturave

20/3 Vjeshta e III. 1913

Kryetarët e nëpunësve dhe këshilli administrator.

Art. 19. Administrata e punëve të prefekturës asht e lanë në dorë të kryenëpunësve që pasojnë ma poshtë.

1. Këshillonjësit
2. Drejtori i Financave
3. Drejtori Drejtësisë
4. Drejtori i Arsimit
5. Drejtori i Bujqësisë-Tregëtisë-Punëve Publike
6. Kryesekretari i Prefekturës.
7. Komandar'i Gjindarmarisë.

Art. 20. Këshilli administrativ i prefekturës formohet prej prefektit, këshillonjësit, drejtorëve të financave, të drejtësisë, së arësimit dhe të bujqësisë, tregëtisë, punëve publike dhe prej katër vetash të zgjedhun nga antarët e këshillit të përgjithshëm. Në sgjëndje të prefektit kryesinë e përdor këshillonjësi.

Art. 21. Këshilli administrorë i prefekturës, s'mund të përzjehet as më ndonji farë mënyre në punët e pushtetit drejtësuer dhe ekzekutuer.

Prefekti, çështjet, që ka të drejtë t'i shqyrtojë këshilla administrore

---

*) Rrugët.

**) Lundrueshëm.

***) Vija uji.

dhe që përkasin administratën e vendit, ja drejton kësaj këshille, ekzekuton vendimet e saj. Një vendim a nji urdhënim të rregullt, që s'ekzekutohet prej vetiu dhe i përket interesave të ndryshme, si dhe veprimet dhe masat administratore që kanë nevojë për nji vendim të veçant, para se të vihen në përmarim, i ve në mendimin e këshillës administratore. Vendimet që kanë fuqi për gjithnji, ose asht nevoja të kenë fuqi për nji kohë të gjatë, para se të vihen në ekzekutim do të kqyren prej këshillës administratore.

Këshilla administratore mund të ndryshojë dhe të ndreqë masat që propozon prefekti dhe ky sakaq i ve në përmarim vendimet e ndryshueme ose kërkon leje prej administratës qendrore. Në qoftë se prefekti ngul kambë për të ekzekutue masat që proponoj kundra mendimit të këshillës administratore, para se t'i zbatojë, asht i shtrënguem të marrë urdhën dhe leje prej administratës qendrore.

**Detyrat e Këshillit**

Art. 22. Këshilli ndihmon prefektin në të gjitha punët e prefekturës dhe shikon ato punë që i janë dhanë si u veçuen nga të tjerat; shikon dhe sheshon punët e nënprefekturës që asht qendër e prefekturës, si dhe çdo punë që kanë të drejtë të bajnë nënprefektët e nënprefekturave. Këshilluesi, tue qenë kryesi i drejtuesit si dhe të gjithë nëpunësvet të shtetit civil, vëzhgon për të rrjedhun mirë punët e shënimet të gjindjes.

**Detyrat e Drejtorit të Financave**

Art. 23. Detyrat e drejtorit të financave janë këto që pasojnë:

a) Të vëzhgojë ndamjen dhe pjesëtimin e ngarkesave publike.

b) Të bajë të mblidhen në kohën e duhun të ardhunat publike, gjobat dhe të ardhunat e tjera të ndryshme.

c) Të vëzhgojë monopolet që krijon qeveria kombëtare;

d) Të bajë të ruhen mirë kamja e patundun, arat, pyjet dhe pronjet e tjera të shtetit; të bajë të shënohen mirë të prishunat e kanunia që përkasin prefekturës: të kontrollojë llogaritë e përgjithëshme të prefekturës: të rregullojë dhe të paraqitë bugjetin e prefekturës.

dh) Të tregojë mendimin e tij përmi rregullimet dhe urdhënat që përkasin dhaniet dhe ngarkesat si dhe punët financiare, të proponojë ndryshimet që i sheh të arësyeshme.

e) Drejtori i financave e përdor tanë kohën tue u përkujdesun për të zbatue mirë e bukur kanunet financiare; në qoftë se ndonji nga nëpunsit e financave mungon në ekzekutimin e detyrës së vet, lajmëron për këtë gja prefektin dhe i parashtron ministrisë së financave veprimin që ban për këtë punë.

Art. 24. Nëpunsit e financës së qendrës së prefekturës janë këta:

1. Drejtori i Financave
2. Ndihmësi i drejtorit, i cili ka detyrë të kontrollojë llogaritë e zyrës.
3. Shkronjësit e zyrës së llogarive

Art. 25. Drejtori i financave, si do që ndodhet në shoqërien e prefektit, meqë asht kryesi natyror për gjithë çështjet e financave dhe të llogarive, asht i përgjegjshëm drejt për drejt kundrejt ministrisë së financave.

### Detyrat e Drejtorit të Drejtësisë

Art. 26. Detyrat e drejtorit të drejtësisë janë këto:

a) Të qeverisë burgjet dhe ndaloret *) dhe të mirësojë shtatin shëndetuer dhe të bretnie të tyne, si të pregatitë rregulloret e duhuna për qeverimin e tyne, t'i parashtrojë në shqyrtimin e këshillës së përgjithëshme.

b) Të botojë në gazetën e vendit dhe me mjete të tjera kanunet dhe rregullimet që përkasin drejtësisë.

c) Të shqyrtojë dhe të rjeshtojë muej për muej listën e pagesave që mbledhin gjykatoret nga gjyqet dhe nga të tjera gjyqësore.

d) Të bajë të ekzekutohen, me drejtësi pendesat e gjykueme.

dh) Të shqyrtojë kërkesat që do të jepen për të lehtësue pendesë dhe, simbas nevojës, të shkruejë raportet e duhuna për t'ja dërgue Ministrisë së Drejtësisë dhe t'ja bajë të njojtuna Ministrisë së Drejtësisë dhe t'ja bajë të njohtuna shkurtazi prefektit.

e) Të ketë nën vëzhgim sjelljen dhe veprimin e nëpunësve dhe të shërbëtorëve të tjerë të drejtësisë dhe të kërkojë rushimin e atyne që mungojnë në përmarimin e detyrës së vet, si dhe të atyne nëpunsave të drejtësisë që s'ekzekutojnë urdhënat që epen nas kanunit.

ë) Të bajë që të rjeshtohen në kohën e duhun statistikat e gjykatoreve.

f) Të parashtrojë mendimet e veta mbi mirësimin e gjykatoreve, burgjeve, procedurave civile, penale dhe tregëtore.

Art. 27. Drejtori i Drejtorisë do këqyrë gjykatorit e rregullta dhe ato të paqes, dhe shtetit ngandonjëherë qarkun dhe krahinat e prefekturës.

### Detyrat e Drejtorit të Bujqësisë-Tregtisë-Punëve Publike

Art. 28. Detyrat e drejtorit të bujqësisë, tregëtisë, punëve publike janë këto:

a) Të shtyjë dhe të kurarojë bujqësinë, tregëtinë dhe industrinë, të vëzhgojë plotësisht degat e burimeve të pasunisë që shtojnë interesat e përgjithëshme.

b) Të bajë të goditen dhe të ruhen mirë udhët dhe urat.

c) Të kontrollojë të goditunat e udhëve të hekurta dhe të trameve që shërbejnë interesat e vendit, si dhe punimin dhe ruejtjen e mirë të tyne.

d) Të vëzhgojë ekzekutimin e mirë të godinave të detit, si ura, molo dhe çentrale dhe rregullën e ruejtjen e tyne.

dh) Të ndreqë rrjedhjen e lumenjve dhe të bajë të goditen shtrate dhe ndërtime të tjera për të ndaluemit e të vershumit të ujnave, të bajë të hapen kanale për të punue anije dhe të ruhen mirë.

e) Të kontrollojë punët që bahen për të tha dhe kullue tokat e lagëta prej nji sindikate, shoqnie a prej nji njeriu të vet, të krahinës që dëshiron t'i thajë.

ë) Të godisë, të ruej dhe të ndreqë godinat publike që gjenden në prefekturë.

f) Të bajë të rrjedhin mirë punët e pyjeve publike dhe vehtiak dhe si domos të shikojë mos prishen pyjet.

g) Të bajë të punohen metalet dhe të ruhen konditat e sipërmarrjes.

---

*) Burgje ku vihen të paraburgosurit.

gj) Të vejë nën rregull të shëndoshë të gjuejtunit dhe të peshkuamit.

h) Të rjeshtojë dhe të parashtrojë raportet, kanunet dhe urdhënimet e sendeve të sipërme.

## Detyrat e Drejtorit të Arsimit

Art. 29. Detyrat e drejtorit të arsimit janë këto:

a) Të ndërtojë shkollat që themelohen dhe qeverisen prej prefekturës e të këqyrë shkollat që themelohen prej krahinave, komuniteteve e prej njerëzve të veçantë.

b) Të vëjë në provim mësuesit e shkollave fillore e të shkruajë e të japë dipllomat, që tregojnë shkallën e vleftës së mësuesve që u provuen.

c) Të kërkojë dhe të bajë që të pranohet sistemi ma i mbaruem i mësimit në shkollat që themelohen prej qeverisë, të shtyjë dhe të inkurajojë artet të bukura; të përhapë dhe të përgjithësojë arësimin, dhe të mbështesë e të ndihmojë mësuesit që janë pleq e të pamundun e që nuk ushqejnë dot vehten, të tregojë mendimin e tij mbi ligjet e urdhënimet që i përkasin arsimit.

Art. 30. Drejtori i arsimit asht kryetari i këshillit të arsimit të prefekturës. Ve në ekzekutim urdhënat e vendimet që sigurojnë rrjedhjen e mirë të punëvet t'arsimit, si dhe urdhënime që jepen prej ministrisë së arsimit mbi këto sende.

Do të përpiqet edhe të themelojë përsërisht shkolla në vendet ku s'ka.

Art. 31. Mbasi të ardhunat e vakufeve, të cilëvet u ka humbë qëllimi mirëbamës, do t'i mbeten arsimit botuer, këto të ardhuna do të përdoren për shkollat e përgjithshme të krahinës dhe të komunitetit ku gjendet vakufi, dhe do të qeverisen prej këshillit të komunitetit nën vëzhgimin e drejtorit të arsimit.

Kur nuk asht shkoqitun mirë qëllimi i mirëbamësisë, nji e treta e gjasë, që asht lanë për ta, do t'i jepet arsimit të prefekturës.

## Detyrat e Kryesekretarit të Prefekturës

Art. 32. Detyra e parë e kryesekretarit të prefekturës asht qeverimi i punëve që i përkasin letërkëmbimeve të prefekturës, rregullimi i regjistravet, si edhe ruajtja e tyne. Për të krye këto dy detyra do të ketë për anë tij nji zyrë të letër-këmbimit dhe nji drejtor të shkresave.

Art. 33. Sado që do të ketë nji sekretar në këshillin administratuer të prefekturës, me gjithë këtë, punët e proces-verbalevet, të bisedimevet, të komunikimeve, mbas udhës dhe në kohën e duhun të vendimevet që jipen, do të jenë nën vëzhgimin dhe përgjegjësinë e kryesekretarit të prefekturës.

## Këshilli i Përgjithshëm i Prefekturës

Mënyra e trajtimit dhe detyrat e këshillit të përgjithshëm të prefekturës.

Art. 34. Misat që do të përmbajnë këshillin e përgjithshëm të prefekturës janë këta:

1. Miset natyrorë
2. Miset e zgjedhun prej popullit.
3. Miset që do të emnohen prej prefektit.

Duria*) e Këshillit të Përgjithshëm asht katër vjetësh.

Art. 35. Miset natyrore janë këshillari, drejtori e financavet e drejtesisë e arsimit dhe drejtori i bujqesisë, tregtisë e punëvet publike dhe kryesekretari i prefekturës.

Art. 36. Ata që do të zgjidhen për misi të këshillit të përgjithshëm të prefekturës, duhet të jenë domosdo banorë të saj prefekture.

Cilado nënprefekture, nga ato që përbajnë prefekturën, formon nji zgjedhëtar dhe miset e këshillavet të krahinavet do të zgjedhin me vota të çiaquna tre e gjer më gjashtë mise pas viettës që ka nënprefektura. Ata që do të zgjidhen në vendin e atyne që heqin dorë ja vdesin në durien e caktueme, do të jenë mise vetëm për kohën që mbetet.

Art. 37. Të caktuemit e rrogavet, që do t'u jipen miseve të zgjedhun për sa kohë që mban këshilli si dhe shpenzimet të udhëtimit, do të bahet prej prefektit bashkë me këshillin e përgjithshëm dhe do të jepen nga pagesat e veçueme dhe të preme të bugjetit të prefekturës.

Art. 38. Prefekti emnon nga pronarët e mëdhenj, nga industrianët dhe nga të diturit nji numur mise sa e katërta e miseve të zgjedhun, edhe miset e emnuem prej prefektit janë për katër vjet.

Art. 39. Këshilli i Përgjithshëm mblidhet mot për mot në qendrën e prefekturës në krye të vjeshtës së parë dhe duria e mbledhjes asht dyzet ditësh. Në të mbaruemit e durisë së mbledhjes, ose edhe ma përpara, mbasi të ketë ndigjue mendimin e zyrës së sekretarisë, kryetari lajmon këshillit dhe prefektit se muerën fund çështjet që përmbidhen te urdhëni i ditës dhe prefekti komunikon që iu dha fund mbledhjes së Këshillit.

Në qoftë se bisedimet e çështjeve të vlefta s'mbarohen në dyzet ditë, prefekti mund ta zgjasë vazhdimin e mbledhjes për një kohë që s'kapërcen gjysmën e dyzet ditëve dhe lajmon administratën qëndrore për këtë gja.

Art. 40. Prefekti s'mund të përndajë këshillin e përgjithshëm pa marrë vendimin e këshillit administratuer dhe në qoftë se sheh se asht domosdo nevojë që të përndahet këshilli i përgjithshëm, atëhere asht i detyruem të kërkojë leje te administrata qendrore si të nxjerre përndarjen e këshillit, duhet të botojë me zadhanie që këshilli tjetër do të mblidhet në dy muaj e sipër.

Art. 41. Në cilëndo periudhë të mbledhjes, këshilla e përgjithshme zgjedh dy njerës, njanin prej këtyre prefekti e emnon kryetar të këshillit. Si të zgjidhet kryetari, këshilli zgjedh dy nënkryetarë e dy shkronjës. Para se të zgjidhet kryetari, kryesinë e këshillit e mban misi ma i motshëm.

Art. 42. Mbledhja e këshillit të përgjithshëm s'ka vleftë kur s'marrin pjesë më shumë se gjysma e miseve që e përbajnë. Vendimet jepen me shumicë absolute, po në qoftë se zanat vijnë baras, atëhere rrëzohet çështja që asht në bisedim.

Në punë të zgjedhjes po që nuk u fitue, zgjedhja do të përsëritet gjer sa të fitohet shumica absolute.

Çdo anëtar do ta apë votën me dorën e tij.

Art. 43. Çashtjet që i përkasin këshillit të përgjithshëm janë këto:

a) Të bajë të rrjedhin pas sistemit që cakton kjo ligjë veprimet e administratës civile, drejtësore dhe financiare të prefekturës.

---

*) Koha gjatë së cilës qëndron në fuqi.

b) Të rjeshtojë rregullimet që do të mirësojnë mënyrën e pjestimit e të mbledhjes së të dhjetave të pagave të tjera.

c) Të mirësojë regjistrimin e ndërtesave që jipen me qira e të pronjave të tjera si edhe çmimin e tyne që u pritë pas mendjes.

d) Të shqyrtojë dhe të vërtetojë bugjetin dhe bilancin e vitit të prefekturës.

dh) Të mirësojë e të sigurojë zbatimin e rregullimeve e të ligjeve mbi arsim, pagesat e të hymeve në qytet (duhulie), mbi mina, ujna e pyje.

e) Të pregatitë mjetet që do t'i japin përparim bujqësisë, tregëtisë, industrisë dhe përgjithësisht të gjitha ndereshave ekonomike.

ë) Të bajë rregullimet që përkasin udhët, tramet, hekurudhat të vendit, dhe përgjithësisht punët botore të prefekturës.

f) të bajë të themelohen dhe të mirësohen hospidalet, vorfnoret e shtëpiat e qortimit.

Këshilli i përgjithshëm, tue shqyrtue çështjet që u treguen ma sipër, ekzekuton vendimet ose, në qoftë se e sheh me nevojë që të marrë leje, ja parashtron administratës qendrore.

Art. 44. Këshilli i përgjithshëm kurrëndonjëherë dhe as me ndonji shkak s'do të mund të ketë të drejtë të bisedojë përmbi veprimin politik të shtetit dhe përmbi çështjet latare të kombit.

Në fillimin e mbledhjevet të këshillit të përgjithshëm, prefekti kërkon të parashtrohet, të shqyrtohet dhe të vërtetohet bugjeti i prefekturës, që e ka rjeshtue bashkë me drejtorinë e financavet.

Në të sosunit të këshillit të përgjithshëm, kryetari i jep prefektit bugjetin e vertetuem dhe prefekti së bashku me drejtorin e financavet, ja çon Ministrisë së Financavet.

Art. 45. Këshilli i përgjithshëm ka të drejtë të shtojë 1-5% (një gjer pesë për qind) mbi pagat botore, për fitim të punëve botërore dhe të arsimit të vendit.

Art. 46. Këshilli i përgjithshëm në qoftë se merr vesh që ngjasin punë jashtë udhëzimeve të ligjeve dhe rregullimeve, në cilindo vend të prefekturës, dhe në shikoftë se kallzimi që i bani prefektit s'u mue në sy, ahere ka të drejtë të lajmërojë administratën qëndrore dhe të tregojë nëpunësin fajtor.

### Administrata e nënprefekturavet dhe detyrat e nënprefektavet

Art. 47. Nënprefekti asht i detyruem të ekzekutojë urdhënat që përkasin administratën e prefekturës dhe urdhënimet (talimat) që përkasin masat që merr prefekti për me shërbye interesat botore.

Meqë mbajtja e qetësisë së nënprefekturës i përket nënprefektit, ky mund të marrë masat e duhuna për të sigurue qetësinë botore (Emniet-i — mumumie), në ndodhtë ndonji ngjarje e jashtëzakonëshme, mbledh, dërgon në atë vend tanë fuqinë e gjindarmërisë së nënprefekturës dhe në e shikoftë me nevojë, lajmëron prefektin dhe sillet pas urdhënit që të marrë.

Art. 48. Renget *) financiare (umur-i-malie) të nënprefekturës, domethanë, të mbledhunit e të dhanavet të pagesavet të tjera si dhe shëndruemit e të prishunavet të vendit, tue qenë nën vëzhgimin e nënprefektit, janë në dorën e drejtorit të financavet të nënprefekturës, dhe për

*) Veprimet financiare.

rengel financiare asht përgjegjëshëm nënprefekti bashkë me drejtorin e financavet.

Art. 49. Në nënprefekturë, veç drejtorit të financavet gjenden: nji nëpunës mbledhës i pagesavet (tahsilet memuru), nji nëpunës i të dhanavet (virgju memuru), nji arkëtar, nji sekretar (tahriret memuru) dhe nji nëpunës i shtetit civil (nufus memuru).

Art. 50. Nënprefekti, sido që ka të drejtë te vëzhgojë gjithë punët e nënprefekturës, s'ka të drejtë të përzjehet në gjyqet që shikohen në gjykatoriet dhe të përdorë influencën e tij për këtë qëllim. Vetëm mund të lajmërojë prefektin për nji paudhësi që bahet prej gjykatorevet dhe për paviefteisinë e nëpunësave të drejtësisë.

Art. 51. Nënprefekti asht i detyruem dhe për sendet që pasojnë më poshtë:

a) Të apë pashaporta dhe leje për gja dhe për armë.

b) Të vërtetojë nëshkrimin e shkresavet, që epen prej primarëve të krahina (nahie mydyr) *) ose prej nëpunësavet të policisë, të cilat shkresa do të përdoren jashtë nënprefekturës.

c) Të shqyrtojë dhe të vërtetojë tarifat e pagavet që epen për kile e kandar si dhe pagat që do të merren nga vendet të shënueme për tregje dhe për panairet e tjera që gjenden brenda në nënprefekturë.

d) Të organizojë gjuhajtje (syrgjyn avlari) për të çfarrosë shtazët e bubrecat (hasherat) të damshme dhe të bajë të merren masat e duhuna për t'i vra.

dh) Të bajë të themelohen arka për të ndihmue dhe për të ushqye të vobegët dhe të shqyrtojë llogaritë e tyne.

**Këshilli administruer i nënprefekturës**

Art. 52. Në qendrën e secilës nënprefekturë do të jetë nji këshill administrativ nën kryesinë e nënprefektit. Në këtë do të jenë drejtori i financavet, sekretari dhe tre mise (aza) te zgjedhur prej këshillavet të krahinavet.

Art. 53. Detyrat e këshillit administruer janë: Të apë me ankad (shtime, muzajede) të dhjetat pas urdhënavet që do të epen nga prefektura, apo t'i administrojë me anën e nëpunësvet (emaneten), të sigurojë rregullin e ankantit të pyjevet të shtetit; të ndërtojë e të ndreqë ndërtesat e shtetit; të shqyrtojë dhe ratifikojë (tazdik) të ardhunat dhe të prishunat e nëprefekturës dhe të bajë që të ruhen dhe të administrohen kamjet e tundme dhe të patundme që i përkasin thesarit botuer; të derisen (tevzi) e të ndahen pagesat ndër krahinat dhe qarqet të shënueme për atë nënprefekturë: këto pagesa do të vihen me ligjë (kanun) të veçanta prej prefekturës. Veç këtyne ky këshill ka për detyrë të vejë në udhë mjetet që do të lehtësojnë (teshil) punët e tregëtisë dhe do t'i apin përparim bujqësisë, sikundër dhe të bajë që të përgjithësohen dhe të shumësohen themelimet (teesisat) të arsimit, të punëvet botore e të shëndetësisë.

Këshilli administruer ka të drejtë të shqyrtojë e të ndryshojë vendimet e këshillavet të krahinavet dhe, përgjithësisht, të tregojë me të shkrueme vendimet e saj tue shqyrtue punët që i ngarkohen nga ana e nënprefektit dhe që i përkasin administratës së vendit.

---

*) Kryetar komune.

## Këshillat e Komunikacioneve

(Xhemaat—mexhisleri)

Art. 54. Në nënprefekturat që janë qendrat e prefekturave si dhe në qendrat e nënprefekturave të tjera do të gjendet nji këshillë i veçantë për komunitetet (xhemaat) e secilës fe dhe shërbëtyre (din ve mezhep). Ky këshill do të ketë gjashtë gjer më dhjetë mise (aza), prej të cilëvet do të zgjidhet me shumicë nji kryetar dhe nji sekretar. Mytevelinijtë e vakufevet e gjinija e tyne në brezin e parë dhe të dytë do mos munden të zgjidhen mise të këtij këshilli.

Këshillat do të njohin si kryesi (merxhi) për punët që u janë besue, qeverinë e vendit dhe këshillin e përgjithshëm të prefekturës; sa për punët e arsimit dhe për rrjedhimet e tyne (teferuat) do të njohin këshillin e arsimit.

Art. 55. Detyrat e këshillavet të komuniteteve janë këto: Të përkujdeset që të ardhunat e vakufeve të prishen atje ku ka urdhnue themeluesi me kondita dhe pas zakonit, edhe gjithashtu uzura e të hollave që janë lanë me dhiatë (testament) për qëllim mirëbamësie. Te bajë që të ruhen dhe të qeverisen mirë teshat dhe pronat e të vorfënve (jetim); të bajë të mbahen mirë bukur faltoret (meraxhid), kishat, teqet, manastiret, medresetë, shkollat fetare dhe varret; të vëzhgojë veprimin e pleqësivet që i përkasin komunitetit; të shqyrtojë llogaritë e gjithë vakufevet, të bajë që të prishen, vetëm e vetëm për shkolla të ardhunat e vakufevet, të cilave u asht humbun qëllimi i mirëbamësisë.

Art. 56. Kryetari dhe sekretari i këshillit të komunitetit, tue qenë në mes të tyne të lidhun me njani tjetrin dhe përgjegjëshëm pronësisht (mesul bil i mall) për të ardhurat dhe të prishunat, qeverimi i të cilave ju asht ngarkue, janë të detyruem të ekzekutojnë rregullën e dorëzimit dhe të kthimit (devruteslim) i vjetri të riut, të deftesave të xhavet të (mevxhud) që gjendet.

## Administrata e krahinave

Art. 57. Në cilëndo krahinë do të jetë nji primar *) dhe nji ndihmës i tij, të cilët janë të detyruem të qeverisin krahinën. Primari asht i ngarkuem t'i bajë të njojtun nënprefektit lutjet dhe qamjet e popullit të krahinës; dhe në qoftë nevojë ja ban të njojtun prefektit të prefekturës ku gjendet krahina.

Primari dhe ndihmësi zgjidhen dhe emnohen nga mezi i këshillës së krahinës mot për mot prej nënprefektit dhe nëpunësitë e tyne ratifikohen (tazdik) prej prefektit. Primari dhe ndihmësi mund të zgjidhen dhe të emnohen përsërisht në të soeunit e kohës së nëpunësivet të tyne. Rroga e primarit caktohet dhe veçohet prej këshillit të përgjithshëm të prefekturës, kur shtrohet bugjeti i përgjithshëm i prefekturës.

Art. 58. Myltezimet **) e të dhjetave dhe të ardhunave të tjera, ndërmarrësit e ndërtesavet, oficerët e ushtrisë që gjenden brenda në kuadro ose jashtë kuadrove dhe nëpunësit që janë të detyruem të shër-

---

*) Kryetar.

**) Sipërmarrësit.

bejnë në qarkun e krahinës, s'mund të jenë as primarë, as ndihmës, as mise (aza) të këshillit të krahinës dhe gjithashtu priftërinjtë, imamet dhe ata që kanë një cilësi fetare të këtillë.

Art. 59. Në qoftë se krahinari e ndihmësi bajnë kobe (xhyrm*) pa heq pas ndëshkim të ndryshëm nga ndëshkimi i të hollave (xheza-i-nakdi)**) dhe në qoftë se në egzekutimin e detyrës bajnë nji gabim e tregojnë nji të metë të randë, nënprefekti tue ba gjyrmimet që duhen (tahkikat)***) i parashtron prefektit përfundjen e gjyrmimeve dhe prefekti i pushon primarët dhe ndihmësit që pushohen nga shkaku i keqbamësisë s'mund t'u kthehet prapë nëpunësia pa mos mbushun dy vjet, dhe atyne që pushohen për shkak faj s'mund t'u kthehet kurrë.

Art. 60. Detyra e primarit të krahinës asht të botojë ligjët (kanunët), rregulloret, urdhënimet dhe porositë e qeverisë; t'i parashtrojë nënprefektit qamjet e popullit kundra nëpunësave, tue vërtetue shkaqet e tyne; të ekzekutojë gjurmimet e parë dhe të lajmërojë nënprefekturën për ngjarjet e kobat dhe të regjistrojë gjendjen e krahinës.

Art. 61. Mbledhësit e të hollave (tahsildar) janë të detyruem të veprojnë nën urdhënin dhe kontrollin e primarit; për të mbledhunit e të ardhunave të shtetit dhe t'i tregojnë defteret.

Art. 62. Në qoftë se primari e ndihmësi a ndonjë nga miset (aza) e këshillit të krahinës pushohet ose vdes, më parë se të mbarohet koha, zgjedhësit e krahinës, tue u mbledhë jashtëzakonit, zgjedhin nji tjetër për kohën e mbetun.

**Këshilli i Krahinës**

Art. 63. Cilado krahinë do të ketë një këshillë të përbamë prej 6 gjer në 12 mise (azanj), simbas vleftës që ka. Anëtarët zgjidhen, pas mënyrës që do të tregohet në kren e zgjedhjeve, për dy vjet.

Art. 64. Detyra e këshillit të krahinës asht të ndajë dhe të caktojë pagesat që urdhnon ligja, të mbarojë mjetet botore (vesait—i—naklie) të fshatrave që gjenden brenda në krahinë, si dhe mjetet shëndetësore; të godisë udhët e veçanta dhe urat, që lidhin njerin fshat me tjetrin dhe të ruajë mirë ndërtesat, kronet, puset, sternat dhe vijat e ujnave të qenura si dhe gjithë ato gjana që kënaqin nevojat e përgjithshme, të mirësojë veglat e bujqësisë, bagëtitë shtëpiake dhe farën e prishun; të ndërtojë dhe të sigurojë godina, si vendi i të rrjedhunit të pronjve dhe të lumenjve, si shtrate dhe molo; të qeverisë mirë koriet, livadhet dhe kullotat e veçanta të fshatrave; të emnojë nëpunësit e policisë, që janë të detyruem të ruajnë rregullën e krahinës dhe të veçojë (tahsis) detyrat e tyne; të shkruejë gjindjen e fshatrave pas sistemit që do të tregojë qeveria dhe të ruajë e të ndreqë shkollat dhe faltoret.

Art. 65. Këshilli i krahinës, së bashku me primarin dhe me ndihmësin, do të përpiqet që të ekzekutohen detyra e mbledhësve për të mbledhun të hollat dhe gjithnji do përkujdeset që të mos mbeten për të mbledhë nga pagesat botore. Do të përpiqet të nxjerrë në shesh vepruesit (fail) e kusarisë, e të udhëprejmies (kuttai tariklëk) dhe të çfarëdo kobe që u shëmëllen këtyne dhe që do të bahet, qoftë e ma-

*) Faj, delikt.
**) Gjobë në të holla.
***) Hetime

dhe dhe tue e lajmërue qendrën e nënprefekturës dhe me të afërmi.. komisar të policisë dhe komandimin e gjindarmërisë, të sigurojë qetësinë e krahinës.

Këshilli i krahinës do të lajmërojë qeverinë, me anën e primarit, në qoftë se ngjet ndonji keqpërdorje (su-i-stimal) e nji potrese kundra popullit nga an e nëpunësvet të policisë, grishësve (mubashir) të gjykatorevet, myltezimeve dhe nëpunësvet të së dhjetave dhe të pagavet (rusum) të tjera.

Art. 66. Në qoftë se këshilli i krahinës e përdor keq detyrën e tij dhe asht nevojë për këtë punë të shpërndahet, nënprefekti, tue pyetun prefektin, e shpërndan këshillin me urdhënin që të marrë nga prefekti dhe fillon zgjedhjet dhe formimin e këshillit tjetër, pas rregullimit të veçantë.

Art. 67. Në çdo vjet primari tue rrieshtue (tenzin) bugjetin e të ardhunave dhe të prishunave të krahinës, e vë që ta shqyrtojë këshilli dhe, si të vërtetohet, ja çon nënprefektit.

Krahina ka nevojë, me doemos, për këto të prishuna: të prishuna për primarinë, për të shkruemit (kertasie) dhe të shtypunit e sendevet që i duhen administratës së krahinës ose vendit, për pajtimet të gazetavet dhe të përkohëshmevet, të cilat përmbledhin vendimet dhe ligjet (kanunet) e administratës, për të regjistrue gjindjen, për rrogën e ruejtësvet të fshatravet dhe të nëpunësvet të vendit; për të ruejtë ose për të pague qiranë të spitalevet dhe të ndërtesavet mirëbase që iu përngjajnë këtyne si dhe të ndërtesavet botore.

## Zgjedhjet:

### Lista e zgjedhësvet

Art. 68. Cilido, ndenjës i nji fshati ose i një çifligu, që ka mbushë 21 vjeç, që ka të gjitha të drejtat civile dhe politike, që s'asht dënue me ndëshkim (muxhazat) as për ndonji krim (xhenajet), që paguen të dhetën e ndonji tjetër dhanie, ose asht zot i nji prone a ndërtese, ose bir i një ati a nane që janë zot të nji prone të këtillë, ose asht në krye të administratës, të nji industrie a nji tregëtie, ka të drejtë të zgjedhë ulemanjtë, fetarët dhe nëpunësit e fesë, mësuesit, mjeksit, miset e gjykatoreve, nëpunësit e administratës së prefekturës, si dhe ata që kanë marrë dhiplomë dhe janë të lejuem të bahen profesorë në shtet a në vënd të huej, sido që s'mbushin kondital (sherait) që i treguem ma sipër, kanë të drejtë të zgjedhin. Ushtarët (nefer) gjindarmët, policët dhe ushtarët që janë në armë për sa kohë që gjenden në armë s'përdorin dot të drejtën e zgjedhjes.

Në çdo vjet, më parë se të hyjë vjeshta e parë, formohet lista e zgjedhësvet që kanë cilësitë që u treguen ma sipër dhe mvaret në vendin ku mblidhet njerëzia. Ata që s'u janë shkrue emnat në listën dhe që s'janë drejtue (muraxhaat) te komisia për të regjistrue emnat e tyne në listën, s'përdorin dot të drejtën e zgjedhjes.

Listat e zgjedhësvet do të dërgohen për mot në katundaritë dhe në këshillat e krahinavet, fund' i fundit gjer në krye të vjeshtës së dytë. Lista e zgjedhjes do të mbetet e varur, pesëmbëdhetë ditë, në nji vend ku mblidhet ma tepër njerëzia, dhe mbrenda në këtë kohë, cilido ka të drejtë të qahet meqë s'asht shkrue emni i tij ose i nji tjetri. Si të shkojë kjo kohë listat do të dërgohen në qendrën e nënpre-

fekturës e do të ruhen atje. Ata që qaben meqë u asht harrue emni ose s'u asht shkruejtë në listë me qëllim të lik, do të drejtohen në kohën që u tregue ma sipër, te primari ose te këshilli i krahinës dhe primari ban që të shqyrtohet çështja prej këshillit dhe të epet nji vendim në njëzet e katër orë. Në qoftë se qarja u rrëzue (red) vendimi që u dha i bahet i njohur qarësit në të dytën njëzet e katër orë.

Art. 69. Çdo shqiptar që ka mbushë moshën njizet vjeç dhe që çdo vjet i paguen shtetit pesëdhetë grosh taksë, me çdo titull qoftë, edhe që asht banues në krahinë e që zotënon tokë e plang në periferinë e krahinës, ka të drejtë të zgjidhet për dy vjet antar i këshillit të krahinës. Nuk kanë të drejtë të zgjidhen ata që janë shërbëtorë, ata që kanë humbun të drejtat civile tanësisht ose pjesërisht, të falimentuesnit që s'e kanë rifitue kredinë, ata që kanë humbun mendjen e gjykimin, ata që janë dënue me nji vjet burgim për delikt, ose janë dënue me nji ndëshkim të barabartë me këtë, ata që janë dënue për vagabondazh, edhe ata që janë në shërbim të nji shteti të huej.

Këshilli administrativ i nënprefektuës, fundi i fundit deri në pesëmëdhetë të tetorit, cakton numurin e anëtarëvet të këshillit të çdo krahine, në bazë të popullsisë së krahinës, e mbasandaj nënprefekti dërgon në qëndër të krahinës dy vetë, nji anëtar të këshillit administrativ të nëprefekturës edhe nji anëtar të këshillit të bashkisë, të cilëve ju shoqnon nji numur gjindarësh të nevojshëm. Këta shkojnë në qendër të krahinës dhe kryejnë veprimet e zgjedhjeve.

Art. 70. Këta nëpunës me të arritun në qendër të krahinës, thërresin kryepleqtë e fshatrave që përbajnë krahinën edhe i ngarkojnë këta për të zgjedhun me shumicë votash gjashtë vetë nga personat që ju shënohen emnat në listat e zgjedhjeve. Këtyne jua ngarkon zgjedhjen.

Art. 71. Mbasi të formohet në këtë mënyrë komisioni i zgjedhjeve, njeni ndër anëtarët e vet zgjidhet kryetar edhe caktohet dita e zgjedhjes. Shpalljet i njoftohen krejt popullsisë së krahinës me anën e kasnecëvet. Kur vijnë zgjedhësit në qendër të krahinës, çdo zgjedhësi i jepet nga ana e komisionit nji biletë votimi të vulosun mbrapa me vulën e krahinarisë; e, që të mos grumbullohen ma shumë se treqind zgjedhës në ditë, caktohet ma përpara numuri i zgjedhësve të çdo fshati që do të vijnë në qendër të krahinës.

Art. 72. Bileta e votimit asht një fletë prej letre të bardhë. Çdo zgjedhës do të shkruejë me dorën e vet, e, po s'diti me shkrue vetë, shkruem me anën e një të besuemi të tij, emnat e mbiemnat e disa njerëzve, numuri i të cilëve duhet të jetë baraz me nji të katërtën e numurit të anëtarëvet që duhet të ketë këshilli i krahinës.

Art. 73. Nëpunësit e dërguem nga qendra e nënprefekturës edhe komisioni i zgjedhjeve do të mbështillet në sallonin e këshillit të qendrës së nënprefekturës, në qoftë se ka sallon të tillë, e, po s'pat, do të mbështillet në ndonji shkollë a tjetër vend të gjerë tue pranue me radhë nga pesë zgjedhës, të cilët i futin biletat e votimit në arkën e pregatitun (për këtë qëllim). Pastaj vihet shënim në listën e zgjedhësvet se erdhi e votoi ky zgjedhës. Mbasi të kenë votue deri në të ngrysun treqind zgjedhësit e ftuem, vrima e arkës edhe vrima e bravës së saj vulosen nga ana e nëpunësve të sipërshkruem nga anëtarët e komisionit të zgjedhjeve. Ky veprim do të përsëritet deri sa të vijnë krejt zgjedhësit e krahinës e të japin votat e tyne.

Art. 74. Kur të marrë fund koha e caktueme, asnji zgjedhës nuk mund të vijë e të japi biletë votimi; edhe arka që mban brenda biletat e votimit dërgohet në formë të sigurt në qendër të nënprefekturës, ku i dorzohet bashkisë së nënprefekturës nga ana e nëpunësvet të nënprefekturës e nga komisioni i zgjedhjeve të krahinës.

Art. 75. Arka kontrollohet në këshillin e bashkisë në prezencën e gjyqit të paqit e të nëpunësit të ardhun. Mbasi të provohet se nuk asht në asnji anë, shqepen vulat, hapet arka, këndohen nji nga nji biletat e votimit, shënohen emnat me radhë në nji listë dhe ata që kanë fitue vota ma shumë, shpallen antarë të zgjedhun të këshillit të krahinës. Për ata që kanë fitue vota të barabarta, shtihet llotari. Aprovimi i antarëve të zgjedhun që do të futen në regjistër i përket këshillit administrativ të rrethit.

## Zgjedhjet e nënprefekturës

Art. 76. Për t'u zgjedhun antar në këshillin administrativ të nënprefekturës, asht kondite që ky të ketë cilësitë e kërkueme për antarinë e këshillit të krahinës edhe së pakut t'i pagojë financës njiqind grosh vergji.

Art. 77. Nënprefekti i rrethit, në çdo dy vjet, dërgon nëpër krahina nji nëpunës të posaçëm i cili i ve antarët e këshillit të krahinës të zgjedhin personat e përshtatun për antarësinë e këshillit administrativ. Secili nga antarët e këshillit krahinor shkruen me dorë të vet në biletën e hapun të votimit që do t'i jepet në dorë, emnat e mbiemnat e nji numuri personash, barabar me numurin e antarëve të këshillit administrativ ose po s'dijti të shkruej ja jep ta shkruajë nji njeriu të besueshëm. Këtë biletë e fut në nji pliko të vulosun sipër dhe ja dorëzon nëpunësit, i cili i dërgon në qendër të nënprefekturës.

Art. 78. Antarët e këshillit administrativ zgjidhen nga ana e antarëve të këshillit krahinuer për dy vjet.

Art. 79. Nëpunësi ja dorëzon bashkisë së nënprefekturës biletat e votimevet që ka pru. Kur të jenë grumbullue biletat e votimit të gjithë krahinave, mblidhet këshilli i bashkisë e trupi i gjykatës dhe hapin zarfat tue qenë prezent nënprefekti. Emnat e personave të shkruem në biletat e votimeve i shkruen në nji listë. Ata që kanë fitue ma shumë vota nënprefekti i deklaron antarë të zgjedhun. Pastaj shënon në listën e posaçme edhe emnat e aq personave nga ata që kanë fitue shumicë votash dhe kjo listë vuloset. Në rast se mbetet vakant antarësia, mbushet vendi me këta. Për këtë çeshtje mbahet nji proçesverbal, i cili dërgohet në këshillin e prefekturës.

## Zgjedhja e anëtarëve të këshillave të kuvendit

Art. 80. Këshillat e pleqësivet të krahinave edhe ata të bashkive zgjedhin antarët e këshillit të kuvendit edhe njëri midis tyne zgjidhet e kryeson. Këshillat e kuvendit përbahen prej katër deri më tetë antarë të zgjedhun për dy vjet.

## Zgjedhja e antarëve të Këshillit të Përgjithshëm të Prefekturës

Art. 81. Antarët e këshillit krahinor të çdo nënprefekture, simbas popullsisë që ka nënprefektura, do të zgjedhin nga tre deri më gjashtë

persona. Antarët që do të zgjidhen në këshillin e përgjithshëm të prefekturës, medoemos duhet të jenë nga banorët e qarkut të asaj prefekture dhe duhet t'i kenë cilësitë e kërkueme për antarët e këshillave administrative të nënprefekturës; koha e shërbimit të tyne do të jetë katër vjet. Me përjashtim të zgjedhjeve që do të bahen për herën e parë, zgjedhjet që do të bahen ma pastaj, do të kryhen në muajt e shënuem këtu poshtë. Meqenëse zgjedhjet e antarëve të këshillave krahinore do të bahen në fillim të shtatorit, menjëherë mbas tyne do të bahen zgjedhjet e antarëve të këshillave administrative të nënprefekturave, atëhere zgjedhjet e anëtarëve të këshillit të përgjithshëm të prefekturës do të përfundohen fundi i fundit me pesëmbëdhetë të nandorit.

Art. 82. Përgjithësisht, nëpunësit e qeverisë, personalisht janë përgjegjës përpara qeverisë drejt për drejt për të gjitha veprimet e qëndrimet e tyne në lidhje me të kryemit e detyrës.

Çdo person që damtohet nga neglizhenca e nji nëpunësi ose nga mungesa e tij në detyrë, ka të drejtë të ngrejë gjyq kundër nëpunësit fajthitës dhe të kërkojë damshpërblim për damin që ka pësue, po të mundet të provojë pretendimin e tij.

Art. 83. Në qoftë se nuk mundet të sigurojë të drejtat e tij me mjetet gjyqësore, atëhere ka të drejtë të kërkojë nga qeveria damshpërblimin e vendosun dhe në këtë rast qeveria i drejtohet nëpunësit përgjegjës. Përgjegjësia e shkaktuem nga veprime personale i përket vetëm nëpunësit. Nuk asht e lejuem t'i drejtohen qeverisë për padi të tilla.

Art. 84. Nëpunsit për neglizhencën e gabimet e tyne në të kryem të detyrës, simbas rregullores që do të vihet në fuqi, do të dënohen me vrejtje, qortim, gjobitje ose pushim.

Art. 85. Emnimet, gradimet, pushimet e pensionet e nëpunsvet caktohen me ligjë të veçantë.

**Zgjedhja e nëpunësve**

Art. 86. Funksionarët e naltë të nji prefekture janë: këshilltari, drejtorët e zyrave të ndryshme, kryesekretarët, komandanti i xhindarmërisë, gjyqtarët, prokurorët, nënprokurorët e gjyqtarët hetues. Prefektin e funksionarët e naltë të prefekturës i zgjedh ministria nga e cila varen, nga personat që i kanë cilësitë e shënueme në ligjin e veçantë. Prefekti emnohet me zgjedhjen e propozimin e Ministrisë së Punëve të Brendëshme e me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me dekretin e kryetarit të shtetit. Funksionarët e nëpunësit e tjerë, zgjidhen simbas rregullit, nga ana e ministrave, dhe emnimi i tyne bahet ose drejt për drejt me dekretin e kryetarit të shtetit, ose, po të jetë nevoja, merret vendimi i Këshillit Ministror dhe pastaj dekretohet nga kryetari i shtetit.

Kur çfaqet nji shtrëngim i jashtëzakonshëm, që të zgjidhet nji person jashtë karierës ose nënshtetas i huej, atëhere për të këtillë njerëz, patjetër duhet të merret vendimi e pëlqimi i Këshillit të Ministrave. Prefektët mund të kërkojnë nga Ministria e Punëvet të Brendëshme zgjedhjen dhe emnimin e nënprefektavet nga personat që i kanë cilësitë ligjore. Ministria e Punëvet të Brendëshme, po ta pranojë propozimin që i bahet, nënprefektat e zgjedhun i emnon me dekret të

krvetarit të qeverisë. Emnimi i drejtorëve të krahinavet meqenëse asht tregue në artikullin përkatës, ata që zgjidhen e emnohen në atë mënyrë, i lajmërohen Ministrisë së Punëve të Brendëshme.

Nëpunësit e financës, sekretarët e nënprefekturave, sekretarët e zyrave të ndryshme, sekretarët e këshillave e kryetagrambledhësit, zgjidhen ndër kompetentët edhe emnohen me urdhërin e ministrisë përkatëse. Nëpunësit e tjerë, simbas gradës së tyne, me pëlqimin e drejtorit të zyrës përkatëse, emnohen drejt për drejt nga prefektët ose nënprefektët.

**Gjyqi i nëpunësve.**

Art. 87. Hetimet e para për fajet që bajnë nëpunësit për punët që ju ngarkohen, kryhen nga zyra ku varet, dhe, po u vërtetue se asht i pandehun, epet në gjyqin përkatës civil për t'u gjykue simbas shkallës së fajit.

Ky ligj asht aprovue, prandaj të shpallet simbas rregullit dhe të veprohet simbas përmbajtjes së tij.

*Nxjerrë nga Gazeta «Përlindja e Shqypnisë», organ zyrtar i Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës, Vit' i I Nr. 25-30 dt. 22 nëndor — 13 dhjetor 1913 (prej art. 1-68, ndërsa art. 69 deri në fund përkthyer nga dok. turqisht.)*

**Nr. 344**

*Letër e Kryetarit të Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës, drejtuar prefektit të Elbasanit, Aqif Pashës, me të cilën e njofton mbi situatën e krijuar në Shqipëri nga ana e Esad Pashë Toptanit dhe masat që duhen marrë për shpëtimin e Atdheut.*

*10 nëndor 1329*
*23 nëndor 1913*

Me nderime mora letrën e gjatë të Lartësisë Suaj, që patët mirësinë të më dërgoni me anë të Zotërivet të tyre Irfan Beut e Halim Beut. M'u ndriçuan sytë duke lexuar atë. Nuk dua t'Ju flas për barrën e rëndë që kam mbi supa dhe për lloj lloj vështirësish që më dalin përpara për të kryer detyrën patriotike që më është ngarkuar. Këto gjëra Shkëlqesia e Juaj i di. Zotëritë e tyre Irfan Beu e Halim Beu përsa kohë qëndruan këtu kuptuan mirë mbi gjëndjen dhe çfar panë e çfar konstatuan me syt e tyre do t'ja raportojnë Shkëlqesisë Suaj. Sikur të gjithë shqiptarët të ishin më patriotë dhe ta çmonin më tepër mbrojtjen e dinjitetit kombëtar, ahere nuk do të largoheshin nga bashkimi midis tyre përpara Europës që vëzhgon punët tona më të vogla, dhe do ta ruanin me durim ekzistencën tonë kombëtare, sidomos tani që ky bashkim është i nevojshëm më shumë se kurrë, sepse nëpër këtë do të siguronim dhe do të ruanim atë formë qeverimi që na lypset. Sidoqoftë, në këtë kohë transformimi, historia do të dallojë patriotin nga tradhëtari dhe do t'i caktojë secilit vendin e tij, simbas shërbimevet e meritavet që ka ndaj atdheut. Se c'vend do të kem unë në histori këtë nuk e di. Sa për Ju,

270

331.11(094)

# RREGULLORE

E

# JETËSHKRIMEVE

L. 5

Shtypshkroja "Nikaj" Shkodër 1921

# Rregullore e jetëshkrimeve.

*Neni 1.* — Ç' do Nëpunës civil âsht i detyruëm të lajmeroj Zyrën e jetëshkrimeve për sà i përket jetëshkrimit të tij.

*Neni 2.* — Ç' do akt qi i përket jetës Zyrtare të Nëpunsave për me qênë i pranuem nga Zyra e jetëshkrimevet, duhet bashkangjitun me origjinalin ose me kopjen e tij të vërtetuëm nga ana autoritetit kompetent, ose nga e Këshillit administrativ.

*Neni 3.* — Ç' do Nëpunës detyrohet t'a shkruej jetëshkrimin e tij me dorën e vet.

*Neni 4.* — Ç' do akt jetëshkrimi do të përmbajnë këta pika: emëni e mbiemëni, vendi e data e lindjes, ç' shkollë ka sosun e çë gjuhë di, me ç' provim ose me ç' titull âsht

emënue, rroga muejore, numri e data e shkresës s' emënimit, data e fillimit në punë, ku kà qênë Nëpunës, në ç' kohë dhe me sà rrogë, i martuem a jo, pasunija qi kà, data e pushimit nga puna, numri e data e shkresës së largimit nga puna, shkaku i largimit, kûr, për ç' shkak e me ç' gjobë â ndeshkue, lëje kûr kà marrë, për sà kohë.

*Neni 5.* — Ç' do Nëpunës âsht i detyruëm ashperisht qi të rrëfejë të drejtat mbi jetëshkrimin e tij, se ndryshe do të hiqet nga puna, ose do të dënohet me nji gjobë nga ana e Ministris.

*Neni 6.* — Në ç' do fundë të motit Kryetarët e ç' do Zyre do të shkruejn në vrejtjen e hapët mendimet e tyne mbi Nëpunësit duke lajmerue dhe Nëpunësit mbi shenimet qi i përkasin.

*Neni 7.* — Në vrejtjen e mësheht do të shenohen nga Kryetarët e Zyreve:

Zotësija, punimi, sjellja, ditunija, inizjativa, mirësit, ligësit dhe karakterët e Nëpunsave pas ndërgjegjës së tij. Ky shenim mbetet i mësheht edhe mund të këndohet vetëm kur të jetë nevoja nga Kryetarët e Zyravet mâ të nalta.

*Neni 8.* — Ç' do Zyre âsht e detyruëme të lajmerojë Zyrën e jetëshkrimeve mbi livizjen, mbi emënimin, dhe transferimin, dhe mbi lëjen e tj. të ç' do Nëpunësi.

Pa mos u lajmerue Zyra e jetëshkrimeve mbi pikat e sipërshenuëme nuk munden të fillojnë Nëpunësit nga puna.

*Neni 9.* — Ata Nëpunës qi nuk e kan rregjistrue jetëshkrimin e tyne në Zyre të jetëshkrimevet, po të kërkojn ndoji Nëpunësi, ose të proponohen nga ana e ndonji Zyre së munden t' emënohen para se t' a paraqesin rregullisht jetëshkrimin e vet.

*Neni 10.* — Drejtorija e jetëshkrimevet, kùr të shofin nevojë, mund të kërkojë shpjegime ose me kërkue dokomenta mbi preteset e Nëpunësit, edhe me korespendue me ç' do Zyre të Ministrive.

*Neni 11.* — Drejtorija e jetëshkrimevet âsht përgjegjse për ç' do qi i përket vrejtjes së mësheht qi të mos kuptohen mëshehtësit edhe ç' do gjâ qi i përket kësaj Zyre.

*Neni 12.* — Letër jetëshkrimet do të jenë të shtypuna dhe do të kenë nji vleftë prej 3 (tre) Fr. ari.

*Neni 13.* — Ministrija e P. të Mbrendshme detyrohet për veprimin e kësaj rregullore.

*Neni 14.* — Kjo ligjë hijn në veprim 15 dit pas çpadhjes.

Tiranë, me 15 - III. - 921.

*Ministr' i P. të Mbrendshme:*
Mehdi Frasheri d. v.

Këshilla Ministrore në bisedën e saj Nr. 375 me 31. III. 921 vendosi pranimin e kësaj rregullorje të përbamun prej 14 nenesh.

Tiranë, me 6. IV. 921.

*Kryeministri :*

Iljas Urioni ð. v.

---

Vertetohet njisija me origjinalin.

Tiranë, me 13. IV. 921.

*Dr. i jetëshkrimeve :*

Hiqmet Delvina.

Rregullore e jetëshkimeve, 1921
*Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë*



Deftesë jetëshkrimi
*Arkivi Qendror i Shtetit*



Deftesë jetëshkrimi
*Arkivi Qendror i Shtetit*



**Mbi sjelljet e nëpunsave kundrejt popullit.**



**Rregullore mbi botimin dhe përndarjen e gazetës Zyrtare.**

Mbi sjelljen e nëpunësave
*Dit' e Re, Viti I, 10 maj 1922, f. 6*

Rregullore mbi botimin dhe shpërndarjen e gazetës zyrtare
*"Dit' e re", Viti I, 10 maj 1922, f.6*



**Shpalljet e M. P. Botore**

**Kërkohet një llogaritar**

Ministri : P. Botore - Bujqsis
S. Koleka

Shpallje e një vendi të lirë pune
*"Dit' e re", Viti I, 17 qershor 1922, f.6*


Buletin Zyrtár.

Ligji i administratës civile të Shtetit Shqiptar



DIT' E RE, E MËRKURË, 24 MAJ 1922

Ligji i administratës civile të Shtetit Shqiptar

*"Dit' e re", Viti I, 24 maj 1922, f. 5-7*



Nëpunsit në ndeshkim

Shpallje e masës disiplinore
*"Dit' e re", Viti I, 24 qershor 1922, f. 2*



Ligja dhe rregullore.

Ligj për gjykimin e nëpunësve
*"Dit' e re", Viti I, 28 qershor 1922, f. 4*



Mbi udhtimet e Zyrtarvet

Mbi udhëtimet e nëpunësve
*"Dit' e re", Viti I, 16 korrik 1922, f. 1*



**Për klasifikimin e rrogavet**

Keshilli Ministruer në bisedën e tij të sotshme vendosi që të formohet nji komision nën kryesin e Shk. Tij Kryeministir Xhafer Ypit tue pasë si nënkryetar Z. Ahmet Zogun, Ministrin e P. të Mbrendëshme, e anëtare Z. Z. Luigj Babën, Drejtorin e Thesarit, Angjelin Sumën, Drejtorin e Njehsimit, Qerim Çelon, sekretarin e përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësiës, Hajdar Ben drejtorin e P. Botore edhe Z. Mati Logorecin, sekretarin e përgjithshëm të Ministriës s' Arësimit, i cili do të përpiqet me klasifikue rrogat e ndryshme të nëpunësave të ç'do degë, me thjeshtue nëpunësinat tue ngrit ata të pa nevojshmet, me çmue shpenzimet e ndryshime të ç'do degë t' administratës tue economin ma të madhe tue i vue themelet e tue trajtue në këtë mënyre budgetin definitiv të këtij vjeti.

Nr. 342, me 16-7-1922

Për klasifikimin e rrogave
*"Dit' e re", Viti I, 23 korrik 1922, f. 3*



**Për orarin zyrtar**

Po marim vesh se shume vetë nga Kryetarët e Zyravet si edhe nga nëpunësit s'janë tue mbajt orë (sahat) me vehte e nga ky shkak nuk po mundem me rregullue vazhdimin e tyne në detyrë si mbas urdhënavet të komunikuem.

Ini të lutun të lajmëroni gjith zyrat e atij Qarku që të detyrohet ç'do nënpunës për me mbajt sahat e me vazhdue rregullisht si mbas Orarit Zyrtar.

Prefektat e Nënprefektat si mbas ligjit urdhënohen të bajnë kontrollimet e nevojshme.

**Mbi Jetëshkrimin e nënpunësvet**

Vijon qarkorja e 7-7-922.

Tue veprue pik për pike si mbas Qarkores së sipërme të kësaj Ministrije ini të lutun të lajmëroni gjith nënpunësit Civil të mvarun prej asaj Prefekturë të na i çojnë biografiet e tyne të pregatituna si mbas rregullores së posatshme të Jetëshkrimeve (ata qi nuk i kan çue) e deri më 30 Gusht 922.

Prefekturat e Nënprefekturat janë të detyrueme mos me ba as nji propozim pa paraqitë jetëshkrimin e atij qi kërkon nënpunësi, gjith ashtu duhet me u lajmërue zyra e Jetëshkrimit (Sek. I i kësaj Ministrije) për fillimet në punë, pushimet nga puna, qertime e lavdime dhe lejet e pushimit të ç'do nënpunësi.

Mos zbatimi i kësaj Qarkoreje shkakton përgjegjësin e Prefektave. Nënpunësit qi nuk do t'a respektojnë këtë urdhën do të ndeshkohen rreptësisht.

Për orarin zyrtar dhe jetëshkrimin e nëpunësave
*"Dit' e re", Viti I, 27 korrik 1922, f. 2*



REGULLORJA E SHTETIT CIVIL



Pjesë e VI.

REGULLORJA E SHTETIT CIVIL



RREGULLORJA E SHTETIT CIVIL

Nenet e përgjithshme

PARAGRAFI IV.

Rregullorja e shtetit civil
*Fletore zyrtare, Viti I, 17 gusht 1922, f. 4*



Shpalljet e P. Botore

Konkurs për dy Sekretarë

Shpallje e një vendi të lirë pune
*Fletore zyrtare, Viti I, 24 gusht 1922, f. 4*



KRYEMINISTRIJA

Qarkore gjith Ministrive, e Drejtorive të Përgjithëshme e Bashkive

Mbi mirsjelljen e nënpunësave

„Për t'i dhanë Shtetit nji formë moderne të dëshirueme, âsht e ditun se ma së pari duhet vazhdimi tregullisht i Nënpunësave në detyrë, punimi i tyne me zell e me energji të plotë e thjeshtë Kombëtar, ashtu dhe sjellja e atyne me ç'do njeri, si në zyrë q'i bie rasti për çdo nji punë zyrtare, si edhe jashtë, të jetë e urtë, e njerëzishme e plot me ndere.

Çdo nënpunës qi del jashtë pikavet të sipërshënueme, qi nuk sillet me njerzi e me urti para popullit tue i bamë atij lehtësinat ma të mëdhaja në veprimet zyrtare të detyrës së vet, por në nji mënyrë deshpruese shpërdon detyrën q'i ka lanë në dorë Shtetit, me nji herë do të nxirret nga puna dhe mbas randësis së fajit do të shohi edhe dënimin e me-

Mbi etikën e nëpunësve
*Fletore zyrtare, Viti I, 17 dhjetor 1922, f. 1*



## Mbi djalektin zyrtar

Si mbas urdhënit Nr. 148, më 13-1-923, të Kryeministriës jui të lutun të autorizoni gjith zyrat qi në shkrim të aktevet zyrtare gjithmon të përdoret dialekti i Elbasanit, i cilli asht pranue si nji djalekt i përbashkët e zyrtar për shtetin t'onë.

14-1-23 n. 763

Mbi dialektin e përdorur në komunikimin zyrtar
*Fletore zyrtare, Viti I, 21 korrik 1923, f. 1*

# Lajme të ndryshme

## Emnime

„Nen-konsullata shqipetare në New Tork në buxhetin e sivjetem u bâ, sikunder dihet, Konsullate.

«Në vend të Zotit C. A. Tashko, nenkonsull, u emerua si titullar i asaj Konsullate Zoti Abdul Sula, ish depu-tet i Dibres. Zotenia e tij u nis për të marrë zyren në dorë».

10. XI. 23. n. 3539

## Konkurs

Në Gjyqin e Fillimit të Vlorës asht çelun vendi Protokollist Kopistit me rrogë Fr. ari 125 në muaj, dhe për ketë vend ashtë çelun një kon-kurse e qi ka me u mbajtë më 25. XI. 1923 n' oren 3 mbas ditë, diten e Djele.

Pra, gjithë ata zoterinj që deshe-rojnë me marrë pjese në ketë konkurse t' i drejtohen Kryesis Gjyqit me një kerkese, tue bashkangjitun keto doku-menta:

1) Certifikaten e nenshtetasiës.

2) Flet lirimin ose dishmin e Re-krutimit; mos me pasë pengim.

3) Dishmin e sjelljeve. 4) Dish-min shkolluer

5) Dishmin e Prokuroris së vendit.

Vlore, më 6-ṭI-1923.

Shpallje emërimi dhe shpallje konkursi
*Fletore zyrtare, Viti I, 13 nëntor 1923, f. 4*



MBRETNIJA SHQIPTARE
KËSHILLI I SHTETIT

# LIGJE DEKRET LIGJE E RREGULLORE

TË VJETIT

1925

BOTIMET E KËSHILLIT TË SHTETIT
VOL. 2 I PËRMBLEDHJES SË LIGJEVE
TIRANË

vet, dhe gjykon e vendon mbi ta mbas parashkresavet të rregullores së mbrendëshme të tij.

Art. 68. – Senati deri sa të bajë rregulloren e vet, vepron mbas rregullores së mbrendëshme të Dhomës së deputetvet.

---

## Pjesa C.

### PUSHTETI PËRMBARUËS

### *KRYESIJA E REPUBLIKËS*

Art. 69. – Kryetari i Republikës zgjidhet prej mbledhjes së përbashkët të Senatit e të Dhomës së deputetvet për shtat vjet, me shumicë absolute votash, dhe në qoftë se për dy herë rrjesht nuk zgjidhet me shumicë absolute, herën e tretë zgjidhet me shumicë relative votash. Sa për këtë herë, zgjidhet prej Kuvendit Kushtetuës.

Art. 70. – As kush nuk mund të zgjidhet Kryetar i Republikës pa qenë Shqiptar me racë e me gjuhë, pa qenë shtetas Shqiptar, pa gëzuem të drejtat civile e politike dhe pa pasun të gjitha cilësit e tjera të lypuna për deputet.

Art. 71. – Periudha shtat vjetshe fillon qysh prej ditës së zgjedhjes. Nji muej para mbarimit të kësaj periudhe, bahet zgjedhja e re.

Art. 72. – Kryetari i Republikës pa hymun në detyrë, betohet përpara Senatit e Dhomës së deputetvet mbas kësaj formule: „Betohem n' emën të Perëndis e mbi nderin t' em se kam për të qenë ruejtës besnik i mëvetësis e i tansis toksore të Shqipnis, i Republikës, si edhe i Statutit e i ligjvet të Shtetit."

Sa për këtë herë betohet përpara Kuvendit Kushtetuës.

Art. 73. – Kryetari i Republikës ka të drejtë me marrë nji shpërblim prej 10.000 fr. ari në muej.

Këjo shumë mund të ndryshohet herë pas here me ligjë.

Shpenzimet e shtëpis zyrtare të Kryetarit të Republikës, rregullohen me ligjë të veçantë.

Art. 74. – Kryetari i Republikës asht i pa përgjegjshëm, veçse për tradhëti të naltë dhe për aktet e tij qi nuk kanë kundërfirmën e Ministrit ase të Ministravet kompetent.

Art. 75. – Kryetari i Republikës, asht kreu mâ i naltë i Shtetit, ka Komandën e Përgjithshme të fuqive t' armatosuna, emnon e ç'emnon Ministrat e zgjedhun prej tij, nëpunësit e naltë të

Shtetit dhe gjith oficerët e fuqive t' armatisuna, asht drejtuesi i politikës së Shtetit edhe ka të drejtë me bamë traktate e marrëveshtje gjith-farësh me Shtetet e huej me pëlqimin e dy Dhomave, dhe me pranue e akreditue trupa diplomatike.

Kryetari i Republikës nuk ka të drejtë me shpallë luftë e me bamë paqe pa pëlqimin e Senatit e të Dhomës së deputetve, veç se në rasë mprojtjeje.

Art. 76. – Kryetari i Republikës urdhënon shpalljen e zbatimin e projekt-ligjeve të votueme prej dy Dhomave. Ka edhe të drejtën e veto-s.

Art. 77. – Në qoftë se trupat Ministruer me ndryshime nuk marrin për dy herë rrjesht votëbesimin e Dhomës së deputetvet, Kryetari i Republikës ka të drejtë të shpërndajë Dhomën; por në qoftë se edhe Dhoma e re nuk i jep votbesimin, at-herë rrëzohet trupi Ministruer.

Deri sa të marri fund konflikti, qindrojnë në fuqi Ministrat e fundit qi nuk muerrën votëbesimin e Dhomës së deputetvet të shpërndame.

Art. 78. – Kryetari i Republikës ka të drejtën e faljes (grace).

Propozimi i ligjës për amniati i përket vetëm pushtetit përmbaruës.

Art. 79. – Kryetari i Republikës mund të thërrasë dy Dhomat në mbledhje të jashtzakonshme.

Art. 80. – Propozimi i ligjevet i përket pushtetit përmbaruës dhe Senatit e Dhomës së deputetvet, por, propozimi i ligjeve qi sjellin me vete shtesa ase barrë financjare, i përket vetëm pushtetit përmbaruës.

Art. 81. – As nji akt i Kryetarit të Republikës nuk ka vlerë pa kundërfirmën e Ministrit ase Ministravet kompetentë.

Art. 82. – Në kohë kryengritjeje, luftë të mbrendëshme ase të jashtme, mobilizimi të përgjithshëm, ase kalamiteti publik, Kryesija e Republikës nën përgjegjësin e trupit Ministruer shpallë shtetin e rrethimit, dhe ven në zbatim ligjën relative në gjithë tokën e Shtetit ase në ndonji copë të sajë; në qoftë se Dhomat janë të mbledhuna, duhet marrë auktorizimi, dhe në qoftë se Dhomat nuk ndodhen të mbledhuna, Pushteti përmbaruës e ven në zbatim, por dekreti i shpalljes së shtetrrethimit i duhet paraqitun Dhomavet në fillim të sesjonit t' afërmë.

Dekreti i shpalljes së shtetrrethimit i paraqitet Dhomës së deputetvet mbas mbledhjes së saj për aprovim ase refuzim, e

cila mbrenda 30 (tridhjet) ditve prej datës së paraqitjes të këtij dekreti, ep vendimin e refuzimit, ase t'aprovimit të tij.

Një ligjë e posaçme ka me rregullue pezullimin e nenevet të Statutit relativ me lirin personale, të drejtën e mbledhjevet, të drejtën e shoqnimit, padhunueshmin e banimit, lirin e fjalës e të shtypit dhe fshehtësin e letravet.

Këjo ligjë mund të vehet në zbatim e tanë, ase pjesësisht.

Në rasë qi s'ka Dhomë deputetësh, thërritet Dhoma e përparshme vetëm për qëllimet e sipër-tregueme, dhe këta deputetë, sa për këtë detyrë, gëzojnë gjithë imunitetet e deputetit.

Art. 83. – Kryetari i Republikës kryeson Ministrat e emnuem prej tij; por këta duhet të paraqiten përpara Dhomës së deputetve jo ma vonë se 5 ditë mbas ditës s'emnimit tue shpallun programën e tyne për të marrë votëbesimin, për ndryshe, quhen sikur kanë marrë votë mos besimi.

Art. 84. – Në rasë vdekje, sëmundjeje të pa-shërueshme qi ndalon veprimin, dorëheqje të Kryetarit të Republikës, në qoftë se trupat legjislative ndodhen të mbledhuna at ças zgjedhin Kryetarin e ri të Republikës, dhe në mos qofshin të mbledhuna, Kryetari i Senatit vetiu zavendëson kryesin e Republikës dhe m'at ças mblidhen vetiu dy Dhomat legjislative për të zgjedhun Kryetarin e ri të Republikës.

Për veç rasave të sipërpërmënduna, në mungesë të Kryetarit të Republikës, zavendëson Kryetari i Senatit, dhe në mungesë të këtij të fundit, Kryetari i Dhomës së deputetvet.

---

## *M I N I S T R A T*

Art. 85. – Ministër mund t'emnohet kushdo qi ka cilësit e lypuna prej ligjës për t'u zgjedhun deputet.

Nuk mund t'emnohen ministër gjinit prej gjaku të Kryetarit të Republikës dhe të Kryetarit të Senatit deri në gradë të dytë; gjith-ashtu dy gjini prej gjaku deri në gradë të tretë gjith n'atë trup Ministruer.

Të huejt prej race, qi natyralizohen shtetas shqiptar, nuk mund t'emnohen Ministër.

Art. 86. – Ministrat hyjnë lirisht në Senat e në Dhomën e deputetvet dhe ndigjohen kurdoherë qi kërkojnë fjalën, por votojnë nër Dhomat e tyne, vetëm ata qi janë Senatora dhe Deputetë.

Art. 87. – Ministrat, pa hymë në detyrë betohen përpara Kryetarit të Republikës.

Art. 88. – Kur trupat legjislative ndodhen në pushim, Qeverija ka të drejtë me bamë dekret-ligjë; por këto do t'i parashtrohen pushtetit legjislatif në fillim të sesjonit t'afërmë për shqyrtim e pranim.

Në qoftë se nuk paraqiten ose nuk pranohen, quhen vetiu të zhvleftësueme.

Art. 89. – Ministrat janë të përgjegjshëm politikisht përpara Dhomës së deputetvet, solidarisht për politikën e përgjithshme të tyne dhe ç'do Ministër veçanërisht për veprat e veta.

Art. 90. – Askurr urdhëni i Kryetarit të Republikës nuk mund të lirojë ministrat prej përgjegjësis së tyne.

Art. 91. – Ministrat gëzojnë imunitetin parlamentar.

Art. 92. – Në ç'do shfaqje të Ministravet, Ministri i Drejtësis mbanë vendin kryesor.

## *KËSHILLI KONTROLLUËS I FINANCAVET*

Art. 93. – Financat e Shtetit kontrollohen prej Këshillit Kontrolluës të Financavet.

Art. 94. – Organizimi i këtij Këshilli, mënyra e ushtrimit të zyravet të tij dhe cilësit e misvet qi e përbâjnë, caktohen në ligjën e posaçme.

Art. 95. – Të drejtat e këtij Këshilli janë kontrolli parashikuës (preventiv) e ndeshkuës (represiv) i llogarive të gjithë administratës së Shtetit e edhe qi caktohen në ligjën e posaçme.

Art. 96. – Kryetari dhe anëtarët e këtij Këshilli emnohen prej Kryetarit të Republikës dhe nëpunsit e tjerë, si mbas ligjës.

Art. 97. – Patundëshmija e Këshillit Kontrolluës të financavet, sigurohet në mënyrën e caktuëme në këtë Statut për misët e Gjyqit të Diktimit, me ndryshimin qi asht vetëm për pesë vjet çë prej ditës s'emnimit të së cilit prej tyne.

## Pjesa D.

## PUSHTETI GJYQSUËR

Art. 98. – Gjykatat janë independente. Në të dhanunit e gjykimevet të veta, nuk dipendojnë prej as nji tjetër auktoriteti veç se prej atij të ligjës.

— 128 —

# Gjendja e parapame e shpenzimevet
të
# MINISTRIS SË FINANCAVET
për ushtrimin financjar prej 1-IV-1925 — 31-III-1926

| Kap. | EMERTIM | | Kompetenca për ushtrimin financjar 1925-1926<br>Fr. ar |
|---|---|---|---|
| | **Titull' i I. Shpenzime të rendëshme** | | |
| | Katheg. e I. Shpenzime efektive | | |
| | *Ngarkime të Shtetit* | | |
| 1 | Rrogë jetike | (a) | 39.860 |
| | | | 39.860 |
| | *Kryesi e Republikës* | | |
| 2 | Shpenz. të përgjith. të Kryesis së Republikës | (b) | 246.800 |
| | | | 246.800 |
| | *Senati* | | |
| 3 | Shpenzime të përgjithshme të Senatit | (c) | 195.000 |
| | | | 195.000 |
| | *Këshilli i Kombit* | | |
| 4 | Shpenz. të përgjith. të Këshillit të Kombit | (c) | 416.840 |
| | | | 416.840 |
| | *Kryesi e Këshillit Ministruer* | | |
| 5 | Personali — Rrogë | | 16.560 |
| 6 | Shpenzime Zyrje | (d) | 2.440 |
| | | | 19.000 |
| | *Ministri e Financavet* | | |
| 7 | Personali — Rrogë | (a) | 114.360 |
| 8 | Ministrija — Shpenzime Zyre | | 48.400 |
| 9 | Qira | | 7.296 |
| 10 | Udhtim e djete | | 7.000 |
| 11 | Kremtime | | 300 |
| 12 | Shpenzime giyqi | | 2.000 |
| 13 | Shpenzime transporti (Instalacjon) | | 300 |
| 14 | Të pa parapame | | 2.000 |
| 15 | Veshë e mbathë shërbëtorësh | | 1.000 |
| 16 | Food reservë | | 2.720 |
| | | | 185.276 |

Parashikimi i shpenzimeve për Ministrinë e Financave

| Kap. | EMERTIM | | Kompetenca për [illegible] financjar [illegible] Fr. ar. |
|---|---|---|---|
| | *Administrimi qarkuer* | | |
| 17 | Personali administruer i Intendancave financjare — Rrogë. | | 596.640 |
| 18 | Shpenzime Zyre | (b) | 11.200 |
| 19 | Qira. | | 11.300 |
| 20 | Udhtim e djete. | | 4.000 |
| 21 | Shpenzime gjyqi | | 17.840 |
| 22 | Shpenzime për vërtetim të taksave | (c) | 20.000 |
| 23 | Mirëmbajtje e pasunis së Shtetit | | 12.000 |
| 24 | Shpenzime për dërgesë të hollash | | 1.500 |
| 25 | Shpenzime transporti (Instalacjon) | | 1.000 |
| | | | 675.480 |
| | *Administrimi doganuar* | | |
| 26 | Personali — Rrogë | | 224.640 |
| 27 | Shpenzime Zyre | (a) | 5.000 |
| 28 | Qira | | 9.550 |
| 29 | Udhtim e djete | | 3.000 |
| 30 | Dërgesa të hollash | | 1.000 |
| | | | 143.190 |
| | *Administrim i Monopolave* | | |
| | Krypë, shkrepsa, letra cingaresh, letra lojë. | | |
| 31 | Personali — Rrogë | | pro memoria |
| 32 | Shpenzime Zyre | (b) | 1.490 |
| 33 | Qira | | 15.000 |
| 34 | Udhtim e djete | | 600 |
| 35 | Agio 5% mbi të shitunit e pullave | | 7.200 |
| 36 | Shpenzime për nxjerrje e bartje krype. | | 494.000 |
| | | | 518.290 |

**Titull' i II. Shpenzime të parendëshme**

Katheg. e I. Shpenzime efektive

*Administrimi qendruer*

| | | |
|---|---|---|
| 37 | Rrogë e Komisjonit Kontrollues | 8.700 |
| 38 | Dam arke. | 5.000 |
| 39 | Përkthim ligjesh e rregulloresh | 1.000 |
| | | 14.700 |

9

12. – Urdhnat e medaljet, janë për t'u mbajtun të kremtet zyrtare për ditët e tjera, mjafton me mbajt vetëm shiritin e urdhnit (o të medaljes) për ata qi janë me uniforma, m'anën e majtë të krahëruësit, me civilat m'anën e majtë në birën e sipërme të qafës.

13. – Kjo ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes.

14. – Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptarr, pëlqejmë këtë ligjë të pranueme prej trupave legjislative dhe urdhnojmë zbatimin e saj.

Tiranë, me 3 XII-1925.

A. ZOGU

*Ministri i P. të Jashtme e zav. Ministri i Drejtësisë*
H. VRIONI

*Ministri i Financavet*
S. STAROVA

*Ministri i P. Botore e Bujqësisë e zav. Ministri i P. të Mbrendëshme*
MUSA JUKA

---

## Nr. 87.

LIGJË, 21 Nëndor 1925.

### Mbi rregullimin e të mbrapambetunave

(Ie botuem në Fletoren Zyrtare, [illegible] Dhetuer 1925, Nr. [illegible])

I. – Autorizohet rregullimi i pagesave të mbrapambetuna si mbas dispozitave të nenit 5 të ligjës së kontabilitetit (vjet 327a-t) sot në veprim.

II. Çelet në Budgetin për ç'do degë administrative nga nji shtyllë pa shifër e cila mer emertimin „borxhe të vjetve të kaluem" ku llogariten të gjith borxhet e përmenduna të cilat ndonëse kanë pasun kreditin e vet n' ushtrimin e përkatshëm e kanë qenë të preguem, kanë mbetë pa u pague deri në ditën e shpalljes së kësajë ligje.

III. – Pagesa e borxhevet të mbetuna nuk mund të kalojnë shumën e savisë të mbrapambetunavet qi mund të nxirren mbrenda ushtrimit 1925–1926 e të cilat do të parashifen në buxhetin e t'ardhunavet të këtij vjeti.

IV. – Autorizohet pagesa e depozitave të pa kthyme e të shpenzueme, të cilat kanë me u nxjerrë mbrenda vjetës 1925–1926.

V. – Inserohen në buxhetin e ushtrimit 1925–1926 të by-

441 —

met nga ndalje pensioni si edhe të dalunat për pagesë pensjoni për ushtar e civila, e cila nuk do të kalonjë shumën e t'ardhunavet të nxjerruna nga përqindja për fond pensioni si mbas ligjës në fuqië.

VI. — Ministria e Financavet asht e autorizuëme për zbatimin e kësaj ligje.

VII. — Kjo ligjë hynë në fuqi me ditën e shpalljes në fletorën zyrtare dhe ka vleftë deri në mbarim t'ushtrimit financjar 1925 – 1926.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, aprovojmë këtë ligjë të pranuëme prej trupave legjislative si mbas shkresës Nr. 167 me 19-XI-1925 të Kryesis së Senatit dhe dekretojmë zbatimin e sajë.

Tiranë, me 21-XI-1925.

A. ZOGU

*Zav. Ministri i Drejtësisë*
*Ministri i P. të Jashtme*
H. VRIONI

*Ministri i Financavet*
S. STAROVA

---

**Nr. 88.**

LIGJË, 5 Dhetuer 1925

**Mbi shpërblimin e Kryetarit të Republikës**

(e botuem në Fletoren Zyrtare, 11 Dhetor 1925, N. [illegible])

1. — Shpërblimi i përmujshëm i Kryetarit të R publikës i caktuem në Statut prej Fr. ar 10.000 shtohet në Fr. ar 20.000.

2. — Këjo ligjë hyn në fuqi që dit/n e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

3. — Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pranojmë këtë ligjë t'aprovuëme prej Dhomavet Legjislative dhe dekretojmë zbatimin e saj.

A. ZOGU
*Kryetari i Republikës*

Tiranë, me 5 XII-925

*Ministri i Financavet*
S. STAROVA

Mbi shpërblimin e Kryetarit të Republikës

Shqiptare prej asaj të Shtetevet të Bashkuem tue pritun lidhjen e traktatit të nalt-përmendun, interesat Amerikane në Shqipni do të kenë traktamentin e kombit ma të favorizuem ashtu edhe interesat Shqiptare n' Amerikë.

3. — Kjo ligjë hyn në fuqi që prej ditës së shpalljes.

4. — Ministria e P. të Mbrendshme e Ministrija e P. të Jashtme ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pranojmë këtë ligjë t' aprovueme prej trupave legjislative dhe dekretojmë zbatimin e saj.

A. ZOGU

Tiranë, me 21-XII-1925

*Zav. Ministri i P. të Jashtme*
*dhe Zav. Ministri i P. të Mbrendshme*
*Ministri i P. Botore e Bujqësis*
MUSA JUKA

---

## Nr. 112.

SHTOJCË-LIGJI, 22 Dhetuer 1925.

### Mbi ndryshimin e § 1 t'art. 5 të ligjës mbi organizimin e gjykatave

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 28 Dhetuer 1925, Nr. 89)

Shtojcë ligjë e ndryshimeve të paragrafit I. t' art. 5 të bamuna me datë 26 VII-1925, të ligjës mbi organizimin e gjykatavet me datë 28-I-1925.

I. — Antarët dhe ndihmës antarët e diktimit të nji dege në rast nevoje të degës tjetër, janë të detyruem të marrin pjesë dhe në këtë degë.

II. — Ministria e Drejtësisë ngarkohet me zbatimin e kësaj shtojcë-neni.

III. — Kjo shtojcë hyn në fuqië që nga dita e shpalljes.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pëlqejmë këtë ligjë të pranuëme prej trupave legjislative dhe dekretojmë zbatimin e saje.

Tiranë, me 22-XII-1925.

A. ZOGU

*Zav. Ministri i Drejtësisë*
*Ministri i Financavet*
S. STAROVA



DAP

– 473 –

**Nr. 113.**

LIGJË, 22 Dhetuer 1925,

**Mbi veprimet e Konsullatës së Stambollit**

[illegible]

1. – Të gjith veprimet e konsullatës së Stambollit, në perindhën e sypëtimimit të saj, njifen të ligjëshme.

2. – Kjo ligjë hynë fuqie që ditën e shpalljes.

3. – Ministeia e P. të Jashtme dhe ajo e Drejtësies ngarkohen me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pranojmë këtë ligjë t'aprovuem prej trupave ligjislative dhe Dekretojmë zbatimin e saj.

Tiranë, 22-XII-1925 — A. ZOGU

*Ministri i P. Botore e Bujqësis*
*Zav. Min. i P. të Mbrendshme*
MUSA JUKA

*Zav. Ministri i Drejtësis*
S. STAROVA

---

**Nr. 114.**

LIGJË, 12 Dhetuer 1925.

**Mbi krijimin e një Drejtorie Politike në Ministrin e P. Jashtme**

[illegible]

1. – Krijohet nji Drejtorië e P. Politike në Ministriën e P. të Jashtme.

2. – Rroga e Drejtorit do të jetë prej Fr. ari 450.

3. – Për t'i bamë ballë pagesës së rrogës së Drejtorit deri në fund të vitit financjar 925-926, transferobet nji shumë prej 2250 Fr. ari nga kursimet e Kredies së Legatës së Bukureshit, Sofjes e Konsullatës së Wienes n'art. „Rroge të Buxhetit të Ministries së P. të Jashtme.

4. – Kjo ligjë hynë në fuqi që ditën e shpalljes.

5. – Ministria e P. të Jashtme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, pranojmë këtë ligje t'aprovuem prej trupavet legjislative dhe Dekretojmë zbatimin e saj.

Tiranë më-22 XII-925 — A. ZOGU

*Zav. Ministri i P. të Jashtme*
*Ministri i P. Botore e Bujqësis*
MUSA JUKA

*Ministri i Financavet*
S. STAROVA

Dekretligje Ligje e Rregullore të vitit 1925, Tiranë, 1938
*Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë*



KOMBETARE
89
R
118

UBLIKA SHQIPTARE

MINISTRIA E FINANCAVET

DREJTORIJA E T'ARDHURAVET

# Ligjë

e

**Administratës Civile e Republikës Shqiptare**

Shtypshkroja Nikaj Tiranë

310
96
L 10

# Ligjë

## e Administratës Civile e Republikës Shqiptare

### Krye I.

**Ndasija Administrative**

Art. 1. Shqipnija asht e ndame në Prefekturat në Nenprefektura, dhe këto në Krahina e Krahinat në Katunde.

Art. 2, Krpetari i Administratës Civile në Prefekturë asht Prefekti, në Nenprefekturë Nenprefekti, në Krahinat Krakinari, dhe në Katunde Plaku i Katundit.

Dëtyrat e Nenprefekturave të qendres nër Prefektura i ngarkohen Prefektit.

Art 3, Ç'do organizim dhe ç'do ndryshim i lidhnis së Nenprefekturave e ndrim qendrave nuk mund të bahet veç se me ligjë.

### Krye II.

**Nëpunësat administrorë**

Art. 4. Nëpunsat administrorë janë këto:

Në qendra të Prefekturave: Drejtori i Financavet, Kryesekretari i Prefekturës, Koma-

ndanti i Gjindarmeris, Drejtori i Arësimit ose i shkollës, Kryenëpunsi i P. Botore, Bujqësis, Kadastres, Komiser i Policis, Nëpunësi i Shtetit Civil, Mjeku i Qeveris e i Karantines, Kapiteni i Portes e të tjerë qi mundet të krijohen.

Në qendrat e Nenprefeturavet: gjithë ata kryetarët e Zyrave qi u përmenden për Prefekturat, dhe që ka në Nenprefektura.

Ner Krahinat, për veç krahinarit ndodhet nji post-komandant dhe si mbas nevojes nji Sekretar i Krahines dhe Komiseri i Policis.

Art 5. Në ç'do qender të Prefektures e të Nenprefektures ndodhen nëpunsa të Drejtësis, t'Ushtris, e të Doganës, Post-Telegrafavet ashtu dhe si mbas nevojes nëpunësa dhe sekretarë të tjerë.

Art 6. Mënyra e zgjedhjes, emnimit dhe gradimit të nëpunësavet ashtu gjobitja e pushimi i tyne regullohet me ligjë e regullore të posaçme të ç'do Ministrije.

## Krye III

### Mënyra e heqjes e të pezullimit të nëpunësavet.

Art. 7. Prefektat në rasë të nevojës, tue tregue arsyena ligjore dhe justifikuese, mund të

kerkoinë prej Ministris kompetente pushimin e ç'do nepunësit qi ndodhet në qarkun e asaj Prefekturë. Kur Ministrija kompetente arsyenat e treguame nuk i shef të mjaftushme, çeshtjen ja referon Keshillit Ministruer dhe lajmron Prefekturën përkatse. Në rasë qi Ministrija kompetente nuk e merr para sysh drejtimin e Prefektit dhe nuk i përgjigjet mbrenda në nji muej e qi ky nepunës të jetë shef i nji Zyres, Prefekti tue marrë responsabilitetin për siper, mund t'a pezulloj nga puna nëpunësin në fjalë.

Art. 8 Prefektat absolutisht kanë të drejten e pezullimit mbi nëpunsat qi nuk janë shefa zyrash, gjith ashtu kanë ketë të drejtë edhe mbi ata nepunësa qi janë shef zyre dhe qi vazhdimi i tyre në detyrë duket se asht kundra qetësis lokale e interesavet shtetnore. Në ketë rasë lajmëron me nji herë Ministrin kompetente.

Gjykatësit dhe nepunsat e tjerë të Drejtësis si dhe Ushtrija përjashtohen nga kjo dispozitë.

Art. 9. Tue përjashtue nepunësat e Drejtësis, Prefektat kanë të drejtë të zbatojnë drejt përsdrejti dënimet disiplinore mbi gjith nëpu-

nësat civil që nuk janë shefa zyrash tue u marrë veshtë me shefin e tyre. Për kategorin ma të naltë tue u marrë veshtë me Ministri ku mvàren ata nepunsa.

Art. 10 Prefektat kanë të drejtë me vuem në korent Ministrin e Drejtësis, mbi veprimet e nepunsavet t'asaj Ministrje. Në zyrat dhe për nepunsat e tjerë Prefekti ka të drejtë të bajë hetime vetë ose me anë t'inspektorave të zyrave përkatëse ose me anë të nji nepunësi t'autorizuem prej tij për ketë qellim.

Art. 11. Fuqija e Policis dhe e gjindarmeris absolutisht jan nen urdhain e Prefektit e të Nenprefektit.

Art 12 Kush të shofii ose të marrij vesh paudhësit e veprimet e jashtligjëshme të nepunsavet, asht i lirë me u ankue ose me lajmërue syperiorin e tij me shkresë ose gojës; ankuesi ose lajmëruesi asht i detyruem me difìue emnin e indentitetin e vet.

Art. 13 Në dalshin të verteta ankimet ose lajmërimet e bamuna kundra nepunësit fillojnë gjyrmimet ligjore përkundrazi nepunësi i akuzuem ka të drejtë t'i drejtohet gjyqit kundra ankuesit.

Art. 14 Kur merret vesh paudhësi ose keqpërdorim i detyres të nji nëpunësi veprohet mbas ligjës mbi gip'imiu e nëpunësavet.

## Krye IV

### Detyrat e Prefektit e të nënpunësave të Prekaturës.

Art. 15. Prefekti mbrenda në qarkun e Prefekturës asht ma i madhi nepunës i Pushtetit përmbaru's dhe përfaqësues i gjith Ministrive; ay asht përgjegjes prej Administratës së përgjithshme të Prefektures.

Art. 16 Prefekti asht i detyruem me sigurue shpalljen dhe zbatimin e ligjëvet dhe të regullorevet të Shtetit; me përdorë kompetencat e me plotsue detyrat të ngarkueme me ata, me mbrojtë të drejtat e Shtetit dhe të popullit, me i zbatue gjithë urdhënat e instruksjonet të Ministrivet.

Art. 17 Ç'do ligjë e regullore qi do të vehet në zbatim, u komunikohet zyravet të ndryshme vetëm me anë të Prefektave. Vendimet dhe instruksjonet qi u takojnë ligjëvet dhe regullorevet e qi kanë me u komunikue prej Ministrivet kompetente direkt zyravet përkatëse veçanerisht i komunikohen edhe Prefektavet,

Zyrat ne fjalë janë të detyrueme me veprue si mbas urdhnit të dhanun me shkrim nga ana e Prefektit mbi mënyren e zbatimit si të ligje-vet e të regulloreve ashtu dhe t'instrukcjone-ve e vendimeve shtetnore.

Art. 18 a) Sigurimi i qetësis së qarkut të Prefekturës;

b) sigurimi i të drejtavet përsonale dhe të pronësis dhe të bazavet të liris, njisis, drejtë-sis;

c) përgatitja e mjetevet përparimtarë për zhdrivillimin ekonomik dhe shoqnuer të popu-llit;

ç) sigurimi i përhapjes s'arësimit botuer;

d) kujdesimi mbi përhapjen e tregtis, indu-stris, bujqesis, të ruejtunit e shodetësis së për-gjithshme;

dh) kontrollimi i Bashkivet, i komisjonevet të ndryshme si mbas ligjëvet relative e vrej-timi i burgjeve;

e) kujdesimi mbi instalimin të emigranta-vet dhe përmirësimi i gjendjes tyne; janë nga detyrat kryesore të Prefektavet.

Art. 19 Gjithë zyrat e ndryshme të Prefe-kturës janë nën kontrollimin e survejancen e Prefektit, për veç drejtësis dhe ushtris.

Art. 20. Ruejtja e qetësis i përket drejt për së drejti Prefektit, ket detyrë e përmbush me anë të policis e të gjindarmeris dhe me anë të nenprefektavet e të krahinarëvet.

Art. 21. Fuqija e gjindarmeris dhe e policis janë të detyrueme me zbatue pa as nji të drejtë kundershtimi urdhnin e Prefektit. Këta vetëm mund të kerkojnë urdhnin me shkresë.

Art. 22. Në rasë të nevojës e kur parashifet nji rrezik i cili kercnon qetësinë publike, Prefekti ka të drejtë me perfitue edhe prej fuqisë ushtarake qi ndodhet në qarkun e vet tue lajmërue për njiheresh Ministrin e P. të Mbrendëshme. Komandanti i fuqisë në fjalë asht i detyruem me ekzekutue urdhënin e Prefektit, të dhanun me shkresë, kur se nuk ndodhet ose nuk asht e mjaftueshme dhe fuqija ushtarake e atij qarku, Prefekti me nji heresh lajmëron Ministrin e P. të Mbrendshme.

Art. 23. Prefekti asht i detyruem me marrë masat e duhuna për të ndaluem kondrabanden doganore e gjithe farësoj kondrabandash tjera. Autoritetet detare e doganore janë të detyrueme me respektue urdhnat e Prefektit të dhanun me shkresë për ketë qellim.

Art. 24 Prefekti ashtë i detyruem me ba-mun inspektim dhe shetitje në qarkun e Pre-fekturës së ç'do tre muej tue lajmërue Mini-strin dhe në fund të ç'do shetitjes Prefekti i paraqit Ministris raportat e pregatituna mbi nevojat e situasjonit të çdo vendi.

Art. 25 Prefekti asht i detyruem me i dhanun gjykatësvet gjithë ndimat e nevojshme për sigurimin e shpejtimin e gjyqevet dhe për zostimin e përmbarimin e vendimevet të gjy-katores.

Art. 26. Për sendet qi nuk i janë lanun në kompetencen e tij, Prefekti kerkon instruk-cjonet e duhuna prej Ministris Kompetente.

Art. 27 Çdo nepunës për veç qi asht i ngarkuem me përmbarue detyren e vet si mbas ligjes por detyrohet me i plotësue edhe urdhë-nat dhe porosinat ligjore të Prefektit.

Art. 28 Kryetarët e Zyravet të ndryshme janë të detyruem me bamun shqyrtimet e ne-vojshme dhe me dhanun mendimet e veta mbi ç'do punë qi ka me i u referue atyne nga ana e Prefektit.

## Krye V.

### Detyrat e nenprefektave

Art. 29. Nenprefekti asht i përgjegjshem

nga administrata e përgjithshme e Nenprefektures dhe asht ma i madhi nepunës i fuqis ekzekutive (zbatuese) e[illegible], asht i detyruemun me ruejtun të drejtat e Shtetit dhe të populli, me sigurue zbatimin e ligjëvet plotësisht dhe me përdorue kompetencën qi i ka ngarkue ligja.

Art. 30. Gjith zyrat administrative të Nenprefektures janë nen vrojtimin e Nenprefektit.

Art. 31 Nenprefekti asht përgjegjes nga qetësija e qarkut të Nenprefektures; ket detyrë e përmbush me anë të Krahinarëvet dhe me anë të policis e Gjendarmeris së Nenprefektures.

Art. 32. Policija dhe Gjindarmerija e Nenprefektures në detyrat policore të Nenprefektures janë të lidhun te Nenprefekti dhe janë të detyrueme absolutisht me zbatue urdhënat e tij.

Art. 33. Në rase eksira-ordinare dhe kuer nuk mjafton fuqija e Gjindarmeris, Nenprefekti asht i lejuem me përdorue fuqinë ushtarake qi ndodhet në qarkun e v.t. Komandantat e fuqis në fjalë janë të detyruem me zbatue urdhënin e dhanun. Këto vetem mund të kerkojnë urdhën me shkresë.

Dekretligje Ligje e Rregullore të vitit 1925, Tiranë, 1938
*Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë*

Art. 34 Me përjashtimin e rasievet ekstraordinare, Nenprefektat korespondojnë vetem me Prefekturen ku janë të varun.

Art. 35 Nenprefekti detyrohet me bamun në ç'do kater muej nji udhëtim në qarkun e vet me qellim qi t' i kontrollojë Krahinat dhe t'i shetisin katundet. Në këto udhëtime Nenprefekti digjon ankimet e popullit, u jep instruksjonet e duhuna Krahinarëvet dhe pleqësivet të katundevet mbi detyrat e tyne, kontrollon dhe siguron qetësin publike dhe të drejtat private e të pronësis, përmbushë detyrat e ngarkurme mbi kqyrjen e çeshtjevet arësimore, bujqesore, botore, dhe shëndetësije, kontrollon vendimet e Këshillavet të Krahinavet. Nenprefekti lajmëron Prefekturen mbi përfundimin e inspektimit me nji raportë të posaçme.

Art. 36. Nenprefektat kanë të drejtë të ven në kurent Ministrin e Drejtësis mbi veprimet e nenpunësavet qi mvaren nga ajo Ministri.

Art. 37 Nenprefekti e ka për detyrë me dhanun ndihmat e duhuna për zbatimin e përmbarimin e vendimevet të gjykatores.

Art. 38 Nenprefekti asht i detyruem me vrejtun burgun, me siguruem zbatimin e rre-

gullores së burgut dhe me ba përmirësimet e nevojshme.

Art. 39 Nenprefekti detyrohet me lehtsue zbatimin e ligjes së rekrutimit, me zbatue rregulloren e Shtetit Civil, me përmbarue gjithë urdhnat e Prefektit, dhe me kontrollue Bashkiet.

Art- 40 Asht në kompetencen e Nenprefektit me zbatue dënimet disiplinore mbi nëpunsat qi nuk janë shefa zyre tue ja njoftue Prefektit.

Për nepunësat që janë shef zyrëje kerkon dënimin e duhun prej Prefektit.

Art. 41 Gjith nepunsat e Nenprefektures janë të detyruem me dhanë mendimin e vetë, dhe me bamun shqyrtimet e duhuna mbi çeshtjet qi pyeten nga ana e Nenprefektit.

## Krye VI

### Detyrat e Krahinarvet

Art. 42 Krahinari asht ma i madhi nepunës i krahines dhe gjendarmerija e policija qi ndodhen n'atë rreth janë nën urdhënin e tij; këta detyrohen me zbatue të gjitha urdhënat qi ka me dhanë krahinari; përveç kësaj Krahinari mbi nepunsat e zyravet të tjera qi gjinden në rrethin e tij ka të drejtë vrejtimi.

Art. 43 Detyrat e Krahinarit janë këto:

a) të ruej qetësin, kur të ndodhet ndo nji ngiarje, si të lajmërojë në ças Nenprefektin e autoritetin gjyqësuer të bajë hetimet e gjyrmimet e nevojshme për të zanë fajtorin;

b) të shpalli ligjët e rregulloret e Qeveris.

c) të mbarojë detyrat qi i përkasin Shtetit Civil;

ç) kur vdes ndonji njeri pa trashigimtarë të lajmërojë zyrat e kadastres të Nenprefekturës:

d) t'i u ndihmojë tagra-mbledhësve

dh) t'i u ndihmojë nepunësat të drejtësis dhe çfardo nepunësi qi vjen në Krahinë.

e) të veprojë bashkë me këshillin e krahinës për të mbaruar detyren e Bashkis në atë vend qe nuk ka Bashki.

ë) të mbarojë detyrat qe u ngarkohen krahinarvet në ligjët e rregulloret e Qevëris.

f) të mbledhij ushtarët e veglat e transportit qi kerkohen në kohen e vazhdimit të veprimevet ushtarake;

g) të kujdesohet për rrugat e urat, për vijat telegrafike e telefonike.

gj) të sigurojë pastrimin e zbukurimin e katundeve.

h) të kontrollojë vazhdimin e mësuesve në shkollë dhe të shtrengojnë prindërit e nxansavet qi t'i degojnë fëmijën e tyne në për shkolla.

i) në rastin e të përhapunit të ndonji semundje të lajmerojë në atëças Nenprefekturen.

j) të ndalojë pergjithsisht kondrabanden.

k) të shtyjë popullin për me zhvillue bujqesin e për me mprue pyjet, kur shef nevojë çel proje dhe pusa e mbledh e çon puntorët e rruges.

l) të mbajë drejtimin e duhun mbi njerzit të pa njoftun qi shetisin në rrethin e krahinës së tij.

Art. 44 Krahinari përmbaron gjithë urdhënat e Nenprefektures, kontrollon veprimet e Këshillavet të pleqsis dhe rregullon e kontrollon zgjedhjen e krynevc.

Art. 45 Krahinari merr para sysh dhe i reporton Nenprefektures ç'do ankim të popullit kundra nepunsavet të ndryshme.

Art. 46 Krahinari kryeson Këshillin e Krahines dhe vendimet e saj i ekzekuton.

## Krye VII

### Këshillat administrative

Art. 47 Në qender të ç'do Prefekture dhe Nenprefekture ndodhet nji Këshillë administrative. Kjo Këshillë në Prefekturat nen kryesin e Prefektit osë zavendësit të tij, përbahet prej drejtorit Financave, Kryesekretarit të Prefektures, nepunësit ma të naltë të botores, e të Bujqesis, e atij t'Arësimit dhe prej kater antarëve të zgjedhun prej popullit, Komand. i Gjendarmeris. Në nenprefekturat nën kryesin të Nenprefektit osë zevendësit të tij përbahet prej Kryenëpunësit të Financavet, Sekretarit të Nenprefekturës, Komandantit të Gjindarmerifs dhe ku ndodhet nepunsit ma të madh të Botores, e Bujqesis, e Kryenëpunsit të shkolles, dhe prej dy antarve të zgjedhun prej popullit. Këto nënshkruejnë vendimet si mbas klasit të nepunsis së tyne.

Art. 48. Krye tarët e zyrave qi nuk kanë pjesë në Këshillat Administrative thrriten në Këshillat vetem për çeshtjet qi u përkasin zyravet të tyne dhe nenshkruajnë vetem vendimet përkatëse të këtyne çeshtjeve.

## Krye VIII

### Mënyra e zgjedhjes s'antarvet të Këshillës Administrative

Art. 49 Antarët e Këshillës Administrative të Prefekturës zgjidhen prej Kryeplakut të ç'do katundi të rethit të Prefekturës dhe të lagievet tue marrë piesë dhe Këshilli i Bashkis, Antarët e Këshillës Administrative të Nenprefekturave zgjidhen prej Krye-pleqvet të ç' do katundi të Nenprefekturës e të lagievet tue marrë piesë dhe Këshilli i Bashkis nder ato vise qe ka Bashkina

Art. 50 Zgjedhja bahet ne diten e caktuar prej autoritetevet administrative, me vota të mshefta nën Kryesin e Gjykatësit ma të naltë të Prefekturës ose të nenprëfekturës.

Nder ato vise qe nuk ka ende gjykatore, zgjedhjet i kryeson autoritetii ma i naltë i Administrates s' atij vendi.

Art. 51 Antarët e Këshillit Administruer zgjidhen për dy vjet.

Art. 52 Për me u zgjedhë antar në Këshillin Administruer duhet me i pas mbushun të 25 vjeçtë, dhe mos me qenë i denuem me ndonji burgim ma shumë se nji vjetë ose për nji kohë ma pakë për vjedhje, çeshtje nderi,

shperdorim besimi dhe duhet të dijë me shkrue e me këndue gjuhen zyrtare e të jetë me eksperiencë.

Art. 53 Kânditaturat i parashtrohen prej t'interesuemit ose prej pesë pleqvet, me shkresë, autoritetit administruer të vendit gjer diten e zgjedhjes.

Art. 54 Diten e zgjedhjeve të mbledhjes ju këndohen emnat e gjithë kandidatëvet; ç'do votues ka të drejtë të votojë 12 vetë për Prefektura, dhe 6 vetë për Nenprefektura.

Art. 55 Antarët e Këshillit Administruer të Prefekturave, dekretohen prej Ministrit të P. të Mbrendëshme tue u zgjedhë kater nga të dymbëdhjetët dhe ata të Nenprefekturave, prej Prefektit tue u zgjedhë dy nga të gjashtet.

Art. 56 Antarët e Këshillit Administruer të zgjedhun prej popullit që pa shkak ligjuer mungonë radhasi në tri mbledhje konsiderohen të rëzuar nga detyra.

Kur nji antar 'i Këshillit Adminitruer mbetet vakant, zgjidhet prej Ministris së P. të Mbrendshme ose prej Prefektit nji tjetër nga atâ qi u shenuen n'art 55.

## Krye IX

### Detyrat e Kёshillave Administrative

Art. 57 Detyrat e Kёshillavet Administrative janё kёto.

a) tё bamunit e çfardo ankanit (shtim ose paksim)

b) tё pregatitunit e kontratave e tё caktuemit tё konditave, tё shitunit e tё dhetavet qeveritare mbas ligjёvet e regullorevet pёrkatёse.

c) pёrdorimi me besim (emanet) i tё dhetavet tё katundevet qi nuk mund tё shiten;

ç) tё shitunit me adjudikatё tё produktevet tё pyjeve tё qeveris;

d) survejanca mbi gjithё pasunit e lujtёshme e tё pa lujtёshme tё Shtetit,

dh) shqyrtimi i listave qё kanё me u paraqitun nga ana e zyravet çeveritare:

e) tё mbaruemit e detyravet qi i ngarkohen Kёshillit me ligjёt e tjera

Art. 58 Vendimet e Kёshillavet tё Bashkis apelohen nё kёshillin administrativ tё vendit deri nё pesё ditё pas komunikimit dhe diktohen: tё Prefekturavet nё Ministrin e P. tё Mbrendёshme tё Nenprefekturave nё Prefekturen deri nё 10 ditё pas komunikimit.

Art. 59 Vendimet e Këshillavet të Nenprefektures apelohen në Këshillë të Prefektures, deri në pesë ditë mbas komunikimit e marrin formen e preme, dhe ato të Prefektures për deri sa të formohet Këshilla e Shtetit, apelohen në Këshillin Ministruer deri në pesë ditë pas komunikimit e marrin formen e preme.

Vendimet qe nuk kanë marrë ende formen e preme pa marrë nji garanti nuk ekzekutohen deri sa të mbarrin atë formë.

Art. 60 Anëtart e Këshillit Administrativ janë të përgiegishëm për vendimet qi apin.

Art. 61 Vendimet merren me shumicë votash dhe në barasim të votave preferohet ana që përkrah Kryetarin e Këshilles.

Art. 62 Në qoftë se t'interesuemit lypin kopjet e vendimit, mundet me ju dhanë pa qenë nevoja me pague as nonji taksë veç se tue ngjitë pullen e nevojshme.

Art. 63 Ata qi kundershtojnë ose pengojnë zbatimin e nji vendimi të Këshilles ose nuk i binden nji urdhënit qe epet nga nepunësat ma të naltë t'Administratës, tue u bazue në ketë ligië, me vendimin e Këshilles Administrore denoheo me nji giobë 30 — 100 fr. ari.

Ky vendim asht i premë dhe zbatohet me nji herë; ata qi nuk ndigjonë me pague gjoben në fjalë, Këshilla Administrative vendos burgimin e tyne tue llogaritë për 10 fr. ari nji ditë burgim. Koha e burgimit nuk mund të jetë ma shumë se pesë ditë dhe ekzekutohet vetem më shkresen e Prefektit ose të Nen-prefektit. Për ata qe përsëritisin fajin, gjoba dhe burgimi dyfishohet.

Art. 64 Kompetenca e caktueme n'art 63 për këshillat administrative kufizohet vetem nder ato çeshtje për të cilat në ligjët e tjera nuk shenohet ndo nji ndeshkim i posaçem.

## Krye X

### Këshillat e krahinave dhe detyrat e tyne

Art 65 Në ç'do Krahinë nodhet nga nji këshillë krahinore dhe antarët e kësaj zgjidhen me vota të mshefta prej këshillavet të pleqësis së katundevet t' asaj Krahinë. Këshillat përbahen prej kater vetash dhe emnohen me dekretin e prefektit.

Art. 66 Këshilla krahinore mblidhet nen Krypesin e Krahinarit ose zevendësit të tij dhe bisedon çeshtjet qi i parashtrohen prej Kra-

hinarit; vëndimet meren me shumicë votash dhe në barasim të votave ana qi gjindet Krahinari preferohet.

Art. 67 Këshillat krahinore janë të ngarkueme të kontrollojnë llogarinat e pasunis së katundeve.

Art, 68 Këshillat Krahinore mblidhen nji herë në javë rregullisht.
Kur të jetë nevoja mblidhen edhe ma shpesh.

Art. 69 Këshilla e Krahines e ndihmon Krahinarin mbi të kryemit e detyravet të shenueme n'art 43 të kësaj ligjë.

Art. 70 Këshilla Krahinore ka të drejtë të vendosi gjobitjen me 5 – 20 fr. ari ose burgosjen me 24-48 orë t'atyneve qi kundershtojnë dhe nuk i binden vendimit të Këshilles ose nji urdhnit ligjuer të Krahinarit. Vendimet kësodore janë të preme dhe zbatohen me nji herë.

Art. 71, Vendimet e Këshillavet mbahen rregullisht në nji liber të posaçem dhe shkurtimet e atyne vendimeve qi shenohen n'art 70 në fund të ç'do muejit me nji raport të veçant i njoftohen Nenprefekturës.

Art. 72 Gjobat e mbledhuna do t'i dorzohen nji antari të Këshilles i autorizuem prej

sajë dhe në fund të ç'do muejit i derdhen n'arkë të Financavet kundrejt nji dittesë të posaçme prej tij.

Art. 73 Këshillat e Krahinavet ndermjetsojnë edhe për zgjidhjen e konfliktetëve në çeshtje taksash e tj. qi ngjajnë në mes të popullit.

Art. 74 Nder ata vise qi nuk ka krahina detyrat e Këshillit të Krahines i përmbushë Këshilla Administrative.

## Krye XI

### Pleqësija e katundevet dhe detyrat e sajë

Art. 75 Ç'do katund e lagje asht e detyrueme me pasë nji pleqësi të zgjedhun e përbame prej nji plaku, dhe prej antarve.

Ato katunde qi kanë ma shum se 100 frymë pleqësija formohet prej nji plaku dhe katër antarëve, ato katunde qi përbahen me ma pakë se 100 frymë, pleqësija formohet prej nji plaku dhe dy antarëve.

Kur nji katund ka lagje të veçanta dhe këto lagje përmbahen të pakten prej 100 frymëve, me pelqimin e administratës mundet të zgjedhin pleqësi të veçanët nga katundi qe mvaren.

Art. 76 Pleqësit e katundevet në krye të motit zgjidhen nga populsija e atij katundi që kanë mbushur të 20 vjeçtë.

Zgjedhjet bahen nen vrejtjen e nepunësit t'emnuem possaçerisht prej autoritetit administruer tue u ndodhë dhe pleqësija e parë e katundit.

Mbasi të mbarohen zgjedhjet mbahen dy procesverbale të nenshkruem prej nepunësit dhe pleqësis së parë, njeri prej këtyne procesverbaleve i çohet autoritetit administruer që varet katundi, dhe tjetra i lehet pleqësis.

Art. 77 Prefekti ose Nenprefekti zgjedhë plakun e katundit midis trevet qi kanë fituar votat ma të shumta.

Art. 78 Për me u zgjedhë plak, ose antar në pleqësi, duhet me i pasë mbushun 28 vjeçtë dhe mos me qenë i denuem me ndonji burgim ma shumë se nji vjet ose për nji kohë ma pak për vjedhje, çeshtje nderi, shperdorim besimi.

Art. 79 Kur bahen zgjedhjet mbas deshires së popullit caktohet edhe sasija, e proporcjoni i pagesës, qi ka me u bamun pleqësis, dhe shenohet në procesverbal tue i lidhun

edhe listen e duhan. Pagesa në rasë kundershtimi mblidhet prej anës administrates. Veç kësaj pagesë nuk kanë të drejtë me lypë kurgja prej katundarve; në daçin pleqtë mundet të sherbejnë edhe pa pagesë.

Art. 80 Aktet qe lëshon pleqësija, nuk kanë vlefte pa patur vulen e pleqësis dhe firmen a plakut dhe të pakten firmen e gjysmes t'antarvet.

Ata që kanë ndonji kundershtim, firmojnë mbassi të shkruajnë pikpamjen e tyne.

Për ç'do akt qe lëshon pleqësija asht përgjegjëse edhe si nepunës.

Art. 81 Lagjet e qytetevet konsiderohen, si nji katund.

Art. 82 Në ç'do katund ndodhen edhe rojtarë si mbas nevojes të cilët zgjidhen nga ana e pleqësis, dhe emnohen prej Qeveris, tue i dhanë leje për mbajtje armësh. Rojtarët kanë për detyrë të rujtunit e pyjevet, aravet, kopshtavet, të rujtunit e qetësis, dhe të zanunit e fajtorëvet. Rrogat e këtyne caktohen edhe sigurohen prej katundit. Rojtarët e katundeve nuk mund të përdoren prej gjindarmeris, për veç se kur të jetë nevojë për stabilizimin e qetësis.

Art. 83 Detyrat e pleqësis janë këto: Sigurimi i qetësis dhe i pastertis së katundit, të rujtunit e godinavet të përgjithshme si shkollë etj., sigurimi i të çuemit të çunavet e të gocavet të katundit në shkollë, të lajmëruemit e krahinarit e të kadastres për pronat e mbetuna pa trashigues, të rujtunit e pyjevet qi ndodhen mbrenda në kufi të katundit, të ndihmuemit për të mbledhunit e tagravet qeveritare, të lajmuemit e krahinarit mbi ngjarjet e shtetit civil si lindje vdekje, ndarje, transferim, kujdesim; për ndreqjen e rrugavet të katundit, për shtimin e gjasë gjallë, dhe përparimin e bujqësisë e tjera; me i mbajtë rojtarët e katundit në vjejtje dhe me i u dhanë urdhnat e duhuna; me mbledhë ushtarët dhe veglat bartëse për ushtrinë në kohen e veprimeve ushtarake, e të vendosunit e ushtarve; me i shpallë popullit ligjët, rregulloret, dhe urdhënat qeveritare; shpejtim i lajmërimit të vendimeve të gjykatores, nzânja e kriminelve dhe e fajtorëve me ndihmen e rojtarëve, dhe të popullit e dorëzim' i tyne autoritetit kompetent.

Art. 84 Pleqësija paqton ngatresat qi lindin midis katundeve.

Art. 85 Pleqësija asht e detyrueme të ruejë gjithë aktet dhe të mbajë nji tefter për të regjistrue veprimet e saja.

Art. 86 Pronat e katundit si kullotat, pyjet e tjera do të regullohen nga ana e Pleqësis.

## Krye XII

### Mbledhja e pleqësis

Art. 87 Në fillim të çdo mueji ose në nji ditë të shenueme, gjithë pleqt e katundevet nen Kryesin e Krahinarit ose të Nenprefektit mblidhen në qendre të Krahinës, ose të Nenprefekturës. Në ketë mbledhje tregohen gjith deshiret e ankimet e nevojat e popullit dhe pa as ndonji ndryshim gjithë bisedimet shkruhen në nji proces verbal, kopja e të cilit pa vonesë i çohet Prefekturës. Në këtë mbledhje Qeverija çfaq e shpiegon ligjët dhe regulloret e reja dhe urdhënat e saj.

Art. 88 Dispozitat e ligjës provizore t'administratës me datë 8-3 922 dhe dispozitat e tjera qi janë në kundershtim me ketë ligjë anulohen.

Art. 89 Kjo ligjë hynë fuqi 15 dit mbas shpalljes në fletoren zyrtare Nr. 57 d. 30-V-928).

— 28 —

Art, 90 Trupi Ministruer detyrohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

Mbasi trupi legjislativ ka votuem;

Mbi proponimin e Këshillit Ministruer;

DEKRETOJMË

zbatimin e ligjës mbi Administraten civile.

Tiranë, me 23 maj 1928.

A. ZOGU

Ministri i Drejtësis:
H. Delvina

Ministri i Arsimit:
Xhafer Ypi

Ministri i P. të Jashtme
I. Vrioni

Ministri i P. të Mbrendshme:
K. Kotta

Ministri i Financavet
Zav. Min. i Bujq. e Pyjevet:
M. Tutulani

Ministri i P. Botore:
S. Vuçitërni

Ligji i Administratës së Republikës Shqiptare të vitit 1928
*Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë*



BIBLIOTEKA KOMBËTARE TIRANË

...blika Shqiptare

...STRIJA E P. TË JASHTME

# DISPOZITA TE PERGJITHESHME

MBI

## Regulloren e pergjithëshme e ceremonisë

Shtypshkroja Nikaj Tiranë 1928

# DISPOZITA TË PERGJITHESHME

mbi

# Regulloren e pergjithëshme e ceremoniës

## Titri i I.

### PER RRALLET E PARANDEJNEVET

### Seksioni i I.

**Per radhet e trupavet dhe autoritetevet në Ceremoni publik**

Art. I. Kur trupat dhe autoritetet janë mble-dhurë së bashku me akt të Qeverisë në cere-monië publike, ata marrin vend në mënyrë të posht-tregueme:

**Në Kryeqytet:**

1) Krpetari i Senatit;
2) Krpetari i Dhomës së Deputetve;
3) Ministrat;
4) Senatorët;
5) Deputetët;
6) Komandanti i P. i Fuqis Armate dhe i Gjëndarmarisë, Krpetari i Shtatit Madhnuer,

Inspektori i P. i Uhtërisë e ay i Gjendarmarise, Komandanti i Shkollës Ushtarake, Nen-Komandanti i Qendrës;

7) Kryetarët e besimevet;

8) Kryetari i Degës Civile, Kryetari i Deges Penale të Gjyqit të Diktimit bashkë me Krye prokurorin;

9) Kryetari i Këshillit Kontrollues, Inspektorët e Pergjithshem, Drejtorët e Pergjith. i Postelegrafevet dhe ay i Shëndetsiës, Organizatorët e Ministrive të ndryshme, Sekretari General i Kryesisë Sekretari General i Drejtësis, Sekretari General i Ministris së P. të Jashtme, Sekretari General i Këshillit Ministruer, Shefat e Seksionevet të Ministris së P. të Mbrend e të Ministris së Financavet, Kryekretari dhe Drejtorët e Ministris së P. Botore e Bulqësis, Drejtorët e Ministris së P. Botore e Bulqësis, Drejtori i Bankës Kombtare, Prefekti i Kryeqytetit, Kryetari i Bashkis dhe Parija e vendit të fitueme, Dhoma e Tregtisë;

---

Art. 2. Nde ceremoninat qi flitet në Art. 1, Kryetari i Senatit në vend të cjathitë të

Kryetarit të Republikës, e Kryetari Dhomës së Deputetëvet në të mengjer;

Art. 3. Në prefekturat e Nënprefekturat, në ceremonina publike, Prefekti ose Nenprefekti pret në ketë mënyrë:

1) Senatorët e Deputetët;

2) Kryetarët e besimevet; Gjykatësi i Shkallës së I. i Paqit e Prokurori;

3) Komandantet e Ushtrisë e të Giendarmarisë;

4) Drejtori i Financës, Inspektori i Arësimit dhe Dreitori i P. Botore;

5) Kryetari i Bashkis me Këshillen, e Parija e vendit;

6) Dhoma e Tregëtisë;

7) Komiseri ose Nenkomiseri i Policis e Noteri;

Art. 4. Në Nenprefekturat ceremonia do të riedhi në mënyrë e tregueme të Art. 3 për Prefekturat.

Art. 5. Në rast të fiimevet zyrtare dhe endividuale për bazë radhe do të mirren paraspsh e ndiemja refyeme n' alinjatet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, të artikullit l. e në Pre-

fekturat alo e alinjateve 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, qi permbedhë art. 3 i kësajë rregulloreje.

Sera në të cilen autoritetet ecin dhe marrin vend në ceremonia publike,

Art. 6. Autoritetet e shenueme në nenin 5 të ftuem në ceremoni publike mbeshtillen në vendin e ceremonis dhe zanë vend si mas radhes të shenueme e të tregueme në nenin e siperthanun në mënyrë qi personi të cillit i nepet e drejta e parakalimit do të ketë gjithmonë në krah të diathtë të tij ate qi do të okupoje vendin e dytë, dhe në krah të majtë ate qi do të okupojë vendin e tretë, dhe kështu vazhdon. Në qoftë se gjendja e vendit ku do të bahet ceremonia e lejon, personi i cilli ka të drejtë parakalimi vihet në mest, të tjerët marrin vend rrotull tij si mas rradhes në dy grupe, autoritetet ndalohen në dy grupe, autoritetet civile ndahen në të djathtë, dhe autoritetet civile ndahen në dy grupe, autoritetet civile ndahen në diathtë, dhe autoritetet ushtarake në të majtë tue ruejtun vendin e tyne të rrëfyem n' art. e siper-kaluem. Ceremonia fillon kuer se autoriteti qi okupon ven-

din e parë merr pjesë. Ky autoritet hiqet i pari.

# Titri i II.

## NDEJME CIVILE

### Seksioni i I.

**Kryetari i Republikës**

Art. 7. Kur Kryetari i Republikës niset prej Kryeqytetit per udhtim zyrtar, trupi i Ministravet e percjellin.

Art. 8. Prefekti e prej në kufi të Prefekturës së tij. Se i cilli do Nenprefekt, gjithë ashtu në kufinin e Nenprefekturës së vetë. Kryetari dhe Këshilla e Pashkis e presin në vendin e mbritjes.

Art. 9. Në qytetin ku Kryetari i Republikës qendron ose banon mjaftë ditë, autoritetet dhe trupat e përmendunat n'art. 4 të këtaj rregulloreje, lajmërohen për oren në të cilen Kryetari i Republikës do t'i pranojë, të cilët në oren e caktueme paraqiten mas radhës të caktueme n'alinjatat e art. 4.

Art. 10. Kur se Kryetari i Republikës ka banue në nji qytet diten e hikjes, autoritetet qi kanë dalë me e pritë, gjenden në nisjen e tij gati per me e percjellë.

Art. 11. N'udhëtimet zyrtare të Kryetarit të Republikës parimisht për bazë të mirren rregullat esenciale të caktueme në ketë rregullore, me gjithë ketë mbasi mund të bahen edhe ndryshime mbi ta, programi i ceremonis i paraqitet përpara Shkelqesis së Tij për pelqim e veprohet si mbas modifikimevet qi mund të bejë.

---

## Seksioni II.

### Ministrat

Art. 12. Në kohë të hymjes në nji qytet të nji Ministrit me nji mision zyrtar, pritet në vendin e mbritjes prej Prefektit, Nenprefektit, Kryetarit të Bashkis me Këshillen.

Trupat dhe autoritetet e përmenduna në alinjatat e art. 4 të kësaj rregulloreje lajmërohen per oren në të cilen Ministri ka me i pranue, dhe paraqiten mas rradhes së Kryendenjes e prezantohen.

Art. 13. Krypetari i Bashkis bashkë me Këshillen, në çastin qi Ministri do të niset, shkojnë dhe e percjellin,

## Seksioni III.

### Perfaqësuesit Diplomatike

Art. 14. Ministravet të huej nuk mund të bahen nderimet civile por vetem nderimet bahen kur Ministri i P. të Mbrendëshme miret vesht me ate të Jashtme dhe urdhënohen nderimet.

## Seksioni IV.

### Mbi vizitat qi duhet t'i bajnë autoritetet prefektit dhe Nenprefektit kur mbrin në detyrë.

Art. 15. Prefektat, Nenprefektat kur marrin në dorëzim dyrat e tyne, Drejtorët e zyravet të ndryshme lypset t'ju bajnë vizitat e para dhe këta duhet t'ja u kthejnë. Në rast t'em-

nimit të Kryetarit të ndonji zyre në Prefekturë ose në Nenprefekturë, këta të fundit janë të shtrenguem të vizitojnë ma parë Prefektin a Nenprefektin. Nëpunësit subaltern qi atyne ju mvaren janë të detyruem me ju ba vizita këtyne. Në të dy rastet vizitat duhet të këthehen.

---

# Titri i III:

## NDERIME USHTARAKE

### Seksioni I.

#### Kryetari i Republikës

Art, 16. Kryetari i Republikës kur hyn në nji qytet qi ka ushtri a Gjindarmeri, ose kur vete në sheshin e ushtrimit, të gjithë trupat ushtarake e të Gjindarmeris marrin armët dhe formohen në rreshta në të shkuemit të tij, a po vendosen në vendet e caktueme.

Hidhen 21 topa.

Art. 17. Po sa qi Kryetari i Republikës arrijnë në vendin e caktuem oficieri qi sundon

Garden e nderit, merr urdhënat nga adjutanti i parë i Kryesis së Republikës.

Art. 18. Nji trup ushtarak n'ecje e sipër në qoftë se takon Kryetarin e Republikës, qendron dhe i banë faqe tue i ba edhe veçaneisht nderimet e parashikueme në Art. 17.

Art. 19. Kur Kryetari i Republikës shkon para nji garde ose Poste, trupat marrin armët dhe i japin nderimet e parashikueme në Nenin 17.

Art. 20. Kur Kryetari i Republikës pranon Oficierët e një Garnizonit a të një fushës ushtarake, ata i prezantohen (paraqiten) prej komandantit të ushtërisë me gradë ma të naltë.

## Seksioni II.

### Ministrat

Art. 21. Kur nji Minister hyn në nji qytet me nji mision zyrtar një tubë ushtarësh dhe gjendarmesh marrin armet dhe mbështillen në udhen qi do të shkojë, dhe oficierët e salutojnë.

Ministri sa kohë që do të qendrojë do të ketë një roje nderi.

Edhe trupat Posta a piquet para të cilavet ay kalon, marrin armët dhe japin nderime.

Ministrit në nisjen e tij bahen po ata nderime qi i janë ba në pritjen e tij.

## Seksioni III.

### Senati dhe Dhomë e Deputetvet

Art. 22. Kur Senati a Dhoma e Deputetvet në gjithë trup (encorpe) shkon me nji ceremoni publike i behen gjith ata nderime që u treguene në Art. për Ministrat.

## Seksioni VI.

### Perfaqësuesit Diplomatikë

Art. 23. Nderimet ushtarake nuk u bahen Ministravet të huaj, por vetëm me urdhen Ministris së P. të Mbrendëshme mas nji marrëveshtjes të kësaj me Ministrin e P. të Jashtme,

## Seksioni V.

### Prefektat

Art. 24. Kur Prefektat arrin për heren e e parë në krye vend (qender) të Prefekturës a Nenprefekturës) a kur vizitoinë për heren e parë si cilen do qender (krye vend) të Nenprefekturës ose Krahinavet pranon vizitat e autoritetevet ushtarake e civile qi ndodhen n' ato Qytete.

Art. 25. Në rast të kremtevet dhe ceremonijeve publike, Prefektave u bahen gjithë ata nderime si u treguen n' art. 23 për Ministrat.

## Seksioni VI.

### Kryetarët e Ushtrisë

Art. 26. Kur Komandanti i P. i Fuqis Armate ose i Gjindarmariës a Shtat-Madhnorei a Inspektori i Ushtris a i Gjindarmariës ven me uji vizitë zyrtare në nji vend ku ka ushtri a gjindarmari u bahen nderimet e duhuna si pas rregullit ushtarake.

## Seksioni VII.

### Nenprefektât

Art. 27. Kur nji Nenprefekt arrin për heren e parë në nji Qytet të garnizonit të qarkut të tij, pranon vizitat e autoritetevet ushtarake e civile qi ndodhen n'atë qytet.

## Seksioni VIII.

### Dispozitâ të pergjithshme me nderimet ushtarake

Art. 28. Nderimet ushtarake nuk jepen kur veç se diten.

## TITRI I IV.

### DISPOZITA TË PERBASHKËTA MBI NDERIMET CIVILE DHE USHTARAKE

Art. 29. Në rast të nji misionit ekstraordinar të çuem nga ana e Qeveris atij i bahen gjithë ata nderime të tregueme në artikullin 21.

Art. 30. Nderimet e tregueme në Art. 21 u bahet në asht se me vendimin e Këshillit

Ministruer shpjegohet bara e Misionit e urdhënohet qi t'i bahet edhe kjo.

Art. 31. Nderimet nuk mund të përfaqësohen, me gjith ketë në kohen e nji ceremonije publike, zevendësi okupon vendin e rezervuem për titullarin e asaj nënpuuësije. Por pas rastit qi tregohet n'art. 12 kerkush nëpunës civil e ushtarak, as nji autoritet publik nuk mund të kërkojë as të japi të tjera nderime nga ata qi janë caktue në ketë rregullore.

Art. 32. Vizitat e tregueme në ketë rregullore në çdo mënyrë kthehen mbrenda 24 orve dhe në qoftë se vizita asht ba me emnin e nji grupi i kthehet Kryetarit të Grupit.

## TITRI I V.

## NDERIME FUNERALE

### Seksioni I.

#### Nderime funerale ushtarakë

Art. 33. Jepen nderime funerale nga trupat ushtarake Kryetarit të Republikës, Kryetarit

Senatit, Kryetarit të Dhomës së Deputetëvet, Ministravet, Ministravet Shqiptare (Perfaqësuese) të vdekun në sherbim, Senatorëvet dhe Deputetvet të vdekun në kohën e mbledhjevet në qytetin e në Asamblen ku marrin piesë në mbledhjet, nëpunësave të naltë të vdekun në sherbim në qytetin e në qendren e detyrës, Prefektavet, Nenprefektavet në Prëfekturat e Nenprefekturat si dhe oficeravet të ç'do grade qofshin.

Art. 34. Për Kryetarin e Republikës flamurët dhe standardet t' ushtëris mbainë zië, nderiesat e avulloret qeveritare ngrenë flamurët e tynë për gjysmë.

Gjith trupat e Shtetit mblidhen në funeralet. Nderimet ushtarake jepen prej gjithë ushtërisë, Gjith dispozitat e tjera qi përkasin funeralit e Kryetarit të Republikës si dhe koha e zisë rregullohen prej Qeveris.

Art. 35. Detashmentat qi detyrohen të marrin piesë në funeralet e personavet të shenuem n'art. 33 perbajnë numerin qi vijon:

. Per Kryetarin e Senatit, të Dhomës së Deputetëve, e per Ministrat tri të katertat e Garnizonit.

Per nji Ministër (Përfaqësues) Shqiptare, Prefekt Komandant i P. Ushtëris e Gjindarmariës, dy të tretat e nji Garnizonit.

Art. 36. Per nji Senator të vdekun si mbas konditavet të nenit 33 në qytetin ku bahen mbledhjet e për nji Deputet të vdekun gjithë po me ato kondita në qytetin ku Dhoma e Deputetëvet ban mbledhjet si dhe për nji Nëpunës të naltë të vdekun në veprimin e nëpunësis se tij dhe në në qytetin ku ka nëpunësin nji bataljon.

Art. 37. Per numurin e saktë të Detashmanëvet përmendun në nenin 35 Garnizoni konsiderohet si me qenë maksimum nji divizion.

Në qytet qi nuk ka Garnizoni për veç se nji regjiment a nji pjesë të regjimentit ushtërija e ndodhun në te, mer pjes ku nuk ka sa të ketë.

---

BIBLIOTEKA KOMBETARE
TIRANE

TITRI I VI.

## MÊNYRA E PARAQITJES KREDENCIALEVET TË MINISTRAVET FUQIPLOTË

Art. 38. Paraqitja e kredencialeve të Ministravet Fuqi-plotë bahet si mbas rregullimit posht diftuem :

1. Në diten dhe oren e caktueme qi do të paraqitet nji Minister Fuqiplote, dy automobila do të venë në shtëpi të Ministrit i cili kur të niset me kredencialet do të jetë vetëm në automobilin e parë tue pasun në anë të majtë Shefin e Protokolit, në automobilin e dytë do të jetë përsonali i Legatës dhe kështu do të vie deri në Pallatin Presidencjale.

2. Ministri Fuqiplotë, Shefi i Protokolit, përsonali i Legatës mbasi të vendosin piksëpari në Sallen e Pritjes, Shefi i Protokolit shkonë pranë Shkelqesis së Tij Presidentit të Republikës dhe lajmëronë ardhjen e tyne, si mbas urdhënit qi do të marrinë lajmëronë Z. Ministrë Fuqiplotë dhe tue e shoqëruar ketë çel porten e Sallës Presidenciale hynë mbre-

nda bashkërisht por në minuten qi Presidenti i nep doren Ministrit, ndahet nga Salla tue mbyllun porten, dhe shkon në Sallen e Pritjes ku ndodhen personeli i Legatës.

3. Në rastin e paraqitjes kredencialevet nuk mbahet as nji fjgjeratë zyrtare; mund të ndodhen persona të naltë të Shtetit qi vetë Shkelqesija e Tij Presidenti të ketë urdhënue prezencen e tyne.

4. Shkelqesijá e Tij Presidenti pret Ministrin Fuqiplotë për përsonelin dhe si të kuptojë qi ndodhen gati, i bije zilës, atë minutë Shefi i Protokolit nga salla e pritjes niset bashkë dhe e sjellë përsonalin në Sallë Presidenciale; mbas prezantimit të këtyne ceremonija merr fund.

**Art. 39. Audiencë lirimi:**

Në qoftë se një Ministri i huej remplacohet me nji herë prej tjetri i mveshun po me atë cilësi, audienca e lirimit bahet po në atë ditë e n'atë kohë në të cilät bahet audienca e suksesorit të tij (shiko titrin 6 art. 38).

Në ketë rast, Ministri i huaj qi merr lirimin shkon me karrocen e vetë e këtu bash-

kohet me suksesorin e tij. Ceremoniali për dorëzimin e letravet të thirrjes po si aji për dorëzimin e leter-kredencialevet. (shiko titrin 6 art. 38).

Në se një Minister i huaj nuk ramplacohej me nji herë nga nji suksesor i 'mveshun po me atë cilësi, a në kjoftë se, për nji shkak cilen do kjoftë, aji deshiron me marrë lerimin para paraqitjes së suksesorit të vet, ky lirim bahet në nji audiencë të veçantë ordinare, pa nevojë qi të ndodhet në ketë audiencë edhe Ministri i P. të Jashtme.

## KREMTIME ZYRTARE

**Kremtime Kombëtare — Pritje në Ditën e motit të ri. Hapja e sekcionëve Legjislative**

1. — Kremtimi i Indipendencës 28 Ndanduer.

2. — Proklamimi i Republikës 21 Kallnduer.

3. Pritja në diten e motit të ri.

Art. 40. Kryetari i Republikës në kremtimin e Indipendencës (28 Nanduer në Krye-

vjetin, e në proklamimin e Republikës (21 Kallnduer) e në ditën e motit të ri, pret për gëzimet dhe urimet e autoritetevet qi janë shenuem në alinjstet e art. 1, e të trupit diplomatik në sallen e në ren e caktueme si mbas programit.

## HAPJA E SEKSIOMEVET LEGJISLATIVE

Art. 41. Ceremoniali për hapjen e Seksionevet legjislative caktohet për sejcilen herë me nji program të veçantë.

Trupi diplomatikë merr pjesë në ketë ceremonie në tribunen qi i asht reservueme. Nji detashman i Gardes radhohet i armatosun përpara Pallatit Presidenciale.

Shoqënimi (le cortège) si mbas programit.

Nji detashman i Gardes bane nderime përpara Parlamentit.

Në hymjen e tij, Kryetari pritet nga Dergatat e Senatit e të Dhomës së Deputetvet e cila zgjidhet si mbas rregulloreve të mbrendëshme të Pushtetit Legjislativ në fuqi.

Dergatat e parashoqënojnë Kryetarin deri në Dhomen e mbledhjevet.

Personat qi e shoqënojnë Kryetarin radhohen mbrapa Tij.

Kryetari, mbas mbarimit të leximit të fjalimit tij, rishoqënohet e deri në hymjen e Parlamentit po me atë ceremonial.

Shoqënimi (le cortège) për kthimin ne Presidence formohet po si aji i nisjes për arrijtjen në Parlament.

## PRITJE KRYETARËSH SHTETI

Art. 42. Për pritjen në Shqipni të Suvranevet, Rexhentavet e të Kryetarvet Shteti, në sejcilen rast, Kryesija e Republikës cakton nji program të veçantë.

## TRUPI DIPLOMATIK

### Rangë e precedënca (preseances).

**Art. 43. Trupi diplomatik perbahet:**

**1. Nunset e S. T. të Papës;**

**2. Të Derguemjt e Jashtzakonëshem e Ministrat Fuqiplotë, nga Ministrat Fuqiplotë, nga Ministrat Residente;**

**3. Nga të ngarkuemit me punë e Konsuj**

të pergjithshem (Kryekonsul) të ngarkuem me punë.

Rangu i agjentavet diplomatike caktohet në secilen rend si mas datës së njoftimit zyrtar të mbrrijtjes së tyne, d. m. th. si mas datës së dorëzimit zyrtar e të leter-kredencjalevet të tyne.

Ministrat Residente vehen në kategorin e dytë në kjoftë se janë të akredituem pranë Kryetarit të Shtetit, natura e letër-kredencjalevet të tyne i lanë qi të jenë të fundit në mes të Ministravet e jo të parët në mes të Ngarkuemvet me punë.

Ministrat Residente kalojnë gjithmonë mbas të fundit Minister Fuqiplotë.

Në se, për cilindo shkak qoftë; diplomata qi ma parë dhe ishin në detyrë dorëzojnë leter-kredenciale të reja, këta vazhdojnë me zanë në mes tyne, rangun qi se cili kishte perpara.

Të ngarkuemit me Punë, qi janë t'akredituem me letër të Ministrit të P. të Jashtme kanë precedencen mbi ata qi përmbushin nji shetbim ndermjetës në kohë-vazhdimin e lar-

gimit të Kryetarit të misionit tyne e qi nuk kanë nji letër direkte të Qeveris së tyne për të pohuem tuqitë e tyne të pa parapacm (accidentals).

Krye-Konsujt të Ngarku:m me Punë gëzojnë po ate qilësi diplomatike të Ngarkuemit me Punë.

Këta Agjenta me gjith qi xajnë nji vend ndermjetës në mes të Trupit Diplomatik e t'atij konsulluer, kanë rangë në mes të Ngarkuemit me Punë si mbas datës së paraqitjes së letër-kredencjalevet.

---

## FUNERAJ T' AGJENTAVET DIPLOMATIKE TË HUAJ

Art. 44. Kuer vdes nji Agjent diplomatik i huej, Ministri i P. të Jashtme lajmon mbi ketë vdekje Shefin e Protokolit dhe Agjenti Shqiptar i akredituem pranë Qeverisë që përfaqësonte i vdekuri.

Cermonija e funerajvet rregullohet në mest të Ministris së P. të Jashtme, të ma të vjetërit nga trupi diplomatik (dekan), të diploma-

tit që e zëvendëson të vdekunin, të Shefit të Protokolit, e të Komandës së P. të Fuqis Armate.

Kryetarët e Senatit e të Dhomës së Deputetvet lajmohen mbi diten e oren e funerajvet.

Nderime funebre për Agjentat diplomatike të huaj bahen si mbas rregulloreve të pranueme për funerajët e Ministrávet Shqiptar (shiko Titrin V. Art. 35).

Anët e Kordonevet mbahen prej Ministrit të P. të Jashtme e nga tre anëtarë të trupit diplamatik prej ma të naltvet me gradë e prej ma të vjetrit (ancien).

Tabutin e pasojnë në rregull këta persona :

Familja e të vdekunit, Anëtarët e Legatës, Shtëpija e Kryetarit të Republikës, Trupi diplomatik, Kryetarët e Senatit e të Dhomës, Ministrat, Prefekti, Kryetari i Bashkis e Këshilla e sajë miqt e të vdekunit.

---

## TITRI I VII.

### CEREMONINA NË PALLATIN PRESIDENCIALE

Art. 45. Pritjet, kremtimet e derket zyrtare në Pallatin Presidenciale rregullohen me

anen e Protokolit të Pallatit, rasë mbas rases.

Art. 46. Cili-do qi pranohet në Odience duhet të jetë i veshun me frak, redingot, zhaket a me petka Kombtare. Gjith ashtu anëtarët e Kabinetit si dhe përsoneli i shtëpisë civile të Presidentit kuer të dalin përpara Shkelqesis së Tij duhet të jenë veshun me zhaket.

Ministri i Drejtësis — Ministri i P. të Jashtme

J. Kedhi d. v. — H. Vrioni d. v.

Ninistri P. Botore e Bulqësis

Zav. Ministri P. Mbrendëshme

**Musa Juka d. v.**

Ministri i Financavet.

**S. Starova d. v.**

Na, Kryetari i Repubikës Shqiptare i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJME:

aprovimin e kësajë rregulloreje dhe Urdhënojme zbatimin e sajë.

A. ZOGU d. v.

Tiranë, me 11-XI-1926

---

Rregullore e Përgjithshme e Ceremonisë, 1928

*Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë*



Vjeti i VII. Tiranë, e Shtunde 14 Korrik 1928 Nr. 74

REPUBLIKA SHQIPTARE

# Fletorja Zyrtare

Botohet prej Ministris së P. të Mbrendshme

PAJTIME: për njimot fr. ar 12 në Shqipni; fr. ar 20 jashta | Drejtimi: Drejtoria e Fletores Zyrtare TIRANË | Një copë e javës fr. ar 0,25; një copë e javës së kalueme fr. ar 1,00

PËRMBAJTJA

Ligji e Regullore:

Ligji organik i Ministris P. Mbrendshme

## LIGJE E REGULLORE

### Ligji organik

i Ministris së P. Mbrendëshme

Kapitulli e Irë

Organizimi Qendruer

Art. 1.

Administrata qendrore e Ministris së P. të Mbrendshme formohet në këtë mënyrë:

a) Sekretarija e Përgjithshme,

b) Drejtorija e Korrespondencës,

c) Drejtorija e Shtetit Civil, Statistik, Emigracjon e Fletore Zyrtare,

ç) Zyra Sekrete, e privatë,

d) Inspektorija,

Dh) Këshilli i Ministris,

f) Llogaritari.

Art. 2.

Mënyra e dasjes e veprimit të këtyne tregohet n' aneksin Nr. a.

Detyrat e Sekretaris së Përgjithshme

Art. 3.

Sekretari i Përgjithshem ka për detyrë në veprimin e Administratës të Ministris t'i ndihmojë Ministrit dhe të plotësojë ç'do vepër t'urdhënueme prej këtij, të pregatisë projekt-ligjet e regulloret e nevojshme për Administratën e Mbrendshme dhe të bajë vrojtim e kontrollim mbi gjithë personelin e Qendrës.

Art. 4.

Sekretari i Përgjithshem si autoritet ma i naltë i Administratës, me autorizimin e Ministrit, ka të drejtë të nënshkruej aktet në rast nevoje, dhe për gjithë veprimin e tij ashtë përgjegjës para Ministrit.

Personeli dhe detyrat e Drejtoris së Korrespondencës

Art. 5.

Drejtorija e Korrespondencës formohet prej këtij personeli:

a) Drejtori,

b) Sekretari i parë

c) Sekretari i dytë

ç) Protokollisti

d) Arkivisti

dh) Dy kopista

e) Një praktikant.

Art. 6.

Drejtori i Korrespondencës ka për detyrë të sigurojë gjithë korrespondencën dhe të ndjekë gjithë veprimet, të çelë e të bajë gjithë formalitetet mbi korrespondencën e gjithë Prefekturave e të Nënprefekturave dhe kur t'a shofë të nevojshme, duke raportue Ministrit të drejtojë shkresat e telegramet nga Prefekturat ose për këto dhe të pregatisë urdhënat e emnimit, të pushimit e të transferimit të gjithë nëpunësve.

Art. 7.

Drejtori i Korrespondencës për gjithë veprimin zyrtar ashtë responsabël para Ministrit.

Ligji organik i Ministrisë së Punëve të Brendshme
*Fletore Zyrtare, viti VII, nr. 74,14 korrik 1928, f. 1*



**Ligjë**

mbi shtimin e tre ingjinjërëve në kuadrin e vjetit 1927-928 të Ministris së P. Botore.

Art. 1.

Kuadri i qendruer si përshkimun në kap. I. rrogë personali të budgetit të Ministris së P. Botore për kohën 1. XII-1927 deri me 31-III-1928 i shtohen fr. ari 7200 për me përballue pagesën e tre ingjinjerëve me rrogë mujore nga 6.00 fr. ari, qëndrimi e të cilëvet krijohet me kët ligjë.

Art. 2.

Mbulimi i kësaj pagese bahet me kursimin e rrogëvet të pa shpenzueme e të pa paguemë nga kap. I rrogë personali, i budgetit të Ministris së P. Botore, kursime të cilat janë si ma poshtë vijojnë:

Rrogë e nji ingjinjeri që marrun vetëm për njimuej në shërbim e për të cilin nuk ka nevojë vazhdimi në detyrë;

| | |
|---|---|
| muaj 11 a 400 fr. ari | 4.400 |
| Rroga e Inspektorit 4 muaj (1. 4. 27-31. 7. 927) 4 a 450 fr. ar | 1.800 |
| Rroga e nd. Log. 4 muaj (1. 4. 927-31. 7. 927) 4 a 250 „ | 1.000 |
| Shuma | 7.200 |

Art. 3.

Kjo ligjë hyn në fuqi prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj ligje ngarkohet Ministrija e P. Botore dhe ajo e Financavet.

Z. E. FRASHRI Pyes Z. Ministrin se këto tre ingjinjera si ap cilët janë do të sjellen?

Z. P. VOKOPOLA (Min. Bujqësisë) Kjo ligjë asht inspirueme nga dëshira e Senatit si mbas dëshirës se shfaqun disa dit ma parë prej Z. E. Frashrit, dhe asht hartue kur unë ishe Zv. Ministri i P. Botore. Përballimi i fondit asht tregue në raportin justifikues, dhe Dhoma e Deputetve e ka pranue qysh atëherë. Pra me qenë se, për kët projekt i gjith ministeri asht shpejtë, lutem të pranohet me ngutësi.

Z. E. FRASHRI. Unë me faleminderime e pranoj.

Pranohet në parim dhe i referohet Komisjonit A me ngutësi.

Z. N. DERVISHI. Z. Kryetar! me kët rast dua të pyes Z. Ministrin e Bujqësisë se, ç'masa ka marrë deri sot për sjelljen e specialistavet për të përmirësue produktin e ullinit, i cili produkt si e dini të gjith edhe Z. Juej asht produkti ma i lirë dhe ma i dobishmi për popullin, sidomos dhe për Shkodrën, dhe Shtetet e tjera si Italija, Turqija e Greqija kan marrë masa me kohë për përmirësimin e këti produkti.

Z. P. VOKOPOLA (Min. Bujqësisë) Z. Kryetar! qysh se kam fillue në detyrë si Minister Bujqësisë kam marrë masa për sjelljen e specialistave për të përmirësue produktin e ullinit, dhe mbas nji lajmit që kam marrë dy specialistat jan nisun për me ardhun.

Z. KRYETARI. Bisedim mbi ligjën e administratës civile (në parim)

Kendohet shkresa e Dhomes së Deputetve Nr. 183 I datë 13-XII-27 me të cilën percillet ligja e administratës civile, bashk me kopjen e raportit justifikues e votueme prej Dhomës së Deputetve, për me u votue edhe prej Senatit.

Kendohet raporti justifikues si vijon;

**Raport-Justitikues**

mbi Ligjën e Administratës Civile

Organizimi i administratës civile i Shtetit Shqiptar bazohet në ligjën e administratës me datë 5-3-922, e cila për veç qi nuk kish marrë aprovimin e Pushtetit Legjislativ e ish

Ligj mbi shtimin e tre inxhinierëve të M. P. Botore
viti 1927-1928 të M. P. Botore
*Fletore Zyrtare, 1 prill 1928*



**Min. e P. Botore**

Mbi marrjen në detyr të disa nepunsave të pezulluem.

Mbasi Konduktorat e Ministris së P. Botore Kol Zhella, Preng Milloshi, Luigj e Lluka Nushi të pezulluem nga puna për dyshim abuzimi siku u shpallë në Fletoren Zyrtare Nr. 60 me 7-6-1928 duelen të pafajshem si mas raportes së Prokurorit së Durrësit Nr. 13/67 me 11-6-1928, Ministria e P. Botore dha dispozitjonet për rimarrjen e tyne në sherbim.

14. VI-28

Mbi marrjen në punë të disa
nëpunësve të pezulluar
*Fletorja Zyrtare , 16 qershor*
*1928, f. 8*

Vjeti i VII. Tiranë, e Prende 13 Prill 1928 Nr. 37

REPUBLIKA SHQIPTARE

# Fletorja Zyrtare

Botohet prej Ministris së P. të Mbrendshme

PAJTIME: për një mot fr. ar 12 në Shqipni; fr. ar 20 jashta | Drejtimi: Drejtoria Fletores Zyrtare TIRANË | Një copë e javës fr. ar 0.25; një copë e javës së kalueme fr. ar 1.00

**FERMBAJTJA:**

Ligjë e Rregullore
Dekret mbi zbatimin e rregullores së pensioneve
Budjeti i Drejtoris së P. të Kryeit të Kuq
Dekret mbi zbatimin e rregullores për administratën e kontabilitetit

## LIGJE E REGULLORE

### DEKRET

### Mbi zbatimin e rregullores së pensioneve

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqit sovrane të Shtetit,

Mbi propozimin e Ministris së Financavet;

Mbasi u bisedue e u pelqye vendimi i Këshillit Ministruer me datë 1-IV-928,

**DEKRETOJMË**

Zbatimin e Rregullores mbi zbatimin e ligjës së Pensioneve.

Tiranë më 7 Prill 1928

**A. ZOGU d. v.**

### Rregullore mbi zbatimin e ligjës së pensioneve

KAPTINË E I.rë

Formimi i Drejtoris së Përgjithshme

Art. 1. Drejtoria e Përgjithshme e Pensionevet përbëhet prej një Drejtori t Përgjithshëm, një Sekretari, dy Llogaritarevet, një Arkëtari, një Protokollist-Arshivisti, një Kopist dhe dy Shërbetorevet. Numri i personalit mund të ndryshohet në budget si mbas nevojës.

Art. 2. Mund të zgjidhet si Drejtor i Përgjithshëm kushdo që të ketë moshën 25 vjetsh e lart, të ketë mbarue një shkollë të naltë e të ketë një eksperiencë prej dy vjetësh së paku në degën e Financës ose në Bankë, ose të ketë shërbye si anëtar i Këshillit Kontrollues, ose si Sekretar i Përgjithshëm ose si Shef Seksioni ose Inspektor i Financavet, ose me në fund të ketë shërbye për vjet së paku si Drejtuer i Financavet, preferohen ata që kanë mbarue një shkollë të naltë edhe kanë eksperiencë dy vjetësh.

Art. 3. Llogaritarët, Sekretari, emnohen mbas një konkursi të dhanun përpara një Komisioni të kryesuem prej Ministrit, e të përbamë prej një Senatori, një Deputeti, Kryetari i Këshillit Kontrollues dhe një nga Inspektorët e Përgjithshëm.

Art. 4. Si nëpunës kançelarije, d. m. th. Protokollist-Arshivist, dhe Kopist, mund t'emnohet kushdo që të ketë krye së paku pesë klasë fillore dhe të jenë marrë me dërpret analoge në zyrat Shtetnore. Kopisti duhet të ketë afësi si pûnë në daktilografi.

KAPTINË E II.të

Detyrat e personalit të Drejtoris së Përgjithshme

Art. 5. Drejtori i Përgjithshëm ka për detyrë:

a) të zbatojë, pa i u shmangë aspak, vendimet e Këshillit t'Administratës, ndër mbledhje të cilit merr pjesë me votë konsultative;

b) të mbikqyrë e të rregullojë kontabilitetin e zyrës që kryeson si edhe kançelarin;

c) të mbajë korrespondencën e Drejtoris së Përgjithshme.

d) t'i paraqesë Këshillit t'administratës, për vendim, të gjitha kërkesat e drejtueme prej Qeveris, ose prej nëpunësave drejt për drejt;

e) të mbledhë e t'i paraqesë për shqyrtim Këshillit t'Administratës të gjitha ligjet e vendimet në mbështetje të cilavet i janë caktue pensionet personavet të ndryshëm civilë para se të dalë ligja e re e pensionevet;

f) të mbledhë llogarit e vjetëve të kalueme për të ndalesat të bame nga Ministrija e Financavet nëpunësavet Civil;

g) të përgatisë e t'i paraqesë për shqyrtim Këshillit t'Administratës modelet e formularevet të nevojshëm për kontabilitet si edhe modelet e dokumentavet që do t'i epen në dorë secilit pensionist për tërheqjen e të

kolltavet nga arkat e financavet ose edhe nga bankat për ndihmë t'arkës së përgjithshme të pensionevet;

b) të kërkojë me kohë të ç'do kaste munjore prej të pensionuarvet nga një çertifikatë vertetuese të vazhdimit të gjendjes së përparëshme.

Art. 6. Drejtori ndënë detyrat e caktuara nga Ilogarit në mënyrë ndiluje midis tyne të cilët kanë për detyrë të kenë mbikqyrë në ç'do mramje të gjitha veprimet e regjistrohe(?) e urdhënueme prej Kryetarit të Zyrës gjatë ditës. Në rast të mos plotësimit të kësajë vepre mbrenda orarit të zyrës janë të detyruem t'i kryejnë edhe jashtë orarit pa të drejtë shpagimi për punime ndër orë të jashtë zakonshme.

Art. 7. Arkëtari ka për detyrë të mbajë të gjitha veprimet kontabile t'arkës për sa i përket marrëdhanievet kjo(?)-kjo të bame drejt për drejt prej tij ose edhe me anën e zyrave të tjera për ndihmë t'arkës së përgjithshme të pensionevet. Në këtë rasën e fundit asht i detyruem të bëj korespondencën që i përket pjesës së tij, mbasi kontabiliteti të ketë marrë shënimet e nevojshme ndër regjistrat e vet. Mbasi arka asht zyrë e pa damun e kontabilitetit, Arkëtari i ka për detyrë t'u ndihmojë pa ndonji shpagim, llogaritarvet, në ç'do rast që t'a shofi të nevojshme e t'urdhënuehme Drejtori.

Art. 8. Sekretari ka për detyrë:

a) të mbajë në një libër të posaçëm vendimet e Këshillit t'Administratës, ndër mbledhje të cilit merr pjesë si Sekretar;

b) të bajë korespondencën administrative të Drejtorisë Pensioneve përveç asaj që i përket kontabilitetit, konceptat e së cilës bahen nga ay i cili llogaritar për pjesën e vet;

c) të kontrollojë shkresat që bahen prej të gjithë nëpunësavet e të mos lanë të kalojë kurr një pa kenë mashkrue me koncept prej Drejtorit e në kjoftë se shkresa i përket degës së llogarisë, edhe prej Llogaritarit përkatës;

d) të mbikqyrë zyrat e konceptimit e të mos lejojë që kurrnjë shkresë të mos lenë pa dalë e të marrin rrugën e vet mbrenda asaj dite në të cilën asht ujdisë për veprime.

e) të shikojë kryet ç'do jave cilat shkresa e akte kanë mbet në dorë të nëpunësavet pa kurrnji përfundim mbrenda asaj jave e të kërkojnë të kryemit e veprës, në kjoftë se akti asht prej atyne që nuk lypë nji kohë pritje ma të gjatë; kenë detyrë ka për t'a kryer edhe në kjoftë se aktet gjinden në dorë të Drejtorit;

f) të venojë që archivet të jenë mbajtë në rregull o mbas sistemit t'urdhënuem e si janë mbajtë mirë të gjitha librat ndihmëse të protokollit (indekse e numrator);

g) të mbi-kqyrë pastërtinë e zyrës e plotësimin e detyravet të shërbetorvet.

Art. 9. Detyrat e Protokolist-Arkhivistit janë:

a) të protokolojë mbrenda ditës, e sa që të jetë e mundur pa vonesë, të gjitha ato akte që i vijnë prej Sekretarit;

b) të mbajë evidencë për të gjithë aktet që u dergohen për veprim nëpunësavet të ndryshem të Drejtorisë dhe t'i paraqesë Sekretarit, kryet ç'do jave nji listë të gjithë atyne akteve që kanë mbetë pa u kryer e në dorë të kujt gjinden. Për këtë gja do të mbaj nji libër të posaçëm evidence;

c) të shikojë që të gjithë shkresat të nisen mbrenda ditës për ku janë destinue e që aktet e zyrës të vendo[illegible]hen n'arkive mbrenda asaj dite [illegible] janë krye.

ç) të shënojë në numrator e n'indeks të gjithë shkresat po sa të jenë kryemë;

d) të nisë pa vonesë, si të [illegible] marrë të gjithë shkresat për të de[illegible] nacionin e tyne;

dh) t'u njesi të gjithë shkresa[illegible] t'ardhuna para-aktet e nevojshme[illegible]

e) të vendojë n'arshivë të gjitha aktet që mbetun në zyrë si [illegible] nisë shkresat për në destinacion[illegible] tyne;

Art. 10. Detyra e kopistit asht[illegible] përshkruemit e të gjithë shkresa[illegible] mbrenda ditës, e po sa të je[illegible] mundun pa vonesë, në mënyrë që [illegible] mos jesin gja për ditën e nesër[illegible] për të verifikue këtë duhet që [illegible] kanë prej të vej nënshkrimin e [illegible] dhe datën e përshkrimit tue i a [illegible] me nji herë Sekretarit për shpër[illegible] veprime ma të tejme.

Detyra e Kopistit asht edhe [illegible] ndihmojë, në rast nevoje Protokolist-Arshivistit ose t'a zavendësoj pa të drejtë shpagimi.

Art. 11. Rrogat e personelit [illegible] Drejtorisë të pensionevet caktohen [illegible] mënyrë që tregohet këtu posht:

Drejtori 400 fr. ari, Sekretari [illegible] dy Llogaritar a 300, Arkëtari [illegible] Protokolist-Arshivisti 250, Kopisti 180, dy Shërbetor a 100.

KAPTINE E III.të

**Disposita të përgjithëshme**

Art. 12. Ç'do nëpunës [illegible] dëshiron të shkojnë në pension [illegible] drejtat e fitume si mbas ligjit [illegible] për detyrë të bajë kërkesën me [illegible] pranë autoritetit nga i cili [illegible] Lutja duhet të përmbajë [illegible] shkoqitet që pasojnë:

a) datën e nisjes së shërbimit [illegible] moshën që kishte n'atë kohë [illegible] që rrogë;

b) në ç'shërbim ka qenë emnue në kohë ka qëndrue në ç'do shërbim, e rrogat relative që ka marrë për se cilin shërbim. Gjithashtu në ka mbet pa nëpunësi e cili kje shkaku i pezullimit;

c) në ka qenë dënue ndonji herë për faje të treguema në nenin 28 të ligjës ose i pushuem në mënyrë të treguem po n'at artikull;

d) n'asht në shërbim a jo në ditë që ka ba kërkesën për pension. Në rasin e dytë duhet të tregohen shkaku i largimit nga detyra.

Art. 13. Të gjithë autoritetet e sipër (Ministrit e Drejtorit) kanë për t'i paraqit Drejtoris së pensioneve origjinalin ose kopjen e lutjes së nëpunësit që dëshëron të shkojnë në pension, të përcjellun me dokumenta të kohës së shërbimit, të vërtetueme edhe nga zyra e jetëshkrimevet si edhe dokumentat e kontributionit të bamë nga lutësi për në arkën e pensioneve.

Të gjithë zyrat financiare janë të detyrueme t'i apin ç'do nëpunësi:

a) nji çertifikatë vërtetuese të kontributionit të bamë nga nëpunësi për në arkën e pensioneve;

b) nji dëshmij shërbimi treguese edhe të rrogës që ka marrë nëpunësi të derdhë n'arkën përqindjet për kontribution pensioni.

Art. 14. Propozitat për qitjen në pension t'atyne nëpunësave që kanë plotësue 35 vjetë shërbim, si mbas nenit 4 të ligjës, ose që kanë arrijtë të moshën 60 vjetësh bahen nga ana e autoritetit të përkatshem, edhe në kjoftë se nuk e kërkon nëpunësi vetë, drejt për drejtë Drejtoris së Përgjithshme të pensioneve e cila do t'i a paraqesë për shqyrtim Këshillit t'Administratës.

Art. 15. Raportat e mjekëvet të parashikueme në nenin 6 të ligjës nuk do të kenë kurr nji vlefte, kjoftë shkak të dhanuna ç'do nëpunësi e prej ç'do mjeku me autoritet sa do të madh, po s'kjenë kërkue ma parë prej autoritetit nga i cili mvaret nëpunësi e caktue dhanësi e raporteve në marrëveshtje me Drejtorin e Shëndetsis. Raportat që eventualisht mund të paraqiten nga nëpunësit në kundërshtim me paragrafin e sipërme të ksaj neni kanë për t'u mbajtë nga autoriteti të cilit i janë paraqitë dhe konsulti mjekësor i dërgohem si mbas nenit 6 të ligjës do t'i ngarkohet tërë mjekvet e jo kur atyne që kishin dhanë raportin e parë.

Art. 16. Nëpunësit, që gëzon të drejtat e pensionit të llogaritshem në mënyrë t'urdhënueme prej nenit 10 të ligjës, e që ka hye në shërbim të Shtetit para se t'arrijte në moshën 20 vjetësh, nuk i llogaritën vjetët e shërbimit që ka ba para asaj kohe, kjofshin prej atyne nëpunsave që qiten në pension detyrisht ase fakultativisht. Për vërtetim të moshës së nëpunësit merren për bazë dokumentat e Shtetit civil të nxjerrun nga regjistracioni i përgjithshëm i bamë ma së mrami herë nga autoritetet Shqiptare.

Art. 17. Në kjoftë se si mbas nenit 14 të ligjës, ndonji nëpunës bahet sakat (invalid) nga të kryemit e detyrës e sipër sa të mos mund të kryejnë detyra publike ose private, për të mundë me u qitë (në pension me rrogën e plotë të muejit të fundit të dalun nga shërbimi, ka për t'u mbajtë nji procës-verbal prej Këshillit t'Administratës së vendit, ku ka me marrë pjesë edhe Kryetari i Zyrës nga i cili mvaret nëpunësi (në kjoftë se ka) tue treguë vendin, datën dhe orën ku ngjau incidenti. Procës-verbalet mbahen me personat që u gjendshin pranë ku ngjau incidenti, dhe në kjoftë se nuk ka ndodhë as kush, Këshilli Administrativ e bazon procësin në hetimet që ka për të bamun me mjete të ndryshme.

Pa zotësija e shërbimit do të vërtetohet me nji raportë mjekësor si mbas nenit 6 të ligjës, të zbatillem në nenin 24 të kësaj rregullore, me përjashtim se në vend të dy mjekvet Ministrija kompetente ka për të caktue si mbas nenit 15 të ligjës.

Art. 18. Vdekjet aksidentale vërtetohen e me procës-verbal të mbajtun në mënyrë të treguem në nenin 26 të kësaj rregullore.

Art. 19. Të gjithë ata nëpunës të dalun nga shërbimi për shkak sëmundje të marrun në kohë të nëpunësis, po jo nga shkaku i shërbimit, dhe që gjendja shëndetsore nuk ju lejon kurr nji shërbim, duhet të paraqesë nji dëshmi të Bashkis së vendit të vërtetueme nga Këshilli Administrativ i qarkut ku kanë banimin e përhershem, në pasqyrën të cilës të vërtetohen konditat ekonomike të nëpunësit që pretendon të marrin ndihmën e nji herëshme si mbas nenit 20 të ligjës.

Si bazë e ndihmës merret rroga e muejit të fundit edhe në kjoftë se n'atë muej që ka dalë nga shërbimi ka qenë gradue me rrogë ma të naltë pa mujt me shërbye gjith muejin. Në llogaritjen të kësaj ndihme nuk do merren para-sysh ndalimet që bahen për kontribution në fondin e pensioneve, por merren si bazë gjith rroga bruto.

Art. 20. Kthimi i shumavet, si mbas nenit 27 të ligjës, të derdhuna n'arkën e pensioneve nga nëpunësat e dalun para se të mbushin 10 vjet shërbim ka për t'u ba mbasi të familjes të parashikueme në nenin 19 të ligjës mbas nji çertifikate të Zyrës së Shtetit Civil të paraqitun Drejtoris së pensioneve të përcjellun

me dokumenta të vërtetuem të vëbekuis në mënyrë të parashtrueme në nenin 29 të këtij rregullore.

Art. 21. Vendimet e Këshillit Administrativ të pensioneve të dhanun për ndihma të një hershme si mbas art. 27 të ligjës i parashtrohen për Dekretim Kryetarit të Republikës si mbas nenit 1 të ligjës.

## KAPTINË E IV-të.

### Kontributiom për në fond'n e pensioneve

Art. 22. Të gjitha Arka e Shtetit janë të detyrueme t'u ndalojnë nëpunësave edhe të pensionuemvet përqindjet për kontribution në fondin e pensioneve si mbas dispozitavet të nenit 31 të ligjës.

Gjobat që u vihen në të holla nëpunësavet për [ndeshkim disiplinuer kanë për t'u kthue nëpër arka të financavet drejt në llogarin e kontributit të pensioneve tue] shenue llojin e t'ardhunës në llogarin mujore që do të paraqitin.

Gjith-ashtu duhet të shënohen në llogarin mujore të gjitha t'ardhunat veç e veç si mbas paragrafevet a) h) të nenit të sipër-përmendun të ligjës. Llogaria mujore duhet t'i bashkohet një listë emnore të nëpunësavet që kanë derdhë kontributionin tuej treguem shumën e derdhun nga secili.

Art. 23. Të gjitha zyrat financiare e arkat tjera paguese janë të detyrueme t'i paraqesin Drejtoris së Përgjithëshme të pensioneve përmuejsisht e jo ma largë se katër ditë mbasi të hyej muaji ndjekës, llogarin e t'ardhunavet dhe të dalunavet t'efektuema n'atë muej për njehsi t'arkës së Përgjithëshme të pensioneve. Së bashku me llogarin do t'i dërgojnë edhe shumat që u teprojnë në favor t'arkës së përgjithëshme të pensioneve.

Në kjoftë se pagesat e pensioneve për atë ndonji zyrës financiare janë ma të mëdhaja se të hymet që kanë për kontributiom në fondin e pensioneve, arka e përgjithëshme e pensioneve ka për t'i dërgue më një herë shumat që i deyron po sa të paraqitohet llogarija mujore.

Kjo gja nuk shkakton ndalimin e pagesavet të pensioneve.

Art. 24. Dhurata e lanuna në testament kanë për t'i u njoftue Drejtoris së pensioneve e cilla, mbas një vendimi të Këshillit t'Administrativ, ka për të disponue zyrtarisht marrjen në dorëzim të gjanë së dhurueme.

Art. 25. Të shlyemit e detyrevet të të gjithë nëpunësavet për kohët e kaluema që nga data 28 Nandor 1912 e deri më 1 Korrik 1923 ka për t'u bë në ndalime 4%, mbi rrogë deri sa të plotësohet shuma e detyrueme e cilla ka për ti u njoftue Ministris së Financavet nga Drejtorija e pensioneve.

Për të marrë me llogarin këtë detyrë, duhet që të gjith nëpunësit civil që dishirojnë me gëzue të drejtat e pensionit që nga data që kanë hye të parën herë në sherbim të Shtetit, të mushin formularin e krijuem nga Drejtorija e pensioneve për këtë qellim.

Sherbimet duhet të vertetohen në dokumenta (dekret), po sa të jenë mundur, t'asaj kohë në të cilen nëpunësi ka hye në sherbim. Në kjoftë se dokumentat nuk tregojnë sasin e rrogës mujore a po vjetore kjo do të tregohet prej zyrës financiare paguese e cilla ka me njoftue edhe shumat që i janë ndalue nëpunsit për kontributiom në fondin e pensioneve.

Art. 26. Për t'ardhunat t'efektueme për njehsi t'arkës së Përgjithëshme të pensioneve që nga data 1 Korrik 1923 e kredej ka për t'i u dhanë ... llogarin që Ministria e Financavet ... parashtrojë Drejtoris së Përgjithëshme të Pensioneve.

Art. 27. Ndalja 4%, e parashtrueme në nenin 32 të ligj-it për ato nëpunës që në kohën e okupacionave të huej kanë ndodhë jashtë sherbimit, ka ... n llogarit tue' u marrë për bazë ... të gjithë kohën e sherbimit, në analogji me nenin 11 të ligjës, rroga ... e mramme që ka marrun para se ... pushoe. Për ato nëpunësa që ... ndodhë në sherbim në kohë ... sipër treguem merret për bazë rroga e thjeshtë e asaj kohe, pa ... shtesë, tue u kthye në ... Shqiptare të sotshme me kurs ... sater si mbas ligjës me datë 10.XI.19...

Art. 28. Bashkia janë të detyrueme t'i paraqesin, ç'do vjet, Drejtoris ... pensioneve një kopje të budgetit ... ventiv t'ardhunavet dhe krye çdo ... llogarin ... t'ardhunavet t'efektueme së bashku me shumen relative të detyrueme si mbas parag. G. të nenit 33 të ligjës.

## KAPTINË E V.

### Mbledhjet e Këshillit Administrativ

Art. 29. Mbledhjet e Këshillit Administrativ proklamohen prej Kryetarit të Këshillit në ç'do diti ... i njoftue për një herë anëtarëvet ... e ditën që Këshilli do të bëjë ... sedim, si edhe oren e mbledhjes.

Art. 30. Në kjoftë se Drejtoria ... mirë vajtjen e administratës ... shtrëngon urgjenia e ndonjë çashtje ... mbledhjen e Këshillit edhe ma shpesh se dy herë në muaj, ka për t'i ... herë propozimin mbledhjes Kryetarit të Këshillit i cilli ka për të ... tarët me mbledhje të jashtë-zakonshme.

Art. 31. Ç'do mbledhje ka për ... para lajmerue edhe Ministris të F...



FLETORJA ZYRTARE 13 PRILL 1928 — 5

KAPTINË E VI.

Dispozita mbi budget.

KRYESI E NDERIT E KRYQIT KUQ

*Ministria e P. të Mbrendëshme*

*Tiranë*

Përgjegje e shkresës Nr. 1227 datë 15 III 928.

Pelqejm Budgetin e Drejtorisë P. të Kryqit Kuq përsipër në shkresën e atjeshme të sipër shenueme, tue autorizue atë Drejtori me e vu në veprim qysh me 1 Prill 1928.

Tiranë me 2-IV-928 — A. ZOGU

T'ardhuna të parapame për vitin Financi r 1928-1929

| Kapit. | Artik. | EMERTIMI I T'ARDHUNAVET | Shuma në Franga ari |
|---|---|---|---|
| | | Kat. e I. | |
| 1 | | Pasuni e pa tundëshme e Kryqit të Kuq Shqip. | |
| | 1 | T'ardhuna prej tokës (çmimi i barit i veres dhe i dimrit) | 300 |
| | 2 | çmimi i vaji nga ullinjt e Shalës | 400 |
| | 3 | Shtypshkronja Tirana | 400 |
| | | | 1100 |
| | | Kat. II | |
| 2 | 1 | Nga shitja e pullavet | 85000 |
| | 2 | Prej Bashkive | 21000 |
| | | | 106000 |
| | | Kat. III | |
| 3 | 1 | Ndihma të Mbrendëshme | 3000 |
| | 2 | Ndihma të Jashtme | 12000 |
| | 3 | Pika e Qumeshtit | 400 |
| | | | 16400 |

Rregullore mbi zbatimin e ligjit të pensioneve
*Fletore Zyrtare nr. 37, viti VII, 13 prill 1928, f. 1-5*

Vjeti i VII. Tiranë, e Ejte 17 Maj 1928 Nr. 52

REPUBLIKA SHQIPTARE

Fletorja Zyrtare

Botohet prej Ministris së P. të Mbrendshme

PAJTIME: për nji mot fr. ar 12 në Shqipni; fr. ar 20 Jashtë | Drejtimi: Drejtoria Fletores Zyrtare TIRANË | Nji copë e javës fr. ar 0.25; nji copë e javës së kalueme fr. ar 1.00

# BISEDIMET E SENATIT

## Sesioni i Marsit i vjetit 1928

### Mbledhja 9.

E Shtunde më 31 Marc 1928
ora 10 para dreke.

**Mbledhjen e Kryeson Z. P. Evangjeli**

me n' Artikullin ma nalt me pelqimin e Ministrit; ajo e nëpunsave të kategoris të tienë bahet me vendimin e Këshillit të Ministrive, tue marrë per rasyesh vjetrsija, dhe aftësija.

Pranohet.

Art. 44 i ligjës paraqitun prej Dhomës së Depuetve ka qenë kështu:

Art. 44 Askush prej nëpunsave nuk mund të gradohet dy shkallë për nji herësh (gradimi bahet i rregullt: dmth. ke u ruejtë të drejtat e gjith nëpunsave të tjerë) E drejta e gradimit prej nji klase në tjetrë fitohet tue sherbye së paku 4 vjet n' atë klasë.

Art. 44 qi bahet Art. 41 i tekstit të ri, Komisioni e ka ndryshue kështu:

Art. 41. Askush prej nëpunsave nuk mund të gradohet dy shkallë për nji herësh. E drejta e gradimit prej nji klase në tjetrën fitohet tue sherbye së paku 4 vjet n' at klasë.

Pranohet.

Art. 45 i ligjës së paraqitun prej Dhomës së Depuetve ka qenë kështu:

Art. 45. Ato nëpunsa qi kan të drejtë për gradim e nuk dëshrojnë të gradohen, ma parë se të bahet ndonji veprim për gradimin e tyne, duhet të lajmerojn Ministrinë, për ndryshe mbas emnimit në mënyrë gradimi mos pranimi shkaktonë humbjen e nëpunsisë qi kan patun ma parë.

Komisioni këtë Art. e ka ngrënë.

Pranohet.

Art. 46 i ligjës së paraqitun prej Dhomës së Depuetve qi bahet Art. 42 i tekstit të ri:

Art. 42. Nji nëpunës ku punon me zellë e energji të plotë autoritetit ma i naltë i tij e nderon me nji letër lavdata, e cila shenohet në jetëshkrimin e tij.

Pranohet

Art. 47 i ligjës së paraqitun prej Dhomës së Depuetve qi bahet Art. 43 i tekstit të ri.

Art. 43. Ata nëpunsa qi kan të drejtë për gradim por nuk gradohen dot për arsye se nuk ka vend vakant, për sherbimet e tyne u jepet nji shtesë rrogë në këtë mënyrë: Ata qi kan nji sherbim prej 5-10 vjet 10% përqind e rrogës.

Ata qi kan nji sherbim prej 10-20 vjet, 25 përqind të rrogës.

Dispozitat e këti Art. do të zbatohen mbasi të kalojnë 4 vjet mbas shpalljes të kësaj ligje.

Pranohet.

Art. 48 i ligjës së paraqitun prej Dhomës së Depuetve ka qenë kështu:

Art. 48 Ato nëpunës qi nuk i kan cilsitë e kerkueme prej kësaj ligjë po për arsye të ndryshme emnohen, nuk mund të marrin rrogë të plotë, vetëm dy të tretat e rrogës, kjo vazhdon deri sa të sehirohet aftësija e tij për atë detyrë. Gjith ashtu prej datës zbatimit të kësaj ligje mbrenda në dy vjet ato nëpunës qi nuk kan cilsinat e tyyne ose prej të cilavet për shkak pa zotsije, ose inkapaciteti nuk shpreshohet ndonji sherbim, nxjerren prej kuadros tue i vue në pozitë, ose tue u dhanë nji shpërblim. Mbas kalimit të kohës së naltpermendun gjith nëpunsat fitojnë të drejtat e caktueme në këtë ligjë.

Art. 48 qi bahet Art. 44 i tekstit të ri, Komisioni e ka formulue me këtë mënyrë.

Art. 44. Ato nëpunsa qi ndodhen në sherbim dhe qi nuk kan cilsinat

të lypuna prej kësaj ligje, mbrenda në dy vjet në qoftë se nuk mbrojtë simbisë e dahun, atëherë nxjerren jashtë kundrus.

Pranohet.

Kapitull VI.

Menyra e ndeshkimit të nëpunsave.

Art. 49 i ligjës së paraqitun prej Dhomës së Deputetve ka qenë kështu:

Art. 49. Mbasi ç'do nëpunës asht i detyruem me vazhdue në detyrë n'orën e miratën e caktueme për të kryemit e detyrës plotsisht, kundravajtimi shkakton zbatimin e një ndeshkimi disiplinuer.

Art. 50 i ligjës së paraqitun prej Dhomës së Deputetve ka qenë kështu:

Art. 50. Ndeshkimet disiplinore të nëpunsave të Ministris P. Mbrendshme janë këto:

a) Qortim me gojë

b) Qortim me shkrim duke u shenue edhe në jeshkrimin e tij.

c) Të premit e nji pjesë së rrogës

ç) Ndalim i gradimit

d) Transferim në vend tjetër

dh) Të zbritunit e nji grade ma t'ulët

e) Pushim nga puna

Komisioni Art. 49 e 50 e ligjës së paraqitun prej Dhomës së Deputetve i ka përmbledhun në nji Artikull e cili me ngjitjen e këtyne dy Artikujve bahet Art. 45 i tekstit të ri.

Kapitull VI.

Menyra e ndeshkimit të nëpunsave.

Art. 45 Nëpunsit ndeshkohen disiplinarisht në rasën kur në zbatimin e tyne nuk përmbushin dispozitat të lypuna prej ligjeve e rregullorëve të Ministris. Ndeshkimet disiplinore janë këto:

a) Qortim me gojë

b) Qortim me shkrim duke u shenue edhe në jeshkrimin e tij.

c) Të premit e nji pjesë së rrogës

ç) Ndalim i gradimit

d) Transferim në vend tjetër

dh) Të zbritunit e nji grade ma t'ulët

e) Pushim nga puna.

Pranohet.

Art. 51 i ligjës së paraqitun prej Dhomës së Deputetve qi bahet Art. 46 i tekstit të ri.

Art. 46. Për nji nëpunës qi qortohet me gojë dy herë mbrenda 3 muajve po u lyp nji ndeshkim i ri ndeshkimi i fundit nuk do të jetë ma i pakët se qortimi zyrtar e shenim në jeshkrim.

Nji nëpunës qi qortohet me shkrim dy herë në gjashtë muaj po u lyp nji ndeshkim i ri, ndeshkimi nuk do të jetë ma pak se të premunit e nji pjese së rrogës bashkë me ndalimin e gradimit.

Kur nji nëpunës qi i pritet rroga dhe i ndalohet gradimi dy herë në nji mot, po u lyp nji ndeshkim i ri ky nuk do të jetë ma i pakët se transferimi i tij bashkë me të zbritunit e nji grade ma t'ulët.

Për nji nëpunës qi transferohet me degradim, po u lyp nji ndeshkim i ri ky nuk do të jetë veç se pushimi të tij nga puna.

Pranohet.

Art. 52 i ligjës së paraqitun prej Dhomës së Deputetve ka qenë kështu:

Art. 52. Këto ndeshkime qi u përmendën ma sipër mbi propozimin e Inspektorave, Prefektave ose Sekretarit të Përgjithshem e të Drejtorave, vendosen prej Këshillit të Ministrisë dhe zbatohen me nji hersh me pëlqimin e Ministrit, të cilit i paraqitet vendimi i Këshillit qi duhet të zbatohet në befime Këshillave. Në sa mori e përmendura në parag. [illegible] b), c), mund të zbatohen prej Ministrit pa pas nevojë për vendimin e Këshillit.

Art. 52 qi bahet Art. 47 i [illegible] të ri Komisioni e ka formulue si këtë mënyrë.

Art. 47. Këto ndeshkime qi u përmenden ma sipër mbi propozimin e Inspektorave, Prefektave ose Sekretarit të Përgjithshem e të Drejtorave vendosen prej Këshillit të Ministrisë dhe zbatohen me nji hersh me pëlqimin e Ministrit. Ndeshkimet e përmendun në paragrafët a) b) c) mund të zbatohen prej Ministrit pa pas nevojë për vendimin e Këshillit.

Pranohet.

Art. 53 i ligjës së paraqitun prej Dhomës së Deputetve ka qenë kështu:

Art. 53. Asnji nëpunës i Ministris P. Mbrendshme nuk mund të ndeshkohet me ndeshkime ma të mdhaja se përshtatë dispozitave e formulueve t'Art. 51, përveç se kur dëshiron pushohet me vendimin e gjykatore. Ndjekjet ligjore kundra nëpunsve bahen si mbas dispozitave të [illegible] mbi gjykimin e nëpunsave.

Art. 53 i ligjës së paraqitun prej Dhomës së Deputetve qi bahet Art. 48 i tekstit të ri, Komisioni e ka formulue me këtë mënyrë.

Art. 48. As nji nëpunës i Ministris P. Mbrendshme nuk mund të ndeshkohet me ndeshkimin ma të madhe se përshtatë dispozitave e formulueve t'Art. 46, përveç se kur dëshiron pushohet me vendimin e gjykatore. Ndjekjet ligjore kundra nëpunsve bahen si mbas dispozitave të [illegible] mbi gjykimin e nëpunsave.

Pranohet.

Art. 54 i ligjës së paraqitun prej [illegible]

Dhomës së Deputetve qi bahet Art. 49 i tekstit të ri.

Art. 49 Gjith ligjet e Shtetit qi i kundërshtojnë dispozitavet të këtij ligje janë t'anulueme.

Pranohet

Art. 53 i ligjës së paraqitun prej Dhomës së Deputetve ka qenë kështu

Art. 54 Kjo ligjë hynë në fuqi që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare, dhe për sa i përket pjesës financjare me 1 Prill 1928.

Art. 53. i ligjës së paraqitun prej Dhomës së Deputetve, qi bahet Art. 50 i tekstit të ri Komisjoni e ka formulue në këtë mënyrë:

Art. 50. Kjo ligjë hynë në fuqi që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Pranohet

Art. 56 i ligjës së paraqitun prej Dhomës së Deputetve qi bahet art. 10 i tekstit të ri.

Art. 51. Ministrija e P. Mbrendshme ngarkohet me zbatimin e këtij ligje.

Pranohet.

Z. KRYETARI. Mbasi gja tjetër për të bisedue nuk kemi, mbledhja mbyllet n'ora 12.30 mbas dreke

## Mbledhja 10.

E Shtunë Marc me 31.1928 ora 4 mbas dreke.

**Mbledhja e Kryesuem Z. P. Evangheli**

Këndohen emnat e Z.Z. Senatorve, dhe mungojnë Z.Z. Gj. Çoba (leje) P. Harito (leje) S. Vapteri, S. Vrioni (leje) Sh. Verlaci Sh. Serreqi.

Mbasi u giend shumica, Z. Kryetari çeli mbledhjen.

Z. KRYETARI. Hyjmë në rendin e ditës: Bisedim mbi Projekt-ligjen mbi transferim e një kredit prej Fr. ari 2300 në Buxhetin 1927-28 të Minis-
trisë P. Mbrendshme (dalë nga Komisjoni me ngarkim).

Këndohet raporti i Komisjonit A. Nr. 5. datë 31-III-1928 si vijon:

P. T.

Kryesisë së Senatit

Komisjoni A. në mbledhjen e vet me datë 31-3-1928, tue qenë në numrin legal mori në bisedim projekt-ligjen mbi transferim kredit prej fr. ari 2.500, në Buxhetin e Min. P. Mbrendshme të vjetit financjar 1927-28 tue gjetë t'arsyeshme transferimin e kredit në fjalë, vendosi pranimin e saj, dhe i lutet Senatit të japë aprovimin e vet.

Kryetari i Komisjonit A.
P. Evangheli d. v.

Sekretari i Komisjonit A.
S. Papa d. v.

Këndohet ligja nen për nen si vijon:

### Ligjë

Mbi transferim kreditash në Buxhetin e Ministrisë së P. Mbrendshme ushtrimi 1927-28.

Art. 1. Zbritet prej Kap. 6. «Qira» të Buxhetit të Ministrisë të P. të Mbrendshme ushtrimi 1927-28 Fr. ari 2.500 (dy mijë e pesqind) e shtohet Kap. 3 «udhëtim e dieta» po të këtij buxheti.

Pranohet.

Art. 2. Kjo ligjë hyn në fuqi që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Pranohet.

Art. 3. Me zbatimin e këtij ligjë ngarkohet Ministrija e P. të Mbrendshme dhe ajo e Financavet.

Pranohet.

Z. KRYETARI: Bisedim mbi projekt-ligjen mbi transferim kreditash në Buxhetin 1927-28 të Ministrisë së P. Mbrendshme (dalë nga Komisjoni me ngarkim)

Këndohet raporti i Komisjonit A. Nr. 6 datë 31-3-1928 si vijon:

P. T.

Kryesis së Senatit

Komisjoni A. në mbledhjen e vet me datë 31-3-1928 tue qenë në numrin legal, mori në bisedim e shqyrtim projekt-ligjen mbi transferim kreditash në Buxhetin e Ministrisë P. të Mbrendshme dhe nga ajo e Drejtorisë së P. të Shëndetësisë 1927-28, tue gjetë t'arsyeshme transferimin e kreditave në fjalë, vendosi pranimin e saje, dhe i lutet Senatit të japë aprovimin e vet.

Kryetari i Komisjonit A.
P. Evangheli d. v.

Sekretari i Komisjonit A.
S. Papa d. v.

Këndohet ligja nen për nen si vijon:

### Ligjë

Mbi transferim kreditash në buxhetin e Ministris së P. të Mbrendëshme, dhe nga ajo e Drejtoris P. të Shëndetësisë 1927-28.

Art. 1. Zbritet prej Kap. 1. Art. 1 "rrogë personeli" fr. ari 180 (njëqind e tetëdhetë) prej Kap. 3 "Qira" fr. ari 400 (katerqind) dhe prej Kap. 11 "krezhtime" fr. ari 920 (nendqind e njëzet) gjithsejt fr. ari 1.450 (njëmijë katerqind e pesdhetë) të degës s'administratës së P. të Mbrendëshme.

Pranohet.

Art. 2. Zbritet nga Kap. 11 Art. 1 "rrogë personeli" fr. ari 3350 (trimijë treqind pesdhetë) Art. 2 "rrogë për mjek të posaçim" fr. ari 2340 (dymijë e treqind e dyzet) e Art. 3. "rrogë për fisharin..." fr. ari 1110 (njëmijë njëqind e dhjetë) dhe prej Kap. 20 "...

Bisedimet e Senatit, Sesioni i marsit 1928
*Fletore Zyrtare, nr. 52, Viti VII, 17 maj 1928, f.1-3*

200. Komisar i Policis (Kl. IIIt.)
150. Sekretari i Shtetit Civil.
150. Polici,

**Nenprefekturat e Kl. Irë**

*Fr. ari në muaj*

350. Nenprefekti.
200. Sekretari
180. Nëpunsi i Shtetit Civil

**Nenprefekturat e Kl. IItë**

300. Nenprefekti
190. Sekretari
180. Nëpunsi i Shtetit Civil

**Krahinat,**

200. Krahinari i Kl. Irë.
150. Krahinari i Kl. IIIt.
120. Krahinari i Kl. IIIt.
100. Sekretari i Krahinës.

## Kaptina e III.

**Klasifikimi e kategorizimi i nëpunsavet të Ministris P. Mbrendshme**

Art. 32.

Të gjithë nëpunsit e Ministris së P. Mbrendshme ndahen në kategori e klasë të poshtë shenueme:

| Kategori | Klasë | Rrogë | Nëpunësija |
|---|---|---|---|
| Irë. | Irë. | 500-450 | Prefektat, Sekretari i Përgjithshem, Inspektorat |
| Irë. | IIt. | 400 | Drejtorat. |
| IIt. | Irë. | 350-300 | Nenprefektat, Kryesekretari i Shtetit Sekretarit e Drejtoris Korrespondencës i Shtetit Civil e Privat. |
| IIt. | IIt. | 299-200 | Kryesekretari i Prefekturës, Sekretar i IIt. në Ministri, Sekretari i Emig. Redaktor'e Administ. i Flet. Zyrtare, Komisari i Policis i Kl. Irë. e i Kl. IIt. Krahinari i Kl. Irë. Protokollist-arshivist, Nëpunës i Shtetit Civil, Sekretarit e Nenprefekturave të Kl. Irë. |
| IIIt. | Irë. | 199-150 | Kopist në Ministri, Sekretar në Nenprefekture, Nëpunës Burgu, Krahinar i Kl. IIt. Nëpunës i Shtetit Civil, në Nenprefekture. |
| IIIt. | IIt. | 149-100 | Krahinar i Kl. IIIt. Sekretar Krahine, Kopist në Prefekturë, e Prathanë në Drejt. e Korrespondencës. |

## Kaptina e IV.

**Kondita dhe cilësit e domosdoshme, për nëpunsit e Ministris P. të Mbrendshme për pranim e emnim**

Art. 33.

Për t'u emnuar në nëpunsit e kategoris së Irë. Kl. i Irë. e i IIt. të Ministris së P. të Mbrendshme kandidati duhet:

a) Të ketë mbaruem nji shkollë të naltë (Universitet) ose Gjimnaz të plotë me sherbim të gjatë dhe me provë zyrtarie.

b) Të jetë nenshtetas Shqiptar me moral e karakter të mirë, dhe të mos jetë dënuar me krimë a me delikt që irondhin dinjitetin, besimin, nderin personal e qeveritar.

Art. 34

Për t'u emnuar në nëpunsit e kategoris së dytë Kl. Irë. për veç kondita'e së shenueme në paragrafin B. t'artikullit sipër treguem duhen dhe këto cilsit:

Të ketë mbaruem nji shkollë të paktën gjysmë Gjimnazi ose të ketë nji sherbim të paktën 3 vjet, në klasën e dytë të kësaj kategorije.

Art. 35.

Nëpunsat e kategoris së IIIt. të Klas'it IIt. duhen të kenë këto cilësina:

a) Të ketë mbarue të paktën gjysmë gjimnaz dhe të ketë zotsinë e duhun të provueme me konkurs.

b) Të ketë gjithë cilsinat e treguema në paragrafin B. t'artikullit 33.

Art. 36

Për t'u emnuem në nëpunsit e kategoris IIIt. Klasit Irë. e IIIt. për veç cilsinavet e provueme ne paragrafin B. t'artikullit 33 kandidati duhet të ketë mbarue të paktën nji shkollë plotore dhe të ketë zotsin e duhur të provueme me konkurs.

Art. 37.

Ata që janë kandidat në të gjithë nëpunsit e kategorive I, II, III, ose ata që emnohen, detyrohen të paraqisin këto dokumenta:

1) Letër-njoftimin e nënshtetsis,

2) Diplomën e certifikatën e shkollës.

3) Letër dëshmin e Këshillit të vendit e të Prokuroris.

4) Letër indemnitetin e nëpunsis dhe letër-shërbimin e vërtetuem.

5) Raportin e mjekut të vërtetuem prej Drejtoris së Shëndetsis.

**Mënyra e emnimit dhe zgjedhja e nëpunsavet.**

Art. 38.

Nëpunsat e kategoris së Irë, Kl. I Irë, e I IItë, dhe nëpunsat e kategoris së IItë, Kl. I Irë, si të shqyrtohen gjithë aktet relative të kërkueme për këto nëpunsi n'artikujt e sipërme, zgjidhen prej Ministrit dhe bahen formalitetet e duhuna si mbas ligjës të nëpunsave në fuqi për emnimin e tyne.

Art. 39.

Për emnimin e nëpunsavet (për veç atyne që përmenden në artikullin 38) Këshilli i Ministris detyrohet të bâjë shpallje me mjete ma të shpejta në gjithë Prefekturat e Nënprefekturat për m'i sjellë në konkurs kandidatët për një nëpunsi vakant. Pranohen në konkurs gjith ata që kanë cilsina dhe dokumentat të përmenduna n'artikullin e sipërtreguem, dhe Këshilli në fund vendos propozimin e emnimit të një kandidati, i cili ka fitue në konkurs.

Kaptinë e Vtë.

**Mënyra e gradimit të nëpunsave.**

Art. 40

Gradimi i nëpunsavet të kategoris së Irë, Klasi i Irë dhe të IItë, bahet në bazë të dokumentavet dhe cilsinavet të treguem n'artikullin ma nalt, me pelqimin e Ministrit, gradimi i nëpunsavet të kategorive të tjera bahet me vendimin e Këshillit Ministrist, tue marrë para sysh:

a) Vjetërsin në shërbim

b) sjelljet në shërbim,

c) moralin dhe energjin,

ç) raportet e inspektorve, ose të superiorve të nëpunsit.

d) zell dhe kujdesi në detyrë, si dhe vjetërsia në nëpunsi.

Art. 41.

As kush prej nëpunsavet nuk mund të gradohet dy shkallë për një herësh. E drejta e gradimit prej një klase në tjetrën fitohet tue shërbye së paku katër vjet n'atë klasë.

Art. 42.

Një nëpunës kur punon me zell e energji të plotë superjori ma i naltë i tij e nderon me një letër-lavdatë, e cila shënohet në jetëshkrimin e tij.

Art. 43.

Ata nëpunës që kanë të drejtë për gradim por nuk gradohen dot për arsye se nuk ka vend vakant, për shërbimet e tyne u jepet një shtesë rroge në këtë mënyrë: Ata që kanë një shërbim prej 5-10 vjet dhjetë për qind e rrogës.

Ata që kanë një shërbim prej 10-20 vjet, 25 për qind të rrogës.

Dispozitat e këtij artikulli do të zbatohen mbasi të kalojnë katër vjetët mbas shpalljes së kësaj ligje.

Art. 44.

Ata nëpunës që ndodhen në shërbim dhe që nuk kanë cilsinat e lypuna prej kësaj ligje, mbrenda në dy vjet, në qoftë se nuk tregojnë zotsin e atëherë nxirren jashtë kuadros.

Art. 45.

Nëpunsit ndëshkohen disiplinisht në rast kur në shërbimin e tyne nuk përmbushin detyrimet e lypuna prej ligjevet e rregullorevet të Ministris.

Ndëshkimet disiplinore janë këto:

a) Qortim me gojë,

b) qortim me shkrim duke u shënue edhe në jetëshkrimin e tij,

c) të premit e një sasie të rrogës,

ç) transferim në vend tjetër,

dh) të zbritunit e një grade ma të ultë

e) pushim nga puna.

Art. 46.

Për një nëpunës që qortohet me gojë dy herë mbrenda 3 muejve po u lyp një ndëshkim i ri ndëshkimi i fundit nuk do të jetë ma i pakët se qortimi zyrtar e shënim në jetëshkrim.

Një nëpunës që qortohet me shkrim dy herë në gjashtë muej po u lyp një ndëshkim i ri, ndëshkimi i ri nuk do të jetë ma pak se të premunit e një sasie së rrogës bashkë me ndalimin e gradimit.

Kur një nëpunës që i pritet rroga dhe i ndalohet gradimi dy herë në një mot, po u lyp një ndëshkim i ri ky nuk do të jetë ma i pakët se transferimi i tij bashkë me të zbritunit e një grade ma të ultë.

Për një nëpunës qi manifestohet me degradim, po u lyp një ndëshkim i ri, ky nuk do të jetë veç se pushimi të tij nga puna.

Art. 47.

Këto ndëshkime që u përmendën ma sipër mbi propozimin e Inspektorave, Prefektave, ose Sekretarit të Përgjithshëm, a të Drejtorave, vendosen prej Këshillit të Ministris dhe zbatohen me një kerash me pëlqimin e Ministrit. Ndëshkimet e përmenduna në paragrafin a, b, c, mund të zbatohen prej Ministrit pa pasë nevojë per vendimin e Këshillit.

Art. 48.

As një nëpunës i *Ministris së P. të Mbrendshme* nuk mund të ndëshkohet me ndëshkimin ma të madh; pa i u përshtatë dispozitave e formaliteteve t'art. 45, per veç se kur dënohet e pushohet me vendimin e gjykatores. Ndëshkimet ligjore kundra nëpunësve bëhen si mbas dispozitave të ligjës mbi gjykimin e nëpunësave.

Art. 49.

Gjithë ligjit e Shtetit qi i kundërshtojnë dispozitave të kësaj ligje janë t'anullueme.

Art. 50.

Kjo ligjë hyn në fuqi që prej ditës së shpalljes në F[illegible]a Zyrtare.

Art. 51.

*Ministrija e P. të Mbrendshme* ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqit sovrane të Shtetit,

*Mbassi* Trupi Legjislatif ka pranuem;

*Mbi propozimin e Ministris së P. të Mbrendshme*;

*Mbassi* u ndëgjue e u pëlqye mendimi i Këshillit Ministruer;

DEKRETOJMË:

zbatimin e Ligjës Organike të Ministris së P. të Mbrendshme.

Tiranë, me 11-VI-928.

A. ZOGU

Ministri i P. të Mbrendshme:
K. Kotta

Ligji organik i Ministrisë së Punëve të Brendshme
*Fletore Zyrtare, nr. 74, Viti VII, 14 korrik 1928, f. 6-8*

Neni 178. Kushdo që, tue qenë në shërbim të postave, telegrafavet, ose të telefonave, dhe tue abuzue kët cilësi, ven, në dorë një letër, një pakë, telegram ose të tjera korrespondenca jo të mbylluna ose i hap tue qenë të mbylluna, me qëllim që të marrë dijeni mbi përmbajtjen, ose i dorëzonë ose ban të dituna qenjen dhe përmbajtjen e tyne në persona që nuk janë destinatarë ose përhap lajme telegrafike ose telefonike, ndëshkohet me burgim të randë nga një deri në tridhjet muej.

Po me këtë ndëshkim, dënohet dhe ay i cili, tue qenë në shërbim të postave, ose të telegrafave, telefonave, dhe, tue abuzue në cilësi, prish ose çduk një korrespondencë epistolare ose telegrafike.

Në qoftë se ndonjana nga vepret e parapame në këtë nen shkakton dam, burgimi i randë asht nga gjashtë muej deri në katër vjet tue i u shtue dhe globa e randë nga një qind deri në pesë mijë fr. ari.

Neni 179. Kushdo që me shkakun e cilësis, së funksionit, të profesionit ose të mjeshtërisë së tij, tue patun dijeni mbi një të mshehtë, e cila po të përhapet, mund të shkaktoj dam, e zbulon në të mshehtë pa ndonjë shkak të arsyeshëm, ndëshkohet me burgim deri në një muej ose me globë të randë nga pesdhetë deri në një mijë fr. ari, dhe në qoftë se dami ngjan, ndëshkimi me globë nuk mund t'jetë ma pak se treqint fr. ari.

Neni 180. Për delikte e parapame në nenet 175, 176, 177, 178, ndjekja bahet mbi kërkimin e anës së damtueme, kurdoherë që vepra nuk ka shkaktue një dam publik.

## KAPTINA VI.

### Delikte kundra lirisë së punës

Neni 181. Kushdo që me violencë ose me frikësim përkufizon ose ndalon me ç'do mënyrë lirin'e industrisë ose të tregtisë, ndëshkohet me burgim deri në njizet muej dhe me globë të randë nga një qint deri në tre mijë fr. ari.

Neni 182. Kushdo që me violencë ose me frikësim shkakton ose ban të vazhdojë një pushim ose pezullim në punim për m'i u imponue puntorëve ose patronëve ose sipërmarrësit paksim ose shtim të mëditjes (salaire) ose lidhje të ndryshme nga ato që janë kontraktue ma parë midis puntorëve dhe patronit ose sipërmarrësit, ndëshkohet me burgim deri në njizet muej.

Neni 183. Kur në fajet e parapame në nenet e mësipërme ndodhin mbrenda kryetarë ose krye-shkaktarë, ndëshkimi për këta asht burgim nga tre muej deri në tre vjet, dhe globa e randë nga pesqint deri në pesë mijë fr. ari.

## TITULLI III.

### Delikte kundra administrasionit publik

## KAPTINA I.

### Spekullimi i nëpunsave

Neni 184. Nëpunsi i Shtetit i cili, tue lihen ose përvehon të holla ose të tjera sende të luejtshme të cilava për shkak të nëpunësis ia ka administrimin ose ruejtjen ose mbledhjen e tyne ndëshkohet, me ndalimin të përhershëm nga oficet publike, me burgim të randë nga një deri në dhjet vjet dhe me globë të randë jo ma pak se tre qint fr. ari.

Në qoftë se fajtori çdamon plotësisht të damtuemin para se të dërgohet përpara gjyqit ose dami i shkaktuem asht i lehtë, ndëshkimi, asht me burgim të randë gjashtë muaj deri në pesë vjet, me globë të randë jo ma pak se dyqint fr. ari dhe me ndalim të përkohëshme nga oficet publike.

Neni 185. Kur fajtori, me qëllim që të mbulojë fajin e parapamë në nenin e ma sipërm, ka vepruë tue mbajtun rrodhorët e librat postafat pa rregull ose tue ba llogaritna e bilanca të rreme ose tue treguë radhonië, dokumenta e libra të rreme, ose tue çfaqe gjendjen e grupave, qeseve ose të pakove me të holla jashtë së vërtetës ose tue ba dhelpënina dhe dinakëria q'i sigurojnë mos daljen në shesh të fajit të tij, ndëshkohet me burgim të randë nga pesë deri në dhjet vjet, me ndalim të përhershme nga oficet publike, dhe me globë të randë baras me shumën e abuzueme.

Në rastet e të dy neneve të ma sipërme, në qoftë se dami asht i vogël ose fajtori ka shpërblye plotësisht këtë dam para se të dërgohet në gjyq, ndalimi nga oficet publike asht i përkohëshëm, dhe burgimit të randë i zbritet gjysma deri në dy të tretat.

Neni 186. Nëpunsi i Shtetit q'asht i detyruem me kontrollimin ose inspektimin e pasunive të luajtshme të Shtetit, në qoftë se neglizhon në të kryemit e detyrës, dhe shkakton në këtë mënyrë të dëmtohet Shteti ose të shtohet debiti, ndëshkohet me globë të randë nga tre qint deri në dy mijë fr. ari.

Neni 187. Nëpunsi i Shtetit q'asht i ngarkuem me blë me shitë, ose m'i prokurue Shtetit ç'do lloj sende, në qoftë se dëmtohen në shitblemjen, ose në vleftën, ose në sasinë ose në fabrikimin e këtyne, tue përdor dhelpënina ndëshkohet me burgim të randë jo ma pak se tre vjet, dhe me-

ndalim nga nëpunësia për një kohë nga tre deri në dhjetë vjet.

Neni 188. Nëpunësi i Shtetit që nuk u paguen puntorëve, të cilët i përdor për ngarë të Zyrës, pagat, siç janë, për punim ose për transportim, ose nuk u ep plotësisht çmimin e sendevet, ose i u a paguan të mangët, ose pa të drejtë i përdorë angari e pa të holla, ose i përdor për punërat vetiake, ndëshkohet me burgim të randë nga gjashtë muej deri në dy vjet, dhe me globë të ranë baras me dy fishen e shumës që ka përfitue nga ky abuzim.

Veçanërisht detyrohet m'i u pague t'interesuemve të drejtat e tyne.

Neni 189. Nëpunësi i Shtetit, që, tue përdor nëpunësa ma pak se numri i caktuem në kadron e zyrës, merr rrogat ose pagat e numërit që mungon, si dhe ay që heq nëpunësit krejt nga shërbimet origjinale dhe i ven në punërat vetiake tue i rregue mbrenda kadros t'asajë zyre, ndëshkohet me burgim të randë nga tre muej deri në tre vjet dhe me globë të ranë baras me shumën e marrun, tue u detyrue dhe me kthimin e të hollavet që ka abuzue.

Në qoftë se heqja e nëpunësit origjinal, dhe përdorimi i tij në punërat vetiake asht ba vetëm për një kohë të shkurt, ndëshkimi asht me burgim deri në tre muej ose në globë të ranë nga një qint deri në një mijë fr. ari.

## KAPTINA II.

### Dhuntim (concussion)

Neni 190. Nëpunësi i Shtetit i cili, tue abuzue nëpunësien e vetë shtrengon një tjetër që t'i apë ose t'i zotohet pa qenë i detyruem atij ose një të treti të holla ose të tjera përfitime, ndëshkohet me burgim të randë nga dy deri në pesë vjet, dhe me globë të randë jo ma pak se treqint fr. ari, dhe me ndalim nga oficet publike për një kohë nga tre deri në pesë vjet.

Në qoftë se shuma ose përfitimi i dhanun ose i zotuem pa të drejtë, ka një vlefë të vogël, ndalimi i përkohëshëm dhe burgimi i randë asht nga një deri në tre vjet.

Neni 191. Nëpunësi i shtetit që, tue abuzue nëpunësinë e vet, bindë një tjetër që t'i apë ose t'i zotohet atij ose një të treti, pa të drejtë, të holla ose të tjera përfitime, ndëshkohet me burgim të randë nga një deri në tre vjet, dhe me globë të randë nga njëqint deri në pesëmijë fr. ari, dhe me ndalim të përkohëshme nga oficet publike.

Në qoftë se nëpunësi, tue përfitue vetëm nga gabimi ose nga pa dijenija e tjetrit, merr një send të cilin ligjësisht nuk duhet t'a marrë, burgimi i randë asht nga gjashtë muej deri në dy vjet, dhe globa e randë nga njëqint deri në dymijë fr. ari, tue i u shtue dhe ndalimi i përkohëshëm nga oficet publike.

Në qoftë se shuma ose vlera e përfitimit të dhanun ose të zotuem pa të drejtë asht e vogël, ndëshkimi me burgim dhe ay me ndalim nga oficet publike zbritet, në rastin e parë, nga tre muej deri në dy vjet, dhe në rastin e dytë nga një muej deri në një vit.

## KAPTINA III.

### M i t ë

Neni 192. Nëpunësi i shtetit që për me ba një vepër të nëpunësisë të vetë që ishte i detyruem t'a bajë, ose për me mos ba një vepër që të nëpunësisë së tij, të cilën ishte i detyruem mos t'a bajë, merr, për vehte ose për tjetrin, në të holla ose në të tjera përfitime, një dorovi (retribution), që nuk ka të drejtë t'a marrë, ose pranon zotime për asilloj dorovina, ndëshkohet me burgim të randë deri në një vit, me ndalim të përkohëshme nga oficet publike dhe me globë të randë nga pesëqint deri në tre mijë fr. ari.

Neni 193. N'punësi i shtetit që merr ose që bën t'i zotohen të holla ose të tjera përfitime për vehte ose për të tjerë, për me vonue ose për me ometue një vepër të nëpunësisë së vetë ose për me ba një vepër kundra detyrave t'asajë nëpunsie, ndëshkohet me burgim të randë nga gjashtë muej deri në pesë vjet, me ndalim të përhershme nga oficet publike dhe me globë të randë nga një qint deri në gjashtë mijë fr. ari.

Neni 194. Për fajin'e parapamë në nenin e ma sipërme, për veç ndalimit të përhershëm nga oficet publike dhe globës së randë të tregueme n'atë nen, ndëshkimi me burgim të randë asht nga tre deri në dhjetë vjet, në qoftë se vepra ka pasun për efekt:

1. Të dhanunit të një nëpunsie, rroge, pensioni, titull nderi, ose të lidhunit e një kontratoje në të cilat interesohet zyra nga e cila varet ay;

2. Favorizimin ose dëmtimin të një ane ose të pandehunit në çeshtje civile ose penale.

Në qoftë se vepra ka pasun për efekt të dhanunit e një vendim dënimi me ndëshkim kundra lirisë personale për ma tepër se një vit, burgimi i randë asht nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet, dhe globa e randë mund të zgjatet deri në maximumin.

Në rast që efekti i sipërmendun asht një dënim me vdekje q'asht ekzekutuem, burgim'i i randë nuk mund të jetë ma pak se pesëmbëdhjetë vjetë.

Neni 195. Nëpunësi i shtetit që, pasi ka kryem një vepër të nëpunsisë vet dhe pa qenë marrun vesh që ma parë, merr, për atë vepër, qoftë për të tjerët, në të holla ose në të tjera përfitime, një retribucion që nuk ka të drejtë t'a marrë ose pranon po n'atë mënyrë zotimë për nalloj daravina, ndeshkohet me burgim deri në tre muej dhe me giobë të randë nga pesdhet deri në një mijë Fr. ari, tue u ndalue përkohësisht dhe nga oficet publike.

Neni 196. Kushdo që i ep mitë ose hind një nëpunës të Shtetit për me krye ndo njenin nga delikte e parapame në nenet e ma sipërme si dhe ay që ndërmjetson në një mitë ndeshkohet, në rastin e nenit 193, me burgim nga një deri në giashtë muej, dhe me giobë të randë nga pesdhet deri në dymijë fr. ari, dhe me ndalim të përkohshëm nga oficet publike, dhe në rastet e tjera, ndeshkohet me giorndo e dënimeve të caktuem për atë që merr mitën.

Neni 197. Nuk ndeshkohet:

1. Nëpunësi i Shtetit i cili për mitën të zotuem ose të marrun prej tij, lajmëron Autoritetin kompetent mbrenda tre ditve q' prej ditës së zotimit ose në marrjen e mitës tue i dorzue dhe të hollat ose sendet që ka marrun.

II. Ay që, tue kthyem nga zotimi ose dhania e mitës q' i ka ba një nëpunësi të shtetit, lajmëron Autoritetin kompetent mbrenda tre ditve q' prej ditës që ka ba zotimin ose që ka dhanë mitën.

Në të gjitha këto raste për mos ndeshkimin e fajtorit duhet që të mos jetë kryem, qoftë dhe pieserisht, vepra për të cilën asht marrë ose pranue ose dhanë ose zotue mitë, dhe të mos jetë shkaktue as ndo një dam tjetër publik ose privat.

Neni 198. Në rastet e parapame në këtë kapitull, mitë marrësi që me gjithse e kishte në dorë t'a mbarohte vepren për të cilën ka marrë mitën ose i asht ba zotimi, me dashjen e vet nuk e kryen atë vepër, ndeshkimi, të caktuem prej ligjës, i zbritet një e treta deri në gjysmën.

Neni 199. Në të gjithë rastet e parapame në nenet e ma sipërme, konfiskohet sendi i dhanun si mitë.

## KAPTINA IV.

### Abuzim autoriteti dhe shkelje e detyrave të lidhuna me nëpunsinë

Neni 200. Nëpunsi i shtetit që, tue abuzue nëpunsin' e vet, urdhënon ose ban kundra të drejtave të tjetrit ç'do lloje vepre arbitrare e cila nuk asht parapae prej ndonjë dispozitë të posaçme të ligjës si faj, ndeshkohet me burgim nga pesëmbëdhjetë ditë deri në një vit, dhe në qoftë se këjo vepra i ka ba me një qëllim privat, ndeshkimi, i shtohet një e giashta, tue u vumë, në vend të burgimit, burgim i randë.

Po me këtë dënim, ndeshkohet dhe ay nëpunës që n' ushtrimin e funksionit të vet ekziton tjetrin të shkeli ligjën ose masat e marruna prej Autoritetit.

Neni 201. Nëpunsi i shtetit që, drejt për së drejti ose me ndërmjetsin' e ndonjë tjetri, ose me vepra simulare, i siguron vehtes një interesë private në ç' do lloj vepër t' administratoret publik, pranë së cilës ushtron nëpunsinë e vet, ndeshkohet me burgim të randë nga një muej deri në pesë vjet, dhe me giobë të randë nga treqint deri në pesmijë fr. ari.

Neni 202. Nëpunësi i shtetit që ban të dituna ose përhap dokumenta ose fakte, q' i ka në dorë ose i di, me shkakun e nëpunsisë, dhe që duhen të mbeten të fshehta, ose me ç' do mënyrë lehtëson që këto të merren vesh, në qoftë se dokumentat ose faktet në fjalë nuk janë nga ato që përmbëdhen në kaptinën I. të titullit I, dhe në kaptinën V. të titullit II, ndeshkohet me burgim deri në tridhjetë muej, dhe me giobë të randë jo ma pak se njëqind fr. ari.

Neni 203. Nëpunësi i shtetit që, për ç' do lloj preteksi, qoftë dhe për heshtjen, errësinën, kundërthanjen ose pa mjaftësin' e ligjës, ometon ose refuzon të baj një vepër të nëpunësisë vet, ndeshkohet me giobë të randë nga pesdhjet deri në një mijë e pesqint fr. ari.

Në qoftë se delikti asht ba nga dy ose ma shumë nëpunësa të marrun vesh që ma parë, gioba e randë asht nga një qint deri në tremijë fr. ari.

Në qoftë se nëpunësi i shtetit asht i degës Drejtësisë, për m' u konsiderue si i ajillë faj omisioni ose refuzimi, duhet që t' ekzistojnë gjithë kondita që kërkon ligja për të ngrehun padië civile kundra tij.

Neni 204. Nëpunësi i shtetit që nuk zbaton urdhënat e superiorit të vet pa ndonjë arsye ligjore, si dhe ay nëpunës që vilet ashpër kundra t' interesuarve, ndeshkohet me giobë të randë nga pesdhjet deri në pesq'int fr. ari, dhe në rast të përsëritjes, përveç ndeshkimit së përsëritës, giyqi mund të vendosi dhe ndalimin përkohësisht nga oficet publike.

Në qoftë se nga mos të kryemit e urdhënit të superiorit si ma sipër, i vjen ndonjë dam Shtetit, ndeshkimi asht me burgim nga pesëmbëdhjetë ditë deri në një vit, dhe me giobë të randë nga një qint deri në dymijë fr. ari, dhe me ndalim të përkohshëm nga oficet publike.

Neni 205. Ushtriaku ose agenti i forcës publike që refuzon ose vonon

pa ndonjë shkak t'arsyeshëm, shurdhimin e një kërkimi q'i bëhet ligjërisht nga Autoriteti kompetent, ndëshkohet me burgim deri në dy vjet.

Neni 206. Nëpunsi i shtetit që në ushtrimin e nëpunësisë së vet ka marrë dijeni për një faj, para ndalimi ose ndalimi i së cilit i takon ushtrimit t'asajë nëpunësije dhe për të cilin veprohet kryesisht, në qoftë se omiton ose pa ndonjë shkak t'arsyeshëm vonon m'i a referue Autoritetit, ndëshkohet me globë të rëndë nga pesdhjetë deri në një mijë fr. ari.

Në qoftë se fajtori asht nëpunës i Policisë gjyqsore ndëshkimi i shtohet dhe ndalimi nga zyret publike për një kohë deri në gjashtë muaj.

Neni 207. Nëpunësit e Shtetit që, mbi numrin tre ose ma tepër dhe të marrun vesh që ma parë, lanë pa ndonjë shkak t'arsyeshëm zyrën e tyne, ndëshkohen me globë të rëndë nga dy qind deri në tre mijë fr. ari, dhe me ndalim të përkohshëm nga nëpunësia.

Po me këtë dënim ndëshkohet dhe ay nëpunës që lën zyrën e vet për me ndalue mbarimin e një puni ose për m'i shkaktue ç'do tjetër dam shërbimit publik.

Neni 208. Nëpunësi kompetent i Shtetit që ban martesë të ndalueme nga ligja ose pa u kryem formalitetet ligjore, ndëshkohet me burgim deri në një muaj, dhe me globë të rëndë deri në treqind fr. ari.

Po me këto ndëshkime dënohen dhe ato tutorë ose kujdestarë që shtyjnë të kujdesuemit e tyne, për me ba një martesë të kundra-ligjshme.

Neni 209. Nëpunësi i Shtetit që ban tregti mbrenda qarkut të nëpunsisë së vet, mbi sendet ushqimore të nevojës së parë, ndëshkohet me globë të rëndë nga pesdhjetë deri në tre mijë fr. ari, dhe ndalohet përkohësisht nga nëpunësia.

## KAPTINA V.

### Abuzimet e fetarvet n'ushtrim të funksionit të tyne.

Neni 210. Fetari që, n'ushtrimin e funksionit të vet, botënisht shan ose poshtron institusionet, ligjat e Shtetit ose veprat e Autoritetit, ndëshkohet me burgim deri në një vit, dhe me globë të rëndë deri në një mijë fr. ari.

Neni 211. Fetari që, tue përfitue nga cilësija e vet, shtiton tjetrin për me poshtrue institusionet, ligjat ose urdhënat e Autoritetit, ose për me mos respektue ligjat, urdhënat e Autoritetit, ose detyrat q'i përkasin një nëpunësi të Shtetit, ndëshkohet me burgim nga një muaj deri në një vit dhe me globë të rëndë nga një qind deri në një mijë fr. ari.

Në qoftë se vepra asht ba botënisht, burgimi mund të zgjanohet deri në dy vjet.

Po me këto dënime ndëshkohet dhe fetari që, tue përfitue nga cilësija e vet, shtrëngon ose bind ndonjanin me ba vepra ose deklarohet që janë kundra ligjës ose në dam të të drejtave të fitueme si mbas ligjës.

Neni 212. Kur fetari, tue përfitue nga cilësija e vet, ban një delikt të ndryshëm nga ato të parapame në nenet e naltpërmenduna, ndëshkimi i caktuem për deliktin e bamun i shtohet një e gjashta deri në një të tretën.

Por, në qoftë se ligja cilësinë e tij e ka marrun parasysh në caktimin e dënimit, ky shtim nuk aplikohet.

## KAPTINA VI.

### Përvetimi i funksioneve publike dhe i shenjave nderi.

Neni 213. Kushdo që, pa të drejtë, i vën vehtes ose ushtron një funksion publik, civil ose ushtrijak, ndëshkohet me burgim deri në tre muaj dhe me globë të rëndë deri në dy mijë fr. ari.

Po me këtë dënim dhe me ndalim të përkohshëm nga zyrat publike, ndëshkohet dhe ay nëpunës që, pasi ka marrë zyrtarisht dijeni për pushimin ose pezullimin e vet nga funksioni, vazhdon t'a ushtrojë.

Gjyqi mund t'urdhënojë që shkurtimi i aktgjykimit të publikohet me shpenzimet e të dënuemit në një fletore të vendit ku ky ka banimin dhe të vendimit ku ka ba fajin, si dy fletoret do të shënohen n'aktgjykimin.

Neni 214. Kushdo që, pa të drejtë dhe botënisht vën shenja, ose vesh petka, zyrtare të një nëpunësie, ose të një eflaji, ose mvar mbi vehte dekoracione, ose medalje, ose shenja të tjera, ose grada që nuk i janë dhanun ose i ep vehtes këmbore tjera, grada dinjitet ose herë publike ndëshkohet me globë të rëndë nga pesdhjetë deri në një mijë fr. ari.

Gjyqi mund t'urdhënojë që shkurtimi i aktgjykimit të publikohet me shpenzimet e të dënuemit në një fletore që e caktom në vendimin.

## KAPTINA VII.

### Violencë dhe kundërshtim Autoritetit.

Neni 215. Kushdo që përdor violencë ose frikësim kundra një anëtari të Dhomave Legjislative, ose një nëpunësi të Shtetit për me e shtrëngue që të bajë ose t'omitojë një vepër të funksionit të vet, ndëshkohet me burgim të rëndë nga tre deri në gjashtë muaj.

Burgim i rëndë asht:

1. Nga gjashtë muaj deri në pesë vjet, në qoftë se faji asht ba me armë;

2. Nga tre deri në pesëmbëdhjetë vjet, në qoftë se faji asht ba prej ma



26 PLETORJA ZYRTARE I KALLNUER 1928

tepër se tre personave të bashkuem dhe t'armatosun, ose me bashkimin e ma tepër se shtat vetave të marrun vesh qi ma parë, qofshin dhe pa armë.

Neni 216. Kushdo që përdor violencë ose frikësim, për me ndalue ose turbullue mbledhjet ose ushtrimin e funksionit të Trupeve qivqore, politike ose administrative ose të përfaqsuesave të kippes ose s'autoriteteve të tjera, të Zyravet ose të Institutave publike, ose për me influencue mbi vendimet e tyne, dënohet pa me ato ndeshkime që caktohen në nenin e ma sipërm.

Neni 217. Kushdo që, merr pjesë në një mbledhje e cila përbahet prej ma tepër se shtatë vetave dhe ka për qëllim të kryemit e fajit të parapame në nenin e ma sipërme tue përdorë violencë ose frikësim, ndëshkohet me burgim të randë nga një muaj deri në dy vjet dhe me globë të randë deri në pesë qind fr. ari. Në qoftë se faji asht ba tue pasun dhe armë, burgimi i randë asht nga tre muaj deri në tre vjet dhe globa e randë jo ma pak se nji qind fr. ari.

Në qoftë se mbledhja përndahet mbi urdhënin e qeverisë, personat që kanë marrë pjesë n'atë nuk ndëshkohen për fajin e parapame në këtë nen; por kryetarët dhe kryeshkaktarët dënohen me ndëshkimin e caktuem për fajin e bamun pa mos u aplikue shtimi i nenit 221.

Neni 218. Kushdo që, përdor violencë ose frikësim për me i u kundërshtue një nëpunësi të Shtetit kur ban detyrat e nëpunësisë së vet ose atyne që, mbi kërkimin e këtij, i apin ndihmë, ndëshkohet me burgim të randë nga një muaj deri në dy vjet.

Burgimi i randë asht:

1. Nga tre deri në tridhjet muaj në qoftë se faji asht ba me armë.

2. Nga një deri në shtatë vjet, në qoftë se faji asht ba me bashkimin e ma tepër se tre vetave t'armatosun ose me bashkimin e ma tepër se shtat vetave të marrun vesht qi ma parë, qofshin dhe pa armë.

Në qoftë se faji asht ba për me shpëtue vedin ose një gjini t'afërme të vet nga rreshtimi, ndeshkimi, për rastin e treguem në § a 1, të këti neni, asht burgim i randë ose burgim deri në gjashtë muej, ose internim për një kohë nga tre muej deri në tre vjet, dhe për rastin e treguem në numerin 1, të këti neni, asht burgim i randë nga dy muej deri në dy vjet, dhe për rastin e treguem në numërin 2, nga gjashtë muej deri në pesë vjet.

Neni 219. Për efektet e ligjës penale me fjalën gjinië e afërme kuptohen: bashkëshortët prindërit (ascendants), të pasardhunit (descendants), ungjërit, nipërit, vëllazënit, motrat dhe vjehrrët, vjehrrat, prindërit e kripave, dhandrit, nusëja, kunatët dhe kunatat.

Neni 220. Kur nëpunësi i Shtetit i ka dhanë shkak fajit, tue kapërcyë me veprat arbitrare të veta kufinin e kompetencës (attributions) së vet, nuk aplikohen dispozitat e nenevet të naltpërmendura.

Neni 221. Kur në fajet e parapame në nenet e ma sipërme ndodhen krye-shkaktarë ose Kryetarë, ndeshkimi për këta, i shtohet një e gjashta deri në një të tretën.

KAPTINA VIII.

Çnderime e të tjera delikte kundra personave që kanë një autoritet publik

Neni 222. Kushdo që, me fjalë, ose me vepra, ofendonne ç'do lloj mënyrë onorin, famën ose dinjitetin e një antari të Dhomave Legjislative ose të një nëpunësi të Shtetit, në praninë dhe për shkak të funksionit së ndeshkohet:

1. Me burgim të randë deri në gjashtë muaj ose me globë të randë nga pesdhjet deri në tre mijë fr. ari në qoftë se ofeza asht drejtuem kundra një agjenti të forcës publike.

2. Me burgim të randë nga një muaj deri në dy vjet ose me globë të randë nga treqind deri në pesë mijë fr. ari në qoftë se ofeza i asht ba një tjetër nëpunësi të Shtetit, ose ndonjë Antari të Dhomave Legjislative.

Neni 223. Kushdo që, ban fajin e parapamë në nenin e ma sipërme, me violencë ose me frikësim, ndëshkohet me burgim të randë nga një muaj deri në tre vjet dhe me globë të randë nga një qind deri në një mijë fr. ari.

Po me këto dënime, ndëshkohet dhe ay që, për ç'arsyeje, përdor violencë ose frikësim kundra një antari të Dhomave Legjislative ose kundra një nëpunësi të Shtetit për shkak të nëpunësisë së vet.

Neni 224. Kur ndonjë nga fajet e parapame në nenet e ma sipërme, asht ba kundra nëpunësit të Shtetit jo për shkak të nëpunësisë së këtij, por kur ky asht tue ushtrue funksionin e vet, aplikohen ndëshkimet e caktueme në ato nene, tue i u zbritë ndëshkimit një e treta deri në gjysmën.

Neni 225. Kur ndonjani nga fajet e parapame në nenit 222 223 asht ba kundra një nëpunsi të Shtetit për shkak të nëpunësisë dhe n'ushtrimin e sipër të funksionit të këtij, aplikohen ndëshkimet e caktueme n'ato nene, tue i u shtuem, ndeshkimit një e gjashta deri në një të tretën.

Neni 226. Kushdo që, me fjalë ose me vepra, ofendon, me ç'do lloj mënyre, famën ose dinjitetin e një e një trupi qivquer, politik ose administrativ në mbledhje e sipër ose të një

gjyqtari në gjyq e sipër ndeshkohet me burgim të randë nga tre muej deri në tre vjet.

Në qoftë se kundra Trupit ose gjyqtarit përdoret violencë ose bahet trikësim, burgim i randë asht nga gjashtë muej deri në pesë vjet.

Nuk bahen ndjekje ligjore veç se me autorizimin e Trupit t'ofenduem.

Në qoftë se delikti asht ba kundra një trupi që nuk asht i formuem në Kshillë, nuk bahen ndjekje veç se mbi autorizimin e Kryetarit hierarshik të tij.

Neni 227. Nuk pranohet që fajtori i ncolpnit nga deliktet e parapame në nenet e ma sipërme, të provojë se faktet ose cilësinat q'i atribohen t'ofendueumit janë të vërteta ose të dijuna botënisht.

Neni 228. Dispozitat që përmbajnë nenet e ma sipërme, nuk aplikohen kur nëpunësi i Shtetit i ka dhanë shkak fajit tue kapërcye kufinin e kompetencës vet me veprat arbitrare.

Neni 229. Në të gjitha ato rasa që nuk janë parapamë nga një dispozitë të posaçme e ligjës, kushdo që, ban një delikt kundra një antari të Dhomave Legjislative ose kundra një nëpunësi të shtetit për shkak të funksionit të vet, dënohet me ndeshkimin e caktuem për deliktin e bamun, tue i u shtue ndeshkimit një e gjashta deri në një të tretën.

KAPTINA IX.

Prishje e vulave dhe heqje nga vendet e dispozitave publika.

Neni 230. Kushdo që, me ç'do lloj mënyrë prish vula të vumuna si mbas një dispozitë të ligjës, ose si mbas një urdhëni t'Autoritetit për me sigurue ruejtjen ose identitetin e një sendi, ndeshkohet me burgim të randë nga tre muej deri në dy vjet; dhe me globë të randë nga pendhjet deri në një mijë fr. ari.

Në qoftë se fajtori asht ay nëpunës i shtetit që ka urdhënue ose ka shkaktuar të vulosunit, ose ay që ka pasë ruajtje ose në dorëzim sendin e sigurueme me ato vula, burgimi i randë asht nga tridhjet muej deri në pesë vjet, dhe globa e randë nga tre qint deri në tre mijë fr. ari.

Në qoftë se faji asht ba për shkak imprudencë ose nga pa kujdesia e nëpunësit ose të ruejtsit, këta ndeshkohen me globë të randë nga pendhjet deri në një mijë e pesë qint fr. ari.

Neni 231. Kushdo që, heq, çduk ose prish, gris ose ndryshon sendë fajli, akte ose dokumenta të ruejtuna në një zyrë publike, ose pranë një nëpunësi të shtetit për shkak të cilësis të tij, ndeshkohet me burgim të randë një deri në pesë vjet.

Në qoftë se fajtori asht po ay nëpunës i shtetit i cili për shkak të nëpunsis së vet kish në dorëzim sendet e fajit, aktet ose dokumentat, ndeshkimi asht burgim i randë nga dy deri në gjashtë vjet, dhe ndalim i përherëshëm nga oficet publike.

Kur dami i shkaktuem nga ay faj asht i vogël ose fajtori kthen të pa ndryshuem aktin, ose dokumentin, pa që të ketë përfitue nga ajo dhe para se të dërgohet në gjyq, ndeshkimi në rastin e § I. asht burgim i randë nga gjashtë muej deri në tre vjet, dhe në rastin e § II. burgim i randë nga një deri në pesë vjet, dhe ndalim i përkohëshëm nga oficet publike.

Neni 232. Kushdo që, heq ose kthen për fitimin e vet ose të tjetrit, ose refuzon m'i dorzue atij që ka të drejtë, sende të ndryshme të vumuna në peng ose në sekuestrim dhe të cilat i janë lanë në besimin e në ruejtjen e tij, ndeshkohet me burgim të randë nga tre deri në tridhjet muej, dhe me globë të randë nga një qint deri në dy mijë fr. ari.

Në qoftë se fajtori asht vetë i zoti i sendit të pengueme ose të sekuestruem, ndeshkimi asht burgim i randë deri në një vit, dhe globa e randë nga pendhjet deri në një mijë e pesë qint fr. ari.

Në qoftë se delikti asht ba nga imprudenca ose pa kujdesja e ruejtsit, ky, për këtë vepër, ndeshkohet me globë të randë nga pendhjet deri në një mijë fr. ari.

Në qoftë se vlera e sendit asht e vogël, ose fajtori e kthen sendin ose paguan vlerën para se të dërgohet në gjyq, ndeshkimit e zbritet një e gjashta deri në një të tretën.

KAPTINA X.

Mburje si me pasë influencë pranë zyrtarëve

Neni 233. Kushdo që, tue u mburrun se ka një influencë ose i shkon fjala te një nëpunës i Shtetit, ose te një antar' i Dhomave Legjislative, merr ose ban t'i epen ose t'i zotohen, atij vetë ose së tjerëve, të holla ose përfitime të tjera, si shpërblim për me shtyt punën ose për me ndërmjetue mbasi atij zyrtari, ose me pretekst sikur ka me ble favorin ose ka me shpërblye atë, ndeshkohet me burgim të randë nga tre muej deri në dy vjet, dhe me globë të randë nga një qint deri në dy mijë fr. ari.

Në qoftë se fajtori asht një nëpunës Shteti, ndeshkimeve u shtohet, në ç'do rast, ndalimi i përherëshëm nga oficet publike.

KAPTINA XI.

Mos përmbushja e detyrimeve dhe mashtrime në furnitura publike

Neni 234. Kushdo që, tue mos përmbush detyrimet që ka marrë për


28 FLETORJA ZYRTARE 1 KALLNUER 1928

sipër, ïrn mungat ushqimit, ose arnde të tjera të nevojshme për një stabiliment ose shërbim publik, ose për me ndalue ose penzanue një kahmiet publik, ndeshkohet me burgim të randë nga gjashtë muej deri në tre vjet dhe me globë të randë ma tepër se pes qint fr. ari.

Në qoftë se mos përmbushja vjen vetëm nga pa kujdesia, fajtori ndeshkohet me burgim deri në një vit dhe me globë të randë deri në tre mijë fr. ari.

Neni 235. Kushdo që bën mashtrim në llojin, cilësinë, ose sasin' e sendeve, të treguame në nenin e ma sipërme, ndeshkohet me burgim të randë nga gjashtë muej deri në pesë vjet, dhe me globë të randë ma tepër se pesë qint fr. ari.

Kurdohert që mashtrimi bahet në të tjera furnitura të destinueme për një stabiliment ose shërbim publik, ndeshkimi asht burgim' i randë deri në dy vjet dhe globë të randë deri në tre mijë fr. ari.

KAPTINA XII.

Dispozita të përbashkëta për kaptinat e ma sipërme

Neni 236. Për efektet e ligjës penale konsiderohen nëpunës shteti:

1. Gjith' ata që janë ngarkue me funksione publike, qofshin dhe të përkohshme, me rrogë ose jo, në shërbim të Shtetit, të Prefekturave, të Nënprefekturave të Krahinave, të Bashkive të katundeve dhe të komuniteteve të pranueme prej shtetit, ose të një institut të ndevuemun prej ligjës në kujdesi të shtetit ose në kujdesie të një Prefekture, Nënprefekture, Krahinarie, të një Bashkie, të një katundi ose të një komuniteti si ma sipër.
2. Noterët.
3. Agjentët e forcës publike dhe fuqis' e gjykatoreve.

Po për nëpunës shteti mbahen edhe punonjësit e Shtetit dhe fuqive; si dhe arbitrat, ekspertat, sindikat, dragomanët, dishmitarët, për sa vazhdon funksioni për të cilin janë thirrun.

Neni 237. Kur ligja konsideron cilësin' e nëpunësit të Shtetit si element përbamës ose si një shkak randësues të fajit, për ankesën e një faj asht ba për shkak të funksionit që ka ushtrue, përfshihet dhe rasti në të cilin personat e treguem në nenin e ma sipërme nuk kanë ma cilësinë e nëpunësi të Shtetit, ose nuk ushtrojnë ma këto funksione kur asht ba faji.

Neni 238. Kur ndonjiai përmbe ba një delikt përveç fajeve ose mbetet që janë të lidhuna me funksionin publik që ka, ndeshkimi të caktuem për deliktin e bamun i shtohet një e gjashta deri në një të tretën, për veç kur cilësia e nëpunësit të Shtetit asht marrë parasysh nga ligja në caktimin e ndeshkimit.

TITULLI IV.

Delikte kundra administrasionit të Drejtësis

KAPTINA I.

Refuzim' i një funksioni të detyrueme me ligjë

Neni 239. Kushdo që, tue qenë i thirrun nga Autoriteti gjyqësuer si dishmitar, ekspert, ose dragoman, merr të përjashtojë vehten nga përzantimi tue vumë përpara pretekste të rrema, ose tue qenë i prezantuem, refuzon të dishmojë ose të bajë detyrën' e ekspertit ose të dragomanit, ndeshkohet me burgim deri në gjashtë muej ose me globë të randë nga njëqint deri në njëmijë fr. ari.

Për ekspertat në këtë rast kur ndeshkohen me burgim, dënimi ka për efekt pezullimin e ushtrimit të profesionit ose të mjeshtërisë për një koh' baras me atë të burgimit.

KAPTINA II.

Simulasion fajesh dhe personash

Neni 240. Kushdo që i kallzon Autoritetit gjyqësuer ose një nëpunësi të shtetit i cili asht i detyruem me i a referue atë Autoritetit, një faj q'e din se nuk ka ngja, ose simulon gjurmat e këtij faji në një mënyrë që mund të fillojnë hetime penale, ndeshkohet me burgim të randë deri me tridhjet muej dhe me globë të randë deri në dy mijë fr. ari.

Po me këtë dënim ndeshkohet dhe ay që deklaron përpara Autoritetit gjyqësuer, rrenësisht, se ka ba një faj ose ka bashkë punue në të kryemit e një faji, për veç se kur një i tillë deklarim i rrem bahet për me shpëtue ndo njenin nga gjinia e afërme e vet.

Neni 241. Kushdo që, prezanton vehten përpara Autoriteteve në vend të një personi tjetër, dhe si kur këtë vepër t'a këtë ba pa qenë u thirrun ose pa qenë u kërkue, ndeshkohet me burgim nga pesë ditë deri në një muej, ose me globë të randë nga pesë dhjet deri në pesqint fr. ari.

Neni 242. Kushdo që, prezantohet ose vën vehten në vendin e një personi tjetër, q'asht dënue me një gjigjykim, ndeshkohet me burgim nga një deri në gjashtë muej dhe me globë të randë nga një qint deri në një mijë fr. ari.

KAPTINA III.

Cpifje

Neni 243. Kushdo që, me kallzim

Vepra penale që lidhen me Administratën Publike

*Fletore Zyrtare, 1 korrik 1928, f. 22-28*

**MBRETNIJA SHQIPTARE**

*KRYESIA E KËSHILLIT MINISTRUER*

# Projekt-Ligjë

mbi

## gjendjen juridike dhe rregullimin hjerarkik të nëpunsave civil

BIBL TEKA KOMBETAR TIRANE

TIRANE

SHTYPSHKRONIA «TIRANA»

1931

KAPTINA I.

## Dispozita të përgjithshme

Neni 1.

Janë nëpunsë gjith ato persona, pa ndryshim seksi, të cilve në bazë të nji emnimi t'autoritetit publik në mbështetje të nji ligjës u ngarkohet nji shërbim shtetnuër me nji rrogë të caktueme në buxhet.

Neni 2.

Quhen të pajtuëm ato persona të huej ose vendes qi merren në shërbim t'administratës publike për nji kohë të caktueme në bazë të nji kontrate.

Të huajtë edhe Shtetasit mund të merren në shërbim me kontratë, kur kan si profesion nji specjalitet teknik, dhe në kët rast rroga e tyne caktohet me kontratë dhe nga kjo pikpamje nuk i shtrohen kategorizimit të rrogave për nëpunsat e tjerë.

Të pajtuemit nuk i shtrhone ligjës se pensjonit, por përfitojnë nga të drejtat dhe privilegjet e nëpunsave për sa vazhdon kontrata.

Neni 3.

Dispozitat e kësaj ligje, përveç klasës ushtarake, zbatohen për gjith nëpunsit e Shtetit, por gjendar-

merija i shtrohet nji ligjës së posaçme dhe përfiton vetëm nga dispozitat e përgjithshme të kësaj ligje.

Neni 4.

Gjith shërbëtorët e zyrave të ndryshme nuk konsiderohen si nëpunës.

Neni 5.

Për me u emnue nëpunsë duhet:

1) Me qenë shtetas shqiptar;

2) Me gëzue e me ushtrue të drejtat civile;

3) Me dijtë mirë me fol, me shkrue e me këndue gjuhën zyrtare;

4) Mos me qenë i dënuëm me ndeshkim kundra lirisë personale për matepër se nji vjetë kundra zakoneve të mira ose për falsifikim, mashtrim, spekulim nëpunsije, dhuntim, mitë, vjedhje dhe keq-përdorim besimi.

Gjith-ashtu mos me qenë i denuëm me nji ndeshkim i cili sjell me vedi ndalimin e përhershëm nga ofiqet publike ose vumjen nën vrejtje të posaçme t'autoritetit të sigurimit publik;

Në rast ndalimi të përkohëshëm për aqë sa vazhdon ndalimi;

5) Me pas sjellje e moral të mirë;

6) Me pas krye studimet e nevojshme dhe me pas të gjitha konditat e tjera të posaçme qi kërkohen për çdo nëpunsi prej ligjës organike përkatse edhe prej kësaj ligje;

7) Me qenë i shndosh dhe i fortë nga konstitucjoni, pa të meta e mungesa qi mund t'influencojnë punimin e tij.

Konstatimi i gjendjes shndetësore bahet me nji raport të dhanun prej dy mjekve.

Neni 6.

Nëpunsi kur, për shkaqe t'arsyeshme, fillon nga detyra ma vonë se dita e emnimit, për efektet ekonomike, konsiderohet se asht emnue ditën e fillimit në detyrë.

Neni 7.

Nëpunsi, para se të fillojë në detyrë, në pransi të dy deshmitarve, do të betohet përpara kryetarit të zyrës së tij në menyrë q ipason: «Betohem mbi nderin tim se do të jem besnik ndaj Mbretit se do të respektoj lealisht Statutin Themeltar dhe ligjet e tjera të Shtetit; se do të plotësqj të gjitha detyrimet e nëpunsisë s'eme me zellë e kujdesi, në konformitet me interesën publike dhe t'administratës, tue rujtë mshefteisnë zyrtare dhe tue konformue sjelljen t'eme zyrtare dhe private me dinjitetni e nëpunsisë qi m'asht m'asht ngarkue».

«Deklaroj se nuk jam dhe se nuk do të jem pjestar i shoqjatave ose i partive, aktiviteti i të cilavet asht i pa-pajtueshëm me detyrat e nëpunsisë s'ime».

«Betohem se kam me plotësue gjith detyrimet e mija tue pas për qëllim kurdoherë vetëm të mirën e atdheut.»

Mbi të kryemit e betimit mbahet nji proce-verbal i posaçëm i cili ruhet midis akteve personale të nëpunsit; Nji kopje e këtij proces-verbali i dorëzohet këtij.

Betimi nuk përsritet kur nëpunsi kalon në nji detyrë tjetër, por kur ka dispozita të ndryshme në ligjet e tjera.

## Neni 8.

Gjith nëpunsit e Shtetit qi ndodhen sot në shërbim, qi nga dita e hymjes në fuqi të kësaj ligje, mbrenda në një muej detyrohen të redaktojnë jet-shkrimin e tyne në konformitet me listat e gjendjes amzore t'aneksueme kësaj ligje.

## Neni 9.

Jet-shkrimi do të bahet në tri kopje, njena prej të cilavet metet në zyrën përkatse, e dyta pasi të vërtetohet prej Ministrisë përkatse ose prej kryetarit të zyrës, dërgohet në Drejtorinë e Pensjoneve dhe e treta e vërtetueme i kthehet nëpunsit.

Nëpunsit qi emnohen për herën e parë në shërbim të Shtetit, bashkanjitun me lutjen për emnim, ose për me marrë pjesë në konkurs, detyrohen me paraqitë jet-shkrimin e tyne si mbas dispozitave të nenit të ma-sipërm.

## Neni 10.

Dokumentat e nëpunsave qi formojnë bazën e jet-shkrimit, n'origjinal ose të përkthyemë, kopjohen në tri shembullore dhe u vërtetohet konformiteti i tyne me origjinalin prej kryetarit të zyrës dhe i njiten fletës se jet-shkrimit.

Ata qi pretendojnë se dokumentat provuese të jet-shkrimit të tyne janë djegë, ose kan hupë, i u epet nji afat i arsyeshëm për me sjellë kopjet nga autoritetet prej ku kan dalë ato dokumenta. Këtyne kopjeve do t'u njitet nji pullë prej 20 qindarë.

## Neni 11.

Që nga data e hymjes në fuqi të kësaj ligje çdo nëpunsë kur ndahet nga nji zyrë, në çdo menyrë qi

të jetë, nga këshilla administrative e vendit, dhe kur asht nëpunsë në qendër, nga Këshilli Epëruër i Ministrisë ku ka shërbye ose nga instituti ku dipendon i epet nji dishmi në të cilën tregohet koha e shërbimit edhe qi i ka dorëzue suksesorit të tij gjith dokumentat, sendet e tjera zyrtare, zyrën dhe llogaritë kur ka.

Neni 12.

Që nga data 28 Ndanduër 1912 deri në datën e hymjes në fuqi të kësaj ligje, për shkak se lëshimi i deshmive për shërbim nuk ka qenë i detyrueshëm, për këto kohë, në vend të deshmisë pranohen prova të tjera, dhe në rast qi në zyrat shtetnore nuk janë mbajtë ose nuk janë ruajtë regjistrat, pranohen dishmitë e autoriteteve të bazueme mbi hetime hindse qi ekzistojnë.

Neni 13.

Në muejin Jenar të çdo vjeti për sejcilin nëpunsë redaktohen nota cilsimi.

Këta nota do të përmbajnë gjith shenimet mbi konditat fizike dhe cilsitë intelektuale të nëpunsit, mbi sjelljet e tija zyrtare dhe private, mbi zelin dhe kujdesinë e treguerne në te kryemit e shërbimit zyrtar si dhe mbi të gjith cirkonstancat e posaçme qi i përkasin plotësimit të detyravet qi i janë ngarkue, mbi aftësinë e tij për nji shkallë nëpunsije ma të naltë si dhe çëdo shënim tjetër qi shifet i arsyeshëm.

Neni 14.

Notat e cilsimit redaktohen dhe nënshkruhen prej funksjonarit qi drejton zyrën ku punon nëpunsi. Kto nota rishikohen e nënshkruhen prej frunksjo-

narit epruër si mbas organizimit hjerarhik të shërbimit.

Cilsimet e shenueme i njoftohen nëpunsit me nji shkresë të posaçme të cilën e nënshkruën ay vetë.

Nëpunsi mbrenda 15 ditëve çë prej komunikimit ka të drejtë me ju sjellë Kshilli Eperuër, të degës së tij kundër cilsimit qi i asht atribue.

Këshilli Epruër, në bazë të raportit, shqyrton shkresën e kryezyrtarit qi ka shenue cilsimin dhe formulon cilsimin definitiv.

Neni 15.

Gjykimi përfundimtar shprehet me këto cilsime:

1) Shum i mirë ;
2) I mirë ;
3) Mesatar ;
4) I keq.

Neni 16.

Cilsimi «shum i mirë» u epet vetëm atyne nepunsave të cilët tue marrë parasyesh shkallën e nëpunsisë shkëlqejnë midis nëpunsve të tjerë nga pikpamja e zotësisë, e kulturës, e zelit dhe e kujdesisë në punë, dhe kan pas herherë sjellje shembëllore.

Në dhanjen e këtij cilsimi merren parasyesh veçanërisht dhe sherbimet e bame në kondita të jashtzakonshme qetësija dhe shndetësija publike koha e kalueme në qendra me kondita të vështira dhe në vise të pashndetëshme, studimet edhe punët zyrtare me randësi të posaçme si dhe botimet mbi degat e ndryshme t'administratës publike, e sidomos ato qi i përkasin administratës me të cilën lidhet nëpunsi, këto cirkonstanca do të përmenden shprehimisht në notat e cilsimit.

Neni 17.

Cilsimi «I mirë» u epet atyne nëpunsave qi kan krye pa ndërprenje detyrat e nëpunsisë së tyne me zotësi dhe kan pasë sjellje dhe moral të mirë;

Neni 18.

Cilsimi «Mestar» u epet nëpunsëve qi kan dhanë prova aftësije të mjaftueshme dhe kujdesi në punë në shkallë ma t'ultë se nëpunsit qi meritojnë cilsimin «i mirë».

Në çdo rast u epet ky cilsim nëpunsve qi, në vjetin të cilit i referohet kjo notë, janë dënue disiplinarisht me nji ndeshkim ma të randë se «Qortimi».

Neni 19.

Nëpunsi qi ka marrë cilsimin «Mesatar» nuk mund të gradohet para se të kalojnë dy vjet që prej skadimit të vjetit në të cilin ka marrë cilësim.

Neni 20.

Cilsimi «i keq» i jepet nëpunsit qi, në vjetin qi i referohet nota, nuk ka tregue zotësi, kujdesi në punë, ose ka pas sjellje të këqija në zyrë ose jashta zyrës. Në çdo rast u epet cilsimi «i keq» nëpunsve, të cilët në vazhdim të vjetit janë ndeshkue disiplinarisht me pezullim nga nëpunsija e nga rroga.

Neni 21.

Nëpunsi qi për dy vjet me radhë ka marrë cilsimin «i keq» i shtrohet procedimit të caktuëm për pushimin e tij nga puna.

Neni 22.

Cilsimi «i keq» i heq nëpunsit të drejtën e gradimit si dhe tagrin me konkurue në provim për gradim, deri sa të konstatohet përmirësimi i tij.

Kėte konstatim e ban Kshilli Epruėr i nėpunsave i cili mund tė ja kėthejė nėpunsit kėtė tė drejtė, kur si mbas mendimit tė tij, shėrbimet e bame prej nėpunsit mbrenda kohė tregojnė se ky asht pėrmirsue.

## KAPTINA II.

## Klasifikimi i Nėpunsve

kategori = grade
grada = klasë

### Neni 23.

Nėpunsat ndahen nė ~~10 kategori~~ 5 grade nė konformitet me tabelėn II) bashkangjitun kėsaj ligje.

### Neni 24.

Kondita e posaçme tė moshės, tė kulturės, tė praktikės, menyra e zgjedhjes, e proponimit, e gradimit, cilsitė e posaçme pėr me u emnue nė nėpunsi tė ndryshme dhe detyrat e posaçme tė nėpunsisė; caktohen nė Ligjet Organike tė çdo Ministrije, ose Drejtorije nė pajtim me parimet e pėrgjithshme tė kėsaj ligje.

Gjithashtu me Ligjet Organike tė posaçme ose me rregullore mund tė caktohen ~~gradat~~ klasët e nėpunsve tė sejcilės ~~kategori~~ grade.

### Neni 25.

Nė nji zyrė nuk mund t'emnohen dy nėpunsė qi kan lidhje gjinije ose krushqije deri nė shkallėn e dytė inkluziv.

### Neni 26.

Rrogat e nėpunsve caktohen si mbas buxhetit.

Rrogat e nėpunsve qi ndodhen nė grada identi-

grade

ke të ~~kategorive~~ të caktueme në tabelën B), janë bara-; përveç nëpunsve të Ministrisë P. Jashtme të cilvet, tue u rujtë barasija e kategorive dhe e gradave në form alokasjoni dhe si mbas vendit ku janë akreditue, ju shtohet, rroga në shkallë t'arsyeshëm.

Neni 27.

Rrogavet të caktueme si mbas buxhetit për çdo kategori dhe për çdo gradë të nji kategorije mbas nji perjudhe shërbimi prej tri vjetve, kur nuk ka ndalime qi rjedhin prej ndeshkimeve disiplinore u shtohet 5% dhe mbas nji perjudhes së dytë prej aq kohe dhe 5% të tjera; në perjudhën e tretë prej katër vjetësh i shtohet 10%.

Neni 28.

Nëpunsat qi kan fitue pjesërisht ose tansisht shtesat e tregueme në nenin e ma-sipërm, në rast qi gradohen edhe rrogat e gradave të reja rezultojnë ma të ultë se rrogat komplesive, nëpunsi i graduëm ruen rrogat komplesive të fitueme.

Neni 29.

Për të gjith emnimet dhe gradimet në nëpunsina të kategorivet 3, 4 dhe 5, posë atyne qi rregullohen me ligjë të posaçme dhe t'atyne qi konferohen ekskluzivisht në bazë të nji provimi, do të merret mendimi i Këshillit Epruër të nëpunsave të cilit i komunikohen, për kët qëllim, të gjitha aktet personale dhe notat cilsimi të nëpunsit. Sa për nëpunsit qi ndodhen në kategoritë 6 e poshtë merret mendimi i kryetarve të zyrave respektive.

Neni 30.

Vendet vakante në nëpunsitë e kategorive 3, 4 dhe 5 mbushen në tri menyra:

1) Tue gradue nëpunsit e asaj kategorije, kur nëpunsija vakante asht në nji shkallë ma të naltë, ose nëpunsit e kategorive imediate ma t'ulta mbasi të merret mendimi i favorshmë i Këshillit Epruër të nëpunsve ose i kryetarvet të zyrave respektive, si mbas nenit të ma sipër;

2) Tue çelë provim midis nëpunsëve të meritueshëm për gradim, në rast qi vendet vakante janë ma pak se ata nëpunsa;

3) Tue çpallë konkurs publik, në rast qi vendet vakante janë ma shum se numri i nëpunsve të meritueshëm për gradim, ose vendet vakante do të mbushen me nëpunsa me kondita të posaçme, ose kur lypet nji kompetencë teknike e posaçme për nëpunsina vakante, të cilën nuk e ka asnji nga nëpunsit e meritueshëm të kategorive ma t'ulta.

Neni 31.

Lista e nëpunsve qi mund të gradohen për meritë pregatitet prej Këshillit Epruër të nëpunsave, i cili mbasi shqyrton aktet personale dhe notat cilsimi të nëpunsve, ven në listë ata qi meritojnë gradim tue caktue dhe shkallën e meritës.

Për t'u vue në listën e gradimit duhet qi nëpunsit të kenë fitue të paktën për tri vjet me radhë cilsinë «shum i mirë» «i mrë».

Neni 32.

Në gjith ket në rast qi mbesin vende të disponueshme, mbas zgjedhjes së tregueme në nenin e ma-

sipërm. Këshilli Epruër mund të shenojë në listën e gradimit dhe ata nëpuns të cilët në vjetin e parë të perjudhës trivjetore kan marrë nji cilsim: «mesatar».

Neni 33.

Me listat e gradimit shenohen të gjith ata nëpuns qi meritojnë gradim në nëpunsina ma të nalta, edhe sikur numri i tyne të jetë ma i math se sa janë vendet e disponueshme.

Nëpunsit e shenjueme në listë tej numrit t'emnave të disponueshëm, gradohen në bazë të këtij shkallzimi sa po qi çelen vende në nëpunsina të gradës ma të naltë.

Me gjith ket në rast qi nëpunsit e meritueshëm për gradim ose nji pjesë e tyne janë shkallzue në nji gradë meritimi, në bazë të mendimit të Këshillit Epruër veprohet si mbas numrit 2 të nenit 30.

Neni 34.

Kur Këshill Eipruër i nëpunsve çfaq nevojën e çpalljes të nji konkursi publik si mbas numrit 3 të nenit 30, pranohen me marrë pjesë në konkurs privatët qi kan cilsitë e përgjithshme për me u emnue nëpuns dhe cilsitë e posaçme për me u emnue n'atë kategori dhe gradë nëpunsije qi asht vakant.

Në konkursin publik mund të marrin pjesë dhe nëpuns të cilët me datën e dekretit qi urdhnon provimet kan mbushë të paktën tri vjet shërbim në kategorinë e nëpunsisë pa nderpjetësisht ma t'ulët, dhe si mbas mendimit të Këshillit Epruër të nëpunsve mbrenda kësaj kohë kan diftue zotsi, kujdesi në punë edhe kan pasë sjellje të mira.

Neni 35.

Konditat, qi dy herë me radhë janë deklarue të pa aftë në provimet e konkursit po për nji nëpunsi, nuk pranohen ma në konkurset e tjera qi mund të çelen për atë nëpunsi.

Neni 36.

Nëpunsi qi merret në procedim disiplinuër, për posë qortimit pasi të merret mendimi i Këshillit Epruër, me urdhën të Ministrit mund të përjashtohet nga provimet ose mund të nxjerret nga lista e nëpunsve të merituesh'ëm për gradim.

Neni 37.

Në rast qi nëpunsi merret në procedim disiplinuër pas provimit ose pas proponimit, në bazë të listave të meritës por para gradimit, gradimi mbetet i pezulluëm deri në përfundimin e procedimit disiplinuër.

Neni 38.

Kur procedimi përfundohet me nji ndeshkim disiplinuër ma të madh se zbritja e rrogës, përjashtimi nga gradimi bahet definitiv.

Neni 39.

Gjith-ashtu përjashtohet nga gradimi nëpunsi kundra të cilit aplikohet nji ndeshkim disiplinuër ma i madh zbritja e rrogës, pas redaktimit të notave të cilsimit të mramë dhe para provimit ose shqyrtimit të listave të meritës.

Neni 40.

Nëpunsit e gjith kategorive qi janë ndeshkue disiplinarisht me maksimumin e pezullimit nga grada rroga, nuk mund të gradohen për nji perjudhë 6 vjetore.

Neni 41.

Kur nëpunsitë vakante të Kategorive 6, 7, 8 dhe 9 janë ma shum se nëpunsit e meritueshëm për gradim çilet konkurs. Në kët, kan të drejtë me marrë pjesë gjith ata nëpunsa të cilët në vjetin e fundit nuk janë dënue me asnji ndeshkim disiplinuër dhe kan marrë nota cilsimi «shum mirë» ose «i mirë» si dhe ata qi kan cilsitë e posaçme të lypuna për nëpunsinë vakante: Gjith-ashtu në konkurs mund të marrë pjesë dhe çdo privat qi, pos cilsive të posaçme të sipërtregueme, ka kondital e përgjithshme të caktueme në Nenin 5 të kësaj ligje.

Neni 42.

Modalitetet e provimit caktohen kurdoherë prej Këshillit Epruër të nëpunsave. Pqovimet epen në pransi të këtij Këshilli ose të nji komisjoni të posaçëm i përbamë prej nëpunsash të delegnëm prej Këshillit Epruër.

## KAPTINA III.

### Këshilli Epruër i nëpunsve

Neni 43.

Pranë çdo Ministrije krijohet nji komisjon nëpunsash të naltë, për ushtrimin e detyravet administrative dhe disiplinore të caktueme në këtë ligjë, i përbamë prej dy Shef-Seksionesh nën kryesinë e Sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë respektive.

Drejtoritë autonome, si ajo e Post-Telegrafave

BIBLIOTEKA KOMBËTARE TIRANË

dhe e Shndetësis qi nga pikpamja herarhike janë lidhë në Ministritë përkatse, në rast qi komisjonit të nalt-përmendun i paraqitet nji çashtje disiplinore ose administrative i atyne Direktorive, kryesisht marrin pjesë në kët komisjon pranë Ministris ku janë lidhë. Këto Drejtori do të kenë nga nji Këshillë të posaçem të perhamë prej kryetarve të Drejtorisë të cilat kan me marrë vendime pregaditorë për emnime, gradime dhe masa disiplinore: këto vendime parashtrohen Këshillit Epruër të Ministrisë.

Ky komisjon merrë emnin «Këshilli Epruër i Nëpunsve».

N'atë Ministri qi ka ma shum se dy Seksione, antart e Këshillit Epruër ndrohen vit për vit me urdhnin e Ministrit.

Gjith-ashtu me urdhën Ministruër emnohen dhe dy zëvends prej nëpunsëve imedjat ma t'ulët se ata qi formojnë Këshillin Epruër për me zevendsue të parët në rast mungimi ose ndalimi të ligjëshëm të ndonjenit prej Këshillit Epruër.

Kur mungon Kryetari i Këshillit Epruër e zëvendson nji prej antarve ma të vjetër.

Këshilli Epruër emnon si sekretar të Këshillit nji nga sekretarët e Ministrisë.

Neni 44.

Në rast qi ndo nji antar i Këshillit Epruër merret vetë nën procedim disiplinuër ipso-jure rezohet nga detyra qi ka në Këshillin Epruër të nëpunsve.

## KAPTINA IV.

## Dorheqje dhe përjashtim nga sherbimi

### Neni 45.

C'do nëpunsë ka të drejtë me dhanë dorëheqjen, po kjo duhet të jepet me shkresë; dorëheqja nuk ka efekt kur nuk pranohet. Nëpunsi qi ka dhanë dorëheqjen asht i detyruëm me vazhdue në të kryemit e detyrave të zyrës, deri sa t'i njoftohet pranimi i dorëheqjes.

Pranimi mund të vonohet për arsye të randa shërbimi dhe mund të refuzohet kur rjedhë nji procedim disiplinuër kundra tij.

Në rast qi pranimi i dorëheqjes për arsyet e sipërtregueme vonohet dhe mbrenda nji mueji nuk emnohet ose nuk fillon në detyrë suksesori i tij, nëpunsi mund të hiqet nga detyra tue lajmerue superjorin.

Gjithashtu nëpunsi qi ka dhanë dorë-heqjen mund të ndahet nga zyra tue lajmerue superjorin vetëm në raste ekstraordinare të provueme.

### Neni 46.

Nëpunsi deklarohet kryesisht dorëheqës:

1. Kur humbet shtetsinë shqiptare;
2. Kur pranon nji misjon ose nji nëpunsi të nji qeverije të huej pa qenë i autorizuëm prej Qeverisë Kombëtare;
3. Kur pa shkak të justifikuëm nuk fillon në shërbim mbrenda afatit qi i asht caktue ose mungon nga zyra për nji perijudhë ma shum se 15 ditë.

BIBLIOTEKA KOMBETARE
TIRANE

4. Kur nëpunsi kryen shërbimin zyrtar në nji mënyrë qi ngatron ose nderpret rregullin dhe vazhdimshmënin e shërbimit.

Neni 47.

Në rast qi konstatohet fakti i përmendun në Nr. 3 të nenit të masipërm, Ministri kompetent tue marrë parasyesh konditat individuale dhe përgjegjësitë personale të nëpunsit, në vend qi të deklarojë dorëheqjen e tij mund të provokojë ndeshkimin disiplinuër tue aplikue pezullimin nga grada e nga rroga, ose përjashtimin definitif nga gradimi.

Neni 48.

Nëpunsi qi deklarohet i pa-aftë si mbas nenit 21 për me krye sherbimin qi i asht ngarkue, ose për shkaqe shëndetsije nuk mundet me krye vazhdimisht dhe me rregull detyrat e nëpunsis së tij hiqet nga shërbimi.

Neni 49.

Përjashtohet nga shërbimi nëpunsi qi asht i pazoti me krye shërbimin zyrtar në kategorinë dhe në gradën e nëpunsisë qi ka.

Me gjith këtë kur administrata shef se nëpunsin në fjalë mund t'a përdori në nji detyrë ma t'ulët se ajo qi ka, mundet me e degradue dhe në ktë rast nëpunsi merrë rrogën e nëpunsisë ma t'ulët që prej datës së degradimit.

Neni 50.

Çdo nëpunës qi ka mrijtë me hye në nji nëpunsi tue paraqitë dokumenta të pavlefshme ose të rrejshme ose tue lanë në heshtje fakte dhe cirkonstanca të cilat do t'a përjashtojshin nga nëpunsija, si mbas li-

gjeve në fuqi, dhe përgjithësisht ay qi ka fitue nji nëpunsi tue përdorë mjete të jasht-ligjëshme, sa po qi vërtetohen rregullisht këto vepra, përjashtohet nga nëpunsija pa u cenue në asnji rast padija penale eventuale.

Neni 51.

Nëpunsi i përjashtuëm nga shërbimi si mbas nenit të ma-sipërm, humb të drejtën e pensjonit dhe të shpërblimit, në rast qi ka, dhe nuk mundet të merret n'asnji nëpunsi tjetër t'administratës publike.

Neni 52.

Nëpunsi, të cilit i asht pranue dorëheqja, ose qi asht deklarue kryesisht dorëheqës, si dhe nëpunsi qi asht vue në pushim, për arsyet e treguema në nenet 63 64, si mbas shkallës së nëpunsisë, me vendim të Këshillit Ministruër ose me ate të Këshillit Epruër mund të ripranohet në shërbim, n'ate kategori dhe me ate gradë qi ka pasë. Dorheqsi i pranuëm ose i deklaruëm ruën vjetërsinë e fitueme, por i pushuemi humbet vetëm vjetërsinë e gradës.

## KAPTINA V.
## Ndeshkime disiplinore

Neni 53.

Kundra nëpunsve qi shkelin detyrat e ofiqit të tyne, ose qi me çdo mënyrë nuk i plotësojnë, merren masa disiplinore të cilat shenohen në gjendjen amzore të nëpunsit.

Ndeshkimet disiplinore, n'asnji rast, nuk cenojnë padinë penale.

Neni 54.

1.) Qortim ;
2.) Zbritje rroge ;
3.) Pezullim nga grada e nga rroga ;
4.) Pushim nga puna.

Neni 55.

Ndeshkimi i tregumë në Nr. 1 të nenit të ma sipërm aplikohet prej kryetarit të zyrës i cili si mbas ligjevet organike kryeson nji degë t'administratës.

Kundra shefave të zyrave qendrore dhe të zyrave lokale qi mvaren drejt për së drejti nga autoritet qendruer, dhe në çdo rast kundra nëpunsave të kategorive 2 dhe 3 dhe qi përfshihen në tabelën B); ndeshkimi i sipërtreguemë aplikohet prej Ministrit kompetent.

Neni 56.

Qortimi asht nji deklarim me shkresë qi tregon pa knaqsinë dhe i drejtohet nëpunsit për shkaqet qi vijojnë :

a) Nga ndalimi i akteve pa veprim në zyrë ma shum se dy ditë pa pasë ndonji arsye të pelqyeshme;
b) Nga mos ardhja në detyrë nji ditë në muej pa pasë ndo nji arsye;
c) Nga mos respektimi i orarit zyrtar në detyrë;
d) Nga mos respektimi i superiorit;
e) Për shkrim letra rekomandimi për favorizim.

Neni 57.

Zbritja e rrogës nuk mund të kalojë 1/5 e saj dhe nëpunsi nuk mund të dënohet me këte ndëshkim për nji kohë ma të gjatë se 6 muej.

Nëpunsi ndeshkohet me zbritje rroge :

a) Për sjellje inkorekte kundrejt superiorvet, kolegvet, nëpunsvet qi dipendojnë prej tij, ose kundrejt publikut;

b) Për mos-bindje të lehtë urdhnave të superjorvet;

c) Për sjellje të çrregullueme;

d) Për mos-mbajtje të mshefësisë zyrtare edhe sikur kjo mungesë të mos ketë shkaktue konsekuenca të damshme;

e) Për heshtje mbi çrregullimet qi ngjajnë në shërbim, mbi veprat e tjera kundra disiplinës, mbi sjelljet inkorekte ose mbi abuzimet e bame nga ana e nëpunsvet dipendent;

f) Për përsëritjen e veprave për të cilat nëpunsi asht ndeshkue me qortim, ose kur veprat e tregueme në nenin e ma-sipërm janë posaçërisht të randa.

Neni 58.

Pezullimi nga grada e rroga mund të vazhdojë prej nji deri në gjasht muej dhe shkakton largimin e nëpunsit nga shërbimi.

Neni 59.

Gruës edhe fëmijve të mitun të nëpunsit të pezullluëm nga grada dhe rroga, mund t'i akordohet nji shpërblim ushqimuër jo ma shum se nji e treta e rrogës së nëpunsit.

Neni 60.

Nëpunsi ndeshkohet me pezullim nga grada e rroga kur:

a) Përsëritë fajet të cilat kan shkaktue ma parë ndeshkimin e tij me zbritje rroge, ose kur këto faje janë posaçërisht të randa;

b) Provokon botime kritikash të pa drejta çiltazi

ose mshehtazi kundra administratës ose superjorit të tij ose botnisht hap lajme qi damtojnë prestizhin dhe kredinë e Shtetit;

c) Ban nji faj nga i cili zbulohet kjarisht se nëpunsi mban sjellje të papëlqyeshme, se vepron me anësi ose duron abuzime shum të randa të nëpunsve dipendent;

d) Tregon mos-bindje të randë kundrejt urdhnave të dhanuna prej superjorëvet;

e) Nuk ka mbajtë mshehtësinë zyrtare dhe kjo ka shkaktue konsekuenca të damshme;

f) Janë damtue interesat e Shtetit ose të privatve në marredhanjet qi kan me Shtetin nga mos-kujdesija e nëpunsit qi ka tregue në të kryemit e detyrave zyrtare;

g) Kur përdorë autoritetin e nëpunsisë për qëllime private;

k) Kur tenton me krijue nji levizje kolektive midis nëpunsve me qëllim qi t'ushtrojë presion në veprimet e superjorve ose qi t'u paksoj autoriteti;

i) Kur nëpunsi poshtnon administratën ose superjorët e tij;

j) Kur dehet në nji shkallë sa qi nuk mund të mohohet.

l) Kur lot bixhos vazhdimisht.

### Neni 61.

Nëpunsi i marrun në gjyqe për nji delikt mund të pezullohet nga grada e rroga; gjith-ashtu duhet pezullue at çast kur gjyqi nxjerrë kundra tij letërndalim të përhershëm. Në kte rastin e fundit masa e pezullimit urdhnohet drejt për së drejti prej kryetarit të zyrës imediate.

### Neni 62.

Kur procedimi ndeshkimuër mbaron me nji vendim definitiv qi mohon ekzistencën e faktit qi i ngarkohet nëpunsit, ose vendimi në fjalë me gjith qi pranon faktin përjashton të marmen pjesë të nëpunsit, pezullimi revokohet, dhe nëpunsi rifiton të drejtat e tija për rrogat qi nuk ka marrë.

Me gjith këtë kur administrata shef se, nga procedimi ndeshkimuer shfaqen fakte dhe cirkonstanca të cilat nxjerrin fajtuër nëpunsin për ndeshkime disiplinore, merren masa këso dore si mbas dispozitave përkatse.

Kjo rregull mbahet edhe në rast kur procedimi asht provokue mbi ankimin e nji privati edhe ky heqë dorë nga padija.

### Neni 63.

Nëpunsi, pamvarsisht nga çdo padi penale, ndeshkohet me pushim nga puna:

a) Për përsritje të ndonji faji për të cilin asht ndeshku ma parë me pezullim nga nëpunsija e nga rroga ose kur faji ose dore asht posaçërisht i randë;

b) Për abuzim autoriteti të randë;

c) Për abuzim besimi të randë;

d) Për mos mbajtje të mshefësisë zyrtare, kur nga kjo Shteti ose privatët kan pësue nji dam të randë;

e) Kur përdorë abuzimisht dhe heqë, për dobi të vet, shuma të cilat i ka nën administrimin ose i mban si depozitë ose me qëllim lejon ose lehtëson qi nëpunsat dipendent të bajnë abuzime këso dorë;

f) Kur pranon shpërblime ose pjesime të çdo lloji nga beneficet e nxjerruna ose të shpresueme prej të

tretëve, të cilat nvaren nga veprimet zyrtare qi rregullohen prej atij nëpunsi;

g) Kur shkelë me dhel detyrat zyrtare tue i shkaktue dam Shtetit ose privatve ose tue vue në rezik të randë qetsinë publike;

k) Për vepra të randa mos-bindje kundra administratës ose superjorve të bame botnisht tue shkelë, në menyrë evidente parimet ma elementare të disiplinës dhe t'autoritetit;

i) Për mungesa të randa kundra nderit dhe moralit, edhe për çdo mungesë tjetër e cila zbulon nji të metë të ndjenjës morale;

j) Për ofendim të personit të Mbretit, të Familjes Mbretnore, të Parlamentit ose për shfaqje botnisht të ndjenjave anmiqsore kundra institutve qi janë në veprim.

Neni 64.

Shkaktohet vetiu pushimi nga puna, pa qenë nevojë të çelet asnji procedim disiplinuër kur nëpunsi denohet prej gjyqit me vendim qi ka marrë fuqinë e gjasë së gjykueme për nji delikt nga ata qi tregohen në Nr. 4 të nenit 5 të kësaj ligje.

Neni 65.

Nëpunsi i pushtëm nga puna nuk mund të rimeret ma në shërbim, përveç kur si mbas mendimit të Këshillit Epruër provohet se nëpunsi nuk e ka bâ fajin qi ka shkaktue pushimin e tij nga puna.

Në kët rast Këshilli Epruër, tue çmue cirkonstancat qi kan shkaktue pushimin nga puna, tregon mendimin mbi pozitën e vjetërsisë qi do t'i konferohet nëpunsit dhe mbi llogaritjen e kohës së pushimit për efektet e pensionit.

**Neni 66.**

Për nëpunsit e kategorive 2, 3 dhe 4 masat disiplinore të tregueme në Nr. 2, 3 dhe 4 të Nenit 54, vendosen nga Këshili Ministruër.

Dhe për nëpunsat e kategorive 5-9 ndeshkimet e sipërtregueme, vendosen prej Këshillit Epruër dhe aplikohen me urdhën Ministruër.

**Neni 67.**

Deklarohet shpëtimi i nëpunsit nga pandehsija me urdhën Ministruër kur në përfundim të procedimit disiplinuër rezulton se faji qi i ishte ngarkue nëpunsit nuk asht bâ prej tij.

**Neni 68.**

Procedimi disiplinuër mund të riçelet kur të dalin në shesh fakte ose prova të reja të cilat sjellin prezumim se nëpunsi asht fajtuër, në rast qi ky ka shpëtue nga pandehsija ose sido qoftë rezulton se ky ka bâ nji faj ma të randë se ay për të cilin asht ndeshkue.

**Neni 69.**

Gjith-ashtu procedimi disiplinuër mund të riçelet në rast qi nëpunsi i dënuëm me nji ndeshkim ma të naltë se zbritja e rrogës, ose bashkashorti ose fmijtë e mitun të nëpunsit qi kan ose mund të kenë nji të drejtë shpërblimi ose pensjoni, parashtrojnë fakte ose prova të reja nga të cilat rezulton se nëpunsi i ndeshkuëm asht i pa-fajshëm ose ka bâ nji faj ma të vogël se ay për të cilin asht ndeshkue.

**Neni 70.**

Riçelja e procedimit disiplinuër urdhnohet prej Ministrit dhe pezullon efektet e ndeshkimit të dha-

nun Këshilli Epruër heton faktet dhe provat e reja qi i janë parashtrue.

Neni 71.

Nëpunsi i ndeshkuëm, në favor të të cilit asht urdhnue riçelja e procedimit disiplinuër, mbi kërkimin e tij ose mbi atë të bashkëshortit ose të fmijve të mitun të tij, nuk mund të dënohet me nji ndeshkim ma të randë se ay qi ka marrë ma parë.

Neni 72.

Në rast qi nëpunsi deklarohet i pa-fajshëm ose dënohet me nji ndeshkim ma të vogël se ay qi ka marrë ma parë, ka të drejtë me marrë plotsisht ose pjesërisht rrogat e pa-marruna në rast qi ndeshkimi i ma-parshëm ka pas për efekt zbritjen ose pezullimin e rrogës, tue u llogarit kur-do-herë, në rastin e dytë, shumat qi i janë dhanë si pensjon ushqimuër gruës ose fëmijve të nëpunsit.

Kjo rregull aplikohet dhe në rast kur riçelja e procedimit asht kërkue prej bashkashortit ose prej fëmijve të mitun të ëpunsit të vdekun.

Neni 73.

Pasi të kalojnë të paktën dy vjet që prej datës së vendimit ndeshkimuër, kur nëpunsi ka dhanë prova të sigurta përmirësimi efektet e ndeshkimit mund t'anulohen pa efekt prapaveprues.

Nji vendim i këtillë merret me urdhën Ministruër t'arsyetum pasi të merret vendimi i Këshillit Epruër.

## KAPTINA VI.

## Pritmeni, disponibilitet lejepushimi

### Neni 74.

Nëpunsi mund të vehet në pritmeni për shkak smundjeje të provuëme, për shkaqe familjare të justifikueme, për shkak shërbimi ushtarak ose nxjerrjeje si Deputet në Parlament. Në të tri rastet nëpunsi i vueëm në pritmeni nuk ka të drejtë me marrë rrogë.

### Neni 75.

Pritmenija për shkak smundjeje mund t'urdhnohet dhe kryesisht mbi propozimin e Këshillit Epruër në bazë të provave të mbledhuna prej këtij mbi pazotësinë fizike të nëpunsit me vazhdue në detyrë nga shkaku i smundjes.

### Neni 76.

Pritmenija për shkaqe familjare mund të refuzohet ose të revokohet, kur-do-herë qi kjo masë shifet e nevojshme për interesin e shërbimit.

### Neni 77.

Nëpunsi i thirun nën armë për me plotësue detyrat e shërbimit ushtarak ose qi vite si vullnetar, vehet në pritmeni për shkak të këtij sherbimi.

Me gjith ket nëpunsi qi thiret nën armë për nji shërbim të përkohëshëm «rezerv» konsiderohet me leje, me kondità që largimi i tij nga zyra të mos kapërzej 6 muej; për kohën qi kalon kët afat nëpunsi vehet në pritmeni.

Nëpunsi me leje për shkak shërbimi ushtarak merrë rrogë vetëm për dy muejt e parë.

Për nëpunsat qi merren nën armë në kohë lufte, vehen dispozita të posaçme.

Neni 78.

Për efektet e vjelërsesë, koha e kalueme në pritmeni, për shkak smundjeje ose shërbimi ushtarak llogaritet plotësisht.

Neni 79.

Koha e kalueme në pritmeni për shkak smundjeje ose sherbimi ushtarak ose për zgjedhje politike llogaritet plotësisht për efektet e shtesave eventuale perjodike të rrogës.

Koha e pritmenisë për shkaqe familjare deri në 6 muej llogaritet në vjelërsi; por çka të ketë kalue ma tepër nuk llogaritet.

Neni 80.

Nëpunsave që smuren në shërbim e sipër dhe nevoja e shërbimit provohet me raport mjeksuër, kur nuk kan mbarue 5 vjet shërbimi u epet 3 muej leje me rrogë të plotë. Në rast qi provohet se mbrenda kësaj kohë nëpunsi i lejuëm nuk asht përmirësue, leja me rrogë të plotë i zgjatet edhe 3 muej.

Nëpunsave qi kan nji shërbim prej 10 vjetësh, u epet 6 muej leje me rrogë të plotë e cila në rast nevoje mund të shtohet edhe 6 muej të tjerë.

Neni 81.

Pritmenija për shkak smundjeje pushon me zhdukjen e shkakut për të cilin asht akordue, dhe në çdo rast nuk mund të vazhdojë ma tepër se nji vjet.

Gjithashtu pritmenija për shkaqe familjare nuk mund të vazhdojë ma tepër se nji vjet.

### Neni 82.

Dy perjudha pritmenije për shkaqe familjare ose smundjeje të nderprenë me nji perjudhë shërbimi aktiv, jo ma tepër se 3 muej llogariten së bashku për efektet e caktimit të kohë-vazhdimi maksimum të pritmenisë.

Kur shërbimi aktiv ndërpritet midis 3 dhe 6 muejve, vazhdimi maksimum i pritmenisë së dytë, nuk mund të zgjatet ma shum se 6 muej.

### Neni 83.

Me kalimin e afateve maksimum të caktuëm në nenet e ma sipërm, në qoftë se nëpunsi për shkak smundjeje vazhdon të jetë i pa aftë me rifillue në detyrën e parë, largohet nga shërbimi tue mos ju cenue e drejta me kërkue shpërblimin ose pensjonin qi i përket si mbas kohë-shërbimit qi ka në bazë të ligjës së pensjonit.

Përkundrazi, nëpunsi qi asht i aftë me rifillue në detyrë dhe me kalimin e afatit të sipërpërmendun nuk fillon konsiderohet dorë-heqës.

### Neni 84.

Nëpunsi vehet në disponibilitet kur, me ndryshimin e kadrove organike ose me suprimimin e nji nëpunsije, mbetet pa vend.

### Neni 85.

Nëpunsit qi mbeten disponibël për shkak suprimimi të nëpunsisë së tij, për muejin e suprimit dhe t'atij qi vijon i jepet rroga e plotë dhe në qoftë se në mbarimin e kësaj kohë nuk emnohet në nji nëpunsi tjetër aq-vleftëse, deri sa t'emnohet, merrë gjys-

mën e rrogës; por disponibiliteti nuk mund të vazhdojë ma tepër se dy vjet në rast qi nëpunsi nuk pranon nëpunsi aq-vlefte qi i asht propozue i pritet rroga.

Neni 86.

Nëpunsi, në rast qi shërbimi nuk pson dam, mund të kërkojë nga kryetari i zyrës së tij leje-pushim e cila gjith-sisht nuk mund të kalojë perjudhën e nji mueji në çdo vjet, përveç rasteve të posaçme të parapame në ligje organike të zyrave të kategorisë së I.

Për shkaqe të randa vazhdimi i lejes mund të zgjatet për nji perjudhë jo ma shum se nji muej tjetër. Ky zgjatim akordohet me urdhnin e Ministrit kompetent në bazë të nji raporti t'arsyetum të kryetarit të zyrës.

Neni 87.

Për sa vazhdon leja, mbrenda kufijve të caktueme si ma sipër, nëpunsi konsiderohet në shërbim aktiv dhe merrë rrogën e plotë me gjith shtesat eventuale të shërbimit aktiv.

KAPTINA VII.

## Pa pajtushmenija me nëpunsi shtetnore

Neni 88.

Cilsija e nëpunsisë shtetnore asht e pa-pajtueshme me çdo nëpunsi private, me ushtrimin e çdo profesjoni tregëti, ose industri, me detyra administra-

tori, këshilltari, komiseri, kontrolori ose sindiku në çdo shoqëni të krijueme me qëllim fitimi, dhe sikur kto detyra t'ushtrohen pa rrogë ose pa shpërblim.

Me gjith ket nëpunsi me autorizimin e Ministrit ose të kryetarit të zyrës të deleguëm prej tij, mund të bahet pjestar i administratës në shoqnikopërative të konstitueme midis nëpunsve.

Neni 90.

Gjith-ashtu asht i pa-pajtueshëm me nëpunsi shtetnore çdo shërbim ose aktivitet qi, si mbas gjykimit të Ministrit ose të kryetarve t'Instituteve Indipendentë të kryetarit të zyrës së deleguëme, shifet i pa-pajtueshëm me plotsimin e detyrave zyrtare dhe me dinjitetin e administratës ose kur Ministri nuk e shef t'arsyeshme lejimin për shkaqe oportuniteti.

Neni 91.

Nëpunsit qi kan tituj akademike mund t'apin mësime në shkolla të nalta deri në 3 orë në javë gjith-ashtu dhe Profesorët e shkollave të nalta edhe të Liceve kur janë të diplomuëm prej degës së Drejtësisë ose prej atyne qi kan lejen e avokatisë mund t'ushtrojnë kët profesion me konditë qi të mos të damtojnë detyrën kryesore të profesjonisë.

Neni 92.

Nëpunsit mund të zgidhen si eksperț ose arbitën pasi të merret autorizimi i Ministrit ose ay i kryetarve t'instituteve Indipendent ose ay i kryetarit të zyrës së deleguëme prej Ministrit. Ky autorizim merret rast për rast.

## KAPTINA VIII.

## Grumbullimi i dy nëpunsive dhe i shpërblim-zavendsije

### Neni 93.

Në rast qi nji nëpunsi mbetet pa titullar për shkak se:

a) Titullari asaj nëpunsije nuk asht emnue endé, ose asht pushue nga puna, ose largue nga shërbimi, ka dhanë ose asht konsiderue dorëheqës ose ka vdekë;

b) Titullari asaj nëpunsije asht pezullue nga grada ose nga rroga, ose asht vue në pritmeni.

Deri sa t'emnohet nëpunsi i rij n'atë detyrë, kjo mund t'i ngarkohet nji nëpunsi tjetër qi konsiderohet i aftë për të kryemit e asaj detyrë.

### Neni 94.

Nëpunsija vakante në qoftë se asht nga ato të kategorive 2, 3 dhe 4, zevendsi emnohet me vendim të Këshillit Ministruër, dhe në kjoftë se asht prej kategorive të tjera, zevendsi emnohet me urdhën të Ministrit kompetent.

### Neni 95.

Nëpunsi i ngarkuëm si ma sipër me detyrën e zevendsimit ka të drejtë me marrë, për gjith kohën në të cilën grumbullohen të dy nëpunsitë në personin e tij, rrogën e tij origjinale dhe gjysën e rrogës së nëpunsit qi zevendson.

Neni 96.

Shpërblimet e zevensisë të caktueme në nenin e ma-sipërm u epen velëm atyne nëpunsve detyra origjinale e të cilve nuk ka të bajë me detyrën e nëpunsisë qi zevendsohet. Prandej në kjoftë se nëpunsi qi zevendson asht ngarkue origjinalisht me detyrat e nëpunsis vakante si bashkpuntor ose si ndihmsë, ose kur zevendsija i takon automatikisht në bazë të ligjës, nuk ka të drejtë me kërkue shpërblimin zevendsije si mbas nenit të ma-sipërm. Me gjith kët dhe nëpunsave të tregueme në paragrafin e ma-parshëm, tue marrë para syesh shtimin e punve dhe kujdesinë e provueme në të kryemit e tyne mund t'u akordohet nji shpërblim me vendim të Këshillit Ministruër mbi propozimin e Ministrit kompetent. Ky shpërblim nuk mund të jetë n'asnji rast ma i madh se nji e treta e rrogës së nëpunsisë vakante.

Neni 97.

Nëpunsit qi dërgohen si zevendës në nji vend jashta qendrës ku ka nëpunsinë origjinale, kan të drejtë me marrë velëm shpenzimet dhe djetët qi i'u akordon ligja për kto raste, edhe nuk ka të drejtë, n'asnji rast, me kërkue shpërblim zevendsije.

KAPTINA IX.

**Dispozita të posaçme për prefektat**

Neni 98.

Prefektat, me vendim të Këshillit Ministruër, mund të vehen në dispozsjon të Ministris së P.

Mbrendshme, kur e lypë interesa e shërbimit.

Prefektat e vuemë në dispozisjon mund të rijnë deri dy vjet në këtë gjendje, përveç kur kan marrë përsipër detyra të posaçme;

Në këtë rast disponibiliteti zgjatet deri sa vazhdon kjo detyrë e posaçme.

Prefektat e vuem në dispozisjon nji-kohësisht nuk mund të jenë ma tepër se dy.

E vumja në dispozisjon me rrogë përkatse u takon Prefektave të karjerës, të cilët të paktën kan pasë nji shërbim prej 10 vjetësh.

KAPTINA X.

## Titulli Zyrtare, Orari Zyrtarë

Neni 99.

Nëpunsi asht i autorizuëm me mbajtë titullin zyrtarë qi ka, si në marredhanjet e shërbimit, ashtu dhe në botimet zyrtare.

Neni 100.

Kur nëpunsi nxjerret në pensjon mund t'i akordohet titulli i gradës së nëpunsisë pa ndërmjetësisht ma i naltë, si nji titull nderi.

Neni 101.

Nëpunsit qi largohen nga shërbimi, përveç rasteve ndeshkimore qi i përkasin disiplinës, kan të drejtë me vazhdue në përdorimin e titullit zyrtarë qi kan pasë, ose me përdorë titullin e nderit qi i u asht akordue.

Neni 102.

Nëpunsi ka për detyrë me respektue plotësisht orarin zyrtarë dhe për kët qëllim asht i detyruëm me qindrue vazhdimisht në vendin ku ushtron detyrën e tij, përveç kur i janë ngarkue funksjone të posaçme të cilat lypin ndryshe.

Neni 103.

Me gjith kët, për arsye të randa dhe të vërtetueme rregullisht, nëpunsi mundet me u autorizue prej kryetarit të zyrës me banue në nji vend t'afërt me ate ku ushtron funksjonet e nëpunsisë, kur ky largim shifet i pajtushëm me të kryemit e plotë e të rregullit të detyrave zyrtare.

Nëpunsi me leje detyrohet me i njoftue kryetarit

Neni 104.

Nëpunsi me leje detyrohet me i njoftue kryetarit të zyrës së vet, vendin ku mund t'i komunikohet, në menyrë ma të shpejtë, njoftimet dhe urdhnat qi i përkasin shërbimit zyrtarë.

Neni 105.

Administrata cakton uniformën të cilën nëpunsit kan të drejtë me veshë è ceremonitë zyrtare të Shtetit.

## KAPTINA XI.

## Personali i gradës e së kategorisë X

Neni 106.

Për me u emnue npunës i gradës C së kategorisë së X, posë cilsive të lypuna në rregulloret e posaçme,

duhet me pasë kondilat e përgjithshme për me u emnue nëpuns edhe mos me pasë kalue moshën 45 vjeç.

Gjith-atshu kandidati duhet të ketë shndetin e nevojshëm për me krye shërbimin në të cilën asht destinue.

Neni 107.

Personeli i kësaj grade ndodhet drejt për së drejti nën urdhnin e kryetarit të zyrës i cili kundrejt atyne ushtron detyrat disiplinore të Këshillit Epruër të nëpunsave.

## KAPTINA XII.

## Dispozita të ndryshme

Neni 108.

Gjith nëpunsit civil situata juridike e të cilve asht caktue në ket ligjë, kur besojnë se kan pesue nji padrejtësi si në vendimet disiplinore Nr. 2, 3 dhe 4, ashtu dhe n'ato qi u përkasin konkursit, vjetërsisë, shpërblimit dhe gradimit kan të drejtë rekurimi diktimisht mrenda 10 ditëve që nga data e komunikimit në Këshillin e Shtetit.

Vendimet e sipërtregueme të dhanuna prej Këshillit Epruër të Ministrive përkatse nuk i shtrohen apelit administratif.

Neni 109.

Situata juridike e Kryetarve, Antarvet dhe Nd. Anarvet të Këshillit të Shtetit të Këshillit Kontrollues

të Prokurorit të këtij Këshilli asht caktue me Statut me ligjet organike të posaçme dhe me rregulloret e posaçme.

Gjith-ashtu situata juridike e funkcionarve të gjyqsisë të cilsueme në nenin 29 të ligjës mbi organizimin e drejtësisë asht caktue n'atë ligjë dhe i shtrohet dispozitave të kësaj ligje për rastet ku hesht ligja e përkatse.

Ligjet organike të çdo dege t'administratës dhe gjith ligjet e tjera janë në fuqi për sa nuk përmbajnë dispozita të ndryshme mbi gradime, masa disiplinore dhe raste pap-pajtushmenije.

### Neni 111.

Nëpunsit e Shtetit qi kan nji shërbim ma tepër se 10 vjet, kur nuk kan burime pasunije të tjera të mjaftueshme veç se rrogës, kan të drejtë preferimi për fmijtë e tyne për me i u akordue bursa studimi si në shkollat e shtetit në Shqipni ashtu dhe jashtë.

### Neni 112.

N'emnimet e nëpunsave qi do të bahen pas hymjes në fuqi të kësaj ligje kur nuk gjinden persona të pajuem me titulla akademike ose me eksperjencë të kypuna prej kësaj ligje dhe prej ligjevet të posaçme mund t'emnohen edhe persona qi pasojnë të parët si në titull akademike ashtu dhe n'eksperjencën por këtyne u epen dy të tretat e rrogavet të caktueme për atë ofiq. Kjo zbritje nuk mund t'i paksoj rrogat ma pak se 250 fr. ari. Të drejtat e fitueme deri tash mbeten të pa prekuna.

Neni 113.

Kjo ligjë hynë në fuqi 15 ditë mbas botimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 114.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Projektligj mbi gjendjen juridike dhe rregullimin hierarkik të nëpunësve,Tiranë, 1931
*Biblioteka Kombtare e Shqipërisë*



FLETORJA ZYRTARE 20 Maj 1931 — 3

ditori, do të formojnë një Shoqëri në konformitet me ligjet, dhe me t'aprovuemit të Shoqnisë në format e dhëna, ky koncesion do të regjistrohet n'emën e Shoqnisë.

Në rast qi Shoqnia qi do të formohet ma vonë do të ketë çfarëdo anonime, koncesjonarët si inisiatorët e Shoqnis n'artheme do të [illegible] në aktin konstituer kondita qi [illegible] dyzetë për qind të kapitalit të [illegible] aksionet nominative.

Art. 21.

K'io Kontratë hyn në fuqi që prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.

Mbret i Shqiptarve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e kontratës mbi ngrefjen e një fabrike birre në Prefekturen e Korçës, lidhun mbdis Qeveris e Koncesjonarve ZZ. Umberto Umberti e Seli e Mborja, e votuerne prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 733-1 d. 27.1.1931 të Kryesis.

Tiranë 3 Prill 1931

ZOG d. v.

Kryeministri

Pandeli Evangjeli d. v.

Ministri i Ekonomis Kombëtare

Mehdi Frasheri d. v.

---

**Dekret-Ligjë**

**Mbi krijimin e Kryeministris**

Art. 1.

Me kompetencat dhe atributet të caktueme në Statutin Themeltar të Shtetit dhe të Ligjit Organik relativ qi do të vinë në zbatim prej 1 Shtatorit krijohet Kryeministrija e Mbretnies Shqiptare.

Art. 2.

Titullari i Kryeministris merr një rrogë të përmuejshme prej 1500 Fr. ari dhe 360 Fr. ari alokasion e cila filon q' prej [illegible] Mesarchia [illegible] (1 Shtator 1929).

Art. 3.

Kryeministrija [illegible] shënuem në Kuadron e budgetit të vitit 1928-29, në [illegible] transferimi, i shlohet [illegible] të justifikimit qi [illegible] prej Këshillit Kontrollues Zyrë [illegible] të [illegible] prej Kryeministris.

Art. 4.

Përveç [illegible] që rrogave dhe [illegible] shënuem n' Art. 2 të ketij Dekret-Ligji budgetit 19.8.1929 të Kryesis së Këshillit Ministruer i shtohet edhe [illegible] prej [illegible] për mobilje, 700 Fr. ari për veshje e mbathje Shërbëtorësh dhe 20,000 Fr. ari përveç shpjesa Kabinet' të Sekret.

Art. 5.

Ky Dekret-Ligjë hyn në fuqi prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 6.

Me zbatimin e këtij Dekret-Ligji ngarkohet Kryeministrija e Ministrija e Financavet.

Kryeministri e

Ministri i P. të Mbrendshme

K. Kota d. v.

Ministri i P. të Jashtme

I. Vrioni d. v.

Ministri i Drejtësis

H. Delvina d. v.

Ministri i Arsimit

Xhafer Ypi d. v.

Ministri i Financavet

M. Tutulani d. v.

Ministri i P. Botore

S. Vuçiterni d. v.

Ministri Ekonomis Kombëtare

Musa Juka d. v.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarve

Mbi propozimin e Kryeministrit Nr. 1540-1 datë 5. XI. 1928.

Dekretligji mbi krijimin e Kryeministrisë së Mbretërisë Shqiptare
*Fletore Zyrtare, 20 maj 1931, f. 3*

# Titulli II.
## Kontratat

### KAP. I.
### Rregulla të përgjithëshme

Neni 19.

Kontratat që lidhin Administratat shtetnore për nevojat e fornituravet, transportevet, blemjevet, shitjevet, koncesjonevet, qiranavet ose punimevet janë të ligjëshme vetëm pas përfundimit t'ankandit publik, ose licitacjonit ose marrëveshtjevet private.

Neni 20.

Si mbas nenit 5 të ligjës së modifikueme prej nenit 1 të dekret-ligjës me datë 13. VI. 1929, mundet të lidhen kontrata me licitacjone:

1) kuer ankandi prishet, si mbas nenit 42;

2) për fornitura të çdo lloji, për transporte ose punime, kuer nji nevojë e ngutëshme të mos lejojë kalimin e kohës së duhun për nji ankand publik;

3) për blemje materjalesh, makinash ose prodhimesh t'artit, që duhen blemun në vendin e prodhimit të tyne, ose që punimi i tyne duhet t'u besohet Shtëpijave të specjalizueme;

4) kuer, cilido qoftë objekti i kontratës, çmimi i parapamun i shpenzimit të mos kalojë shumen e fr. ari 2.000 dhe nuk mund të përsritet prej nji Administrate pá kalue nji afat prej tre muejshë.

Në rastin e permendun në pikën 1 të këtij neni kondítat, ku do të përbàhet edhe çmimi, që do të caktohen në kontraten me licitacjon nuk duhet të jenë ma të pafavorshme për Shtetin se ato të caktueme për ankand.

Neni 21.

Mundet të lidhen kontrata me marrëveshtje private kur:

1) ankandi publik dhe licitacjoni rakomituar prishen;

2) ngutësija e punimev... blerjevet, e transportevet të mos lejojë të pritunit e afatit per kryemjen e veprimeve t' ankandit publik e të licitacjonit;

3) nevojitet blerje makinash, veglash e sendesh që vetëm nji Firmë asht në gjendje t' i furnizojë;

4) duhet të merren me qirà ndertesa të destinueme për sherbime qeveritare;

5) i çdo lloji qoftë objekti i kontratës, shuma e parapame e shpenzimit mos të kalojë shumen e fr. a. 300 dhe nuk duhet të përsëritet për nji Administratë pà kalue tre muej.

Në rastin e përmendun në n. 1 të këtij neni kondítat, ku do të përbàhet edhe çmimi, nuk duhet të jenë ma të pàfavorshme për Shtetin se ato të caktuame për ankandin e për licitacjonin.

Për rastet e përmenduna në pikat 2 e 3, nevojitet aprovimi i Këshillit Ministruer.

Neni 22.

Kurr, si mbas dispozitës së nenit 6 të ligjës, kërkohet ndërhyrja e Këshillit të Shtetit, Administratat duhet t' i dërgojnë fletshpalljen e ankandit, ose, mbas rastet e rikurimit në licitacjon ose marrëveshtje private, aktet e tjera që zanë vendin e shpalljes, si edhe projekt-kontraten për të marrun ma parë mendimin mbi ta.

Ndër rastet e parapame prej nenevet 20 e 21, në të cilat ndiqet licitacjoni ose marrëveshtja private, Administratat duhet t' i tregojnë Këshillit të Shtetit sa herë që i kërkohet mendimi i tij si mbas dispozitës së nenit 6 të ligjës, përveç aktevet që përmendim në paragrafin e ma sipërmë, edhe nji raport justifikues mbi nevojen e rikurimit në licitacjon ose në marrëveshtje private. Shkaqet e sipërpërmendura duhet të tregohen edhe në vendimin e aprovimit të kontratës që do të pregatitet në bazë të dispozitës së nenit 53.

Neni 23.

Për me caktue n' asht ose jo e nevojshme marrja e mendimit preventiv të Këshillit të Shtetit për nji kontratë vazhdueme, si mbas paragrafit të parë të nenit 9 të ligjës, duhet të merret për bazë shuma që resulton nga të gjith vjetët që zgjatet lidhja.

Neni 24.

Projekt-kontratat duhet të përmbajnë regullat dhe kondita të caktueme për zbatim, tue parashkrue punimet, veprat dhe furniturat që duhet të kryhen.

Dispozitat dhe kondítat e sipërtregueme mund të caktohen në nji kapitull të përgjithshëm, i cili vihet në zbatim me urdhnin e Ministrit kompetent ose të Komandase të Përgjithshme të Mbrojtjes Kombtare e Gjindarmeris, pasi të jenë marrun mendimi i Këshillit të Shtetit.

Neni 25.

Ata që lidhin kontrata me Shtetin duhet t' u apin garancin e caktueme prej Administratës që lidh kontraten, në nji masë jo ma të paktë se 3 % dhe jo ma të naltë se 10 % të shumës së parapame në kontratë.

Janë të përjashtuem nga detyrimi i garancis privatët që japin me qirà pronat e tyne, gjithmonë kur kontrata nuk u ngarkon ndonji barrë të caktueme.

Neni 26.

Garancija duhet të jepet në të holla ose me garanci të nji Banke në Shqipni të pranueshme prej Qeveris, ose me anë t' ipotekës së parë mbi pasuni të paluejtshme.

Në këte rastin e fundit sasija e garancis duhet të jetë dyfish nga ajo e caktueme për të dy format e tjera dhe veprohet si mbas dispozitave të përmbajtuna në ligjen me d. 31 maj 1934, e shpallun në Fletoren Zyrtare me d. 12 qershorr 1934, n. 34.

Për sipërmarrëjet e nxjerrjes së të dhetavet zbatohen dispozitat e ligjëvet përkatëse.

Neni 27.

Garancit në të holla derdhen n' arken e Zyravet financjare ose pranë Bankavet që ndodhen në Shqipni të njohuna prej Qeveris.

Në mbarimin e ankandevet, garancit u kthe-

hen konkurrenlevet, tue u mbajtë vetëm ato të sipërmarrësvet, të cillat mbetten të depozitueme deri në mbarimin e plotë të kontratës.

Neni 28.

Për punimet që, prej natyrës së tyne ose për shkaqe tjera, duhet të kryhen n'ekonomi nevojitet aprovimi i Këshillit Ministruer, kuer çmim' i parapamë i tyne kalon shumen e 500 fr. arë.

Neni 29.

Ndër kontratat për fornituna, transportime dhe punime pagesat në njehsi nuk mund të kalojnë të nandë të dhetat (9/10) e shumave të justifikueme.

Nder kontratat që u përkasin fornituravet dhe obligimeve të tjera të vazhdueshme, dhe q' i shtrohen likuidimit periodhik, mund të pranohet pagesa e plotë për perjudhen e shkueme; por gjithmonë kuer kredija e fornitorit ose e sipërmarrësit të jetë e vërtetueme prej autoritetit kompetent.

Nder kontrata për qiramarrëje ndertesash nuk mund të vihen kondita për pagesa paradhanjesh nga ana e Shtetit.

Neni 30.

Kuer nuk shifet e dobishme shitja si mbas regullavet e materjalit ose të sendeve t'Administratës që rrjedhin nga rrenimet, transformimet ose ndryshimet e godinavet shtetnore, këto mund t'u cedohen sipërmarrësvet kundër nji pagese, tue caktue vleften e tyne me anë të çmuesvet.

Çmim' i materjalevet ose i sendeve të cedueme sipërmarrësvet zbritet prej kushtimit të punimit tue paksue në nji masë korispondente me të paktë shumen e shpenzimit dhe ngarkimit në budget.

Neni 31.

Shpenzimet e kontratës janë në barrë të fornitorit ose të sipërmarrësit; dhe përgjithësisht, në barren e përsonit që lidh kontratën me Administratën, përveç rasteve të posaçme kuer, për interesin ekskluziv të Shtetit, dhe si mbas nji marrëveshtjes së shprehun, shpenzimet në fjalë duhet të bahen prej Shtetit.

në të cillin duhet të jenë të tregueme gjith personat e sipërmarrjes të lïuem me konkurs, si dhe përfundimin e levizjevet.

Proçes-verbali në fjalë duhet t'i bashkohet edhe kopja e letër-lïmeret, si dhe ofertat origjinale të marruna nga gjith konkurentet.

Dispozitat proçedurale të caktueme për ankandet publike, përsa mund të jenë të pajtueshme me në formë, aplikohen edhe për levizjonet.

Neni 46.

Marrëveshtja private bâhet atëherë kur kontraktohet me nji sipërmarrje ose persona të caktueme.

## KAP. III.

### Lidhja, pranimi e zbatim' i kontratës

Neni 47.

Pasi të jenë mbarue adjudikata veprohet, n'afatin e caktuem me shpalljen e ankandit, si mbas dispozitës së nenit 33 (n. 10), në lidhjen e kontratës, përveç rastevet, kur Administrata e shef t'arsyeshme që proçes-verbali i adjudikatës të zâjë vendin e kontratës.

Në qoftë se n'afatin e naltë-treguem nuk lidhet kontrata nga faj' i adjudikatarit, veprohet në perveltimin e garancis në favorin e Arkës së Shtetit, pa qenë nevoja për nji vendim gjyqi, posë reprimave të tjera në kurriz të sipërmarrësit.

Neni 48.

Lidhja e kontratës bâhet me anën e Notarit publik e si mbas formave të lypuna nga ligja përkatëse.

Neni 49.

Kontrata me marrëveshtje private, përveç mënyrës së caktueme me nenin e sipërm, mund të lidhen edhe:

a) me nji akt-detyrimi të nënshkruem prej ofertuesit;

b) me anën e korrespondencës si mbas zakonit të tregtis, kur marrëveshtja bâhet me nji Shpi tregtare.

Neni 50.

Kontrata e lidhun me nji Shpi tregtare ose me nji Kooperativë tregtare, duhet të tregojë personat që janë t'autorizueme ligjërisht me marrë në ngarkim e me lidhun dorën (kuietancë).

Neni 51.

Proçes-verbalet e adjudikatës si dhe kontratat, edhe në qoftë se janë të lidhuna me korrespondencë tregtare, si mbas nenit 49, duhet t'aprovohen me dekret të Ministrit kompetent ose prej të deleguemit të tij.

Neni 52.

Në projekt-kontraten duhet të caktohet nji afat për pelqimin e saji si mbas nenit 51.

Në rast se Administrata e lën pa-dune këtë afat, kontraktuesi ka tager me u lirue nga pengimi me anë të nji deklarate të posaçme, por pa pasë të drejten e ndonji dameshpërblimit.

Neni 53.

Urdhëni i aprovimit të kontratavet duhet të përmbajë këto shenime:

1) daten e kontratës;

2) emnin e mbi-emnin e tjera të kontraktuesit;

3) forniturat, transportin, punen për t'u bamun, sendin e lidhuem ose të marrun me qira, ose për t'u cedue, dhe çdo lloj t'objektit të kontratës;

4) shumen;

5) kapitullin e budgetit të cillit i përket e ardhuna ose shpenzimi që rrjedh prej kontratës.

Neni 54.

Urdhëni i aprovimit të kontratavet duhet t'i komunikohet, së bashku me dokumentat e duhuna, Zyravet kontabile për me marrun pengimin si dhe për regjistrimet përkatëse të tyne.

Neni 55.

Kontratat për të cillat Administrata ka pyetun mendimin e Këshillit të Shtetit, i komunikohen Këshillit kontrollues së bashku me urdhënin përkatës t'aprovimit, për kontrollin preventiv që âsht në kompetencen e tij.

Neni 56.

Kur kontratat të jenë t'aprovueme e, si mbas rastit, të regjistrueme në Këshillin kontrollues, Administrata kujdesohet për zbatimin e tyne tue marrun masat e nevojshme për adhimen, vazhgimin dhe drejtimin e veprimevet.

Përfaqsuesat edhe kryetarët e sipërmarrjevet duhet të jenë të pelqyem nga ana e Administratës e cilla mund të kërkojë ndrrimin e tyne në vazhdimin e kohës së punimevet ose të forniturave.

Neni 57.

Nëpunësit e caktuem për drejtimin e punimevet, dhe për mbikqyrjen e furnituravet dhe të transportevet nuk mund të bajnë shtesa ose ndryshime të tjera në kontratat e lidhuna.

Këta mbahen përgjegjës për shtesat e ndryshimet e bamuna prej tyne, në mungesë t'autorizimeve eprore.

Neni 58.

Punimet, shërbimet dhe furniturat që janë të lëshueme n' adjudikatë i shtrohen kolaudimit, përfundimisht ose tanësisht, nga ana e nëpunësve të caktuem prej Administratës përkatëse.

Kolaudimet nuk mund të bahen nga persona që kanë drejtue ose vzhgue përmbarimin e kontratës, me përjashtim për punimet dhe furniturat kur çmimi i tyne nuk kalon fr. a. 1.000, për të cillat mund të zanë vendin e kolaudimit një certifikatë e zbatimit në rregull e lëshueme prej ugjentit të ngarkuem me drejtimin ose vzhgimin e tyne.

Kontratat që lidhen nga Administrata Shtetërore
*Fletore Zyrtare , 22 maj 1936, f. 3-9*

# Titulli V.

## T' ardhunat e Shtetit

### Neni 93.

T' ardhunat e Shtetit kalojnë në të dy fazat, të vertetimit dhe të nxjerrëjes të treguemе veças ndër llogarinat administrative.

Për disá t' ardhuna vërtetimi dhe nxjerrja mund të rezultojnë njikohësisht.

### Neni 94.

Vërtetimi kryehet kuer Administrata financjare e ban të pá-kundërshtueshme të drejten e kreditit të Shtetit dhe përsonin debitor, tue regjistrue, si kompetencë të vjetit, shumen e kreditit që skadon mbrenda atij ushtrimi.

Vërtetimi bâhet, si mbas rastevet, me anën e kompilimit të listave ose të protokoleve t' aprovueme prej organevet kompetente, me lidhje kontratash, me lëshim lejesh, me zbatim tarifash, me shitje pullash e tjera.

### Neni 95.

Nxjerrja bâhet kuer i detyruemi derdh n' Arkën financjare, drejtazi ose me anë të tagrambledhësavet ose të Zyravet nxjerrëse, shumën që u âsht i detyruem me pague.

### Neni 96.

Të ardhurat e shtetit
*Fletore Zyrtare , 22 maj 1936, f. 13*

# Titulli VI

## Shpenzimet e Shtetit

### KAP. I.

### Regullat e pergjithëshme

Neni 109.

Asht në kompetencën e ç'do Ministrije me autorizue shpenzimet mbrenda kufijve të fondeve të caktueme në budget.

Me urdhen që të regjistrohet në Këshillin Kontrollues, Ministrat mundën me i delegue Drejtorave të përgjithshem, Sekretarve të përgjithshëm, ose në mungesë të këtyne ndo'i funksjonari tjetër të Ministris të drejten me marrun pengime për pagesa, dhe me nënshkrue mandat-pagesat.

E drejta që u jepet kryetarve të Zyrave të qarqevet për me marrun pengime për pagesa dhe me urdhënue të tilla, asht e përfshime në mandat-pagesat per çelje krediti që u jepen këtyne për qëllimet e caktueme në nenin 53 të ligjës.

Neni 110.

Shpenzimet e Shtetit kalojnë fazat e pengimit, të likuidimit dhe të pagimit.

Neni 111.

Pagesa e shpenzimeve mbrenda kufijve të Mbretnis asht e caktueme me mënyrat e tregueme në kaptinën e IV të këtij titulli.

Pagesa e shpenzimevet jashta Shtetit bahet me anë *shëjuesve, të Bankës Kombtare të Shqipnis, në të cillen Arkëtari i Qendrës derdh shumat e mandatavet përkatëse të lëshueme prej çdo Administrate.

### KAP. II

### Pengimi i Shpenzimevet

Neni 112.

Quhen si të penguema ato shuma për të cillat Administrata shtetnore ka marrë obligimin me i pague, kundrejtë punimesh të kryeme, ose obli-

Shpenzimet e shtetit
*Fletore Zyrtare , 22 maj 1936, f. 15*



DAP

Vjeti i XV. Tiranë, e Ejte 23 Korrik 1936 Nr. 49

MBRETNIJA SHQIPTARE

# Fletorja Zyrtare




Botohet prej Ministris së P. të Mbrendëshme

PERMBAJTJE:


1) Dekret-Ligjë mbi disa shtime të Ligjës Organike të Ministris së P. të Mbrendshme f. 1-2
2) Dekret-Ligjë mbi ndryshimin e Kuadrit Organik të oficerave të Gjindarmeris f. 3
3) Dekret-Ligjë mbi shtuzen e nji fondi prej fr.ari 10.000 në budgetin e Drejtoris së P. të Reformës Agrare f. 3
4) Akordime shperblimi të njiherëshëm f. 3-5
5) Shkarkim nga detyra e transferim f. 5
6) Interniim familjesh f. 5
7) Regjistrime Shtetsije f. 5-6
8) Zgjatim afati për shitje të dhete f. 6
9) Shitja e dajlaneve Shkodër e Lesh. f. 6
10) Humbje vule f. 6
11) Fletë Shpallje për ndërtimin e fiokalit Shkollës Vokopolë f. 6-7
12) Fletë Shpallje f. 7-9
13) Fletë shpallje për ndërtimin e vijës së Ujit Sarandës f. 9
14) Fletë Shpallje ankandi për fornituren e landë shkresoriat për nevojat e Ministris së Financavet, të Drejtoris Financavet Tiranë e Laboratorit Kimik f. 9-12
15) Leter-Adjudikatë f. 12-14
16) Shpallje Gjyqesh f. 14-16


## Dekret-Ligjë

### mbi disa shtime të Ligjës Organike të Ministris së P. të Mbrendshme

Neni 1.

Në Ministrin e P. të Mbrendshme krijohet Drejtorija e Bashkive dhe e Komunave.

Neni 2.

Drejtorija do të ketë personel:

| | | |
|---|---|---|
| a) Nji Drejtor | me rrogë mujore fr. ari | 450 |
| b) Dy Inspektora | " | 350 |
| c) Nji Sekretar' i lrë | " | 330 |
| c) Nji Sekretar' i II-të | me rrogë mujore fr. ari | 250 |
| d) Nji Kopist | " | 160 |
| dh) Nji Sherbëtuer | " | 100 |

Neni 3.

Drejtorija ka për detyrë me kqyr të gjitha veprimet e korrespondencës dhe punët e tjera që i përkasin Bashkive e Komunave.

Inspektorat në konformitet me urdhnat qi marrin nga Ministrija, inspektojnë herë pas here Komunat në të gjitha veprimet e tyne, dhe Bashkit e Mbretnis vetëm për sa i përket llogarive e Gjendjes Civile përfundimet e inspektimeve i-a parashtrojnë Drejtoris me nji raport të shkoqitun.

Neni 4.

Cilësit qi duhet të kenë Drejtori dhe Nëpunsat e tjerë të Drejtoris janë ato qi shenohen në kapitullin e IV të Ligjës Organike të Ministris së P. të Mbrendshme me datë 11. VI. 1928.

Neni 5.

Hollsinat mbi atribucionet e personelit të Drejtoris dhe mënyrë e aplikimit të detyrave të tyne kanë me u caktue me nji rregullore të posaçme.

Neni 6

Çdo dispozitë ligjore në kundërshtim me përmbajtjen e këtij ligje mbetet pa fuqi.

Neni 7.

Rrogat e personelit të Drejtoris së Bashkive e të Komunave sipas dhe gjithë shpenzimet që rrjedhin nga krijimi i saj do të paguhen nga kapitulli përkatës të buxhetit Ministris së P. të Mbrendshme.

Neni 8.

Për me përballue pagesat deri me 31 Mars 1937 të cilat nuk janë parapa në budgetin Pre-

Krijimi i Drejtorisë së Bashkive dhe Komunave në Ministrinë e Brendshme;
*Fletore Zyrtare nr.49, Viti XV,23 korrik 1936, f.1*

# Fletorja Zyrtare

| Pajtima : Për një mot në Shqipni | Fr. ari | |
|---|---|---|
| Jashtë | | 20 |
| Një copë e javës | | 0,20 |
| „ „ „ „ vjetit të kaluem | | 1 |
| Për numerat special caktohet herë pas here | | |
| Lajmerim | | 10 |
| Shpallje | | 10 |
| Shpallje nakandi për një kohonë | | 2 |

Drejtimi : Ministria në P. të Mbrendshme
Redaksia në Fletores Zyrtare
TIRANË

Redaktor : ZEF M. DAJÇI

Art. 4.

Ndalohet marrja në sherbim ose të vnejt në punë natën e të vogjelve që nuk kanë mbushun moshën 18 vjeç dhe të femnave të çdo moshe që të jenë, në gjithë stabilimentat ose uzinat industriale dhe tregtare, publike ose private, me përjashtim të atyneve ku sherbejnë vetëm pjesëtarët e një familjeje, dhe kur këto vende nuk janë të rrezikshme, të ndyta dhe inkomode, dhe kur puna nuk bëhet me kazana avulli ose me motore mekanike. Në rastin e fundit, drejtori i stabilimentit duhet të marrë leje nga Ministria e Ekonomisë Kombëtare. Ministria e Ekonomisë Kombëtare këto leje do t'i japë vetem për marrjen në sherbim të djemve të një moshe 16 vjeç e nalt dhe të grave të një moshe 18 vjeç e nalt, dhe vetem për një pushim prej tetë orësh, dhe kur puna nuk asht e rrezikshme për shëndetin e tyne dhe në bazë të një raporti doktori që puna e natës nuk formon ndonjë pengim në rritjen e tyne.

Art. 5.

Dispozitat e art. 4 nuk aplikohen për punën e djemve me një moshë 16 vjeç e nalt në çdo industri dhe zeje qoftë, kur, për arsye fenomenesh të natyrës, aksidentesh ose rastesh analloge të paparashikueshme ose të ndalohen, dhe të cilat nuk kanë një karakter të vazhdueshëm, vazhdimi i punës në industrinë ose zejtarinë çrregullohet, dhe kur natyra e punës nuk permeton vonesë në rregullimin, dhe kur nga ndonjë trondisje ose ndonjë dëm kërkohet reparim i përnjiherëshëm.

Ky përjashtim lejohet vetem me autorizimin e Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare, po në rastet urgjente mund të jepet leje prej lejen në fjalë edhe prej autoriteteve të permendura në art. 11 të kësaj ligje. Në këtë rastin e fundit, një deklaratë simultane në shkrim e bamun Ministrisë s' Ekonomisë Kombëtare për lajmërimin e përjashtimit, konsiderohet e mjaftë. Përjashtimi i dhanun prej autoriteteve lokale nuk mund të jepet per një kohë ma të gjatë se një javë, dhe të interesuemit duhet t'i drejtohen Ministris së Ekonomis Kombëtare për zgjatimin e afatit.

Autorizimi i dhanun prej Ministris së Ekonomisë Kombëtare për sherbimin e djemve 16 vjeç e nalt në punime nate, në rastet e parapame prej kësij artikulli, nuk mund të jepet per një kohë ma të gjatë se 60 ditësh, në perjudhen e një vjeti, dhe pushimi i natës nuk mund të shkurtohet në ma pak se 10 orë.

Art. 6.

Dispozitat e kësaj ligje nuk zbatohen për grat që mbajnë posta drejtimi të cilat implikojnë përgjegjësi, dhe që nuk janë të angazhuera për punë krahu të zakonshme.

Art. 7.

Në raste shumë me rendësi dhe kur interesi publik e kërkon, ndalimi i punës së natës mund të pezullohet me një vendim të Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare për sa i përket djemve të një moshe 16 vjeç e nalt.

Art. 8.

Për efekt të kësaj ligje, me fjalën natë kuptohet një kohë të paktin prej 11 orësh të vazhdueshme në të cilën përfshihet edhe orari 22 mbremave deri 5 në mëngjes. Për fanat kjo periudhë mund të zavendësohet me periudhën 21 deri 4.

Art. 9.

Koha e natës që përmendet në art. 8 mund të zbritet në 10 orë, vetëm 60 ditë në vjet, kur puna e ndonjë industrie mvaret nga stina. Në rast të tillë, të interesuemit duhet të marrin leje nga Ministria e Ekonomisë.

Art. 10.

Në industrinë e tullave, kur fabrikimi bahet me punë dore, mund të lejohet të punuarit e djemve të një moshe 16 vjeç e nalt prej orës 4 në mëngjes deri në orën 8 mbremave me kusht që t'u jepet një çlodhje e paperme, prej tre orësh të paktën, çdo ditë në kohën e verës.

*Fletore Zyrtare, 15 tetor 1936, f.2*



68 FLETORJA ZYRTARE 15 Tetor 1936 4

## Regjistrime Shtetsije

Si mbas vendimit të Këshillit Ministruer Nr. 781 me 5-X-936 autorizohen zyrat kompetente me krye të gjitha veprimet e duhuna për rregjistrimin e Shtetsis Shqiptare të quejtunit Kadri Ymer Zeqja, biri i Ymerit dhe i Shahzimes, lindun në Dibër të Madhe me 1908, i pa martuem, së bashku me vëllan e tij pa nanë, Mustafa Zeqja, biri i Sherifit, lindun në Dibër të madhe m 1913, i pa martuem dhe me t'amen Shahzime, bij e Rustemit dhe e Vahides, lindun po në Dibër të Madhe me 1876 e vejë, banuese në Tiranë e ardhun në Shqypni Qysh përpara tre vjetësh, mbasi këta tue qenë nga raca e gjaha Shqiptare i kanë plotësuem gjith kondítat e caktueme në paragrafin 5 t' Art. 7 të Kodit Civil, dhe bërimin e nevojshëm konfuerme ndryshimit të paragrafit 1 t' art. 2 të Rregullores së Shtetsis, t'a bajnë para Zyrës së Gjendjes Civile ku kanë qendrimin e tyne e ku do të regjistrohen.

## Konkurs për Kryetar Komunesh

I njoftohet publikut se në kuadrin e personelit Komunal janë 7 vende hapun për Kryetar Komunesh. Për emnimin e tyne do të zbatohen këto dispozita:

I) Kandidatët që kanë krye mësimet Universitare me sukses do t'emnohen pa provim.

Në qoftë se numri i kandidatëve Universista asht mâ i madh se numri i vendeve të hapta, atëhere do t'emnohen ata Universista që kanë notat mâ të mira.

Në qoftë se numri i kandidatëve Universista âsht mâ i paktë se numri i vendeve të hapta, për vendet e pa plotsueme do të bahet nji konkurs me provim me datën 2-XI-1936 ditën e hanë n'orën 9 para dite përpara nji komisjonit të posaçëm në Ministrin e P. të Mbrendëshme.

II) Kandidatët që do të marrin pjesë në këtë konkurs do të jenë:

a) Ish Kryetar Komunesh mbetun jashtë kuadrit e që kanë krye kursin komunal.

b) Sekretar Komunesh tash në shërbim ose ish Sekretar Komunesh mbetun jashtë kuadrit. Por këta duhet të kenë mbarue së paku nji shkollë të mesme kombëtare, të kenë bâ së paku 5 vjet shërbim Komunal edhe të kenë krye nji kurs Komunesh.

c) Ish Kryesekretar Prefekturash, ish Sekretar Nënprefekturash, ish Nëpunës të Shtetit Civil, ish Gjyqtar, ish Kryesekretar Gjyqesh dhe ish Noterë e ish Nëpunsa të [illegible]; të mbetun jashtë kuadrit.

III) Kandidatët, qofshin Universista ose jo, do të paraqesin në këtë Ministri lutjen e tyne jo mâ vonë se me 27-X-1936 tue dërgue njiherit dokumentat që vijojnë:

a) Akt-penalitetit.

b) Akt të Gjendjes Civile.

c) Akt vërtetimit të kryemjes shërbimit ushtarak.

d) Dokumentat shkollore; në origjinal ose kopje të vërtetueme prej Ministris s'Arsimit.

e) Kandidatët e përmendun në paragrafet a, b, c të numrit II, duhet të paraqesin nji certifikatë për vertetim të shërbimit që kanë bâ.

Ministri i P. të Mbrendshme:
ETEM TOTO d. v.

## Fiet-Shpallje

1 Bashkia e Sarandës nxjerr në ankant publik rregullimin e rrugës anës së detit bashkë me Trotuarët dhe kanalet e saj si dhe rregullimin e korelizes të murit e Mollos gjat kësaj Rruge si mbas planit e preventivit përkatës të hartueme prej Zyrës Teknike të Bashkisë.

2. Adjudikata do të zhvillohet në Zyren e Bashkisë 21 ditë mbas botimit të kësaj shpalljeje në Fletoren Zyrtare.

3. Ofertat do të shfaqin zbritjen përqindse mbi çmimin bazë të çdo plese dhe duhet të jepen jo mâ vonë se ditën e orën e caktueme për këtë ankant.

4. Ofertat duhet të permbajnë shprehimisht pranimin e kondítave dhe duhet t'kenë nënshkrimin e ofertuesit të qartë bashkë me dokumentat e garancis.

5. Garancija asht caktue në fr. ari 200 dhe do-

Konkurs për kryetar Komune
*Fletore Zyrtare, 15 tetor 1936, f. 4*

MBRETNIJA SHQIPTARE
KËSHILLI I SHTETIT

# VENDIMET e KËSHILLIT të SHTETIT

TË VJETIT

## 1937

BOTIMET E KËSHILLIT TË SHTETIT
Nr. 9 I PËRMBLEDHJES SË VENDIMEVE
TIRANË, 1938

mendimin se në rastin e pyetun veprimet e ekzekutimit të sekuestrimit duhen kryer prej Drejtoris se Financavet t'atij qyteti.

Vendimi Nr. 26, 18 Kallnuer 1937

**NËPUNËS — Pezullim nga detyra — Ndalim Gjyqi — Kthim rroge.**

*Në rasë ndalim gjyqi nëpunësit të pezulluem i kthehen rrogat e ndalueme.*

Këshilli i Shtetit... muer në bisedim shkresën Nr. 132 me datë 14.I.1937, të Ministris së P. Botore, e përcjellun Këshillit të Shtetit: bashkë me dy lutje me datë 12.I.1937, se cila të adresueme asaj Ministrije prej ZZ. Ingj. S. P. Kryetar'i Zyrës Botore të Korçës dhe sekretarit të asaj zyre Gj. B.

**Objekt' i konsultimit**

P. T. Ministria e P. Botore, mbassi ZZ. Ingj. S. P. dhe sekretari i tij Gj. B. ishin pezullue nga detyra për disa çrregullime të ndodhuna në pagesat e puntorve dhe ishin urdhënue kundra këtyne hetimet paraprake e mbassi për të dy këta u vendos ndalim gjyqi dhe u kthyen prap në detyrat e tyne, ajo P. T. Ministri pyet Këshillin e Shtetit që, mbasi ligja mbi ndjekjet penale kundra nëpunsavet nuk ban fjalë si duhet veprue në rastin konkret, d.m.th. a duhet t'u paguhet gjysma e rrogës, gjatë kohës së pezullimit të këtyne nga nëpunsija, qysh prej datës 23.X.1936 e deri me 12.I.1937, a po duhet t'u paguhet rroga e plotë?

Aktet në fjalë i u-referuen Seksionit të Drejtësis, i cili çfaqi mbi to mendimin e vet Nr. 6 datë 16.I.1937.

**Mendim dhe arsyetim**

Tue qenë se neni 4 i dekret-ligjës mbi ndjekjet dhe gjykimin penal kundra nëpunsavet civile të Shtetit thotë shprehimisht se: „për me bâ ndjekjet penale kundra një nëpunsi civil të Shtetit pikësëparit duhet të bahen kundra atij hetime paraprake *dhe në përfundim të këtyneve të jetë çfaq nevoja e ndjekjeve penale*" kurse në rastin konkret për të dy nëpunsat asht dhanë ndalim gjyqi dhe bile të dy këta nuk janë marrë në hetim as nga hetuesi gjyqsuer kompetent, dhe mbassi paragrafi i III i nenit 23 të kësaj dekret-ligje thotë se: „në qoftë se në *përfundim të gjyqit* vendoset pafajsija e nëpunsit i kthehet këtij nëpunsija e mëparëshme, ose emnohet në një vend vakant dhe mund t'i jepet gjysa, ose një e treta e rrogës", që kështu kuptohet se për t'i dhanë nëpunsit të pezulluem 1/2 ose 1/3 e rrogës duhet të jetë dhanë vendim gjyqi e të jetë deklarue pafajsija e tij.

kurse në rastin konkret, përpara se të jepet vendimi gjyqi këta të dy nëpunsit në fjalë janë marrë prapë në shërbim, arsyetisht e logjikisht vjen si pasojë të kthyemit të plotë të rrogave të këtyne për sa kohë vazhdoje pezullimi i tyne nga detyra. Prandaj Mbledhja e përgjithshme me shumicë votash çfaq mendimin se ZZ. Ingj. dhe sekretarit të zyrës lliotore të Korçës, duhet t'u kthehet rroga e plotë.

### Mendim i pakicës

Si mbas një Parimit juridik që kemi në fuqi, kur një çështje nuk mund të zgjidhet me një dispozitë të çqueme të ligjës, merren parasysh dispozitat që rregullojnë raste shëmbëllore ose analloge.

Në rastin konkret, nëpunsi q'asht larguar nga puna dhe asht marrë prapë në shërbim, si mbas pikpamjes s'ime, nuk ndryshon as fare nga ay që largohet, përpara ose pas hetimeve paraprake, dhe si mer ndalim gjyqi ose pa-fajsi, riemnohet. Ky i fundit, si mbas nenit 23 të dekret-ligjës mbi ndjekjet dhe gjykimin penal kundra nëpunsave civil të Shtetit, kur riemnohet si mer gjysmën ose një të tretën e rrogës ashtu dhe në rastin konkret nëpunsi i riemnuem, jam i mendimit që duhet të marrë gjysmën ose një të tretën e rrogës.

Vendimi Nr. 28, 19 Kallnuer 1937

**PENSION — Kryetarë komunesh kl. I — Efektet ligjore të së drejtës së pensionit.**

*Kryetarët e Komuneve t' kl. I, qi ushtrojnë edhe detyrat e NënPrefektit dhe të Kryetarit të Bashkis në qendrën e vet, për efektet e pensionit konsiderohen nëpunës Shteti.*

Këshilli i Shtetit,, murr në bisedim shkresën Nr. 8292-II datë 2.XI.1936 të Ministris së P. të Mbrendëshme, me të cilën pyetet mendimi i këtij Këshilli se: Kryetarët e komuneve të klasit të Ire q'ushtojnë detyrat e bashkive dhe të komuneve dhe qi veprojnë edhe si nënprefekt, për efektet ligjore të së drejtës së pensionit, duhet të konsiderohen nëpunsa bashkiak a po komunal?

Aktet në fjalë i u-referuen Seksionit t'Administratës, i cili çfaqi mbi to mendimin e vet Nr. 8 d.14.I.1937.

Mbledhja e përgjithshme pasi studioi aktet si dhe mendimin e Seksionit, me unanimitet vendosi si vijon:

Rasti i pyetun paraqit karakteristikat e një problemi juridik i cili nuk parashikohet as prej dispozitavet të ligjës së pensioneve civile e ushtarake as prej atyne të ligjës së bashkive.

Dr. H . . . nuk ësht pushuar nga detyra legalisht e as ilegalisht për detyra e tij i ësht suprimuar dhe prej ditës së njoftimit të këtij suprimimi automatikisht i ka prerë të gjitha marrëdhanjet me Bashkin e Kryeqytetit dhe ka qenë i lirë të merresh me profesionin e tij e pra nuk ka as një të drejtë për rrogë ose për ndonjë ç'damtim tjetër gjatë kohës që ka qëndruar pa punë e cila ndofta mund t'ishte edhe e përjetëshme.

Për një minut sikur të supozohesh se Bashkit ose Shteti për ofiqet e *suprimuar* te detyroheshin për pagesa rrogash e shpërblimesh nëpunsave të tyre, të mbetun jashtë shërbimit, atëhere nuk do të mjaftonte edhe një budget tjetër për këtë qëllim kur se rroga paguhet për një nëpunsi q. figuron në budget dhe kur titullari i kësaj ndodhet në *detyr e sipër* ose me leje të caktuar në ligjë.

Në rastin në bisedim as ofiqi i Z. Dr. H . . . ka ekzistuar, as ky ka shërbyer, e as me leje nuk ka qenë, as ndonjë lidhje nuk ka patur me Bashkin dhe prandaj reklamimet e tija për rrogë janë të jasht-ligjëshme dhe nuk ka mundësi ligjore të merren parasyesh dhe prandaj unanimisht shfaq mendimin e refuzimit të lutjes së tij.

<u>Vendim Nr. 138, 6 Maj 1937</u>

**NËPUNËS — Hetime paraprake — Ndërhyrja vetiu e Prokurorit në shqyrtimin akteve zyrtare — Autorizimi për ndjekje penale kundra nepunsit — Ligja mbi ndjekjet kundra nepunsave Civil.**

***Hetimet e bamuna prej Prokurorit kryesisht dhe pa autorizimin e Ministris Kompetente, kundra nepunsit, nuk formojnë bazë udhëheqëse për rezultatin positiv ose negativ të hetimeve paraprake.***

Këshilli i Shtetit... muer në bisedim dosarin prej 97 e faqesh të hetimeve paraprake, të bame prej të deleguarve hetues z. . . . . , Prokuror i Shtetit në Peshkopi, autorizuar prej Ministris së Drejtësis dhe z. Q . . . . K . . . . , Inspektor i Financave, emruar prej Ministris së Financave, për hetime kundra: T . . . I . . . . , Drejtor i Financës së Dibrës, Z . . . P . . . . , nepunsit të tatimeve dhe R . . . Q . . . . , tagrambledhës kalorës në Peshkopi, mbi ndjekjen dhe gjykimin penal të nëpunsave në fjalë, të përcjelluna me shkresën Nr. 8/III Res datë 21 Prill 1937 të Ministris së Drejtësis.

Mbledhja e Përgjithshme, pasi studioi gjanë e gjatë të

tha shkresat, aktet e proces-verbalet e ndryshme si edhe llogarite që përmbahen në listat e bashkangjitun, me unanimitet vendosi si vijon:

a) Nga shqyrtimi i dosjes relative përcjellun këtij Keshilli konstatohet se, Prokurori i Dibrës, . . . . . si bazë kryesore të pretendimevet të tija, për dërgimin në gjyq të tre nëpunsave të financës së Peshkopis, ka hetimet e filluara me inisiativën e tij e t'ushtruara drejt për drejt prej vetës së tij, pa qenë i autorizuar prej kurkujt e pa qenë i shoqruar prej as një të deleguari tjetër të Ministris përkatse; veprim ky q' ësht në kundërshtim të plotë me urdhrimet e art. 13 të ligjit mbi ndjekjet dhe gjykimin penal kundra nëpunsave civil të Shtetit, dispozita të cilat nuk e autorizojnë kurrsesi prokurorin të filloje hetimet pa qenë *së bashku* me të deleguarin e Ministris tjetër.

Pra, baza e hetimevet të filluara prej z. Prokurorit, duke mos qenë konform me dispozitat e ligjit vet-vetiu kuptohet se gjith veprimi hetimor i zhvilluar gjer në datën 1 Prill 937 të shoqërimit t'ispektorit të Ministris së Financave ësht nul, ësh i pa qenë, dhe, prandaj, hetimet paraprake normale e të rregullshme nuk mund të bazohen në këto veprime t'ushtruara në kundërshtim me ligjin, dhe kështu këto nuk mund të jenë udhë-heqës as për rezultatin pozitiv as negativ të hetimeve paraprake. Duke konsideruar në këtë menyr' të pa qenë verimet e para të së Z. prokurorit vet-vetiu duhet të quhen të pa qena edhe të gjitha bazat e pretezës së tij e cila, fund krye, ësht themeluar vetëm në pohime, në thënje e kundër-thënje të tekstit t' akteve hetimore të zhvilluara jo në konformitet me dispozitat procedurale të caktuara në nenin 13 të ligjës si u tregua më sipër.

b) Duke rrzuar bazën të vetme të pretendimit të z. Prokurorit nuk mbetet vend për t'u marrë në konsideracion hetimet e tija të para dhe aq më tepër konkluzioni i rrjedhur prej këtyre; duke marrë parasyesh sa u tha sipër, rrjedh vetiu se, kur, në bazë t'autorizimit të Ministrive përkatëse, kanë filluar hetimet paraprake për tagrambledhësin R. . . . Q. . . . nuk ka patur vend pretendimi i përvetimit të 417.60 fr. ari vlefta e pullave të monopolit e të Kryqit të Kuq, mbassi këto pulla tërësisht u gjendnë të depozituara n'Arkën e Financës e jo në xhepin e R. . . . Q. . . . ; pra për këtë të fundit nuk ka vend akuza për pervetim të hollash dhe zbatimi i dispozitave t'art. 184 të Kodit Penal, sepse të hollat tërësisht kanë ekzistuar dhe nuk janë çdukur ose fshehur. Në qoftë se këto pulla nuk kanë qenë të ngjitura në volumet e duarve t'arkës në kohën kur filluan hetimet paraprake, kjo mungesë ka rrjedhur prej veprimit të pa autorizuar të z. Prokurorit, kur ky pa pasë kompetencë kishte marrë volumet e

duarve t'arkës dhe kështu kishte ngritur posibilitetin për t'u ngjitur pullat prej të ngarkuarit te z. R . . . Q . . . z. Nazmi Xhidrës, i cili, për mungesë të volumeve, duke u ndodhur në pa mundësi për të ngjitur pullat, këto i ka depozituar n'arkën e financave, prej ku janë marrë e u janë ngjitur duarve t'arkës mbasi këto janë kthyer prej z. Prokurorit.

Në ketë menyrë kur pullat me vlefte 417.60 fr. ari kanë qenë n'arkë shumë kohë përpara se të fillonin hetimet paraprake pretendimi për përvetim të shumës së sipërme, ësht i pa vendmë e pa as një bazë.

c) Në këtë mënyrë duke mos patur as një fakt për përvetim të hollash e as një faktor kryesor për këtë vepër nuk mund të ketë bashkëpuntorë për një faj të pa ekzistuar, dhe prandej atribuimi i z. Prokurorit për bashkëveprimtarin e z. T . . . I . . . , drejtor i financës dhe të z. Z . . . P . . . , nepunës tatimesh, ësht pa as një mbështetje ligjore dhe prandaj nuk mund të merret në konsideracion.

Për sa i përket ometimit t'atribuar prej Prokurorit për z. T . . . I . . . , që ky nuk ka nxjerrë me kohë gjobën prej 500 fr. ari prej Selim Sylejmanit nga Fushalija, dhe zbatimi i dispozitave t'art. 203 të Kodit Penal, nuk ësht i mbështetur n'asnjë bazë ligjore sepse drejtori i financës së Peshkopis z. T . . . I . . . vendimin relativ të gjobitjes së Selim Sylemanit e *ka marrë* dhe e ka venë *n'ekzekutim*. Pra, në këtë mënyrë nuk mbetet vend për pretendimin e ometimit në detyrë.

Vonesa e rrjedhur prej datës 15 Maj gjer më 23 Tetor 1936 nuk ësht shkaktuar nga një ometimi në detyrë i z. T . . . I . . . , por nga mungesa me leje e z. Hasan Kokës, Llogaritar i Financës dhe një kohë tjetër nga veprimet e shumta të zyrës që kryesonte.

Vdekja e Selim Sylejmanit para dy ditsh të ekzekutimit të vendimit të gjobitjes së tija vet-vetiu kuptohet se ka qenë e pa paraparë prej drejtorit të financës dhe prandej pretesa e humbjes së 500 fr. ari të gjobës prej ometimit në detyrë të z. T . . . I . . . ësht pa as një themel ligjor.

Për terë arsyet e theksuara më sipër, mbledhja e përgjithëshme e këtij Këshilli me unanimitet vendosi refuzimin e kërkimit të z. Prokurorit të Dibrës, për dërgimin në gjyq të tre nëpunsave të treguar më sipër dhe pranimin e pikpamjes së inspektorit të financave për mos nevojën e ndjekjeve penale.

zbato' et edhe nji rekruti bujk të martuem, ndonse grueja e tij ka nji vlla, mbassi vllau i gruas nuk mund të konsiderohet ndihmës edhe për sa i përket administrimit të pasunis bujqësore.

Komanda e Mbrojtjes Kombetare, tue mos marrë parasyesh kët mendim, rekrutin, qi paraqitet në gjendjen e sipërme, e ka marrë për shërbim të plotë.

Kërkohet mendimi i Këshillit të Shtetit.

Aktet iu referuem Seksionit të Drejtësis, i cili shfaqi mendimin e vet Nr. 52 datë 25-VIII-1937.

**Mendim e arsyetim**

Neni 38 i Ligjës së Rekrutimit parashef rasën në të cilën rekruti âsht i vetëm, d.m.th. pa ndonji ndihmës të parapam në pasqyrën e nenit 34. Në rasë konkrete rekruti nuk mund të konsiderohet i vetëm, pse vllau i grues, kunati i tij, i babet ndihmës në bazë të pasqyrës së përmendun dhe të nenit 31 të Rregullores mbi zbatimin e Ligjës së Rekrutimit. Ky konsiderohet ndihmës si për motrën e vet, gruen e rekrutit, ashtu edhe për administrimin e pasunis bujqësore të rekrutit, mbasi kjo pasuni âsht e përbashkët e bashkëshortve: në kët rasë rekruti, pra, i shtrohet shërbimit të plotë.

Në bazë të nenit 24 të Ligjës së Rekrutimit Këshillit Administrativ ka kompetencë me u shfaqë vetëm mbi ndryshimet eventuale të gjendjes familjare të rekrutit mbas kontrollimit ose gjatë shërbimit të tij ushtarak.

Këshilli i Shtetit, tue marrë parasyesh sa u tha sipër si edhe mendimin e Seksionit, shfaq unanimisht mendimin se nji rekruti, qoftë edhe bujk, qi në bazë të dispozitave të kjarta të ligjës, ka për ndihmës kunatin (vllan e gruas) nuk mund t'i zbatohet neni 39 i Ligjës së Rekrutimit.

<u>Vendimi Nr. 261, 30 Gusht 1937</u>

**NËPUNËS — Projekt dekret ligjë mbi jerarchin dhe gjendjen ekonomike të nëpunsave.**

Këshilli i Shtetit ... mori në bisedim, në bazë të nenit 27 të Rregullores së tij, projekt-dekret-ligjën mbi jerarchin e gjendjen ekonomike të nëpunsave të Shtetit, përcjellë me shkresën 2115 datë 26 Gusht 1937 të Kryesis së Këshillit Ministruer dhe mbasi studioj raportin justifikonjës të këtij pro-

jekti dhe mbasi mori, prej Z. Ministrit të Financavet, shpjegimet ndriçonjëse konstatoj se:

1) Projekt-dekret-ligji mbi jerarchin e nëpunsave dhe mbi gjendjen ekonomike të tyre ësht një projekt sui generis, i pa shembëlltë me as një ligjë tjetër t'ayijë Shteti tjetër të kësaj natyrë. Përveç kësaj të mete kapitale projekt-dekret-ligji i ri ësht i pa pajtuar-bëm me qëllimin final që duhet të ketë frymëzuar hartimin e tij.

2) Projekt-dekret-ligji q'ësht i pa shembëlltë me ligjet e kësaj natyre të shteteve të tjerë kuptohet nga fakti se të gjith ligjet e tera mbi gjendjen juridike të nëpunsave civil edhe ay i Italis me 11 Nëndor 1933 Nr. 2395 tekstin e këtij projekt-dekret-ligji e kanë vënë si aneks ose si alegato në fund të ligjit kryesor i cili cakton të *drejt'at e detyrat* e nëpunsave, *cilësit* e këtyre dhe pastaj, më në fund, shton pasqyrën distinktive të kategorivet dhe të rrogavet.

Nga sa u tha sipër kuptohet se ësht ligji mbi gjendjen juridike të nëpunsave, ose, për randësin e tij si e kanë pagëzuar shumë shtete e shumë autore, ësht statuti fodamental i nëpunsavet që me dispozitat e shumta të tij, automatikisht, nxier në shesh si aneks pasqyrën e kategorive dhe të rrogave të nëpunsave dhe jo kjo pasqyrë të vërë bazat e statutit themeltar të fonksionarve të Shtetit se një veprim i këtillë ësht anormal dhe pa as një përfundim pozitiv të dëshiruar.

3) Projekt-dekret ligji i filluar me këtë motif të gabuar, duke mos përmbajtur as një dispozitë për të drejtat, detyrat e cilësit e nëpunsave, vet-vetiu kuptohesh se gjendjes koatike t'administratës s'onë — në pikpamje rroge — dhe deshprimit t'arritur në kulm të nëpunsave, po për distenksione rrogash e ofiqesh jo vetëm që nuk mund t'i jepte fund një herë e mirë por këtë do t'a ngatronte shumë më keq e në mënyrë të pa çqitshme si do t'a provojnë faktet konkrete, të kopjuar prej këtij projekti, që do të shënojmë më poshtë.

4) Historia e administratës s'onë shtetrore e 17 vjetëve të fundit na tregon se mungesa e garancis fondamentale, e të drejtave dhe detyravet të nepunsave të përmbledhura në një ligj, ka shkaktuar të konstatojmë, vit për virt, në mes të fonksionarve të Shtetit distenksione si pas ëndjes të njerit dhe të tjetrit dhe kështu kur një universitar i diplomuar nga një fakultet, si rrogë fillestare, në një dikaster ka marrë një rrogë të majme, po shoku i këtij po me ato tituj studimi në një dikaster tjetër ka marrë, si rrogë organike fillestare, një shumë mikroskopike.

Ky dallim rrogash në mes të diplomuarve të një *fakultetit* ka arritur kulmin kur të diplomuarit kanë qenë të fakulteteve të

ndryshme: një i diplomuar nga fakulteti i Drejtësis në Ministrin e Jashtme kur merr 200 fr. ari në Ministrin e Drejtësis 240 fr. ari kolegu i tij i diplomuar n'inxhinieri merr 400 fr. ari n'agronomi po këtë rrogë. një mjek i diplomuar nga fakulteti i mjeksis kur merr 250 fr. ari kolegu i tij i veterinaris merr 400 f. ari.

Dhe pikërisht këto distenksione të çuditëshme në mes të fonksionarve të Shtetit kanë detyruar Prisin t'onë të madh prej vjetit 1923 e gjer më sot të marrë inisiativën e rregullimit definitif të situatës juridike të nëpunsave e cila deri diku në qoftë se do të rregullohesh me projekt-ligjin e paraqitur Parlamentit dhe e tërhequr për një ristudim, do të keqësohet më tepër me projekt-dekret-ligjin e ri që — si do t'a provojmë më poshtë — nuk bën as gjë tjetër përveç se pa drejtësivet dhe dallimeve të gjermësotshme t'u ngjitë epite'in legal dhe t'i legalizojë definitivisht.

5) Projekt-dekret-ligji në bisedim, ose të themi më mirë *aneks* i ligjit t'ardhshmë të nëpunsave, duke legalizuar pa drejtësit vinjonjëse kundra nëpunsave, anulon edhe ligjet organike që kanë vene bazën themeltare t'administratës s'onë dhe që, në mungesë të statutit fondamental të nëpunsave, kanë caktuar, në mënyrë ekspresive, *cilsit, detyrat* dhe të *drejtat* e fonksionarve dhe që kanë fiksuar strukturën organike të dikastereve në qendër e në qarke.

Duke u abandonuar dispozitat e ligjeve organike — për t'u konfirmuar me dispozitat e alegatos A ose B të ligjit t'ardhshmë të nëpunsave të pregatitur në formë projekt-dekret-ligj — vetvetiu do të krijohen ose do të suprimohen zyra e titul *arë*, pa as një kriter do të gradohen ose do të degradohen nëpunsa, do të shtohen e do të paksohen rroga.... dhe ky basqyl i krijuar vuf'netarisht hërë herë do të ngrihet përpjetë e herë herë do të unjet në mënyrë që stabiliteti ideal n'administratën shtetrore do të mbetet një gjë për t'u dëshiruar.

6) Në një projekt-ligj të destinuar për rregullimin e situatës juridike të nëpunsave pa u formuar *pikësëpari* kaptinat:

1) Mbi cilësit e nëpunsave;

2) „ mënyrën e emrimit, transferimit, pushimit, gradimit e degradimit;

3) Mbi lejen, orarin, masat disiplinore;

4) Mbi të drejtat e obligimet e nëpunsave, mbi vjetërsinë, rrogën e mbi çdo gjë tjetër;

nuk mund të formohet alegatoja e këtij projekt-ligji se kjo pasqyrë, e aneksuar në fund mbi klasifikim e rrogave, është pjella naturale e kaptinava të sipërme e jo diçka në vedi.

Dhe pikërisht alegato-ja e ligjit të nëpunsavë, pa as një dispozitë nga të këtij, duke u hartuar në formë dekret-ligji nuk ka venë as bazat e klasifikimit të nëpunsavë, nuk ka unifikuar titujt e rrogat e këtyre, nuk ka parashikuar as një masë për t'ardhmen, nuk ka korrigjuar as një nga gabimet e gjermësotme mbi sasin distenktiva të rrogave të nëpunsavet me cilësi të njejta, mbi titujt e nëpunsive të krijuar me qëllim shtesë-rroge, nuk ka shëruar as një nga sëmundjet e administratës s'onë por ka mjaftuar me kopjimin e kadrove organike të vietit financiar 1937-38 dhe këto — në bazën e rrogave netto — i ka radhitur në disa lista të ndara në dy kategori e në disa range.

Ndofta dëmi do t'ishte mjaft i kufizuar sikur këto lista të përcjella me disa nene ligjesh të mos preknin gjendjen aktuale të struktrës organike t'administratës s'onë por mjerisht këtë e prekin nga themelet sepse duke pranuar në kategorin A drejtonjëse edhe maturantët me shkollë të mesme hap portën e mbyllur të nëpunsive drejtonjëse edhe për këta gjysmakë të cilet vof në bazën e ligjeve në fuqi, nuk mund të merren në shërbimin e shumë Ministrive dhe pra një gjë q'ësht ndaluar sot nuk mund të lejohet nesër tek e cila një komb i tërë ka varur shpresat e zhvillimit dhe të lumtëris.

7) Kaq për sa i përket bazës së projekt-dekret-ligjit dhe tani hyjmë n'analizën e tekstit të tij.

Pasqyra krahasonjëse që kemi nxierrë nga listat e projektit dhe që po e radhitim më posht na bind se për klasifikimin e nëpunsavë nuk ësht ndjekur as një kriter dhe ësht mjaftuar vetëm me insirimin në lista të kuadrove të buxhetit të vitit n'udhtim; pra të gjitha të metat, të gjith dallimet e gjermësotme të gjendjes aktuale janë përsëritur dhe kanë veshur petkun e legalitetit.

Për të formuar një konviksion të plotë, nga shembëllat e shumta po të tregojmë se:

1) Profesori i shkollavet të mesme me titull studimi t'universitetit fillimisht ësht klasifikuar në rangun 13 të kategoris A me 150 fr. ari rrogë mujore kurse kolegu i tij ingjinieri i diplomuar po nga universiteti fillimisht ësht klasifikuar në rangun 9 të kategoris A me 250 fr. ari rrogë mujore.

2) Mjeku i diplomuar nga universiteti i mjeksis fillimisht ësht klasifikuar në rangun 13 të kategoris A me 150 fr. ari rrogë mujore kurse kolegu i tij i veterinaris me titull studimi t'universitetit fillimisht ësht klasifikuar në rangun 9.... të kategoris A me 250 fr. ari rrogë mujore.

3) Mjeku duke u klasifikuar në rangun 13 të kategoris A logjikisht duhesh edhe kolegu i tij farmacisti maksimum, t'ishte

po në kët klas kur se ky okupon klasën 11 të kategoris A. me 190 fr. ari rrogë.

4) *Mësonjësi* fillor më diplomë normaleje si rrogë fillestare kur ka 150 fr. ari dhe kur klasifikohet në rangun 13 të kategoris A kolegu i tij gjeometri me mësime shumë më të paka — ësht klasifikuar në ragun 11 të kategoris A me 190 fr. ari rroge fillestare, klas në të cilin mesonjësi fillor mund t'arrijë vetëm pas 15 vjet shërbimi.

Duket të përsëritim këtu se gjeometri në kët mënyre jo vetëm q'ësht klasifikuar dy range më lart se *mësonjësi*, por kaq here më lart ësht klasifikuar edhe nga mjeku universitar edhe nga profesori universitar.

Kaq prova sa për të treguar disproporsionin e anomal'n në mes të rrogave të fonksionarve të Shtetit.

Dhe tani duhet të theksojmë se projekt-dekret-ligji në bisedim jo vetëm që nuk ka unifikuar në bazën e një kriteri rrogat e sotme të nëpunsave por, pa as një bazë, në kategorin A, disave u ka zbritur rrogat aktuale dhe një heresh u ka zbritur edhe gradat ekzistente: për këtë veprim të pa justifikuarshmë dhe eksepsional me parimet udhë-heqëse të projektit mjafton të themi se Kryeinspektori i Oborit Mbretnor me rrogë mujore origjinale prej 900 fr. ari kur duhesh — si pas rrogës — të klasifikohesh në rangun e lrë të kategoris A jo vetëm që nuk ësht klasifikuar në këtë rang por nuk ësht klasifikuar as në rangun e llte dhe ësht hedhur në rangun e llltë me 650 fr. ari rroge.

Nga sa thamë sipër kuptohet se projekti ka ndryshuar klasat e kategoris ekzistente dhe ka përdorur të drejtën e *degradimit de facto* gjë e cila ësht e pa shpjeguarshme.

Po kështu ësht i pa shpjeguarshmë edhe veprimi i falljes së titujve dhe lartësimi i edigeve për disa nëpunsira: për shembëll në bazën e budgetit të sotme pranë *Ministris së P. Botore* kur ekziston shef i zyrës teknike dhe kur ky duhesh të klasifikohesh në rangun e 9të — në projektin e ri — ky titull ësht ndryshuar në *Kryeingjenier teknik* dhe me këtë titull të falur i ësht rritur rangu në disa herë d.m.th. nga klasi i 9të ësht gradnar në klasin e 5te; po kështu në budgetin e vjetit n'udhëim dhe në ligjin organik të Ministris së P. të Mbrendëshme kur nuk ekziston nonjë nëpunsi me titull *Kryeinspektor* në projektin e ri ësht krijuar ky ofiq dhe natyrisht për titullarin e ri ësht rezervuar një rang më i lartë në kategorin A. d.m.th. Inspektori i Ministris së P. të Mbrendëshme nga klasa 8të ësht hedhur në klasin e 6të po të këtij projekti.

Ësht një pikë kryesore e tepër e *rëndësishme* të theksojmë se në Alegaton A të ligjit mbi gjendjen juridike të Shtetit Italian, prej


DAP

Vendim Nr. 178, 22 Maj 1937

**NËPUNËS — Leje p'shimi — Shkaqe shëndetsore — Ndërpremja e lejes — Afati 6 mujor — § 2 i nenit 44 i ligjës së nëpunsave.**

*Dy leje të dhanuna, për shkaqe shëndetsore, një nëpunsi, të ndërpremuna prej 44 ditësh punimi konsiderohen si vazhdimi i njera tjetrës.*

Kë'shilli i Shtetit.... muer në b'sedim shkresën e Ministris së P. të Mbrendëshme Nr. 4728 datë 20 Maj 1937.

**Ob'ekti i Konsultimit**

Me shkresën e nalt-përmendun pyete' nëse dy lëje të dhanuna për shkaqe shëndetsore njij n'punësi, të ndërp'em na prej 44 dite'h punimi, konsiderohen si vazhdim njëna tjet'ës në mënyrë qi të formojnë nji lëje të vetme 6 murj'he, ose, tue u marrë parasysh ndërpremja e 44 ditve, nëpunsit, mbas mbarimit të periudhës së dytë të lëjes, mund t'i jipet edhe nji lëje tjetër ?

**Arsyetim e mendim**

Mbledhja e Përgjithshme, tue marrë parasyesh mendimin e shfaqun prej Seksionit të Drejtësis me Nr. 29 datë 21-V-1937, dhe tue konstatue se me § 2 të nenit 44 të Ligjës së Nëpunsave nuk parashihet ndërpremja e lëjeve për shkake shëndetësore, si edhe se Ligja Organike e Ministris së P. të Mbrendëshme përgjithsisht nuk flet mbi dhanien e lejeve të këtilla, në bazë të § 2 të nenit 2 të „Dispozita mbi interpretimin dhe aplikimin e ligjeve përgjithsisht", me vota të përbashkëta shfaq mendimin se në rasën konkrete, të paraqitun prej Ministris së P. të Mbrendëshme dubet zbatue disporita e § 5 e nenit 112 të D. L. O. t'Arsimit.

Vendim Nr. 193, 31 Maj 1937

**ARSIM — Provim i plekunis dhe i semimaturës — Takë provimi — Përjashtim — Bursjerë të Shtetit — D. L. O. e Arsimit, neni 299.**

*Bursjeret e Shtetit, qofshin edhe me nota jo të mira në përfundimin vjetuer, nuk u shtrohen tak'ave të provimit.*

Kësh'lli i Shtetit.... muer në bisedim shkresën e Ministris s'Arsimit Nr. 2206/II datë 27-V-1937.

Vendim Nr. 358, 15 Nandœr 1937

**NËPUNËS — Shperblim avukator — Nëpunës Shteti — Përfaqësim finance në gjyq — Ligja mbi nxjerrjen e të ardhunave Shtetnore neni 82.**

*Nëpunësit e Shtetit që marrin rrogë e që përfaqësojnë Financën para gjyqeve nuk kanë të drejtë të marrin edhe shpërblim avokator.*

Këshilli i Shtetit... murr në bisedim çështjen që i përket së drejtës avokatore prej fr. ari 30 që pretendon nëndrejtori i Financave të Kukësit, përcjellë këtij Këshilli bashkë me aktet e tjera relative, me shkresën Nr. 4237-6 datë 16-IX-1937 dhe shkresën suplementare me datë 9-XI-937 të P. T. Ministrisë së Financave.

**Objekt Konsultimi**

P. T. Ministrija e Financave pyet në se titullari i Nëndrejtoris së Financave të Kukësit ka të drejtë të marrë shpërblim avokator fr. ari 30, sepse ka përfaqësuar Financën në gjykatoren lokale në padin e ngrehun nga Financa kundra A... M... për detyrimin e fr. ari 1.290, të rrjedhun nga taksa e së dhjetës të vitit 1934, mbassi këjo e drejtë âsht sanksionuar edhe me akt-gjykimin Nr. 10 me datë 12-II-1935 të Gjykatës Paqtuese të Kosovës, i cili edhe ka marrë formën e preme.

Aktet në fjalë i u-referuen Seksionit të Drejtësis, i cili shfaqi mendimin e vet Nr. 64 datë 15-XI-1937.

**Mendim dhe arsyetim**

Mbledhja e përgjithshme e këtij Këshilli, mbassi e shqyrtojë mirë çështjen edhe tuke marrë parasyesh:

a) Se iradei-Senije-a me datë 14 Nisan 1308 turqisht që përmbahet në librin „Lahikai-Kavanin f. 619 e që ban fjalë për të drejta avokatore për davatë e Bankës Bujqësore, në të cilën mbështetet edhe pretendusi, Nëndrejtor i Financës së Kukësit, âsht abroguar me ligjën e re (neni 98) mbi nxjerrjen e t' ardhunave Shtetnore datë 29 Mars 1932, dhe kështu iradesë në fjalë nuk i mbetët më vend zbatimi.

b) Se debitoret e Shtetit ndahen në dy kategori, *në bashkëdhanës* edhe *në debitore të thjeshtë* dhe sa për kategorin e parë flet kjartësisht

ligja mbi nxjerrjen e t'ardhunave Shtetnore me datë 29 Mars 1932, në nenet 1, 4, 82 etj. të saj, kur se për debitorët e tjerë bëjnë fjalë ligjet e tjera, si ajo e të Dhetave, ligja mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqsore etj. etj. dhe, mbassi në rastin konkret shuma e obligimit rrjeth nga taksa e së dhetës në i detyron Arkës dhetari A... M... kështu që në këtë rast nëpunsit kompetentë që bënë sekvestrime dhe shitje me ankand të pasunis së bashkëdhanësve *mnk kanë të drejtë të marrin shpërblim 5% mbi shumën e d'tës*, si mbas nenit 82 të ligjës mbi nxjerrjen e të ardhunave Shtetnore, se ky nen flet vetëm për *bashkë-dhanësit* që detyrohen me pagim taksash tatimi, vergjie e tjera kësodoret, e jo për debitorët e tjerë që ngarkohen me pagim të dhetash, të cilat nxiren me anë akt-gjykimesh, p. sh. sikur se në rastin konkret, prandaj edhe në qoftë se gabimisht këta nëpunës kanë marrë shpërblim 5% duhet t'ja kthejnë arkës.

ç) Se nëpunsat kompetent që përfaqësojnë Financën në krahinat, ku nuk ndodhen përfaqësues ligjore nëpunës ose avokatë, ose përfaqësues në gjyq që paguhen me shpërblim ose rrogë, ata nëpunësa, në një përfaqësim gjyqsor që bejnë para gjykatës lokale, s'bëjnë gjë tjetër përveç se kryejnë detyrën e tyne, për të cilën marrin rrogën respektive, pra nuk kanë të drejtë të marrin edhe honorar avokator, i cili në këtë rast duhet të mbetet në favor të ekonomis së Shtetit e jo t'i kthehet gjyq-bjerësit debitor, si pretendon P. T. Ministria e Financeve, sepse nga do'a e këtij ka dalë një herë, mbassi u sanksionua me vendim gjyqi.

P r a n d a j

ky Këshill me vota unanime shfaq mendimin se nëpunsat e Shtetit që marrin një rrogë e që përfaqësojnë Financën para gjyqeve nuk kanë të drejtë të marrin edhe shpërblime avokatore.

Vendim Nr. 359, 16 Nandor 1937

**KONTRATË — Vendim i Këshillit Ministruer — Marrëveshje private — Arsye ngutësije — Afati në mes të vendimit dhe t'ekzekutimit.**

*Kur në mes të vendimit autorizues të Këshillit Ministruer për marrëveshje private dhe ekzekutimit të këtij kalon një afat të paktën sa aj si duhet për uvktrimin e ankandit publik, ngutësija konsiderohet e zhdukun dhe autorizimi, për marrëveshje private, si i pa qenun.*

Këshilli i Shtetit... muer në bisedim adjudikimin e forniturave

# Ligjë

## mbi

## krijimin e Drejtoris s' Imigracjonit pranë Ministris P. të Mbrendshme

Neni 1.

Në kuadrin e personelit t'ushtrimit financjar 1937-1938 të Ministri së P. të Mbrendshme krijohet Drejtorija e Imigracjonit me nji personel të përbamë :

| | | |
|---|---|---|
| Nji Drejtor me rrogë mujore | Fr.ari | 450.— |
| Nji Sekretar' i I. me rrogë mujore | „ | 330.— |
| Nji Sekretar' i II. Protok. Arsh. Kopist. | „ | 250.— |
| Nji Inspektor me rrogë mujore | „ | 350.— |
| Nji Agronom me rrogë mujore | „ | 300.— |
| Gjasht të Sekretarë Imigracjoni në dispozicjon me nga. | „ | 100.— |

ue i-u shtrue ndaleavet të jashtzakonëshme të


DAP



Nr. 4 FLETORJA ZYRTARE 2 Fruer 1937 5

caktueme në ligjën datë 19 Maj 1937 për aprovimin e parapamjeve të t'ardhunavet e shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1937-1938.

Neni 2.

Personeli i tashëm që figuron në kuadrin e personelit t'ushtrimit financjar 1937-1938 të Ministris së P. të Mbrendëshme i përbamë prej nji Sekretari të I. të Imigracionit me rrogë mujore fr. ari 350 (treqindepesëdhet) e nji Sekretari të dytë të Imigracionit me rrogë mujore prej fr. ari 200 (dyqind) suprimohet nga data e hymjes në fuqi të kësaj Dekret-Ligje.

Neni 3.

Drejtorija e Imigracjonit ka me u marrë me veprimet e instalimit e të tjera që u përkasin Imigrantave.

Kompetencat e detyrat e personelit kanë me u caktue me Rregullore të posaçme.

Neni 4.

Sekretarët e Imigracjonit që janë në dispozicjon, kanë me u dërgue në çdo Qark që të nevoiten pa të drejtë dietash e i pague vetëm shpenzimet e udhtimit.

Neni 5.

Për përballimin të rrogave të personelit të Drejtoris s'Imigracjonit krijue si mbas nenit 1 të kësaj Dekret-Ligje, në gjendjen e parapamjeve të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1937-1938 të Ministris së P. të Mbrendëshme, nen Kap. 1 «Rrogë personeli etj.» shtohet nji fond prej fr. ari 6.000. (gjashtëmijë).

Neni 6.

Fondi fr. ari 6.000 (gjashtëmijë) shtue mbas nenit 5 të kësaj Dekret-Ligje, paksohet nga Kap. 1 «Rrogë personeli e siokacione» të gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1937-1938 të Ministris së Punve të Jashtme.

Neni 7.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 8.

Me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje ngarkohet Ministri i Financavet, i P. të Mbrendëshme e Ministri i P. të Jashtme.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëvet

Mbi propozimin e bamun me shkresën Nr. 1913/II datë 16-IX-1937 të Kryeministris,

Si ndigjoj dhe pëlqej vendimin e Këshillit Ministruer me datë 30-VIII-1937,

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi krijimin e Drejtoris s'Imigracjonit pranë Ministris së P. të Mbrendshme.

Durrës, me 21 Shtatuer 1937.

ZOG. d. v.

Kryeministri:

Zav. Ministri P. Mbrendshme:

K. Kotta. d. v.

Ministri P. të Jashtme

Ekrem Libohova. d. v.

Ministri Drejtësis e Zav.

Ministri Financavet:

Th. Orologa. d. v.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 21 Shtatuer 1937, mbi krijimin e Drejtoris s'Imigracionit pranë Ministris së P. të Mbrendshme, i ratifikuem prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 245/I ex.37 datë 19-I-1938 të Kryesis së tij, dhe Urdhënon shtimin e tij në Kodet e Mbretnis si ligjë.

Tiranë, me 24 Kallnuer 1938.

ZOG. d. v.

---

## Ligjë - Autorizuese
### mbi shtypjen e 600.000 copë monedha argjenti nji frangshe Ari

Art. 1.

Autorizohet Qeverija Mbretnore me hye në marrëveshtje me Bankën Kombëtare të Shqypnis për shtypjen dhe vuemjen në qarkullim të 600.000 copë monedha argjenti nji frangshe ari me kondita që:

a) Shtetit t'i takojë nji fitim prej 300.000 fr. ari dhe ky t'i paguhet nga ana e Bankës Kombëtare qysh ditën e hymjes në fuqi të kësaj Dekret-Ligje;

Dekretligj mbi krijimin e Drejtorisë së Emigracionit pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme
*Fletore Zyrtare, 2 shkurt 1937*

# L I G J Ë

## Mbi Rregullimin e zyrave t' Administratës Qendrore të Ministris së Arsimit dhe mbi krijimin e Komisjonit Teknik

Neni 1.

Pranë Administratës Qendrore të Ministris së Arsimit, vendet organike të personelit drejtues janë:

1 Sekretar i Përgjithshëm;
3 Drejtorë Kryetarë-shërbimi;
2 Shefa të Seksioneve;
3 Antarë të Komisionit Teknik;
1 Kryesekretar;
2 Sekretarë të Parë;
1 Arkeolog;
5 Sekretarë;
1 Kryellogaritar;
1 Llogaritar;

Vendet organike të personelit zbatues janë;

1 Kryeprotokolist;
1 Protokolist;
1 Arkivist i Parë;
1 Arkivist;
1 Magazinier;
1 Spedicioner;
4 Kopista.

Neni 2.

Mbas sistemimit, në konformitet me nenin 10 të personelit që gjindet në kuadrin e Administratës Qendrore në kohën e zbatimit të kësaj Ligje, konkurset shpallen vetëm për vendet që herë mbas here mbeten hapët.

Për vendet drejtuese, emnimet bahen mbas nji konkursi në bazë titujsh e provimesh; për vendet zbatuese mbas nji konkursi në bazë titujsh vetëm.

Mbas sistemimit të personelit që sot gjindet në kuadrin e Administratës Qendrore, në konkurset për vendet drejtuese që do të mbeten hapët pranohen vetëm ata që zotnojnë titullin e studimit. Për me marrë pjesë në konkurs për vendin e Kryellogaritarit e për atë të Llogaritarit titulli i nevojshëm i studimit asht së paku dëftesa e lirimit të shkollës së Mesme Tregtare shkallës së naltë. Për me marrë pjesë në konkurs për vendet e an-

tarve të Komisjonit Teknik titulli i nevojshëm i studimit asht doktorata a diploma universitare e nji vishshme me nji shërbim të lavdueshëm prej së paktën tri vjetësh n'arsim, ose së paku vazhdimi për dy vjet i mësimeve universitare me nji shërbim të lavdueshëm prej pesë vjet e nalt, gjithashtu n'arsim; në të çmuemit e titujve në konkurset titulli i shërbimit ka mâ vlefsë se titulli i studimit. Për të gjitha vendet e tjera drejtuese titulli i studimit i nevojshëm asht doktorata ose diploma e studimeve të nalta në pedagogji, në filozofi, në letërsi, në shkenca, me nji kohë shërbimi jo ma pak se tri vjet, ose studime universitare me nji kohë shërbimi n'Administratat t'arsimit jo ma pak se 7 vjet dhe për Sekretarët si titull mission dëftesa e shkollës së Mesme me nji shërbim jo ma pak se dy vjet.

Për vendet zbatuese që do të mbeten hapët, mbas sistemimit të personelit që gjindet sot në kuadrin e Administratës Qendrore, në konkurset pranohen vetëm ata që zotnojnë të paktën si titull studimi dëftesën e shkollës së Mesme shkallë t'u-lët. Modalitetet për pesatimin në konkurse, për formimin e komisioneve provuese, për programet e për provimet caktohen në Regulloren.

Nenl 3.

Sekretari i Përgjithshëm rregullon disiplinën dhe mbikqyrë të gjitha zyrat e të gjitha shërbimet e Administratës Qendrore dhe i raporton drejt për drejt Ministrit.

Janë kompetenca të posaçme te Sekretarit të Përgjithshëm:

1) Çashtjet e përgjithshme që i përkasin gjendjes juridike dhe ekonomike të personelit të Ministris e t'Administratave të mvaruna;

2) Regullimi i letërshkëmbimit, 3) kundret e vjetërsis së personelit t'Administratës Qendrore, 4) shpenzimet e Zyrës s'Administratës Qendrore, kontratat dhe çdo veprim tjetër financjar i Ministris, 5) statistika, 6) ruejtja e mbikqyrja mbi dhurimet e pasunit e lanuna prej Entesh private ose botore për arsim, 7) higjena ndër shkolla foshnjore fillore e të mesme të çdo lloji e shkalle, 8) mbikqyrja e protokollit, arkivit, bibliotekës e magazinës së Ministris, 9) jetëshkrimi i personelit mësimuer dhe i nëpunësave të Ministris, 10) kryemja, me urdhën të Ministrit, e inspektimeve dhe hetimeve q'i ngarkohen.

Neni 4.

Drejtori e Kryetar-Shërbimi për Arsimin e Mesëm mvaret drejt për drejt nga Sekretari i Përgjithshëm mbi kërkesë e me urdhën të të cilit studjon dhe proponon zgjidhjen e veprimeve mbi arsimin e Mesëm që hyjnë në kompetencë të Sekretarit të Përgjithshëm, disiplinon dhe kontrollon të gjitha veprimet e Drejtoris, ushtron funksionet mbi të gjitha shkollat e mesme dhe disponon inspektimet dhe hetimet mbi to.

Janë në kompetencë të posaçme të Drejtoris s'Arsimit të Mesëm: 1) çashtjet e përgjithshme mbi shkollat e mesme dhe mbi Konviktet e tyne, 2) ndërtesat, orendit, mjetet e veglat mësimore, laboratorët, uzinat, zyrat model-, fushat eprovimtare të shkollave të mesme, 3) gjendja juridike dhe ekonomike e personelit mësimuer të shkollave të Mesme, 4) ngarkimet dhe zavendësit në shkollat e Mesme, 5) mbikqyrja mbi bursat e mësimit për shkollat e Mesme të Nalta të mbrendshme e të jashtme, 6) veprimet që u përkasin nxanësve dhe shqyrtimi i raporteve finale t'institutave të Mesme, 7) përpilimi i listës së profesorëve t'aftë për Drejtorë, 8) mbledhja e dokumentave historike dhe mbikqyrja mbi gërmimet arkeologjike e mbi monumentat kombtare, 9) veprimet që u përkasin Bibliotekave Shtetnore dhe Muzeve.

Neni 5.

Drejtori Kryetar Shërbimi për Arsimin Fillor mvaret drejt për drejt prej Sekretarit të Përgjithshëm mbi kërkesë e me urdhën të të cilit studjon e proponon zgjidhjen që hyjnë në kompetencën e posaçme të Sekretarit të Përgjithshëm, disiplinon e kontrollon të gjitha veprimet e Drejtoris, ushtron funksionet e mbikqyrjes mbi të gjitha shkollat fillore dhe mbi të gjitha institucionet parashkollore e ndihmuese dhe disponon inspektimet e hetimet mbi to.

Janë kompetenca të posaçme të Drejtoris s'Arsimit Fillor:

1) Çashtjet e përgjithshme mbi shkollat fillore dhe mbi institucjonet parashkollore e ndihmuese të tyne, 2) lokalet, orendit e mjetet mësimore të shkollave fillore dhe t'institucjoneve parashkollore e ndihmuese, 3) të gjitha veprimet që u përkasin

konviktevet të lidhuna me shkolla fillore, 4) mbikëqyrja e bursave të mësimit në shkolla fillore, 5) gjendja juridike dhe ekonomike e personelit mësimuer e jo mesimuer t'arsimit filluer, 6) të gjitha veprimet që u përkasin inspektorive t'arsimit, 7) veprimet që kanë lidhje me detyrshmënin shkollore, 8) veprat plotsuese të arsimit filluer, 9) kurset për të rritun dhe përhapja e arsimit në popull, 10) zavendësit n' arsimin filluer, 11) caktimi i qarqeve t'inspektimit të shkollave fillore, 12) shqyrtimi i raporteve finale mbi shkollat foshnjore e fillore, 13) përpilimi i listës së mësuesvet t'aftë për zyra ma të nalta.

Neni 6.

Shef Seksjonet ndihmojnë respektivisht Drejtorit e arsimit Mesëm e Filluer mbrenda detyrave të caktueme në nenet 4 e 5 të kësaj Ligje.

Kryesekretari veç detyrave të caktueme me Rregullore, ngarkohet edhe me mbajtjen e letër-shkrëmbimit rezervat.

Neni 7.

Komisioni Teknik asht nën mvarjen e drejtë për drejtë të Ministris, mbildhet në mbledhje të përgjithshme çdo herë që e shef të nevojshme, kryen inspektimet dhe hetimet mbi shkolla të çdo lloji e shkalle dhe noponon masat e duhuna si mbas përfundimeve të tyne.

Janë kompetenca të posaçme të Komisionit Teknik:

1) botimi i teksteve shkollore të Shtetit për shkollat fillore;

2) kontrollimi mbi botimet e mbi zgjedhjen e teksteve shkollore për shkolla fillore e të mesme të çdo lloji e shkalle, 3) kontrollimi mbi botimet edukative e mbi letrsin fëminore, 4) botimi i revistës pedagogjike të Ministris, 5) shqyrtimi dhe pëlqimi i dorshkrimeve per tekste shkollore e për botime edukative të paraqituna prej arsimtarësh, 6) përpilimi ose përkthimi prej njuhësh të huaja tekstesh shkollore 7) përpilimi i programave shkollore, 8) studimi mbi ndryshime ligjesh e Rregulloresh shkollore, 9) inspektimet e ngarkueme prej Ministris mbi të gjitha shkollat e mbi gjithë personelin e Administratave të mvaruna prej administratës Qendrore, 10) formimi e kontrollimi i bibliotekave të shkollave të mesme e të bibliotekave të vogla të shkollave fillore.

Pirateimi i kompetencave midis të tre Anëtarëve të Komisjonit Teknik dhe modalitetet mbi kryemjen e inspektimeve dhe të hetimeve disiplinohen prej një rregulloreje të mbrendshme.

Neni 8.

Ministrija kur e shef të nevojshme me rastin e përpilimit ose të përkthimit ose të shqyrtimit të dorëshkrimeve të teksteve shkollore të ndryshme mund të thërrasi përkohësisht për të marrë pjesë në Komision mësues e teknikë të specializuem të shkollave të çdo lloji shkalle.

Neni 9.

Ministri, Sekretari i Përgjithshëm, të tre Drejtorët Kryetarë shërbimi dhe nji anëtarë i Komisjonit Teknik formojnë Këshillin Qendruer të Ministris s' Arsimit. Këshilli Qendruer asht organ deliberativ. Ministri asht Kryetari i Këshillit dhe e mbledh këtë çdo herë që e gjen të nevojshme. Antari i Komisjonit Teknik zgjidhet prej Ministrit herë pas here si mbas urdhnit të dikës në çdo mbledhjeje.

Janë kompetenca të Këshillit Qendruer:

1) përpilimi i ligjeve dhe i rregulloreve, 2) emnimet, shpërngulljet, ndeshkimet disiplinore dhe shpagrimet prej shërbimit të personelit të mvarun prej Ministris, 3) çelja e mbyllja e shkollave të çdo lloji e shkalle dhe e konvikteve, 4) dhanja e e premja e bursave të mbrendëshme e të jashtme, 5) projektet e reformave administrative e shkollore, 6) buxheti i përgjithshëm i Ministris, 7) studimi e zbatimi i mjeteve ma të përshtatshme për mbërritjen e qëllimeve që ndjek Ministrija, 8) caktimi i shpërblimit të përkthimevet, të konkurseve për autorët e libravet.

Neni 10.

Ministrija ka të drejtë t'a sistemojë pa konkurs në vendet e parapame në nenin 1 të kësaj ligje personelin drejtues e zbatues që gjendet në kuadrin e Administratës Qendrore si mbas detyrave të ushtrueme deri sot prej secilit nëpunës.

## Dispozita transitore

Neni 11.

Deri sa mos disponohet ndryshe kompetencat e Drejtoris për Edukatën Kombtare „Djelmënija Shqiptare" mbetem ato të parapame në Dekret-



Ligjës organike të Ministris s' Arsimit me datën 28 Shkurt 1934.

Neni 12.

Deri në aprovimin e Ligjës mbi reformën e shkollës së mesme, personeli i Bibliotekëve dhe i Muzeve Kombtare do të mbetet në kuadret organike t' administratës Qendrore të Ministris.

Neni 13.

Ministrija e Arsimit ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Neni 14.

Çdo dispozitë ligjore që vjen në kundërshtim me dispozitat e kësaj ligje mbetet pa fuqi.

Neni 15.

Kjo ligjë hynë në fuqi me datën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.

Mbreti i Shqiptarëve

D E K R E T O N

Aprovimin e zbatimin e Ligjës mbi rregullimin e zyrave të Administratës Qendrore të Ministris s' Arsimit dhe mbi krijimin e Komisjonit Teknik, i votuem prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 400/I datë 14. III. 1938 të Kryesis së tij.

Z O G. d. v.

K r y e m i n i s t r i:
K. Kotta d. v.

Ministri i Arsimit:
Fejzi Shatku d. v.

Ligj mbi rregullimin e zyrave të administratës qendrore të Ministrisë së Arsimit
*Fletore Zyrtare, 11 prill 1938*



# KONKURS

## për vendin vakant të Kryesekretarit të Këshillit të Shtetit

Për vendin vakant të Kryesekretarit të Këshillit të Shtetit hapet konkursi me këto kondita:

1. Kandidatët duhet të paraqesin në Këshillin e Shtetit:

a) Diplomën origjinale të mesimeve të kryeme në fakultetin e Drejtësis, bashkë me përkthimin shqip të vertetueme si mbas dispozitave ligjore në Ministrin e Arsimit;

b) dishmin mbi kryemjen e shërbimit ushtarak ose të lirimit nga ky sherbim;

c) në qoftë se nuk janë në sherbim të Shtetit, dishmin mbi sjelljet, të leshueme nga autoritetet kompetente të shumtën 1 muaj para shpalljes së kejij konkursi;

ç) në qoftë se janë ne sherbim të Shtetit, dishmin e Dikasterit perkates mbi nënpunësin që mbajnë;

d) në qoftë se nuk janë ne sherbim të Shtetit, dokumentin ose dokumentat prej cilëve të shifet sherbimi shtetnuer i mâ parshem dhe arsyeja e largimit prej kejij.

Kerkesa, e shkrueme me dorë nga vetë kandidati, bashkë me dokumentat e treguem, duhet të jetë në Kshillin e Shtetit deri më 12 Nandurr 1938.

Nuk merren parasysh:

a) kerkesat që mrrijnë mbas datës 12 Nandorr;

b) kerkesat që nuk do të jenë të përcjellune prej dokumentave të sipër-treguem, pa përjashtime;

c) kerkesat e atyne që nuk jane ose nuk janë kênë në sherbim të Shtetit.

2. Me 14 Nandorr, n' orën 9 p. d. kandidatët do të paraqiten personalisht në Keshillin e Shtetit, ku, perpara nji komisioni të veçantë, do t' i shtrohen nji provimi me shkrim në njenën nga këto gjuhë: anglisht, frangjisht, gjermanisht, italisht; përveç tij, per t' u zhvillue në njênën nga gjuhët e permendura si edhe në gjuhen shqipe, do të jetë mbi nji problem juridik.

3. Kroga janë e caktueme me nenin 18 të ligjes mbi organizimin e Keshillit të Shtetit.

Nga Keshilli i Shtetit.

Shpallje konkursi për vend vakant
*Fletore Zyrtare, 24 tetor 1938*



SHPALLJE KONKURSI

për katër atashe në Ministrin e P. të Jashtme

1. Në Ministrij të P. të Jashtme çelet konkurs për katër vende për atashe, me rrogë mujore 200 fr.ari nominal.

2. Kandidatët, në bazë të nenit 31 dhe 32 të Ligjes Organike të Ministris së P. të Jashtme, duhet të paraqesin në Sekretarin e Pergjithëshme të saj, mbrenda 15 ditëve prej datës së shpalljes në fletoren zyrtare, bashkë me lutjen perkatëse, edhe dokumentat që vijojnë :

a) Letër-njoftim ose vertetesë nenshtetsije shqiptare ;

b) Leter-lirim nga sherbimi ushtarak ;

c) Vertetesë mirë-sjelljeje të lëshuar nga Prokurorija e Shtetit të Kryeqytetit ose të vend-banimit të tij ;

d) Diplomen në origjinal, nga e cila të rezultojë kryemja e një Fakulteti Drejtësije ose të një Shkolle të Naltë Shkencash Politike ose të një Shkolle të Naltë Tregtare.

Shpallje konkursi për katër atashe në Ministrinë e Punëve të Jashtme
*Fletore Zyrtare, nr.70, Viti XVII, 13 shtator 1938*

Mbretnija Shqiptare
Prefektura e Gjinokastres
Nr. 2870/3

Gjinokastre, me 31/10/31

312

351

P.T.
Ministries P. te Mbrendeshme
Sekret. Pergjithesshme
Tiranë

Mbi[illegible]:
Pergjitje jeteshkrime.

Me lidhje me urdhenin Nr. 7731 ... d. ... 3/10/31.

Ketu ngjitur, kemi nderin t'Ju pergjigjim dy copa jeteshkrime bashke me dokumentat relative, njera e Z. [illegible] Krye[illegible]'i Komunes Qendres Permetit dhe tjetera e [illegible] Sekretar'i Komunes [illegible] qe na jane percjelle me shkresat Nr. 4871/I dhe e Nr. 4871/II d. 26/X/31, te N/Prefektures Permetit.

[illegible] se, nga keto, ajo e [illegible] nuk pershkruan ne letre ordinare [illegible] pjesa [illegible] te [illegible], me gjithe qe ky [illegible] ka deklaruar vete jeteshkrimin e ka [illegible] qysh ne vitin 1922, [illegible] kohe me te cilen i [illegible] dhe [illegible] e [illegible] nga ajo P.T. Ministria.

1396 4

Prefekti

Ministria e P. te Mbrendeshme
Drejtoria e Korrespondences
9124 Nr. 7731/II

Tirane, me 9/XI/31

P. T.
Kryeministriq
(jeteshkrimit)
Tirane

Per t'u marre shenim keto siper kemi nderin te trasmetojme shkresen dublikate te Prefektures Gjinokastres.

9 XI 1931

MINISTRI I P. TE MBRENDSHME:

AQSH F. V. D.



Model jetëshkrimi

(15)

Kopje e dokumentave qe permbajne jeteshkrimin mbi
sherbimet ne punesira qeveritare te Sekretarit Atundarie Kolcyres
Z. Aziz Elmazit.

ZYRA E VETEDASHESVE TE AMERIKES
KORÇE

Nr. 35

CERTIFIKATE NDERI

Z. Aziz Elmas i shtytun nga ndjenja patriotike mori pjese ne garden Civile te organizuar ne Amerike,,dhe erdhi t'i sherbeje Atdheut si vullnetar. Ne nje periudhe prej kater muajsh tregoj bindje, disipline dhe atdhedashuri te shquar duke sherbyer ne kufine Shqipetaro Greke, si edhe ne çdo pune qe urdhenohej prej Gvernies dhe prej Komandes.

Ne periudhen e [illegible] te sherbimit me tij nuk mori [illegible] nje denim dhe [illegible] [illegible] trupit [illegible] [illegible] nje tjeter per veç shpenzimit dhe bindje te plote [illegible] [illegible] si deftim sherbimi me sjellje, disi[illegible]

Kjo certifikate [illegible] i jepet [illegible] Kudo pra qe te paraqitet jane te lutun [illegible] dhe atdhe dashje te shquar. [illegible] ndihmen dhe perkrahjen e duhun. [illegible] e Qeverise Shqiptare [illegible]

Komandant i trupit Vullnetar
Kapiten
Aqif I. Permeti d.v.

Korçe Gusht 4/1920

Kopje Dekreti

Tirane 23/10/920

Ministria e P. Mbrendeshme
Nr. 7316

D E K R E T

Zotni Aziz Elmas Permeti
Zotnia e juaj [illegible] nepunesi i Zyres se Shtetit civil ne Kolcyre se proge majore qe i perket asaj Nenprefekturie [illegible] prej juej drejtesije, energji dhe bindesi te plote ne [illegible] ligje.

Ministri i P. te Mbrendeshme
A. Zogu d.v.

Kopje Certifikate

Librazhd me 28/6/924

SHTETI SHQYPETAR
Nenprefektura e Librazhdit

Keshilli Administratore
Nr. 75

C E R T I F I K A T E :

Keshilli administrator nep kete certifikate, me te [illegible] tregon se Z. Aziz Elmazi qe transferohet Sekretar i Shtetit Civil ne Tepelene ka sherbyer ne kete Ofiq te Nenprefektures e Librazhdit qysh nga data 21/IV/921. e deri me 28/6/1924 me rrogen majore te caktuem me buxhet 150. Ne kohen e sherbimit tij eshte sjelle e diftue [illegible] dhe ka [illegible] sjellje te mira qe i [illegible] nje nepunesi.

Kryetar i Keshillit
Z.V. Nenprefekti
M. Kothere d.v.

Antar
Z.V. Sait Elmas.
Myfti Myslim

Antar
Z. N. Keys.
Nenp. Finan.
Bedri Bej[illegible].

Antar
Gj. Pepymes
Sh. Kokoza d.v.

Z.V. Sekretar i
Nenprefektures
A. Sorapulli d.v.

Ministri e P. Mbrendeshme
Seks. III
Shkurtim
Mbi disa transferime

Tirane 23/7/924
Prefektures Gjinokaster

Ju njoftohet se Z. Ali Kuta, Zevendes Sekretar i Shtetit Civil te Tepelenes, transferohet si Sekretar i Shtetit Civil ne Gjinokaster, dhe ne vend te tij ne Tepelene emnohet Z. Azis Elmazi, Zevendes Sekretar i Shtetit Civil te Librazhdit. Dekretat ju dergohen ngjitazi per me ja u dorzue te emertuemve, me te njajtat [illegible] dates e fillimit ne pune.

Ministri i P. Mbrendeshme
Shala d.v.

Ministri e P. Mbrendeshme
Nr. 519

Prefektures
BERATIT

Per dije e veprim lajmeroni qe Z. Asllan [illegible] [illegible] Librazhd, ku transferohet si zevendes Sekretar i Shtetit Civil te asaj Nenprefekture.

Ministri i P. Mbrendeshme
Shala d.v.

Prefektures
ELBASAN

Per njoftim e veprim.

Ministri i P. Mbrendeshme
Shala d.v.

Prefektura e Elbasanit
Nr. 2631.

Elbasan me 5/8/924

Nenprefektures
LIBRAZHD

Per dije e veprim ngjitazi ju dergohet Dekreti i Z. Azis Elmazit, mbi transferimin e tij si Sekretar i Shtetit Civil, ne Tepelene.

Z.V. Prefekti
Kapitan
A. Koprencka d.v.

Nenprefektura e Librazhdit
Nr. 352

Librazhd 28/8/924

Z. Azis Elmazit
Sekretarit Shtetit Civil Ketu:

Ngjitazi ju dergoj per dije e veprim Dekretin qe urdhenon transferimin tuej per ne Nenprefekturen e Tepelenes tue me lajmrue [illegible] datën e nisjes.

Z.V. Nenprefekti
M. Kotheri d.v.

Nenprefektura e Tepelenes
Nr. 1760/I

Tepelene 29/12/924

Shtetit Civil
K E T U

Per njoftim e veprim ju komunikojme urdhenin e Prefektures Gjinokastres Nr. 4462/I date 29/12/924 ne baze te urdhenit te Perfaqesuesit te Komandes P. te Operacionit ju njoftohet se Sekretari i Shtetit Civil i kesaj Nenprefekture Zotni Azis Elmazi pushohet dhe ne vend te tij emnohet Z. Hajri Lago i cili fillohet ne pune dhe na lajmeroni. Dekreti relativ ju dergohet me von.

Z.V. Nenprefekti
Sh. Sadulla d.v.



Kopje dokumentesh që përmbajnë emërime në pozicione publike
*Arkivi Qendror i Shtetit*



KONCEPT 92

VDEKJE FASHIZMIT – LIRI POPULLIT

QEVERIA DEMOKRATIKE E SHQIPNIS

KRYEMINISTRIJA

Drejtorija e Personelit

Tiranë, më 9/3/1945

-QARKORE.-

Gjithë Ministrive.

Mbas luftës së përgjakshme që pati si rezultat çlirimin e plotë të vendit, një luftë e re e madhe i imponohesh popullit : ajo e rindërtimit. Rindërtimi e vendit kërkon po ashtu vendosje, disiplinë dhe vullnet pune. Gjithshka duhet përtri. Edhe aparati Shtetnor i ri duhet ndërtue në themele të reja, të shëndosha, me funksion të vërtetë të një aparati në shërbim të popullit. Për këtë duhet punë dhe njëkohësisht dhe një ndërrim të mentalitetit të vjetër të nëpunsit. Koncepti vjetër i nëpunsit Shtetnor që punonte sa për të siguruar rrogën duhet të zëvendësohet me atë të vetëdijes së punës, të jemi koshient se i shërbejmë aparatit t'onë të popullit, pjesë të pandarë të të cilit jemi dhe jo një aparati të huaj si më parë. Duhet t'i kushtohemi pra punës, të punojmë edhe mbas orarit, të punojmë për t'i kryer punët dhe të mos i lejojmë punët për nesër kurse ka mundësi të kryhen brenda ditës po të rrimë gjysëm ore më tepër në detyrë. Të punojmë me rithmin partizan, me vrullin e dinamizmin e lëvizjes së popullit për të punë dhe në rindërtimin fitoren, që po tjetër nuk do mungojë, [illegible] patën në fushën e luftës me armë.

Me gjithë se në përgjithësi nëpunsit e thirrun në shërbim kanë qenë në naltësin e besimit që i dha populli në veprën e madhe të rindërtimit të ndërmarrë nga Qeverija Demokratike dhe për këtë dëshmojnë rezultatet e arritura në [illegible] edhe me ndërtime rekord si ato të Ministrisë P. Botore etj., konstatohet se një pjesë e nëpunsave i ka dehun fitorja dhe nuk po vendosin me të njajtin entusiazëm të ditëve të para.-

Të kohët e fundit shihet një braktisje e zyrave për t'ndenjur në Gjyqin e Popullit për kriminelët e luftës, largim nga zyrat mbrenda orarit të punës, kërkesa për leje etj.

Sot më tepër se kurrë na imponohet se punë sa më tepër. Prandaj të porositen të gjithë nëpunsit të respektojnë përpiktësisht orarin të mos largohen nga zyrat kur t'iu takojë po të kërkojnë leje nga Drejtorat e Personelit të cilët do t'i autorizojnë kur punët t'urgjohen dhe për të cilët janë përgjegjës, të kufizojnë frekuentimin e gjyqit dhe biletat e hyrjes t'ia japin më shumë popullit dhe lejet e gjata t'u japin vetëm për raste me karakter të rëndësishëm dhe urgjent.-

Të porositen gjithashtu gjithë nëpunsit që të kenë kujdes në përdorimin e pasurisë Shtetnore, të kenë koshiencë se asht pronë e popullit dhe pra të dinë t'a ruajnë dhe t'a harxhojnë për interesat e tij.-

Të kemi ndërgjegjen e nëpunsit të pushtetit të ri të popullit i krijuar për t'i shërbyem popullit.-

K R Y E M I N I S T R I :

Qarkore mbi funksionin e Drejtorisë së Personelit, 1945

*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 298, f. 1*



KONCEPT V. F. - L. P. 121

QEVERIA DEMOKRATIKE E SHQIPNIS
KRYEMINISTRIJA
Drejtorija e Personelit

Tiranë, më 17 - 3 - 1945

-. Q A R K O R E .-
Gjithë Ministrive.

T i r a n ë.

Nga sa referon Komisioni për Shqyrtimin e problemit të nëpunësve formue pranë Kryeministris, konstatohet se nuk asht kuptue mirë në disa Dikastere funksioni dhe randësia e Drejtorisë së Personelit që ka çdo Ministri. Në disa raste Drejtori i Personelit asht konfondue me nëpunsin e biografis d.m.th. më një regjistrues të emnimeve të nëpunësve ka nga Ministria sipas propozimeve të nërgjegjëse që Sekcionet ose Drejtoritë e Ministrisë bajnë.-

Vetë fakti që Zyrat e Personelit janë Drejtori tregon se sa randësi kanë në ndërtimin e aparatit të ri Shtetnor. Janë Drejtorat e personelit përgjegjëse para Ministrit dhe në përgjithësi para Shtetit për vijën e shëndoshë që duhet ndjekur në rekrutimin e nëpunësve. Janë këta që do t'i njohin s'afërmi gjithë nëpunsat e dikasterit tyre: në punë, në jetën e tyre të përditshme, t'i njofin vlerën e tyre personale, karakterin e tyre dhe garancinë që japin për Pushtetin e Popullit, si shërbyes të këtij.-

Prandaj e shofim të nevojshme të kujtojmë se propozimet për emnim ka Ministri duhet t'i paraqesi Drejtori i Personelit që do të kontrafirmojë konceptin e çdo emnimi si përgjegjës direkt para Ministrit i cili vendos mbi emnimin. Mënkuptohet se Drejtori Personelit nuk mund të propozojë nga koka e tijë, po për çdo emnim do të konsultohet me Drejtorin perkatës të degës ku do të shërbejë ay nëpunës, pse nga pikpamja teknike janë këta ma në gjendje që t'i njohin nëpunsat.-

Ky përcaktim përgjegjësie nuk duhet të jetë shkak, përkundrazi, po përkundrazi një lidhje më e ngushtë me Drejtoritë tjera të Dikasterit për forcimin e kollaboracionit në mes nëpunsave.-

K R Y E M I N I S T R I :

Qarkore mbi funksionin e Drejtorisë së Personelit, 1945
*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 298, f. 2*


DAP



KËSHILLI MINISTERIAL

VENDIM

№ 1 më 11 Kallndor 1945.-

Këshilli Ministerial, në mbledhjen e mbajtur më 11 Kallndor 1945,

Vendosi:

me i propozue Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar sa vijon:

I.- Suprimimin e Ministrisë së Rindërtimit.

II.- Krijimin e Ministrisë së Asistencës Sociale.

III.- Emërimin për Ministër i Asistencës Sociale, Shokun Gjeneral-Major BEDRI SPAHIU.

IV.- Krijimin e Këshillit Ekonomik, ku do të bëjnë pjesë titullarët e këtyre Dikasterëve: Ministri i Ekonomisë, Ministri i Punve Botore, Ministri i Asistencës Sociale dhe Ministri i Financavet.

V.- Formimin e Komisionit të pllanit, që do të pregatisë - nga pikpamja teknike - Projektet e Dikasterëve të ndryshëm.

VI.- Krijimin e Drejtorisë së Statistikës pranë Kryeministrisë dhe formimin, pranë Dikasterëve, të seksioneve të Statistikës si edhe në çdo nënprefekturë nga një përgjegjës për Statistikë.

VII.- Krijimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Pyjeve.

VIII.- Emërimin për Ministër të Arsimit Shokun KOSTAQ CIPO, në vend të Shokut Prof. GJERGJ KOKOSHI.

Ministri i P. të Jashtme: (Dr. Omer Nishani d.v.)

Nën-Kryeministri: (Myslim Peza d.v.)

KRYEMINISTRI: dhe Ministri i Luftës e i Mbrojtjes Kombëtare: (Enver Hoxha d.v.)

Ministri i Ekonomisë: (Dr. Medar Shtylla d.v.)

Ministri i Drejtësisë: (Manol Konomi d.v.)

Ministri i P. të Mbrendëshme: (Haxhi Lleshi d.v.)

Ministri i Shëndetësisë: (Dr. Ymer Dishnica d.v.)

Ministri i P. Botore: (Ing. Spiro Koleka d.v.)

Ministri i Financavet: (Ramadan Çitaku d.v.)

Ministri i Rindërtimit: (Bedri Spahiu d.v.)

Ministri i Shtypit, Propagandës dhe Kulturës Popullore: (Prof. Sejfullah Malëshova d.v.)

Asht njï me origjinalin:
Sekretari i Përgjithshëm i Kryesis së Këshillit Ministerial:
(Algi Kondi d.v.)

Vendim i Këshillit Ministerial, 1945
*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 74, viti 1945, f. 1*

KONCEPT

QEVERIA DEMOKRATIKE E SHQIPNIS

KRYEMINISTRIJA

T.F. - L.P.
12.I.1945.

Tiranë, më

KRYESIS SË KËSHILLIT ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR

Tiranë

Bashkëlidhur Ju dërgojmë, për aprovim, kopjen e Vendimit të Këshillit Ministerial Nr.1 datë 11.I.1945, si edhe Projekt-Ligjet: 1) Mbi tatimin e jashtëzakonshëm të fitimeve të luftës; 2) Mbi konfiskimin e pasurive që ndodhen në Shqipëri të Shteteve Italian dhe Gjerman dhe mbi marrjen në kontroll të pasurive të shtetasve të tyre; 3) Mbi anulimin e koncesionit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe t'aksioneve të saj; dhe 4) Mbi caktimin e tarifave të taksave të regjistrimit t'autoqjeteve dhe lëshimit të lejeve shoferi; dhe 5) Mbi shtrirjen e qiravet bujqësore.

KRYEMINISTRI

Model Shkrese nga Kryeministria 1945

*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 74, viti 1945, f. 2*



QEVERIA DEMOKRATIKE E SHQIPNIS

MINISTRI E FINANCAVET

Tiranë, më 5-5- 1945

Nr. 6 Kon.

KRYEMINISTRIS.

TIRANË.

Këtu ngjitur ju përcjellim nga tre copë fashikuj të ligjeve :

1.- Mbi tatimin e jashtëzakonshëm të fitimeve të luftes.

2.- Mbi konfiskimin e pasurive që ndodhen në Shqipni të Shteteve Italian dhe Gjerman dhe mbi marrjen në kontroll të pasurive të shtetasve të tyre.

3.- Mbi anullimin e koncesionit të Bankës Kombëtare të Shqipenis dhe t'aksioneve të saj.

Lutemi që t'i paraqiten Keshillit Anti-Fashist për aprovimin përkatës.

Ministri i Financave,
( Ramadan Çitaku.)

Model shkrese i Ministrisë së Financave 1945

*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 74, viti 1945, f. 3*



KËSHILLI MINISTERIAL

VENDIM

№ 10 — 26 Prill 1945.-

Këshilli Ministerial në mbledhjen e mbajtur më datë 26 Prill 1945,

Vendosi:

me i paraqitë Kryesis së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar për ligjo-rim Projekt-Ligjët e posht-shënuar, të provuar në këtë mbledhje, dhe që janë:

1) Projekt-Ligja mbi Organizimin e përkohëshëm gjyqësor;

2) Projekt-Ligja mbi abrogimin e dispozitave ligjore të promulgu-ame gjatë okupacionit të huaj, mbi pa-vlefshmërin e vendimeve penale të dha-në gjatë asaj kohe prej autoriteteve ushtarake dhe mbi vleftën e dispozitave ligjore q'ishin në fuqi para datës 7 Prill 1939;

3) Projekt-Ligja mbi zgjedhjen e gjyqtarve popullorë;

4) Projekt-Ligja mbi disa dispozita në lëndë pensioni;

5) Projekt-Ligja mbi abrogimin e rrogave jetike.-

6) Projekt-Ligja mbi taksimin e alkoolit, të pijeve alkoolike dhe të birrës; e

7) Projekt-Ligja mbi vijat e ujit.-

8) Projekt-Ligja mbi t'ardhunat e Këshillave N.Ç.të N/Prefekturave

Ministri i Punve të Jashtme: Dr.Omer Nishani d.v.

Zëv/Kryeministri: Gjeneral-Major Myslim Peza d.v.

KRYEMINISTRI dhe Ministri i Luftës e i Mbrojtjes Kombëtare: Gjeneral-Kolonel Enver Hoxha d.v.

Ministri i Ekonomis: Dr.Medar Shtylla d.v.

Ministri i Drejtësis: Manol Konomi d.v.

Ministri i Punve të Mbrendëshme: Kolonel Haxhi Lleshi d.v.

Ministri i Shëndetsis: Dr.Ymer Dishnica d.v.

Ministri i Punve Botore: Ing.Spiro Koleka d.v.

Ministri i Financevet: Kolonel Ramadan Çitaku d.v.

Ministri i Arsimit: Prof.Kostaq Cipo d.v.

Ministri i Shtypit, Propagandës dhe Kulturës Popullore: Prof.Sejfulla Malëshova d.v.

Ministri i Asistencës Sociale: Gjeneral-Major Bedri Spahiu d.v.

V. Sekretari i Përgjithshëm: Mihal Prifti d.v.

Asht njï me origjinalin
Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrisë:

Vendim i Këshillit Ministerial 1945
*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 74, viti 1945, f. 5*



KËSHILLI MINISTERIAL

VENDIM

№ 75 më 23 Qershor 1945.-

Këshilli Ministerial në mbledhjen e mbajtur në datë 23.6.1945,

**Vendosi:**

aprovimin e të Projekt-Ligjëve, Projekt-Rregulloreve, Projekt-Vendimeve dhe Projekt-Statuteve të treguame në listën e bashkëngjitun këtij Vendimi, të cilët do t'i paraqiten Kryesis së K.A.N.Ç. për ligjorim.-

Ministri i Punve të Jashtme: Omer Nishani d.v.

Nën-Kryeministri: Gjeneral-Major Myslim Peza d.v.

KRYEMINISTRI dhe Ministri i Luftës e i Mbrojtjes Kombëtare: Gjeneral-Kolonel Enver Hoxha d.v.

Ministri i Ekonomis: Dr. Medar Shtylla d.v.

Ministri i Drejtësisë: Manol Konomi d.v.

Ministri i Punve të Mbrendëshme: Kolonel Haxhi Lleshi d.v.

Ministri i Shëndetsis: Dr. Ymer Dishnica d.v.

Ministri i Punve Botore: Ing. Spiro Koleka d.v.

Ministri i Financavet: Kolonel Ramadan Çitaku d.v.

Ministri i Arsimit: Prof. Kostaq Cipo d.v.

Ministri i Shtypit, Propagandës dhe Kulturës Popullore: Prof. Sejfulla Malëshova d.v.

Ministri i Asistencës Sociale: Gjeneral-Major Bedri Spahiu d.v.

Sekretari i Përgjithshëm: Mihal Prifti d.v.

Asht një me origjinalin
Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministris
(Mihal Prifti)

Vendim i Këshillit Ministerial,
*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 74, viti 1945, f. 6*

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA.....

Nr. 231 Res

T.P. I.P.
Tiranë,më ... 

## QARKORE

Ka filluar të organizohet më mirë puna n'aparatin t'çdo Dikasteri dhe përgjegjët për këtë gjë,që përgjithësisht bëhen të vendosura,porse akoma ka të meta.

### I.- MBLEDHJET E KËSHILLAVE TË DIKASTEREVE

Këshillat e punës në Dikastere janë forma të mira për një punë t'organizuar dhe të shëndoshë kolektive kur shihen problemet e rëndësishme të çdo sektori pune,ç'këmbehet eksperienca dhe dilet me konkluzione.

Mbledhjet e Këshillave të Dikastereve gjer më sot janë bërë në përgjithësi dhe janë rrahur problemet e çdo Dikasteri.Mirëpo nuk ka patur një rregull në lidhje me kohën dhe me pregatitjen e këtyre mbledhjeve.Disa i kanë bërë mbledhjet në fillim të muajit dhe disa nga mesi i muajit si në Shëndetësi. [illegible], për të shqyrtuar rezultatet e punës të muajit të kaluar.Ka edhe raste që s'janë bërë çdo muaj p.sh. M. e Tregëtis. Që të kenë efekt dhe të shërbejnë për muajin e ardhshëm këto mbledhje, duhet të kenë marrë fund gjer më datën 5 të çdo muaji.Asgjë nuk duhet të pengojë këtë mbledhje.Problemet që do të shtrohen të jenë pregatitur,të shqyrtohen dhe të nxirren rezultatet për çdo sektor pune.

Për këtë mbledhje duhet të ketë një rend dite të pregatitur nga lart më parë.Rendi i ditës duhet të ketë probleme kryesore që dalin nga të gjithë sektorët e punës dhe rreth këtyre të zhvillohen diskutime nga të gjithë përgjegjësit e sektoreve të ndryshëm dhe të dalet me konkluzione,të shkëmbehen eksperienca dhe të arrihet në përfundime konkrete.Dita e mbledhjes dhe rendi i ditës të jenë bërë të ditur në mënyrë që pjesëtarët e Këshillit të bëjnë pregatitjet e duhura dhe të mos ndodhij si në Ministrin e Bujqësisë dhe të Shëndetësisë që lajmërimi bëhet në mëngjesin e asaj dite që do të bëhej mbledhja.

Pregatitja e një rendi dite të studjuar mirë me problemet më të rëndësishme do t'i [illegible] që mbledhjet e Këshillit të Dikasterit të marrin një formë [illegible] nga përgjegjësat e çdo sektori pune,të bëhen përsëritje të kota, të [illegible] për ditë të tëra siç ka ndodhur në Ministrin e Financavet dhe të Tregëtisë.Atje ku ka patur një pregatitje të mirë si në M. e Industrisë dhe Kooperativa puna ka dhënë rezultate të mirë dhe brenda një kohe relativisht të shkurtër 3-4 orësh.

### II.- [illegible]

Kemi shumë raste që problemet nuk studjohen mirë; nuk shikohen nga të gjithë anët,por përciptazi dhe për këtë arsye në disa sektorë kemi mjaft të meta.

./...

Kur problemet nuk shtrohen drejtë dhe nuk studjohen mirë, rigorisht që nuk dilet me konkluzione dhe vendime të sakta, dhe si konsekuencë udhëzimet që dërgohen poshtë me shkrim s'janë në gjëndje të zgjidhin. Ministrija e Industrisë përgatiti plan të gabuar dhe pa u kontrolluar u dërgua për zbatim poshtë. P.N. e Tregtis detyrohet t'a korrigjojë disa herë Urdhëresën për grumbullimin e leshit.

Instituti i shkencave bën kërkesë për shtesë fondi mbasi rezultoi që ai të kishte tepricë një gjë e tillë ka ndodhur edhe me shërbimin e Kështu që ka bërë kërkesë Ministria Botores pa patur nevojë.

## III.- ELEMENTAT QË DËRGOHEN PËR KONTROLL

Puna operative në shumë Dikastere në lidhje me shkuarjen e elementëve poshtë nuk është kuptuar drejtë. Shumë elementë që shkojnë poshtë nuk janë të përgatitur mirë dhe nuk i japin ndihmë e dobi organeve të Pushtetit lokal dhe t'administratës, dhe në disa raste i ngatërrojnë punët. Kjo është tepruar kaq shumë sa që Komitetet Ekzekutive bëjnë ankesa të një-pas-njëshme me të delegatët e Dikastereve. Të delegatët shkojnë të pa përgatitur dhe kufizohen në lëvizjen e qarkoreve dhe japin mendime të thata pa u bërë një analizë të mirë problemeve kryesore, pa shkëmbim të mendimeve dhe pa një bashkëpunim të shëndoshë ku të japet ndihma efikase dhe të bëhet shkëmbim eksperiencë.

Pika të deleguar nga Ministrija e Shëndetësisë dhe e Drejtësisë nga mungesa e një përgatitje të shëndoshë jo vetëm që nuk kanë ndihmuar por kanë bërë një punë negative dhe për konsekuencë janë çfaqur shenjat e një demobilizimi.

Është e nevojshme që të vihet në përdorim të rregullt libri i shënimeve Inspektorëve, i cili shërben për të kontrolluar se lëshimet gabimet e gjetura në parë dhe korrigjimin e këtyre gabimeve me kohë. Kontrolli duhet të ketë karakterin e një instruksioni dhe bashkëpunimi të fortë që ndihma të ketë efektin e duhur. Elementat që shkojnë poshtë në tonë në dukje të metat që shikojnë atje për një-kohësisht të dalin dhe të metat dhe mungesa e ndihmës së duhur nga lartë, mbasi ka bërë vaki që organet poshtë të deleguarve që u a kanë paraqitur dhe u kanë kërkuar zgjidhjen e disa problemeve prej dhe me anë shkresash dhe telegramesh të përsëritura kanë mbetur udhëzime kaq gjer në punë herë dhe përgjigja ka munguar për një kohë të gjatë.

Kur shkohet poshtë, të lidhet paraprakisht se cila bëhet për çdo gjë ndihmë e Kom.Ekzek. Rregullisht çdo i deleguar që shkon poshtë t'a përfundojë punën me përgjegjësin e sektorit përkatës dhe po të duhen sqarime, të vijë në kontakt me Kryetarin, Sekretarin ose përgjegjësin e tjerë. Duhet patur parasysh se Komitetet Ekzek. janë shumë të ngarkuara me punë, prandaj kontaktet të bëhen me sektorët përkatës, dhe puna të përfundojë shpejt, pa ... në të shkurtër.

## IV. PUNA ME PROGRAM

Që të sistemohet mirë sektori ku punohet dhe t'arrihen rezultate pozitive, duhet që puna të bëhet me plan. Kjo gjë nuk është kuptuar drejt gjersa tani nuk është vënë në praktikë nga Drejtoritë Operative si D.P.SH.A.I. e Qarqeve, Degët dhe Seksionet, si atë të Personelit, të cilat nuk punojnë as me plan mujor as me plan ditor, disa herë përpilohen plane formale duke mos-verifikuar zbatimin e tyre dhe me vonë që planet të jenë i përgatitur mirë me pika të caktuara

./....

3

– 3 –

[illegible]

V. [illegible]

[illegible]

[illegible]

VI. [illegible]

[illegible]

VII. [illegible]

[illegible]

./...


- 4 -

KRYEMINISTRI,

Qarkore për organizimin e punës në aparatin shtetëror Ref.- A.SH.
Fondi Këshilli i Ministrave, Dosja nr. 368, viti 1948, f. 4



Qarkore për disiplinën në punë Ref.- A.SH. Fondi Këshilli i Ministrave, Dosja nr. 366, viti 1948, f. 6



\- 9 -

Zhvillimi dhe drejtimi i kritikës e i autokritikës do të [illegible] nëpërmjet [illegible] do të forcojnë disiplinën në [illegible] përgjegjësit [illegible] duhet t'evitojnë [illegible] kritikën që drejtohet kundra tyre për të mbrojtur [illegible] të lejojnë të kritikohen nga inferiorët [illegible] duhet të bëjnë edhe autokritikë [illegible] shte e nevojshme edhe për vetë zhvillimin e kritikës e t'autokritikës në të gjithë nëpunësit.-

VII.- Duhet të punohet vazhdimisht nga aparati [illegible] nëpunësve detyrat dhe të drejtat e tyre. Detyra dhe të drejtat janë baza kryesore për të pasur një disiplinë të fortë, pse kjo disiplinë do të jetë e ndërgjegjshme, [illegible] me interesin e përgjithshëm dhe me atë të nëpunësit. Nëpunësi duhet të dijë mirë për cilën punë [illegible] dhe të drejtat e tija si nëpunës. [illegible] të gjitha fajet dhe i disiplinuar.-

Për këtë qëllim të rëndësishëm duhet t'i jepet rëndësi popullarizimit të ligjit të nëpunësve (që del së shpejti), i cili duhet të studjohet nga çdo nëpunës.-

VIII.- Por, për të pasur një disiplinë të fortë në [illegible] dhe që punët të kryhen si duhet, duhen marrë edhe masa, këto do t'i detyrojnë dhe do t'i detyrojnë dhe do mësojnë nëpunësit t'ona të disiplinohen.

a) Nga njëra anë, për neglizhencat, [illegible], parregullsitë etj. të mos të merren masat e duhura se një herë dhe për [illegible]. Për fajet [illegible] duhet të merren këto masa ndëshkimore:

Vërejtje verbale
" [illegible] në biografi
" [illegible] në biografi
" [illegible]
[illegible] nga detyra.-

[illegible] duhet patur kujdes që këto masa të merren në vend dhe të zbatohen mirë, pse për ndryshe nuk do të vlejnë për edukimin e nëpunësve, por do të bëjnë efekt të kundërt. [illegible] drejtohen para gjyqit.-

b) Nga ana tjetër, që të kryhen sa më mirë detyrat, që të forcojmë disiplinën dhe që të zhvillojmë emulacionin në një shkallë të gjërë në këtë drejtim nuk duhet që të merren vetëm masa ndëshkimore kundrejt atyre që s'punojnë mirë, por duhet që [illegible] nëpunësve e punëtorëve që punojnë më tepër, që dallohen në punë, t'u jepen shpërblimet e duhura. [illegible] e domosdoshme për zhvillimin e disiplinës, për zhvillimin e emulacionit në punë.-

[illegible] për zhvillimin e emulacionit në këtë drejtim duhet të jenë:
[illegible] (diploma [illegible])
[illegible] nga ana e Ministerit
[illegible] të ndryshme [illegible] e rritit.-
[illegible]

[illegible] edhe masa të tjera si popullarizimi me shtyp i punëtorëve të dalluar etj.

[illegible] ndëshkimore dhe me shpërblimet [illegible] e drejtë që duhet të zbatohet nga nëpunësit dhe krijohen kushte për forcimin e disiplinës.-

IX.- Të gjitha Drejtoritë, Degët, Seksionet dhe zyrat duhet, detyrimisht të dijnë mirë dhe me hollësi kompetencat që u përkasin. Kjo gjë do t'eliminojë konfuzionin, do të bëjë që punët të jenë të caktuara mirë dhe pra të kryhen mirë e me [illegible], por do të kemi më tepër kontrolli në punë dhe të [illegible] disiplinohet. Për këtë arsye, të gjitha zyrat duhet të caktojnë sa më parë dhe drejt kompetencat e tyre [illegible] dhe plotësimet. [illegible] duhet të kemi kujdes që kompetencat t'u caktojnë plotësisht nga njëra anë dhe nga ana tjetër të kemi kujdes që këto të mos bëhen pengesë për zhvillimin e iniciativës në punët e funksionarëve, nuk të gjenden shkak për mos kryerjen e [illegible] punëve [illegible] se nuk në kanë caktuar këtë detyrë në kompetencë.-

Duhet patur kujdes që rregulloret e kompetencave të kanë ndryshimet e nevojshme kur edhe [illegible] deri sa atë të plotësohen definitivisht.-

./.



Qarkore për organizimin e punës në aparatin shtetëror

*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 368, viti 1948, f. 6-11*

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE
K R Y E M I N I S T R I A

Nr....[illegible]... Res.

V.F. L.P.
Tiranë më..12.V.....949

GJITHË MINISTRIVE
GJITHË DREJTORIVE AUTONOME
GJITHË ORGANIZATAVE

Para disa kohe me nji qarkore të posaçme ju kemi njoftuar që çdo korespondencë me shtetet e jashtëme për çfarë do karakteri do t'a kaloni me anën e Ministris P.Jashtëme dhe nuk lejohet n'asnjë mënyrë që të korespondohet direkt, mbasi asht e nevojshme të përdoren rregullat diplomatike.

Me kete rast ju vemë në dijeni edhe për korespondencën që do të bëni me Legatat t'ona dhe sidomos çështjet rezervate asht e nevojshme të kalojnë me korierën diplomatike (me anën e Ministris P. Jashtëme).

Ka pasur raste që asht zhvilluar korespondencë direkt me Legatat t'ona dhe jo vetem kaqë, por zarfat janë shkruar në gjuhën shqip, mbasi dijnë të shkruajnë e të këndojnë gjithë shqipen, si p.sh. Ministria e Tregetisë i bën një letër (shkresë) Legatës Shqiptare për Atasheun Tregetar Budapest Hungari, jo vetem që ja dërgon direkt por e shkruar kaq dhe jo rezervat.

Kjo letër kishte karakter rezervat "udhëzime" se si duhet te punojë Atasheu Tregetar. Posta nuk dinte se ku t'a dorezonte dhe ja dorezoje Ministris P.Jashtëme Hungareze dhe mbasi zarfi ishte çelur gabimisht në këtë rast vihet në pozitë Ministrija e P.Jashtëme Hungareze që t'i shpië Legatës s'onë letrën e hapur dhe të kërkojë ndjesë për gabimin e bërë. Ky gabim nuk asht i vogël.

Prandaj ju vemë në dijeni që të mos ndodhin gabime të tilla, posta duhet të dergohet me anën e Ministris P.Jashtëme, duhet të ketë adresën e plote dhe në gjuhë frëngjisht.

SEKRETAR' I PËRGJITHSHËM:

- - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - -

MINISTRISË SË P.JASHTËME

T I R A N Ë

Për dijeni [illegible] në lidhje me propozimin t'uaj Nr.P/XI 1810/[illegible]

[illegible] I PËRGJITHSHËM :

*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 353, viti 1949, f. 3*



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
K R Y E M I N I S T R I A
Nr. ..342....

V.F. [illegible] 46
Tiranë më 28.IV..49

GJITHË DIKASTERET
GJITHË ADMINISTRATAT E [illegible]
T i r a n ë

Nga ana e kësaj Kryesije është konstatuar që në disa raste akte të ndryshme që i [illegible] për aprovim Këshillit të Ministrave nuk përmbajnë formën e titullarit të [illegible] ose të administratës [illegible].

Prandaj porositemi që këtej e tutje, akte të tilla, që trajtojnë çështje si aprovime [illegible] të pa parashikuara, projekt [illegible] ose projekt [illegible] e të tjera çështje të këtij karakteri dhe që kërkojnë aprovim nga Këshilli Ministerial, duhen të firmohen nga vet titullarë i dikasterit ose i administratës [illegible] për arsyena të ndryshme e të [illegible] akte në pamundësi të kryej një veprim të tillë [illegible] një nga ndihmësit e tij.-

[illegible] KRYEMINISTRIT:

Lidhur me firmosjen e akteve nga titullarët
*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 353, viti 1949, f. 46*

Projekt-Rregullore [illegible] 50

1.Të gjitha Ministritë dhe Administratat qendrore autonome, nga ana e drejtuesave të tyre të kërkohet e të kontrollohet me rigorozitet zbatimi i përpiktë i orarit zyrtarw të punës.

2.Të gjithë ata nënpunës që paraqiten me vonesë në zyrë në mëngjes,lene emrin e tyre tek portjeri i Dikasterit,i cili gjithë listën e bashkë me minutat e vonesës për secilin ja paraqet Kryetarit të Degës Administratës.

3.Kryetari i Degës u referon Shefave të Degëve emrat e nëne punsave të tyre evartës që kanë dalë von në zyre,ndërsa për rastet e mungesës nga vetë Shefat e Degëve,i referon Në/Ministrit ose Ministrit.

4.Nënpunsi që paraqitet në zyrë me vonesë në zyrë,për të parrën here thirret e këshillohet nga Kryetari i Degës prej nga ana ret.Kur vonesën e përsërit për të dytën herë emri i tij shpallet në një vënd të dukshëm të Dikasterit,për të tretën herë i tërhiqet vemendja në mbledhjen plenare të gjithë nënpunsave dhe kur përsërit për të katërtën herë një mungesë të tillë i bëhet verejtje me shënim në biografi,nga ana e Dikasterit.Për rastet më të theksuara se kaq padisiplinia merrën edhe masa më të rënda disiplinore deri përjashtim nga puna.

5.Gjatë orarit zyrtar të punes nuk lejohet të bëhet asnji levizje e kotë nga një zyre në tjetrën.Çdo nënpunës që don të dali jashtë Dikasterit të tij për ndonji punë zyrtare,lajmëron më parë përgjegjësin e tij duke i treguar se ku do vejë,për ç'farë pune dhe afersisht sa do të okupohet me atë punë.

6.Gjatë orarit zyrtar ndalohet çdo takim për punë private ose që s'kanë të bëjnë aspak me natyrën e punes në Dikasterit.

7.Pritja e popullit siç kanë qënë deri tani prej orës 12 e deri 2.30 (ose dhe n'orar tjetër)[illegible].

Kushdo që kërkon të bisedojë për të referuar ankime ose të tjera probleme të lidhura me natyrën e punës zyrtare të Dikasterit ose të një Dikasteri tjetër,duhet të kërkojë të marë orë takimin,me atë që kërkon të bisedojë (vetëm që nga Kryetar Dege e lart lejohet të lënë pikë takime me persona të jashtëm për çështje zyrtare e jo private).

Të gjitha kërkesave me shkrim që i paraqiten Dikasterit nga persona të ndryshëm,u jepet përgjegje zyrtare duke ja drejtuar direkt t'interesuarit ose Komitetit ekzekutiv në juridiksionin e të cilit ay banon që t'a njoftojë.

Nënpunës që vijnë të thirrur nga rrethet për punë të ndryshme zyrtare priten në çdo orë,pse [illegible] orë takimit të lënë me ata me të cilët bisedojnë.Takimet dhe kërkesat të këtyre duhet t'u jepet gjithmonë procedimet që të mos qëndrojnë me ditë të tëra këtu në qënder,duke lënë punën në rrethe.

8.Të praktikohet nga gjithë Dikasteret që takimet për punë me nënpunsa të ndonji [illegible] (si mbledhje të ndryshme, komisione etj.)t'i lënë gjithnji atma orës 10.Lejohet hyrja e nënpun save të jashtëm në një Dikaster vetëm mbasi të jetë marrë pëlqimi i nënëpunsit me të cilin kërkon të bisedojë.

9.Të gjithë nënëpunsit e jashtëm,kur hyjnë pa punë zyrtare në një Dikaster,duhet të lënë tek portieri letër-njoftimin,vendin e e punës ku punojnë dhe me cilin do bisedojnë.

10.Nënpunsit që dalin mbas dite për punë zyrtare,duhet e detyrueshme të paraqesin te portieri(që në katë rast punën e tij do t'a bejë një nga pastruese-shërbyesit)letër-njoftimin.-

./.

- II -

11) Sekreti i Shtetit duhet të ruhet me sigurësi nga të gjithë nëpunësit.Kur nëpunësit dalin nga zyra duhet të bënë mbyllin mirë zyrarët dhe dollapët e akteve.Për çdo heqje aktesh nga pakujdesija janë përgjegjës dhe proçedohen.Kur kanë në dorë e përpunojnë një akt me karakter sekret nuk e mbyllin me sirtarin e vet,por e dorëzojnë në zyrën e Sekretevë(reservato).Të merren sa në mes dreke kur dalin në zyrë i tërheqin përsëri nga zyra sekrete dhe vazhdojnë punën.Zyra Sekrete duhet çdo ditë dhomën e vet dhe dollapët dhe sirtaret që mund t'i ketë t'i mbyllë me dyll.

12) Gjithë grilat e dhomave që ndodhen në katin e parë të mbartomes si dhe ato të zyrës Sekrete kur nëpunësit dalin nga zyrat duhet që t'ulen

13) Përcjellja e akteve për në daktilografi ose nga një nëpunës të tjetër,nuk do bëhet me anë të shërbyesave,por n'orët 8,10 dhe 12 shkon në çdo zyrë një daktilografist dhe i mbledh.Përjashtohen rastet kopër urgjente që mund të çohen në çdo orë.Dërgimin e tyre nga një zyrë në tjetrën kur paraqitet nevoja e bën vetë nëpunësi i interesuar, ose e dërgon të mbyllur në zarfë.

14) Kur mbaron orari zyrtar i punës portieri kontrollon gjithë zyrat në se këta janë mbyllur e siguruar mirë.

15) Të gjithë nëpunësit e një Dikasteri janë të detyruar t'i njoftojnë Dikasterit adresën e tyre(Nr.e shtëpisë,Lagjen ose Rejonin)për t'u gjetur lehtësisht në rast se nevojiten për ndonji punë jashtë orarit

---------

Rregullore për orarin zyrtar

*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 353, Viti 1949, f. 50-51*

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË

MINISTRIA KOMUNIKACJONEVE P.T.T.

(Dega e Pergjithshme)

Nr. 171 Prot.

Tiranë, më 4/5/ 1949

LANDA: Dergohen sugjerime mbi projekt rregulloren e brendeshme.

K R Y E M I N I S T R I S

T I R A N E

Gjegje shkresës t'uaj Nr. 552... date 3/5/49.

Kjo Ministri esht plotsisht dakord qe te vihet me zbatim projekt rregullorja e perpilluar prej asaj Kryesije me perjashtim te pikës 10 per te cilen nuk mendojem se eshte e nevojshme te jete.

Per sa i përket pikës 2,3 dhe 4 nga ana e ketij Dikasteri asht vepruar si vijon:

Per ç'do dite nga ana e portierit mbahet nje liste me emnat e te gjith nepunsave renduer sipas alfabetit. Sejcili nepunës shenon oren e ardhjes. Lejohet ardhja ne Dikaster brenda ores 8 e 5. Mbas kesaj ore asnje nepunes nuk pranohet te hyj me punë njekohesisht asht përgjegjes dhe për pengesën qe shkakton. Perjashtohen rastet kur meret leje. N'oren 8 e 15 te çdo dite lista mbassi kontrollohet nga ana e Kryetarit Deges Administrates i referohet udheheqjes se dikasterit. Nga kjo menyre veprimi çeshtja e respekti-

./.



mit t'orarit zyrtar ka gjetur zgjidhjen e duhur.

P. M I N I S T R I:

Sugjerime për projekt-rregulloren
*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 353, Viti 1949, f. 51-52*

170

**INSTRUKSION [illegible] E DOSJEVE TË KUADRIT NË [illegible] DHE NË KOMITETET [illegible] TË P.P.[illegible]**

I.- Mënyra e njohjes së kuadrit me anë të dokumentave :

Për njohjen dhe studimin e thellë të kuadrit një rol me rëndësi luan studimi i kuadrit me anë të dokumentit. Për zgjedhjen e kuadrove Dikasteret dhe kom. ekzekutive duhet të ndihmohen në radhë të parë në njohjen e kuadrit në punë e sipër personalisht, por [illegible] duhet [illegible] të ndihmohen edhe në studimin e dokumentave të tyre. Prandaj mbajtja e dosjeve të kuadrit dhe pasurimi i vazhdueshëm i tyre bëhet një nga detyrat e [illegible] të dikasterit edhe komitetave ekzekutive për të bërë një politikë të drejtë në lidhje me zgjedhjen e ngritjen e kuadrit.

II.- Kush mban dosjen të kuadrit :

Për mbajtjen e pasurimin e dosjeve të kuadrit pranë Komitetit Qëndror ngarkohet Drejtorija e Kuadrit pranë Komiteteve të Partisë [illegible] rrethe seksjonet e kuadrit dhe në punëtorët degët e zyrat e personelit.

a) Komiteti Qëndror mban dosje për të gjithë kuadret anëtarë e kandidatë Partije e të pa parti që përfshihen në nomenklaturën e Komitetit Qëndror.

b) Komitetet e Partisë në rrethe mbajnë dosje për të gjithë kuadret që përfshihen në nomenklaturën e Komitetit të Partisë si dhe për ato kuadro që përfshihen në nomenklaturën e Komitetit Qëndror dhe të dikastereve e organizatave qëndrore të masave, për të cilat kërkohet [illegible] me propozim të Komitetit të Partisë si për kuadrot e Komitetit [illegible], të Prokurorisë, Gjykatave, [illegible] Komunale [illegible] të tyre dhe për kuadret e Komitetit Rinisë, grupe, instruktorët e [illegible] profesjonale etj.- Kurse kuadret e nomenklaturës të dikasterove përjashtohen kuadret teknikë si inxhinierë, rojtarë [illegible], llogaritarë (shih 4 e Kap. III të nomenklaturës) për të cilët mban dosje vetëm Komiteti [illegible] i rrethit. Komiteti i Partisë për Tiranën nuk duhet të mbajë dosje për kuadret e nomenklaturës Komitetit Qëndror që punojnë [illegible] dikastere, institute e organizata qëndrore të masave dhe as për kuadrot e aparatit të dikasterit dhe institutave qëndrore.

c) Dikasteret dhe organizatat qëndrore të masave mbajnë [illegible]

- 2 -

për kuadrot e nomenklaturës së tyre dhe për kuadrot e nomenklaturës K.Q., për të cilat ata i bëjnë propozime Komitetit Qendror. Dikasteret mbajnë dosje dhe për teknikët e lartë [illegible] veçanërisht, për kuadrot të [illegible] [illegible], mjekë, inxhinierë etj. që përfshihen në plan të Rep. [illegible] të nomenklaturës. [illegible] nuk mbajnë dosje.

ç) Komiteti [illegible] mban dosje për të gjithë kuadrot e aparatit të Komitetit [illegible] [illegible] të Komitetit [illegible] për të gjith kuadrot e ndërmarrjeve lokale të atij rrethi, të [illegible] të ndërmarrjes që varen nga një ndërmarrje nacionale që ka qendrën e vet në një rreth tjetër ([illegible] [illegible] [illegible] që qëndrojnë [illegible] [illegible] [illegible] dhe të gjithë [illegible] të nomenklaturës të dikaster[illegible] [illegible] ministrisë [illegible] [illegible], inxhinierë etj.) që punojnë në atë rreth. Për kuadrot e [illegible] e Organizatave, Komiteti [illegible] nuk mban [illegible] ([illegible] nomenklaturës së Komitetit [illegible]) [illegible] atë i [illegible] [illegible] Komitetit të Partisë.

d) Ndërmarrjet nacionale do të mbajnë dosje për të gjithë [illegible] e ndërmarrjes së tyre [illegible] [illegible] të [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] kuadrot e [illegible] të tyre që ndodhen në rrethe tjera. [illegible] mbajnë dosje [illegible] [illegible] e lartë [illegible] [illegible] dhe për kuadro e [illegible] [illegible] të [illegible] të kualifikuar.

[illegible] ndërmarrjet lokale [illegible] [illegible] e ndërmarrjes që varen nga ndërmarrjet nacionale, nuk mbajnë dosje.

III.- Dokumentet që përbëjnë dosjen e kuadrit :

Dosja e kuadrit përmban këto dokumente :

a) Autobiografia : Të gjithë kuadrot bëjnë auto-biografi [illegible] [illegible] [illegible] 3-4 faqe të daktilografuara [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] të bëjnë [illegible] jetën e tyre. Autobiografia duhet të përmbajë datën e firmën e [illegible]. Autobiografia [illegible] [illegible] nga i interesuari duhet të [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] të kuadrit dhe [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] të gjitha [illegible] e [illegible] [illegible] [illegible] e kuadrit [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] për t'u [illegible].

b) [illegible] : [illegible] do të [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible].

./.

ç) Karakteristikat: Në shënohen cilësitë e kuadrit në punë, në interesohet për ngritjen e tij profesionale, pjesëmarrja e tij në jetën politike, sjellja e tij në jetën shoqërore etj. Karakteristikat duhet të lidhen ngushtë me rezultatet e punës që ka pasë ky kuadër në sektorin e punës që i është ngarkuar si p.sh. kur bëhet karakteristika e Drejtorit të fabrikës duhet shënuar si është kryer plani i fabrikës, kur kur të karakteristika e Kryetarit të Pushtetit në lokalitet, shënohet si është kryer gjatë asaj kohe puna e pushtetit n'atë lokalitet etj. Karakteristika duhet të përmbajë material të studjuar mirë. Përshkrimin e karakteristikave nuk ka nevojë formular të veçantë, por kur hartohet kihet parasysh që në të, të vihen çështjet kryesore që karakterizojnë atë kuadër gjatë një periudhe të caktuar dhe [illegible] përsëritën në atë gjëra që janë thënë në karakteristikat e mëparshme, por të kenë vazhdimësi. Karakteristika nuk duhet të jetë me shumë se një faqe e daktilografuar.

Karakteristikat përpilohen me kërkesën e organeve të interesuara në herë që këto shikohen të nevojshme. Zakonisht karakteristikat bëhen njëherë në vit me kërkesën e organeve më të larta. Për këtë qëllim organet e kuadrit në pushtet sipas [illegible] planifikojnë gjatë vjetit kohën se kur duhet t'i kërkojnë këto karakteristika duke zgjedhur për kuadrot e çdo sektori kohën më të [illegible] p.sh. për kuadrot e bujqësisë këshillohet përpilimi i karakteristikave në dimër, sepse në atë kohë dihen mirë rezultatet e arritura prej atyre kuadrove gjatë fushatës së [illegible] bujqësore dhe ka më shumë kohë në dispozicion për përpilimin e karakteristikave etj. Ka edhe karakteristika të jashtëzakonshme që kërkohen nga lart në raste nevoje p.sh. kur një [illegible] në përgjithësi [illegible] kuadro dhe nuk ka të dhënat e duhura kërkon karakteristikat e tyre, ose kur [illegible] nacionale e komitetet ekzekutive propozojnë për lëvizje të kuadrit përpilojnë edhe karakteristikat, të cilat vihen në dosje.

Karakteristikat e pushtetit bëhen direkt nga përgjegjësi i pushtetit në institucionin ku punon ky kuadër [illegible] i tij i bën si [illegible]. Në karakteristika duhet të dalë më shumë anë e punës [illegible], aftësia profesionale e kuadrit, rezultatet që ka arritur në punë

./..

sjelljet e tij si edhe qëndrimi i tij politik.

Shtojmë se organet e pushtetit (Dikasteret, ndërmarrjet etj.) e t'organizatave qëndrore të masave nuk mund të kërkojnë karakteristika Partisë, prandaj në këto raste (për kuadrot e nomenklaturës së tyre) përgjegjësi i pushtetit kur bën karakteristiket duhet të konsultohet më parë me sekretarin e organizatës bazë.

Karakteristikat përpilohen sipas shembullit q'i bashkangjitet këtij instruksioni. Çdo karakteristikë para se të futet në dosje duhet të studjohet nga shefi i degës ose i zyrës së kuadrit, t'i bëhen vrejtjet e duhura dhe të shënuar se të shikuar e firmuar nga të dy, kur kanë bindjen se ajo nuk është objektive, atëherë ajo anullohet dhe kërkohet karakteristikë tjetër.

Çdo karakteristikë duhet të mba përmbajë datën dhe firmën.

ç) <u>Fletë-informimi mbi kuadrin :</u> Kjo është një fletë që shënohet në dosje të kuadrit ku shënohen të gjitha informatat që kemi për një kuadër, përshtypjet që ka dega ose zyra e kuadrit për të, opinione të ndryshme të shfaqura nga shokë të autorizuar, informata të pa vërtetuara ende etj.-gjëra që kanë të bëjnë me atë kuadër. Në fletë-informim duhet shënuar emri i atij q'e ka këtë opinion ose informatë dhe data kur e ka. Informatat e pa vërtetuara të shënuara në fletë-informim, kur verifikohen në se nuk dalin të vërteta, fshihen nga fletë-informimi dhe, në se vërtetohen, shënohen dokumentat vërtetuese në dosje (dokumenta, shkresa zyrtare etj.). Kur vjen karakteristika tjetër e kuadrit, kontrollohen se shënimet që ndodhen në fletë informimin dhe se nuk është shënuar në karakteristikë ndonjë gjë që është vënë në fletë-informim, kjo shënohet në karakteristikë në opinion [illegible] formimi n'i lartë dhe fshihet nga fletë-informimi.

d) <u>Në dosje shënohen gjithashtu kopje të dokumentit për kryerjen e shkollës shtatë-vjeçare</u>, të mesme ose universitet (për fillores s'ka nevojë). Kopje të certifikatës për kryerjen e kursit 3/vjeçar ose të shkollës së Partisë. Kopje të certifikatave të Presidiumit të Kuvendit Popullor mbi dekoratat që mban ky kuadër. Vendime të Partisë ose Pushtetit mbi atë kuadër, si kopje vendimi mbi dënime ose lavdërime q'i janë dhënë atij kuadri dhe opinione dhe shënime të tjera mbi atë kuadër të vërtetuara nga Dikasteri ose Komiteti ekzekutiv.

./.

- 5 -

IV.- Pasurimi i dosjeve :

Dosjet e kuadrit duhet të pasurohen vazhdimisht se të gjitha organet e kuadrit në pushtet (sipas nomenklaturës) [illegible] të gjitha ndryshimet që pëson kuadri.

a) Për një kuadër që ka pasur ndryshime nga koha që ka bërë dokumentet dhe organi më i lartë (sipas nomenklaturës) e shikon të nevojshme, atij kuadri i kërkohet të plotësojë një autobiografi të re ose një shtojcë biografije, ku duhet të shprehë ndryshimin që ka pasur ashtu si e ndjen ky vetë. Autobiografija e re e shtojcë-biografija mund të bëhen edhe me kërkesën e t'interesuarit.

b) Vendosen në dosjen e kuadrave vazhdimisht, karakteristikat, kopje të vendimeve të marra për atë kuadër për masa ndëshkimore, kopje të dokumentave shkollore posa që mbaron shkollën, ose kurse specializimi etj.-

Për të gjitha këto ndryshime shënohen në dosje kopjet e këtyre dokumentave dhe shënohen në fletë-biografi në vendet përkatëse në faqe 3-4.

c) Ndryshimet në punë që pëson një kuadër (transferimi, [illegible] gradimi etj.) këto shënohen në vendin e posaçëm të fletë-bio[illegible] lëvizjet e kuadrit.

ç) Opinioni që duhet të japin herë pas here inspektorët, kryetarët e degëve, shefat e seksioneve dhe të deleguar të dikasterit ose të Komitetit ekzekutiv si dhe shënime të tjera që dalin nga raportet e ndryshme të punës mbi atë kuadër. Këto duhet të jenë të faktuara mirë, sigurta dhe mbasi përgjigja [illegible] personalisht t'atij q'i lëshon. Çdo opinion tillë para se të shënohet në fletë-informimin për kuadrin duhet vërtetuar mirë nga dega ose zyra e kuadrit. Vetëm kur ka ndonjë opinion me rëndësi mund të vendoset direkt në dosje mbasi verifikohet duke përmbajtur datën dhe firmën t'atij q'e lëshon.

d) Për kuadret e nomenklaturës së Komitetit Qëndror autobiografi ose shtojcë-biografija bëhet vetëm me kërkesën e Komitetit Qëndror ose me kërkesën e t'interesuarit. Për dokumentat e tjera me të cilat pasurohet dosja e kuadrit të nomenklaturës së Komitetit Qëndror bëhet vetëm me kërkesën e Komitetit Qëndror, por edhe me kërkesën e Komitetit të Partisë ose të Pushtetit, por në këtë rast [illegible]

./.

- 6 -

Partisë ose Komitetit) një kopje e këtij dokumenti t'i dërgohet edhe [illegible] nistrit (Qendrës) për t'u vendosur në dosjen që mban për atë kuadër [illegible] nitet Qendror.

ç) Të kihet parasysh që për kuadrot e nomenklaturës e për të cilët mban dosje edhe Komiteti i Partisë, ose Pushteti, të [illegible] tha dokumentat që shërbejnë për mbajtjen dhe pasurimin e dosjeve [illegible] të përpilohen në dy kopje në mënyrë që të pasurohen paralelisht të [illegible] dokumentat.

V.- Mbi vërtetimin e kontrollin e dokumentave që mbahen në dosje :

a) Çdo dokument ose shënim që futet në dosje duhet të jetë i vërtetuar mirë dhe i autorizuar për t'u futë në dosje nga M/Ministri në Dikaster, nga Sekretari i Komitetit ekzekutiv në komitetin ekzekutiv [illegible] nga Drejtori në ndërmarrje nacionale, duke u vulosur dhe firmuar prej tij. Asnjë dokument të mos ndodhet në dosjen e kuadrit pa vulën Dikasterit ose Komitetit ekzekutiv dhe pa firmë.

b) Çdo dokument që vihet në dosje duhet të jetë i daktilografuar [illegible] dhe pa asnjë shkarravitje ose prishje me bojë ose laps.

c) [illegible] mbas e përmbajtjes të çdo dosjeje duhet të vihet lista e dokumentave që përbejnë dosja duke shënuar llojin e dokumentit, [illegible] kush ja lëshon, numuri e data e dokumentit dhe firma e atij që kontrollon (një herë në vjet) sipas modelit që ju bashkangjitet.

ç) Një herë në vjet në Dikaster, M/Ministrat, Sekretari i Komitetit ekzekutiv, drejtori ose N/drejtori i ndërmarrjes Nacionale kontrollon të gjitha dosjet që mban dikasteri, komiteti ekzekutiv ose [illegible] marrja një nga një, në se përmbajnë të gjitha dokumentat që janë [illegible] atje, dhe në se janë regjistruar në listë, dhe mbasi e kontrollon, në [illegible] lën "Firma dhe data e kontrollit" të listës së dokumentave në [illegible] dhe datën. Ky kontroll do të vlejë edhe për të parë nëse del e nevojshme t'i kërkohet ndonjë kuadri karakteristikë, shtojcë-biografije, [illegible] [illegible] e tjera, se gjithëse këto rregullisht duhet të bëhen gjatë [illegible] Në rast se del ndonjë dokument mangut atëhere mbahet proçes-verbal rregullit ku shënohet ç'dokument ka humbur, në ç'rrethana, cili është [illegible] [illegible] etj.- Nga ana e organeve të kuadrit në pushtet duhet të [illegible] het kujdes i madh për të gjetur arsyen e humbjes së atij dokumenti.

./.

173

- 7 -

duhet të bëhen hetimet e duhura për të gjetur shkakun e humbjes. Një kopje e proçes-verbalit për dijeni i dërgohet organit që s'përfshin në nomenklaturën e tij.

VI.- <u>Shfrytëzimi i dosjeve :</u>

Dosjet personale të kuadrove duhet të shfrytëzohen për studimin dhe njohjen e mirë të kuadrit.

A) Dokumentat që ndodhen në dosjet e kuadrove duhet të studjohen vazhdimisht nga ana e degëve dhe sipas të kuadrit në punë:

a) Për të parë nevojat, kërkesat e dëshirat e kuadrove si p.sh. nevoja që të kalojnë në kurse specializimi etj.; b) Për t'a njohur dhe studjuar sa më mirë atë kuadër p.sh. mbassi dega e kuadrit në dikastere e ka parë në punë e sipër dhe ka përshtypjet e tija, studjon dhe dokumentat e tij për të njohur të kaluarën e atij kuadri dhe për të formuar në këtë mënyrë një opinion të drejtë mbi atë.

B) Para se të vendosat lëvizje e një kuadri duhet gjithmonë të studjohet me kujdes të madh dosja e tij duke mos lënë gjë pa parë, vetëm kështu studimi i atij kuadri do të jetë i plotë dhe të dhënat të jenë më të sigurta. Vetëm duke i bërë një studim t'imtë duhet [illegible] duhet dokumentat që ndodhen në dosje dhe duke i lidhur këto me [illegible] personale të kuadrit në punë, do të jemi në gjendje të formojmë një opinion të plotë e të drejtë për një kuadër dhe të vendosim drejt [illegible].

C) Dosjet personale duhet të shfrytëzohen edhe për të plotësuar formularët mbi regjistrimin e kuadrit sipas formës së caktuar nga Sekretaria e Kuadrit dërguar me shkresën Nr.271/20 datë 8/11/1949 për [illegible] në studime të mëtejshme në lidhje me të gjitha treguesit e nevojshëm si nga ana e shëndetit, kulturës, origjinës shoqërore etj. dhe të nxirren konkluzionet e duhura.

VII.- <u>Ruajtja e sigurimi i dosjeve :</u>

Për mbajtjen dhe ruajtjen e dosjeve duhet të tregohet konspiracion dhe vigjilencë e madhe.

a) Dosjet duhet të mbahen në dhoma të sigurta dhe të mbyllura në kasaforta ose sënduk të posaçme, ku të mbrohen nga zjarri dhe nga ndonjë aksident tjetër.

b) Dosjet e kuadrit do të mbahen sipas rendit alfabetik.

c) Çdo dosje mbi mbulesën e saj duhet të ketë emërin, emërin e babës e mbiemërin.

ç) Përveç Ministrit e N/Ministrit Kryetarit e Sekretarit Komitetit ekzekutiv, drejtorit e ndërmarrjes Nacionale dhe punonjësve që punojnë me kuadrin dosjet nuk mund të studjohen prej kurkujt, veçse në raste të nevojshme duke marrë autorizimin e Nd/Ministrit për kuadrin, sekretarit të komitetit ekzekutiv ose Drejtorit të Ndërmarrjes.

d) Dosjet e kuadrit nuk shikohen nga vetë t'interesuarit. Dosjet e Nd/Ministrave e të Kryetarit të Degës Kuadrit i mban Ministri, të Sekretarit të Komitetit ekzekutiv e të referentit të personelit i mban Kryetari komitetit ekzekutiv dhe të N/Drejtorit e të Referentit të personelit të ndërmarrjes i mban Drejtori i Ndërmarrjes Nacionale.

VIII.- Udhëzime mbi lëvizjet e dosjeve :

Për lëvizjet e nevojshme që pësen një kuadër veprohet në kë mënyrë:

a) Kur transferohet një kuadër prej një rrethi në një rreth tjetër atëherë së bashku me urdhërin e transferimit të tij, bëhet edhe transferimi i dokumentave përkatëse në komitetin ekzekutiv ose institucjonin (sipas nomenklaturës që është ay kuadër) të rrethit ku shkon ay kuadër jo më vonë se 6 ditë nga nisja e atij kuadri.

b) Kur një kuadër kalon nga nomenklatura e dikasterit n'atë të Komitetit Qëndror, dikasteri i dërgon K.Q. dokumentat origjinale që ka jo më vonë se 6 ditë nga data e emërimit të tij dhe dikasteri për kartotekën e tij mbajnë një kopje të dokumentave t'atij kuadri. Në këto raste për të gjitha dokumentat njësija me origjinalin duhet të vërtetohen nga Ministri.

c) Kur një kuadër transferohet nga një rreth në një tjetër kalon nga nomenklatura e komitetit ekzekutiv n'atë të dikasterit, atëhere rrethi që e kishte n'efektivin e tij së bashku me kopjen e dokumentave që i përcjell rrethit ku transferohet ay kuadër, i përcjell dikasterit dokumentat e tij origjinale.

ç) Kur një kuadër ndodhet ose hurbet për një kohë të pa caktuar ose u larguar mekanikisht nga puna, dokumentat ruhen n'arshivën e veçantë

d) Kur një kuadër kalon, nga nomenklatura e dikasterit n'atë të

./.



- 9 -

komitetit ekzekutiv dosjet mbahen n'arshivën e dikasterit, nëse Kom.ekz. ka një kopje të dosjeve dhe nëse Kom.ekz.nuk ka dosjen e atij kuadri atëherë Dikasteri ia dërgon Kom.ekzek.përkatës.

dh) Kur një kuadër i nomenklaturës së K.P.ose i Kom.ekz.kalon në nomenklaturën e dikasterit atëherë kopja origjinale e atij kuadri që mban komiteti ekzekutiv i kalon dikasterit përkatës.

e) Kur një kuadër nuk gjen në punë në rrethin e tij dhe largohet në një rreth tjetër, Kom.ekzekutiv i jep rekomandimin ku shpjegoh sepse është hequr nga puna n'atë rreth.Kom.ekzekutiv nuk mund të vendosë një kuadër në punë pa patur dosjen e tij, prandaj Kom.ekzekutiv i rrethit ku paraqitet ai kuadër për punë, i kërkon zyrtarisht dosjen e tij Kom.ekzekutiv të rrethit prej nga vjen dhe ky i fundit duhet t'ia dërgojë jo më vonë se 3 ditë nga marja e njoftimit zyrtar.

f) Kur një kuadër kërkon punë për herë të parë në një rreth tjetër, Kom.ekzekutiv i atij rrethi s'mund të vendosë pa i kërkuar më parë një karakteristikë të gjërë rrethit prej nga është i interesuari, prandaj duhet t'i nisë rrethit nga është ay kuadër emërin, emërin e babës, mbiemërin, vënd-lindjen, (fshatin) vënd-banimin dhe gjeneralitete të tjera të domosdoshme për njohjen e saktë t'atij personi duke ia marë këto nga dokumentet zyrtare që paraqet i interesuari fletër-njoftimi etj. Komiteti ekzekutiv i rrethit nga është ay person mbasë heton mirë brënda 10 ditëve nga njoftimi zyrtar duhet t'i përgjigjet me ekzaktësi komitetit që ja kërkon.

Të kihet parasysh se vetëm ndërmjet të komitetit ekzekutiv të rrethit, ndërmarrjet ose dikasteret marin kuadro për plotësimin e organikave të tyre.

IX.- Përgjegjësia personale në lidhje me mbajtjen e dosjeve :

Për mbajtjen, ruajtjen dhe pasurimin e dosjeve të kuadrit ngarkohet me përgjegjësi personale N/Ministri që miret me kuadrin, sekretari i komitetit ekzekutiv dhe drejtori i ndërmarrjes.

Kur transferohet shefi i dosjes ose zyrës kuadrit ose zëvendësohet me një tjetër, duhet të bëhet me proces-verbal të rregullt dorëzimi i plotë i dosjeve të kuadrit, sipas formularit të vogëlit që ju bashkëngjitet.

Instruksioni mbi krijimin e dosjeve në pushtet lëshuar me nën Nr.1762 datë 28/XI/49 anullohet.-

Z/MINISTRI :
[signature]

Udhëzim mbi mbajtjen e dosjes së kuadrit
*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 353, Viti 1949, f. 170-178*


REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
MINISTRIA KOMUNIKACJONEVE P.T.T.
DOSJE
Nr.
LANDA:

Shkresë mbi kategorizimin e degëve të Ministrisë
*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 610, viti 1949, f. 46*

ORGANIKA E MINISTRIS INDUSTRI - [illegible]

| Nr. Rend. | Emertimi Detyres | Emri e Mbiemri | Nr. punë. | Rrog. |
|---|---|---|---|---|
| 1) | Ministri | | 1 | |
| 2) | Zv.Ministri | | 1 | |
| 3) | Zv.Ministri | | 1 | |
| 4) | Zv.Ministri | | 1 | |
| 5) | Sekretar i Kolegjumit dhe Komitetit teknik | | 1 | |
| 6) | Sekretar i Ministrit dhe Zv.Ministrave | | 1 | |
| 7) | Inspektor per Industrine | | 1 | |
| 8) | " " Minierat | | 1 | |
| 9) | " " [illegible] dhe Drejtorive e [illegible] | | 1 | |
| 10) | Kryetari Zyres Speciale | | 1 | |
| 11) | [illegible] | | | |
| 11) | Drejtor i [illegible] | | 1 | |
| | ZYRA E [illegible] | | | |
| 12) | Kryetar Zyre | | 1 | |
| 13) | Zv.Kryetar Zyre e Shef i [illegible] | | 1 | |
| 14) | Shef i [illegible] | | 1 | |
| | ZYRA E [illegible] | | | |
| 15) | Kryetar Zyre | | 1 | |
| 16) | Zv.Kryetar Zyre e Shef i [illegible] | | 1 | |
| 17) | Shef i [illegible] (pelagos) | | 1 | |
| | ZYRA E [illegible] | | | |
| 18) | Kryetar Zyre (ekonomist) | | 1 | |
| 19) | Zv.Kryetar Zyre e Shef i planifikimit [illegible] ([illegible]) | | 1 | |
| 20) | Shefi i [illegible] (ekonomist) | | 1 | |
| 21) | Shefi i statistikes (ekonomist) | | 1 | |
| 22) | Kryereferent i statistikes (teknik) | | 1 | |
| | [illegible] | | | |
| 23) | Drejtor | | 1 | |
| 24) | Kryeinxhinier (Zv.Drejtor i [illegible]) | | 1 | |
| 25) | Zv.Drejtor | | 1 | |
| 26) | [illegible] | | 1 | |
| 26) | Inxhinier per [illegible] | | 1 | |

128

- 2 -

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|
| 27) | Sekretar - [illegible] | | 1 | |
| | DEGA TEKNIKE E PRODHIMIT | | | |
| 28) | Kryetar Dege (Inxhinier) dhe Shef [illegible] per [illegible] | | 1 | |
| 29) | Zv.Kryetar Dege - Shef per [illegible] (Inxh.) | | 1 | |
| 30) | Shef per [illegible] - [illegible] (teknik) | | 1 | |
| 31) | Shef per industrializimin - [illegible] | | 1 | |
| | DEGA [illegible] | | | |
| 32) | Kryetar Dege - Shef per [illegible] (Inxh.) | | 1 | |
| 33) | Zv.Kryetar Dege - Shef per [illegible] - [illegible] (Inxh.) | | 1 | |
| 34) | Shef per [illegible] - [illegible] (teknik) | | 1 | |
| | DEGA E [illegible] | | | |
| 35) | Kryetar Dege - Shef i prodhimit | | 1 | |
| 36) | Shef i prodhimit [illegible] (agronom) | | 1 | |
| 37) | Shef i prodhimit [illegible] (agronom) | | 1 | |
| 38) | Shef i prodhimit [illegible] dhe [illegible] (teknik) | | 1 | |
| | DEGA E [illegible] | | | |
| 39) | Kryetar Dege, Shef i [illegible] dhe i [illegible] | | 1 | |
| 40) | Shef i [illegible] | | 1 | |
| 41) | Inxhinier i [illegible] | | 1 | |
| | DEGA E PLANIT | | | |
| 42) | Kryetar Dege dhe Shef i planifikimit [illegible] | | 1 | |
| 43) | Shef i planifikimit [illegible] | | 1 | |
| 44) | Shef i statistikes | | 1 | |
| | DEGA E FINANCES DHE [illegible] | | | |
| 45) | Kryetar Dege Shef kontabel | | 1 | |
| 46) | Zv.Kryetar Dege - Shef per planin financiar | | 1 | |
| 47) | [illegible] | | 1 | |
| 48) | [illegible] | | 1 | |
| | DEGA E [illegible] DHE [illegible] | | | |
| 49) | Kryetar Dege, shef planif. dhe [illegible] | | 1 | |
| 50) | Zv.Kryetar Dege - Shef i planifikimit [illegible] (teknik) | | 1 | |
| 51) | Shef i [illegible] transportit (teknik) | | [illegible] | |

189

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|

DREJTORIA E PRODHIMIT MATER. NDERTIMI DHE IND. LOKALE

52) Drejtor . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

53) Kryeinxhinier (Zv.Drejtor i I-re). . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

54) Zv.Drejtor . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

55) Kryemekanik . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

56) Ingjinier per ndertimet. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

57) Sekretar - kopist . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

DEGA TEKNIKE E PRODHIMIT MATERIAL [illegible]

58) Kryetar Dege e shef per [illegible].(Ingj.). . . . . . . . . . . . . . . 1

59) Shef per sharrat (Ingj.). . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

60) Teknik per punim druri e zdrukthtarie .(teknik). . . . . . . . . . . . 1

DEGA TEKNIKE E PRODHIMIT INDUSTRIS LOKALE

61) Kryetar Dege . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

62) Shef per lende druri (teknik). . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

63) Shef per artikujt ushqimore (teknik) . . . . . . . . . . . . . . . . 1

64) Shef per artikujt e ndryshem (Ingj.) . . . . . . . . . . . . . . . . 1

DEGA E PLANIT

65) Kryetar Dege e shef prodhimi . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

66) Shef i planit kostos . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

67) Shef i statistikes . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

DEGA E FURNIZIMIT DHE [illegible]

68) Kryetar Dege dhe shef i furnizim materialesh . . . . . . . . . . . . 1

69) Shef i planifikimit mat.furnizimit (teknik) . . . . . . . . . . . . . 1

70) Shef i shperndarjes transportit (teknik). . . . . . . . . . . . . . 1

SEKSIONI KUADRIT DHE FUQIS PUNTORE

71) Shef seksioni i plotesimit dhe pregatitjes kuadrit. . . . . . . . . 1

72) Teknik per norma pagash dhe fuqia puntore (teknik). . . . . . . . . 1

SEKSIONI FINANCES DHE KONTABILITETIT

73) Shef seksioni e shef kontabel . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

74) Zv.Shef kontabel ekonomist financiar . . . . . . . . . . . . . . . . 1

75) Revizor . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

DREJTORIA E [illegible] DHE [illegible]

76) DREJTOR . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

77) Kryeinxhinier . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 1

√.



130

- 2 -

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|
| | [illegible] | | | |
| 77) | Shef seksioni (Ing.) | | 1 | |
| 78) | [illegible] | | 1 | |
| | [illegible] | | | |
| 79) | Shef seksioni | | 1 | |
| | [illegible] | | | |
| 81) | [illegible] | | 1 | |
| 82) | [illegible] | | 1 | |
| 83) | [illegible] | | 1 | |
| | [illegible] | | | |
| 84) | [illegible] | | 1 | |
| 85) | [illegible] | | 1 | |
| | [illegible] | | | |
| 87) | Shef seksioni | | 1 | |
| | [illegible] | | | |
| 88) | [illegible] | | 1 | |
| | [illegible] | | | |
| 89) | Kryetar dege (Inxhinier) | | 1 | |
| 90) | Zv.Kryetar Dege (Ing. [illegible]) | | 1 | |
| 91) | [illegible] | | 1 | |
| | [illegible] | | | |
| 92) | Kryetar Dege (Inxhinier) | | 1 | |
| 93) | [illegible] | | 1 | |
| 94) | [illegible] | | 1 | |
| | [illegible] | | | |
| 95) | [illegible] (Inxhinier) | | 1 | |
| 96) | Inspektor (Inxhinier) | | 1 | |
| | [illegible] | | | |
| 97) | Kryetar Dege (Ing.) | | 1 | |
| 98) | Inspektor për cilësinë | | 1 | |
| 99) | " " " | | 1 | |
| | [illegible] | | | |
| 100) | [illegible] | | 1 | |

131

- 5 -

| 1 | 2 | 3 | | |
|---|---|---|---|---|
| 100) | [illegible] (Dr. [illegible] i [illegible]) | 1 | | |
| 101) | [illegible] Dr. [illegible] | 1 | | |
| 102) | [illegible] | 1 | | |
| 103) | [illegible] | 1 | | |
| | [illegible] | | | |
| 104) | [illegible] ([illegible]) | 1 | | |
| 105) | Dr. [illegible] ([illegible]) | 1 | | |
| 106) | [illegible] | 1 | | |
| 107) | [illegible] | 1 | | |
| 108) | [illegible] | 1 | | |
| 109) | [illegible] | 1 | | |
| | [illegible] | | | |
| 110) | [illegible] ([illegible]) | 1 | | |
| 111) | Dr. [illegible] ([illegible]) | 1 | | |
| 112) | [illegible] | 1 | | |
| 113) | [illegible] ([illegible]) | 1 | | |
| | [illegible] | | | |
| 114) | [illegible] ([illegible]) | 1 | | |
| 115) | [illegible] | 1 | | |
| | [illegible] | | | |
| 116) | [illegible] | 1 | | |
| 117) | [illegible] | 1 | | |
| 118) | [illegible] | 1 | | |
| | [illegible] | | | |
| 119) | [illegible] | 1 | | |
| 120) | [illegible] | 1 | | |
| 121) | [illegible] | 1 | | |
| | [illegible] | | | |
| 122) | [illegible] | 1 | | |
| 123) | [illegible] | 1 | | |
| 124) | [illegible] | 1 | | |
| 125) | " | 1 | | |



133

- 3 -

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|
| | [illegible] | | | |
| [illegible] | Kapiten Dege [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| | [illegible] | | | |
| [illegible] | Kapiten Dege | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| | [illegible] | | | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | " " | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| | [illegible] | | | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | " | | 1 | |
| | [illegible] | | | |
| [illegible] | Kapiten Dege [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | " | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |
| [illegible] | [illegible] | | 1 | |


134

Organika e Ministrisë së Industrisë dhe Minierave
*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 914, viti 1954, f. 127-134*

136

| Nr. Rend. | EMERTIMI I DETYRAVE | Numri i Personelit | Paga |
|---|---|---|---|
| | **Dega e Kont. dhe Kontrollit Kontingjent.** | | |
| 1. | Kryetar Dege . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| 2. | Shefi i Sektorit Kontingjentave (Zev.K/Dege).. | 1 | 5.200 |
| 3. | Krye-Kontrollorë . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.500 |
| 4. | K o n t r o l l o r ë . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.000 |
| 5. | " . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.000 |
| 6. | Shefi i Sektorit Thesarit dhe shpërnd. trikave | 1 | 5.200 |
| 7. | Kryereferent " " " " " | 1 | 4.500 |
| 8. | " " " " " " | 1 | 4.500 |
| | b) **DREJTORIJA E URDH. SOC. DHE PRODH. GRUMBULL.** | | |
| 1. | D r e j t o r i . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 10.000 |
| 2. | Shefi i Sektorit Tregtimit Special . . . . . . | 1 | 5.200 |
| | **Dega e Ushqimit Social** | | |
| 1. | Kryetar Dege ( Zev. Drejtor ) . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| 2. | Shefi i Sektorit Normave dhe Planit (Zev.K/Dege) | 1 | 5.200 |
| 3. | K/Referent për normat dhe planin . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| 4. | Shef për Gatimet(Teknik ) . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 5. | Shef Sektorit Ushqimit social . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| | **Dega e Prodhimit Grumbullimit** | | |
| 1. | Kryetar Dege . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 6.400 |
| 2. | Shefi i Sekt. Prodhimit dhe konserv. ( Zev.K/Dege ) | 1 | 5.200 |
| 3. | K/Referent për pemët e konservimit. . . . . . | 1 | 4.500 |
| 4. | Shefi i Sektorit grumbull. dhe ekon. ndihm. (Agronom) | 1 | 5.200 |
| | **Dega e Karburanteve dhe vegla auto.** | | |
| 1. | Kryetar Dege. . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 6.400 |
| 2. | Shefi i Sektorit Karburanteve (Zev.K/Dege). . . | 1 | 5.200 |
| 3. | K/Referent për Karburantin. . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| 4. | Shefi i Sekt. veglave auto. (Teknik). . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 5. | K/Referent për vegla auto. (Teknik) . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| | IV. **DREJTORIJA PLAN - [illegible]** | | |
| 1. | D r e j t o r . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 10.000 |
| | **Dega e Planit** | | |
| 1. | Kryetar Dege (Zev. Drejtor ). . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| 2. | Shefi i Sektorit planit përmbledhës (Zev.K/Dege) | 1 | 5.200 |
| 3. | K/Referent për planin . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| 4. | Shefi i Sektorit Qarkullimit të mallrave. . . . | 1 | 5.200 |
| 5. | Shefi i Sektorit punës, pagave dhe fuqisë punëtore | 1 | 5.200 |
| 6. | Shefi i Sektorit Statistikës. . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 7. | K/Referent i Statistikës. . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |

../..

- 13 -

| Nr. Rendor | EMËRTIMI I DETYRAVE | Numuri i Personelit | Paga |
|---|---|---|---|
| | **Dega e Financës** | | |
| 1. | Kryetar Dege | 1 | 7.000 |
| 2. | Shefi i Sektorit Financës për trag. mbrend. Zev/K/Dege | 1 | 5.200 |
| 3. | K/Llogaritar për tregtinë e mbrendëshme | 1 | 4.800 |
| 4. | K/Llogaritar për tregtinë e mbrendëshme | 1 | 4.800 |
| 5. | Shefi i Sektorit Financës për Tregtinë e Jashtme | 1 | 5.200 |
| | **Dega e Kontabilitetit** | | |
| 1. | Kryetar Dege | 1 | 7.000 |
| 2. | Shefi i [illegible] bilancave (Zev.K/Dege) | 1 | 5.200 |
| 3. | K/Llogaritar i [illegible] të bilancit | 1 | 4.800 |
| 4. | K/Revizor | 1 | 5.500 |
| 5. | Revizor | 1 | 5.000 |
| 6. | " | 1 | 5.000 |
| 7. | " | 1 | 5.000 |
| 8. | " | 1 | 5.000 |
| | **Dega e Administratës** | | |
| 1. | Kryetar Dege | 1 | 6.400 |
| 2. | [illegible] i Llogarisë (Zev/K/Dege) | 1 | 5.200 |
| 3. | K/Llogaritar për tregtinë e jashtme (Valutës) | 1 | 5.200 |
| 4. | Llogaritar | 1 | 4.000 |
| 5. | Shefi i Sektorit Zyrës Sekrete | 1 | 5.200 |
| 6. | Proto-Arshivist i Zyrës Sekrete | 1 | 3.800 |
| 7. | Kryeprotë arshivist i protokollit hapët | 1 | 3.400 |
| 8. | Kryekopjist i Zyrës Sekrete | 1 | 3.400 |
| 9. | Kopjist i zyrës sekrete [illegible] | 1 | 2800 - 3200 |
| 10. | Kopjiste, [illegible] | 1 | 2800 - 3200 |
| 11. | Kopjiste, [illegible] | 1 | 2800 - 3200 |
| 12. | Përkthyes i [illegible] | 1 | 6.500 |
| 13. | Përkthyes [illegible] | 1 | 4500, 5000, 5500 |
| 14. | Shërbyes | 2 | 2.400 |
| 15. | Centraliste | 1 | 2.400 |
| 16. | Portier | 1 | 2.400 |
| 17. | Shofer i [illegible] | 1 | - |
| 18. | Shofer i [illegible] | 1 | - |
| 19. | Shoferë për Zev/Ministrat | 2 | - |
| 20. | Shofer | 1 | - |
| 21. | [illegible] | 1 | 3.800 |
| | **V. DEGA E [illegible]** | | |
| 1. | Kryetar Dege | 1 | 7.000 |
| 2. | Shef seksioni për [illegible] prodh. [illegible] (Zev.K/Dege) | 1 | 5.200 |
| 3. | K/Ref. për [illegible] prodh. industriale | 1 | 4.500 |
| 4. | Shef seks. për [illegible] prodh. [illegible] | 1 | 5.000 |
| 5. | Kryereferent | 1 | 4.500 |

..../..

- 4 -

138

| Nr. Rendi | [illegible] | Numri i Personel | Page |
|---|---|---|---|
| | **VI. - DEGA E KUADRAT** | | |
| 1. | Kryetar Dege. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| 2. | Shef seks. ngjer-dar jes kuadrit (Zev.K/Dege ). . . . | 1 | 5.200 |
| 3. | K/Referent i biografive dhe evidencës. . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| 4. | Shef seks. prejatitjes kuadrit. . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 5. | Inspektor shkolla dhe kurse [illegible]. . . . . . . . . . . | 1 | si pun. e urës. |
| 6. | Shef seks. [illegible] . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 7. | | | |
| | **VII. - [illegible] TREGTI. S JASHTME** | | |
| | *Dega e Bilanceve* | | |
| 1. | Kryetar Dege. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| 2. | Shef [illegible] të Bilanceve ( Zev.K/Dege ). . . | 1 | 5.200 |
| 3. | Shef [illegible] Import Eksportit. . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 4. | [illegible] për Import Eksportin. . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| 5. | [illegible] . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 6. | [illegible] . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| 7. | Shef i statistikës. . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 8. | K/Referent i statistikës. . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| 9. | K/Referent i [illegible] ( [illegible] ). . . . . . . | 1 | 4.500 |
| 10. | " " materialeve( " ). . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| 11. | Shef i [illegible] studimeve. ( Rang. Drejtor ). . . . . | 1 | 10.000 |
| | *Dega Marrëdhënie me Jashtë* | | |
| 1. | Kryetar Dege. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| 2. | Shef sektori për [illegible] (Zev.K/Dege ). . . . . . | 1 | 5.200 |
| 3. | " " " Poloni - Gjermani . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 4. | " " " Çekosllovaki - Hungari. . . . . | 1 | 5.200 |
| 5. | " " " Rumani - Bullgari. . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 6. | " " " [illegible] . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 7. | " " [illegible], [illegible] e transportit. . . | 1 | 5.200 |
| 8. | K/Referent " " " . . | 1 | 4.500 |
| 9. | Shef sektori Dëgamave. . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| | *Sektori Protok. dhe Shifrave* | | |
| 1. | Shef i Protokollit. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| 2. | Shifrant [illegible] . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 3 | |
| | *Dega Marrëdh. Tekniko-[illegible]* | | |
| 1. | Kryetar Dege. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| 2. | [illegible] për [illegible] ( Zev.K/Dege). . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 3. | [illegible] për [illegible] . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| | Shuma Totale : | 138. | |

Aprovohet kontingjenti prej 138 ( njëqind/tridhjetetetë ) veta.-

Shënim: [illegible] i Personelit që janë [illegible] kategorizohen konform tabelës [illegible] të pagave të Tregtisë [illegible] e të larta.- -

Organika e Ministrisë së Tregtisë
*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 914, viti 1954, f. 136-138*



Skema e Ministrisë së Industrisë - Ndërtimit
*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 914, viti 1954, f. 149*



1030 Skema e Ministrisë së Industrisë dhe Minierave
*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 914, viti 1954*



Skema e Ministrisë së Industrisë dhe Minierave
*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 914, viti 1954*

A P R O V O H E T
KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË R.P.SH.
( MEHMET SHEHU )

16.VII.1949

ORGANIKA E MINISTRISË SË FINANCAVE

| NR. RAND | EMËRTIMI I DETYRAVE | NUMRI I PERSONEL. | RROGA BAZE |
|---|---|---|---|
| | I.- U D H Ë H E Q J A | | |
| 1. | M i n i s t ë r. . . . . . . . . . . . . | 1 | |
| 2. | Zv/ M i n i s t ë r I. . . . . . . . . . | 1 | 14.000 |
| 3. | Zv/ M i n i s t ë r. . . . . . . . . . . | 1 | 13.000 |
| 4. | Shef i Kabinetit. . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| 5. | Inspektor i Ministrit. . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| 6. | Sekretar i Ministrit . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| | S H U M A : | 6 | |
| | II.- DREJTORIJA E BUXHETIT | | |
| 7. | D r e j t o r. . . . . . . . . . . . . . | 1 | 10.000 |
| | a) DEGA E BUXHETIT | | |
| 8. | Kryetar Dege ( Zv.Drejtor) . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| | SEKSIONI BUXHETIT NACIONAL | | |
| 9. | Shef Seksioni. . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 10. | Krye-Referent. . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| | SEKSIONI BUXHETIT LOKAL | | |
| 11. | Shef Seksioni. . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 12. | Krye-Referent. . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| | ZYRA E KONTABILITETIT QENDROR | | |
| 13. | Kryetar Zyre ( Zv.Kryetar Dege). . . . . | 1 | 6.400 |
| 14. | Shef Llogarije . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.300 |
| 15. | Krye-Llogaritar. . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.800 |
| 16. | Krye-Referent statistike . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| | S H U M A : | 9 | |
| | b) DEGA E FINANC.MASAVE SOCIAL KULTURALE | | |
| 17. | Kryetar Dege . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| | SEKSIONI ARSIM-SHËNDETËSIE | | |
| 18. | Shef Seksioni. . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 19. | Krye-Referent. . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |

../...

- 2 -

| NR. RED | EMERTIMI I DETYRAVE | NUMRI I PUNETORVE | RROGA BAZE |
|---|---|---|---|
| | SEKSIONI I KUJDESIT SOCIAL | | |
| 20. | Shef Seksioni ( Zv.Kryetar Dege ). . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 21. | R e f e r e n t. . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 3.800 |
| 22. | K/Revizor. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 6.000 |
| 23. | R e v i z o r e. . . . . . . . . . . . . . . . . . | 2 | 5.200 |
| | S H U M A : | 5 | |
| | III.- DREJTORIJA FINANCIMIT EKONOMIS POPULLORE | | |
| 24. | D r e j t o r i. . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 10.000 |
| | a) DEGA FIN.INDUS.MIN.ARTIZ.NDERT.E KOMUNIKACION | | |
| 25. | Kryetar Dege ( Zv.Drejtor) . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| | SEKSIONI INDUSTRI,MINIERA E ARTIZANAT | | |
| 26. | Shef Seksioni ( Zv.Kryetar Dege) . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 27. | Kryo-Ekonomist . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 2 | 4.500 |
| | SEKSIONI NDERTIM-KOMUNIKACION | | |
| 28. | Shef Seksioni. . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 29. | Kryo-Ekonomiste. . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| | S H U M A : | 6 | |
| | b) DEGA FINAN.BUJQ.GRUMB.TREGTI E KOOP. | | |
| 30. | Kryetar Dege . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| | SEKSIONI BUJQESISE | | |
| 31. | Shef Seksioni ( Zv.Kryetar Dege) . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 32. | Kryo-Ekonomiste. . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| 33. | Revizor per S.M.T. . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| | SEKSIONI TREG.GRUMB. E KOOP. | | |
| 34. | Shef Seksioni. . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 35. | Kryo-Ekonomiste. . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| | S H U M A : | 6 | |
| | c) SEKSIONI FINANCIMIT EKONOMIS LOKALE | | |
| 36. | Shef Seksioni. . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 37. | Kryo-Ekonomiste. . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| | S H U M A : | 2 | |
| | c) DEGA E FORCIMIT KONTABILITETIT | | |
| 38. | Kryetar Dege . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| 39. | Shef Studimeve llogarive ( Zv.Kryetar Dege). . . . | 1 | 6.500 |
| | S H U M A : | 2 | |
| | IV.- DREJTORIJA E T'ARDHURAVE | | |
| 39. | D r e j t o r. . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 10.000 |
| | a) DEGA E T'ARDHURAVE SHTETNORE | | |
| 40. | Kryetar Dege ( Zv.Drejtor) . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| | SEKSIONI I PLANIFIKIMIT | | |
| 41. | Shef Seksioni ( Zv.Kryetar Dege) . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 42. | Kryo-Referent. . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |

../...

- 3 -

| NR. RAD. | EMERTIMI I DETYRAVE | NUMRI I PERSONELIT | RROGA |
|---|---|---|---|
| 43. | R e f e r e n t . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 3.800 |
| | SEKSIONI [illegible] | | |
| 44. | Shef Seksioni. . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 45. | Kryo-Referent . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| | SEKSIONI [illegible] | | |
| 46. | Shef Seksioni . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| | SEKTORI I REVIZIONIT | | |
| 47. | Kryo-Revizor. . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 6.000 |
| 48. | R e v i z o r . . . . . . . . . . . . . . . . . | 2 | 5.200 |
| | S h u m a : | 10. | |
| | b) DEGA E [illegible] | | |
| 49. | Kryetar Dege. . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| 50. | Kryo-Referent i lutjeve dhe ankesave. . . . . . | 1 | 4.500 |
| | SEKSIONI [illegible] | | |
| 51. | Shef Seksioni ( Zv.Kryetar Dege). . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| | R e f e r e n t . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 3.800 |
| | SEKSIONI [illegible] | | |
| 52. | Shef Seksioni . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| | SEKTORI I REVIZIONIT | | |
| 53. | Kryo-Revizor . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 6.000 |
| 54. | R e v i z o r ë . . . . . . . . . . . . . . . . | 3 | 5.200 |
| | S h u m a : | 9 | |
| | V.- DREJTORIJA E ORGANIZIMIT DHE E PAGAVE | | |
| 54. | D r e j t o r . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 10.000 |
| | a) DEGA E ORGANIZIMIT DHE PAGAVE | | |
| 55. | Kryetar Dege,( Zv.Drejtor). . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| 56. | Referent i kartotekes . . . . . . . . . . . . . | 1 | 3.800 |
| | SEKSIONI [illegible] PAGAT | | |
| 57. | Shef Seksioni ( Zv.Kryetar Dege ) . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| | SEKSIONI ORGA.E PAG.[illegible] | | |
| 58. | Shef Seksioni . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| | SEKSIONI ORGAN.E PAG.[illegible] | | |
| 59. | Shef Seksioni . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| | SEKSIONI ORGAN.PAG.[illegible] | | |
| 60. | Shef Seksioni . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| | S h u m a : | 6 | |
| | b) DEGA [illegible] ADMINISTRATIVE | | |
| 61. | Kryetar Dege. . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.800 |
| 62. | Kryo-Referent . . . . . . . . . . . . . . . . . | 2 | 4.500 |
| | S h u m a : | 3 | |
| | SEKTORI I REVIZIONIT | | |
| 63. | Kryo-Revizor. . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 6.000 |
| 64. | R e v i z o r ë . . . . . . . . . . . . . . . . | 3 | 5.200 |
| | ../... S h u m a : | 4 | |

| Nr. Rend | EMERTIMI I DETYRAVE | [illegible] | [illegible] |
|---|---|---|---|
| | VI.- DREJTORIJA E KURSIMEVE DHE SIG. SHTETRORE | | |
| 65. | D r e j t o r . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 10.000 |
| 66. | N /Drejtor. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 8.000 |
| | a) DEGA E HUAVE SHTETRORE DHE KURSIMEVE | | |
| 67. | Kryetar Dege. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| | SEKSIONI I HUAVE SHTETRORE | | |
| 68. | Shef Seksioni ( Zv.Kryetar Dege ) . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 69. | Krye-Referent i Thesarit dhe i Obligacioneve. . | 1 | 4.500 |
| | SEKSIONI I KURSIMEVE | | |
| 70. | Shef Seksioni . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 71. | Krye-Referent . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| 72. | P i k t o r . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.000 |
| | S H U M A : | 6 | |
| | b) DEGA E SIGURIMEVE SHTETRORE | | |
| 73. | Kryetar Dege. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| | SEKSIONI I SIG. JETËS DHE PRONËS | | |
| 74. | Shef Seksioni ( Zv.Kryetar Dege ) . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 75. | Krye-Referent . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| 76. | [illegible] . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | - |
| | SEKSIONI I SIG. BUJQËSISË E BLEGTORISË | | |
| 77. | Shef Seksioni . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 78. | Krye-Referent . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| 79. | A g r o n o m . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | - |
| 80. | V e t e r i n e r . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | - |
| | S H U M A : | 8 | |
| | c) DEGA E KONTABILITETIT DHE E REVIZIONIT | | |
| 81. | Kryetar Dege. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| 82. | K/Llogaritar ( Zv.Kryetar Dege ) . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 83. | Krye-Referent për plan financë. . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |
| 84. | Llogaritar. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 2 | 4.000 |
| 85. | Krye-Revizor. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 6.000 |
| 86. | R e v i z o r . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 3 | 5.200 |
| | S H U M A : | 9 | |
| | VII.- DREJTORIJA E KONTROLLIT | | |
| 87. | D r e j t o r . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 10.000 |
| | SEKSIONI I ORGANIZIMIT | | |
| 88.- | Shef Seksioni ( Zv.Drejtor ). . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 89. | Krye-Revizor. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 10 | 6.000 |
| 90. | R e v i z o r ë . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 13 | 5.200 |
| | S H U M A : | 25 | |
| | VIII.- DEGA E KUADRIT | | |
| 91. | Kryetar Dege. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| 92. | K/Referent i Kartotekës . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.500 |

../...

- 5 -

| Nr. Ren | Emertimi i detyrave | Numri i personel. | [illegible] |
|---|---|---|---|
| | [illegible] | | |
| 93. | Shef Sektori ( Zv.Kryetar Dege) . . . . . . . . . . | 1 | [illegible] |
| | IX.- DEGA E SHËRBIMIT VALUTAVE | | |
| 94. | Kryetar Dege. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 7.000 |
| | SEKTORI I [illegible] | | |
| 95. | Shef Sektori ( Zv.Kryetar Dege). . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 96. | L l o g a r i t a r . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 4.000 |
| | S H U M A : | 3 | |
| | X.- DEGA [illegible] | | |
| 97. | Kryetar Dege. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | - |
| 98. | Zv.Kryetar Dege . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | - |
| | S H U M A : | 2 | |
| | XI.- DEGA E ADMINISTRATËS | | |
| 99. | Kryetar Dege. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 6.400 |
| 100. | Ndihmës i Kshilltarit. . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 6.500 |
| 101. | J u r i s t i . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.800 |
| 102. | K/P r o t o k o l l i s t . . . . . . . . . . . . . | 1 | 3.400 |
| 103. | P r o t o k o l l i s t . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 3.200 |
| 104. | K o p i s t e . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 2 | 3.200 |
| 105. | K/Llogaritar. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 106. | Ekonomat-Magazinier . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 3.800 |
| 107. | P a s t r u e s e . . . . . . . . . . . . . . . . . | 3 | 2.400 |
| 108. | K o r i e r. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 2.400 |
| 109. | Shofer i Ministrit . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | - |
| 110. | " i Kshilltarit. . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | - |
| 111. | " i Ministrisë. . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 2 | - |
| 112. | C e n t r a l i s t e . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 2.400 |
| 113. | P o r t i e r . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 2.400 |
| 114. | Referent i [illegible] . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 3.600 |
| 115. | K/K o p i s t e . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 3.400 |
| 116. | Shaptilografist . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 3.200 |
| 117. | Kaloriferist. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 2.600 |
| 118. | Shef Sektori Sekret. . . . . . . . . . . . . . . . | 1 | 5.200 |
| 119. | Proto-arkiviste Sekrete. . . . . . . . . . . . . . | 1 | 3.800 |
| 120. | K o p i s t e . . . . . . . . . . . . . . . . . . . | 2 | 3.200 |
| | S H U M A : | 27 | |
| | Totali si Dikaster: | 140 | |



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

**VENDIM**

Nr. ______ dt. ______

MBI

HEQJEN E SHTESËS MBI PAGË PËR RANG DIPLOMATIK PËR PUNONJËSIT E MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME

Këshilli i Ministrave, duke u mbështetur në luftën e gjithanshme që klasa punëtore dhe masat punonjëse zhvillojnë nën udhëheqjen e partisë kundër të gjitha shfaqjeve të burokratizmit për forcimin e aparateve shtetërore dhe për kalitjen e mëtejshme revolucionare të kuadrove,

V E N D O S I :

1. Të hiqet shtesa për rang diplomatik për punonjësit e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

2. Pika 1 e shënimeve të lidhjes Nr.3 të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.88 datë 24.6.1967, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
( MEHMET SHEHU )

Organika e Ministrisë së Financave
*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 914, viti 1954, f. 174-179*



31

RELACION

PER

NOMENKLATURËN E KUADRIT

Në qëllim që rregullat e caktuara nga Komiteti Qëndror i Partisë, për emërimet e kuadrove si dhe për gjithë punën me kuadrot, të zbatohen edhe në rrugë shtetërore, paraqesim projekt-vendimin mbi nomenklaturën e kuadrit.

Për projekt-vendimin që u paraqitet, jemi bazuar në vendimin dhe instruksionet përkatëse të Byrosë Politike të Komitetit Qendror P.P.SH.

Ky projekt-vendim i u dha dikastereve dhe institucioneve qëndrore për të bërë vërejtjet e tyre. Ato vërejtje që neve na u dukën se janë në vend, i u paraqitëm aparatit K.Q.P.P.SH. dhe për ato që bashkërisht u ramë dakord u inkluduan në këtë projekt.

Vërejtjet e dikastereve për të cilat ne dhe aparati i K.Q.P.P.SH. s'jemi dakord, janë :

1.- Ministria e Shëndetësisë propozon që të shtohen për kuadrot e shëndetësisë emërtimet përkatëse, p.sh. mjek, ndihmës/mjek, "infermier" laborant" etj. kurse ne mendojmë që këto të përfshihen në emërtimin "teknikë të lartë", të "mesëm" dhe "të ulët".

Ministria e Ndërtimit gjithashtu bën vërejtje që në projektin e nomenklaturës të shtohet shprehimisht "disenjatorë", "figuranta", "n/teknik" etj. Ne mendojmë se edhe këto përfshihen në emërtimin "teknikë të mesëm" e "të ulët".

2.- Komisioni i Kontrollit të Shtetit kërkon të shtohet: "K. Kontrollit të Shtetit ka të drejtë të marrë masa disiplinore deri në pushim nga vendi për të gjithë kuadrot me përjashtim të kuadrove të nomenklaturës së K.Q.P.P.SH. dhe të Këshillit të Ministrave". Ne mendojmë kjo të mos hyrë me qenë që është e përcaktuar në dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor Nr.1480 neni 4 germa c.

3.- B.Q. i Artizanatit propozon që të shtohen për nomenklaturën e Këshillit të Ministrave: anëtarët e Këshillit Qëndror të Bashkimit t'Artizanatit. Ne dhe K.Q. jemi të mendimit që këto të bëhen me aprovimin e aparatit të K. Qendror P.P.SH. dhe me qenë se janë organe të zgjedhura të mos përfshihen në këtë projekt-vendim.-

13/XI/1956.-

SEKRETARI I PERGJITHSHEM :
( Spiro [illegible] ) d.v.

Mbi nomenklaturën e kuadrit

*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 500, viti 1956, f. 1*

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Tabela Nr.1

[illegible]

| Nr. Rend. | D i k a s t e r i : | Numri i vëndeve që shkurtohen: |
|---|---|---|
| 1/ | Ministria e ministrave dhe [illegible] | 102 |
| 2/ | " industrisë | 55 |
| 3/ | " bujqësisë | 55 |
| 4/ | " komunikacionit | 30 |
| 5/ | " tregtisë | 50 |
| 6/ | Komiteti [illegible] i [illegible] | 45 |
| 7/ | Drejtoria e [illegible] | 25 |
| 8/ | Bashkimi qëndror i koop. [illegible] | 15 |
| 9/ | Bashkimi qëndror i koop. [illegible] | 20 |
| | Shuma: | 417 |

Tabela Nr.2

[illegible]

| Nr. Rend. | D i k a s t e r i : | Shkurtimet që fugin per 1960 | Shtesat që lirë organika |
|---|---|---|---|
| 1/ | Ministria e ministrave dhe [illegible] | – 263 | + 263 |
| 2/ | Ministria e [illegible] | – 174 | + 174 |

V E R T E T O H E T,
SEKRETARI I [illegible]
( [illegible] )d.v.

[illegible]

Pasqyrë mbi shkurtimin e personelit
*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D 151, viti 1960, f. 3*

PROJEKT-VENDIM

PER

NOMENKLATUREN E KUADRIT

Keshilli i Ministrave i Republikes Popullore te Shqiperise, me qellim qe me vendosjen e kuadrove t'aparatit shteteror te ndiqet nje procedure e njellojte, dhe ne perputhje me rregullat e vena nga Komiteti Qendror i P.P. te Shqiperise, ne mbledhjen e tij te dates ............:

V E N D O S I :

I.- NOMENKLATURA E KESHILLIT TE MINISTRAVE TE R.P.SH.:

1. Ne nomenklaturen e Keshillit te Ministrave te R.P. te Shqiperise, hyjne kuadrot me funksionet qe vijojne:

- Ndihmësit e sektoreve te aparatit te Kryeministrise dhe instruktoret e sektorit te pushtetit lokal.
- Kryetaret e degeve te ndryshme t'aparatit te Kryeministrise me perjashtim te kryetarit te deges kuadrit.
- Zv/Kryetari dhe anetaret e arbitrazhit shteteror prane Keshillit te Ministrave.
- Kryeinspektoret, inspektoret dhe kryellogaritaret e aparatit te Kryeministrise.
- Kryetaret e zyrave te ndryshme prane Kryeministrise, stenografet, sekretaret e Kryeministrit dhe te Zv/Kryeministrave.
- Kryetaret e degeve te ministrive dhe te institucioneve te tjera qendrore, shteterore e kooperativiste, me perjashtim te kryetareve te degeve te kuadrit, si dhe ata te prokurorise pergjithshme, te gjykates se larte dhe t'aparatit Presidiumit te Kuvendit Popullor.

./..

- Drejtori administrativ i Institutit te Shkencave dhe sekretari shkencor i Presidiumit te Institutit te Shkencave.

- Nv/drejtoret per anen shkencore te Institutit bujqesor e zoologjik dhe te Institutit te historise dhe te gjuhesise.

2. Kuadrot e tjera te aparatit te Kryeministrise qe nuk perfshihen ne nomenklaturen e Komitetit Qendror te P.P. te Shqiperise dhe te Keshillit te Ministrave te R. P. te Shqiperise, vendosen ne aprovimin e Nv/Kryeministrave, sipas sektoreve te tyre, ose te Sekretarit te Pergjithshem te Kryeministrise.

II.- NOMENKLATURA E MINISTRIVE DHE E INSTITUCIONEVE TE TJERA QENDRORE, SHTETERORE E KOOPERATIVISTE:

3. Ne nomenklaturen e Ministrive dhe te Institucioneve te tjera qendrore, shteterore e kooperativiste hyjne te gjitha kuadrot e aparatit te tyre me funksione me te ulta nga ato qe permenden ne pikat 1 te ketij vendimi.

4. Ne nomenklaturen e perbashket te ministrive ose institucioneve te tjera qendrore, shteterore dhe kooperativiste, dhe te komiteteve te partise per qarqet e rrethet qe lidhen drejtperdrejt me qendren, hyjne kuadrot qe jane caktuar ne nomenklaturen e Komitetit Qendror te P.P. Shqiperise.

III.- NOMENKLATURA E KOMITETEVE EKZEKUTIVE TE K.P. TE QARQEVE DHE RRETHEVE QE LIDHEN DREJTPERDREJT ME QENDRIN.

5. Ne nomenklaturen e komiteteve ekzekutive te K.P. te qarqeve dhe te rretheve qe lidhen drejtperdrejt me qendren hyjne kuadrot e aparatit te tyre me funksione nga referent e poshte.

IV.- NOMENKLATURA E NDERMARRJEVE SHTETERORE NACIONALE:

6. Ne nomenklaturen e ndermarrjeve shteterore nacionale hyjne kuadrot me funksione daktilografist e poshte si dhe punetoret e

./..



- 3 -

të gjitha kategorive.

V.- <u>PROCEDURA PËR VENDOSJEN E KUADROVE.</u>

8.- Emërimet, lëvizjet dhe pushimet e kuadrove të aparatit administrativ dhe të organizatave kooperativiste, bëhen në bazë të propozimeve të organeve [illegible] në të cilat bëhen [illegible] që [illegible] dhe me [illegible] e organit që e ka në nomenklaturë.

9.- Propozimet për vendosjen e kuadrit që hyn në nomenklaturën e Këshillit të Ministrave të R.P. të Shqipërisë, si dhe të kuadrit që hyn në nomenklaturën e Komitetit Qendror të P.P. Shqipërisë, kur propozimi bëhet nga ministritë ose institucionet qendrore, bëhen mbasi të jetë marrë dhe mendimi i komitetit të partisë për qarkun ose për rrethin që lidhet drejtpërdrejt me qendrën në juridiksionin e të cilit punon ky kuadër. Mendimi merret me shkrim ose verbalisht nga titullari i ministrisë ose i institucionit, përgjegjës sekretari të komitetit të partisë dhe shënohet në propozimin që i bëhet Komitetit Qendror.

Kur propozimi bëhet për një kuadër që punon në aparatin e ministrisë ose institucionit që bën propozimin, atëhere merret vetëm mendimi i byrosë së organizatës bazë të atij institucioni ose, kur nuk ka byro, i sekretarit të organizatës bazë. Edhe në këtë rast mendimi i marrë shënohet në propozimin që i dërgohet respektivisht Këshillit të Ministrave ose Komitetit Qendror të Partisë.

10.- Për kuadrot që hyjnë në nomenklaturën e përmendur të institucioneve qendrore shtetërore dhe kooperativiste dhe të komiteteve të partisë për qarqet dhe rrethet që lidhen drejtpërdrejt me qendrën, veprohet në mënyrë që vijon: kur një institucion vendos të bëjë një lëvizje kuadri bëhet për të të merret edhe mendimi i paraprak nga byroja e komitetit të partisë për qarkun ose rrethin i cili i dërgohet nga sekretari institucionit qendror shtetëror ose kooperativist përkatës. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe kur vendos [illegible] komiteti i partisë të një qarku ose rrethi që lidhet drejtpërdrejt me qendrën.

./..

Kur të dy organet që e kanë në nomenklaturë nuk bien dakord midis tyre, çështja i referohet Sekretariatit të Komitetit Qendror të P.P.të Shqipërisë për t'u zgjidhur.

11.- Për lëvizjen e kuadrove që hyjnë vetëm në nomenklaturën e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore shtetërore e kooperativiste, ose të komiteteve ekzekutive të k.p.të rretheve dhe rretheve që lidhen drejtpërdrejt me qendrën ose të ndërmarrjeve shtetërore kur kjo lëvizje bëhet brenda për brenda sferës së tyre vendos titullari, i ministrisë, institucionit ose ndërmarrjes, por duke marrë kurdoherë në konsideratë edhe mendimin e byrosë së organizatës bazë të partisë dhe atje ku nuk ka byro të sekretarit të organizatës bazë. Vendimi jepet verbalisht, por duhet të shoqërohet me dokumentet që parashikohen për emërim.

12.- Për vendosjen e një kuadri duhet të shihen nevojat që e dhe të jepet mendimi politik dhe [illegible] në punë. Organet shtetërore dhe kooperativiste për propozimet që bëjnë për lëvizje dhe emërime të kuadrit duhet të paraqitin këto dokumente:

a) propozimin sipas në formë të një relacioni të shkurtër [illegible], ku të përshkruhen arsyet për të cilat kuadri propozohet. Në relacion duhet të [illegible] edhe mendimi i komitetit përkatës të partisë ose i byrosë të organizatës bazë ose i sekretarit të organizatës bazë (kur nuk ka byro);

b) karakteristikën e kuadrit;

c) një kopje të autobiografisë, dhe të fletë-anketës personale, kur ky kuadër duhet për herë të parë në nomenklaturën e organit të cilit i drejtohet propozimi.

Për kuadrot që propozohen të lëvizin paraqiten njëkohësisht edhe propozimi se me kë do zëvendësohet, ose kur ky kuadër i fundit, nuk përfshihet në nomenklaturën e organit që i propozohet.

13.- [illegible] i propozimeve të bëra për vendosje kuadri nuk

./..

duhet të zgjidhet në jo më shumë se 15 ditë për ministritë, institucionet e tjera qëndrore, komitetet ekzekutive të k.p. të qarqeve dhe rretheve që lidhen drejtpërdrejt me qëndrën dhe ndërmarrjet shtetërore, dhe 20 ditë për Këshillin e Ministrave të R.P. të Shqipërisë. Në përfundim të shqyrtimit të procedimit vihet në dijeni me shkrim organi i interesuar. Vendimi i marrë i komunikohet verbalisht edhe të interesuarit nga personi kryesor që e ka në varësi.

VI.- RUAJTJA E DOKUMENTEVE TË KUADROVET.

14.- Dosjet personale dhe evidenca e kuadrit të nomenklaturës së Këshillit të Ministrave mbahen nga dega e kuadrit pranë Kryeministrisë.

Ministritë dhe institucionet e tjera qëndrore mbajnë dosjet personale kuadrit të nomenklaturës së tyre, duke përfshirë edhe kuadrin e nomenklaturës së dyfishtë dhe të asaj të Këshillit të Ministrave.

Ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore me karakter social që varen nga ministritë, mbajnë dosjet personale për kuadrot e nomenklaturës së tyre.

Komitetet ekzekutive të k.p. të qarqeve dhe rretheve që lidhen drejtpërdrejt me qëndrën, mbajnë dosjet personale kuadri për kuadrot e nomenklaturës së tyre.

15.- Dosjet personale të kuadrit përmbajnë: fletë njoftimi, autobiografinë, fotografinë, karakteristikat dhe dokumente e vendime të ndryshme mbi kuadrin. Dokumentet përkatëse të kuadrit plotësohen për të gjithë kuadrot që përfshihen në nomenklaturë.

16.- Dosjet personale të kuadrove mbahen sipas rendit alfabet dhe regjistrohen në një indeks të veçantë i cili duhet të ketë këto kolona: numurin rendor, emrin, emrin e babait, shënimin e lindjes dhe vendlindjen kolonën e fundit bëhen shënimet përkatëse kur kuadri lëviz nga një nomenklaturë në tjetrën.

Të gjitha materialet që përbëjnë dosjen e kuadrit regjistrohen në listën e dokumentave që vihet po në këtë dosje dhe që nënshkruhet nga shefi ose kryetari i degës së kuadrit të institucionit përkatës.

Materialet që ndodhen në dokumentat e kuadrit ndahen në tri pjesë: në pjesën e parë vendosen fletë anketa dhe autobiografi në pjesën e dytë, - karakteristikat të radhitura sipas vjetëve dhe në pjesën e tretë, - materiale të ndryshme (dokumenta shkollore vendime të ndryshme, pjesë nga shtypi, informacione, deklarata e tjera).

11.- Dokumentat e kuadrit plotësohen në mënyrën që vijon:

a) Autobiografija plotësohet vetë nga secili kuadër. Në autobiografinë kuadri shënon me hollësi jetën dhe punën e tij deri në kohën e shkrimjes së saj duke sqaruar të gjitha çështjet që kanë lidhje me personin e tij. Autobiografija shkruhet me dorë nga vetë i interesuari dhe në një kopje me dokumenta ruhen për atë kuadër;

b) Fletë anketa plotësohet, gjithashtu, nga i interesuari. Shefi i seksionit ose kryetari i degës së kuadrit ahere bën verifikimin e fletë anketës personale dhe të autobiografisë që ka paraqitur kuadri me anën dhe shënimin e tij të plotë dhe firmën. Kur s'ka të drejtë shefi i seksionit i kuadrit kërkon deklarata e të dhëna nga organet e shtetit dhe të partisë nga vjen ky kuadër dhe shënon nga organet e drejtësisë. Për anëtarët me parti duhet të bëhet edhe krahasimi me dokumentet e partisë duke iu drejtuar për këtë komitetit të partisë të qarkut ose rrethit. Edhe fletë anketa personale bëhet në një kopje që dokumenta ruhen për atë kuadër.

Për çdo dokument kuadri dorëzon nga një fotografi në masën 3-4 cm.;

c) Karta e detyrave plotësohet nga dega ose zyra e kuadrit dhe shërben për ndjekjen e evidencës së lëvizjeve të kuadrit për një periudhë të caktuar. Karta e detyrave mbahet nga të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore për nomenklaturën e tyre. Plotësimi i kartave të detyrave të fillojë duke përfshirë periudhën nga 1 janari 1956.

./..

 

Dokumentet e përmendura në gërmën b) dhe c) janë sipas modelit që përmban instruksioni i Komitetit Qëndror të P.P.të Shqipërisë (botuar në vitin 1955).

18.- Për kuadrot me gradën nën referent e poshtë dhe për punëtorët e të gjitha kategorizimeve, mbahet kartelë personale sipas modelit që i bashkangjitet këtij vendimi dhe autobiografija.

19.- Degët e seksionit ose zyrat e kuadrit të institucioneve shtetërore kanë për detyrë të pasurojnë vazhdimisht dokumentet e kuadrit në mënyrë që këto të pasqyrojnë gjithnjë jetën reale të kuadrit gjatë zhvillimit të tij, rezultatet që ka arritur kuadri në punë, me qëllim që të mund të bëhet një politikë e drejtë mbi vendosjen e kuadrit, sipas aftësive dhe besnikërisë të tij politik.

<u>Pasurimi i dokumentave të kuadrit bëhet në këtë mënyrë:</u>

a) Me anë të karakteristikave që paraqiten me rastin e propozimit për vendosje kuadri. Në këto karakteristika përveç gjeneraliteteve të kuadrit duhet të përshkruhet dhe veprimtaria e tij në punë, aftësija profesionale dhe organizative e kuadrit, përpjekjet e tij për ngritjen ideollogjik kulturel e profesional, qëndrimi dhe sjellja e tij kundrejt punës e shokëve, disiplina në punë, sjelljet e tij në shoqëri etj. duke nxjerrë si anët pozitive dhe ato negative. Karakteristikat duhet të jenë reale dhe objektive dhe në përpilimin e tyre duhet të merret dhe mendimi i byrosë ose i sekretarit të organizatës bazë të partisë në punë;

b) me anë të shtojcës autobiografive, të dokumentave shkollore, të vendimeve të ndryshme që merren nga pushteti ose partia për atë kuadër, të materialeve të ndryshme dhe të opinioneve që duhet të jepin kurdo ndonjë herë kuadrot drejtuese të institucioneve, materialeve të shtypit që flasin për atë kuadër dhe të takimeve të përgjegjësave me kuadrin;

Për të gjitha ndryshimet që pësojnë kuadrot organet që e kanë kuadrin në evidencë e tyre duhet të njoftojnë organet më të larta në nomenklaturën e të cilëve hyn kuadri, me anë të një modeli të njëllojtë me atë Nr.1 që përmban instruksioni i Komitetit Qëndror të P.P.të Shqipërisë ose me relacion të veçantë që bashkangjitet modelit Nr.1.

./..

Këto ndryshime shënohen në fletë anketën dhe dokumenti vendoset në dosjen personale të kuadrit sipas merret përsipri i përgjegjësit të institucionit.

Materialet që vendosen në dokumentet e kuadrit nuk duhet të hiqen prej andej qoftë edhe sikur të jenë me përmbajtje jo të saktë. Në raste të tilla duhet të bëhet verifikimi këto shënohen në dokumentet përkatëse me sqarimin.

20.- Për të lëvizur dokumentet e kuadrit nga një nomenklaturë në tjetrën veprohet në këtë mënyrë:

a) Kur një kuadër propozohet për të lëvizur për herë të parë nga një nomenklaturë në tjetrën, organi që bën propozimin i dërgon organit më të lartë, së bashku me propozimin edhe dokumentin e tij si kuadër. Kur propozimi aprovohet dokumenti mbahet nga organi në nomenklaturën e të cilit kaloi kuadri, ndërsa kur nuk aprovohet dokumenti i kthehet përsëri organit që ka bërë propozimin;

b) kur kuadri transferohet nga një institucion në tjetrin, duke u përfshirë edhe rastet kur mbetet në të njëjtën nomenklaturë, organi pranë të cilit mbahen dokumentet e kuadrit ja dërgon, brenda 10 ditëve nga transferimit, organit pranë të cilit u transferua kuadri;

Dokumentet e kuadrove që dalin nga nomenklatura dhe të atyre që vdesin ruhen në arkivën të posaçme.

21.- Dokumentet e kuadrit duhet të mbahen në dhoma të sigurta dhe të veçanta ku ndalohet hyrja e njerëzve të tjerë përveç nëpunësve që merren me kuadrin dhe atyre që janë caktuar për t'i kontrolluar.

Çdo dosje tërhiqet me një fletëse të rregullt, të lëshuar nga personi i lejuar për të tërhequr dokumentin për studim.

Dosjet e kuadrit nuk duhet të dalin jashtë arkivës ku mbahen përveç rasteve të përcjellit nëpër rrugë zyrtare. Çdo dosje e tërhequr gjatë ditës nga personat e autorizuar për studim duhet të dorëzohet para mbarimit të orarit zyrtar në zyrën e kuadrit.

Çdo nëpunës që punon në zyrën e kuadrit ka përgjegjësi personale për kujdesin që janë ngarkuar të mbahen. Gjithashtu personi që tërheq për studim dokumentet e kuadrit ka përgjegjësi në rast se bën ndonjë

./..

10

- 9 -

material. Kur humbet ndonjë dokument mbahet proçes verbal i rregullt rreth humbjes së tij e i cili firmoset nga [illegible] i kuadrit dhe nga personi që ka humbur dokumentin, mbasi u njoftuar menjëherë përgjegjësi kryesor që merret me kuadrin.

21.- Kanë të drejtë të studjojnë dokumentat e kuadrit:

a) Përgjegjësat e institucioneve dhe zëvendësat e tyre për dokumentat që hyjnë në nomenklaturën e institucionit që drejtojnë si dhe dokumentat e kuadrove që hyjnë në nomenklaturën e institucioneve që varen prej tyre;

b) Drejtorët e drejtorive qëndrore dhe zëvendësit e tyre për kuadrot e drejtorisë së tyre;

c) Kryetarët zëvendëskryetarët dhe sekretarët e komiteteve ekzekutive për kuadrot e nomenklaturës së tyre dhe të ndërmarrjeve e institucioneve lokale që varen prej tyre si edhe përgjegjësit e kuadrit aty.

Kanë të drejtë të kontrollojnë zyrat e kuadrit të institucioneve qëndrore shtetërore punonjësit e aparatit të Komitetit Qëndror të P.P.të Shqipërisë për sektoret e tyre; kuadrot që punojnë në zyrën e regjistrimit të kuadrit në Komitetin Qëndror të P.P.Sh.,/ inspektorët e Komitetit Qëndror P.P.Sh. në Sek I/Dega e kuadrit në Kryeministri për të gjitha zyrat e kuadrit në çdo institucion shtetëror [illegible] organizatës bazë të partisë për zyrat e kuadrit të qendrës së punës ku ata punojnë si dhe zyrat e kuadrit të dikasterit dhe institucionet qëndrore.

VII.- RAPORTIMI I KUADRIT DHE MËNYRA E PLOTËSIMIT TË TYRE

22.- Për punën me kuadrin përdoren këto raporte statistikore:

a) Raporti mbi përbërjen e kuadrit;

b) raport mbi lëvizjen e kuadrit;

c) raport mbi dhënien dhe shlyerjen e masave ndëshkimore;

ç) raport mbi përbërjen e kuadrit teknik;

d) raporti vjetor mbi politikën e kuadrit;

dh) raport mujor mbi vëndet vakante.

Modeli i raporteve statistikore të lartëpërmëndur është i njëllojtë me atë që përmëndet në instruksionin e Komitetit Qëndror të P.P.të Shqipërisë.

./..

23.- Raporti mbi përbërjen e kuadrit i dërgohet Komitetit Qendror të P.P.Sh. nga ministritë dhe institucionet e tjera qëndrore për kuadrin e nomenklaturës së tyre dhe për ato të nomenklaturës së Komitetit Qendror.

Gjithashtu këtë raport, organet inferiore ua dërgojnë organeve superiore nga varen, për nomenklaturën e tyre dhe për atë të organeve superiore.

Në të njëjtën kohë organeve më të larta u dërgohet nga organet më të ulta dhe lista kontrolluese ku shënohet organika dhe përbri saj emrat e kuadrove të nomenklaturës të organit më të lartë, me qëllim që të mund të kontrollohet në se organet më të ulta kanë marrë pa aprovimin përkatës kuadro të nomenklaturës të organit më të lartë. Për këtë çdo institucion shtetëror duhet të mbajë librin e organikave ku shënohet përgjegjësija e kuadrit, emri atësija dhe mbiemri. Kjo mbahet për tërë kuadrot që kanë në efektivin e tyre pavarësisht nga nomenklatura.

24.- Raporti mbi lëvizjen e kuadrit u dërgohet organeve superiore nga organet vartëse vetëm për lëvizjet e kuadrit të nomenklaturës [illegible] të fundit. Ky raport plotësohet nga shënimet që mbahen për të gjitha lëvizjet e nomenklaturës së organit që i dërgon në një regjistër të posaçëm, të ndarë në tri pjesë ku shënohen ngritjet, uljet dhe lëvizjet orizontale e të tjera. Regjistri duhet të ketë këto të dhëna: emrin e mbiemrin, datëlindjen, origjinën shoqërore, stazhin në parti, shkollën që ka kryer, arsimin në parti, kurset profesionale, përgjegjësinë që kish, përgjegjësinë që merr, arsyet e lëvizjes.

25.- Raporti statistikor mbi masat ndëshkimore u dërgohet organeve më të larta nga organet më të ulta për kuadrot që janë në efektivin e këtyre të fundit pavarësisht nga nomenklatura.

Në këtë raport përveç masave të dhëna do të shënohen edhe masat e shlyera. Institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore, masat që marrin kuadrot e tyre nga ana e partisë, duhet t'i përcjellin nga sekretarët e organizatës bazë të partisë.

./..

- 11 -

26.- Raporti mbi teknikën e lartë i dërgohet Komitetit Qëndror të P.P.Sh. vetëm nga ministritë dhe institucionet të tjera qëndrore shtetërore që kanë në ekonomin e tyre teknikë të lartë, pavarësisht se i kanë ose jo në [illegible].

27.- Raporti vjetor mbi politikën e kuadrit u dërgohet organeve më të larta së bashku me raportet e përmendura në pikat 23,24,25 dhe 26. Në këtë raport [illegible] gjendja e kuadrit, si edhe në tërë kompleksin politika e kuadrit (ngritja, vendosja, pregatitja, [illegible] e tjera). Ky raport jepet në shkrim dhe duhet të përmbajë hollisira, konkluzione e masa për përmirësimin e gjëndjes dhe jo në formën e një shpjegimi të thjeshtë të raporteve statistikore. Të përpara se të bëhet ky raport organi përkatës duhet të shqyrtojë problemin e kuadrit pregatitjen dhe në bazë të këtij shqyrtimi, të konkluzioneve dhe detyrave që do të nxjerrë të përpilohet raporti.

28.- Raporti mujor mbi vëndet vakante u dërgohet organeve më të larta nga organet më të ulta për të lajmëruar mbi vëndet vakante.

VIII.- [illegible]

29.- Në qëllim që të evitohen gabimet dhe të kemi uniformitet në plotësimin e fletë anketës personale ministritë dhe institucionet e tjera qëndrore si dhe të gjitha institucionet e tjera të [illegible] shtetërore [illegible] të udhëhiqen për këtë nga "Udhëzimi për mbushjen e fletë anketës personale" i aprovuar nga Byroja Politike e Komitetit Qëndror të P.P.të Shqipërisë.

30.- Për plotësimin e rregullt të raporteve statistikore që u përmendën në kapitullin VII të këtij vendimi, të gjitha institucionet shtetërore të udhëhiqen nga "Udhëzimi mbi plotësimin e raporteve statistikore të kuadrit" aprovuar nga Byroja Politike e Komitetit Qëndror të P.P.të Shqipërisë.

31.- Për zbatimin e detyrave që përmenden në këtë vendim të bëhet një kujdes i veçantë nga të gjithë udhëheqësit e institucioneve shtetërore dhe nga punonjësit që merren me kuadrin. Për plotësimin në rregull, të detyrave që përmenden në këtë vendim, të [illegible]


DAP

- 1[illegible] -

[illegible] ndër-marrjeve [illegible] dhe jo më pakë se një herë në vit të bëhet kontroll i përgjithshëm i regjistrimit [illegible] të kuadrit në lidhje me mbaj-tjen e rregullt të dokumentave, plotësimin e dokumentave të kuadrit, plotësimin dhe mbajtjen e evidencave dhe të regjistrave në rregull e tjera.

Ministritë dhe institucionet e tjera qëndrore të ushtrojnë kontroll mbi organet varëse dhe të japin ndihmën e nevojshme për zbatimin e detyrave që përcaktohen në këtë vendim.

[illegible].- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.-

---

Dakt. [illegible]

18/VI/195[illegible].-

Projektvendim mbi nomenklaturën e kuadrit

*Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Këshilli i Ministrave, D.151, viti 1960, f. 2-13*

# Departamenti i Administratës Publike gjatë 18 viteve të saj

Departamenti i Administratës Publike (DAP) është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 443, datë 05.09.1994, si një njësi brenda strukturës së Kryeministrisë, e cila, në përputhje me programin e qeverisë, do të kryente studimet, projektligjet dhe projektaktet nënligjore për strukturën, detyrat dhe funksionimin e administratës publike.

Gjatë kësaj periudhe, Departamenti i Administratës Publike caktohet përgjegjës për hartimin e politikës së përgjithshme të formimit, rekrutimit dhe promocionit (promovimit) të nëpunësve të administratës publike. Së bashku me Ministrinë e Punës, Emigracionit e Përkrahjes Sociale, si dhe Ministrinë e Financave, DAP-i merr një përgjegjësi tjetër të rëndësishme: hartimin e sistemit të pagave dhe të shpërblimeve për administratën publike dhe konceptohet si një qendër koordinuese dhe zbatuese e asistencës teknike për administratën publike.

Pra, DAP-i u ideua si urë lidhëse për të gjitha nivelet e strukturës organizative e funksionale të administratës publike, me një strukturë të vogël organizative[1]. Përpjekjet për të ndërtuar një shërbim civil në Shqipëri, u konkretizuan me miratimin e ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996, "Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë", me synimin për t'i dhënë fund politizimit të administratës, duke ngritur një shërbim civil të bazuar në meritat. Njëkohësisht, krijohet një ndarje mes funksioneve politike dhe atyre tekniko-profesionale, për të cilat mendohej të funksiononte sistemi i karrierës. Miratimi i këtij ligji u shoqërua edhe me vendimin nr. 657, datë 16.09.1996, "Për rregullat e etikës në shërbimin civil", qëllimi i të cilit synonte përsosjen e shërbimit civil shqiptar, si dhe forcimin e besimit dhe të mbështetjes së publikut ndaj tij, duke përcaktuar rregulla të sjelljes së personave që punojnë në shërbimin civil.

1 Drejtori i Departamentit të Administratës Publike, këshilltari i drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, shefi i Sektorit, specialist, sekretar dhe shofer.

Departamenti i Administratës Publike tashmë nuk konceptohet vetëm si një strukturë qendrore monitoruese dhe koordinuese, por i caktohet një rol tepër i rëndësishëm: ai i promotorit të ndryshimit institucional, konceptual etj. DAP-i kryeson Grupin Ndërministror të Menaxhimit të Personelit, të Organizimit dhe të Shërbimeve[2], të cilit i njihet e drejta e përmirësimit dhe e evidentimit të problemeve të personelit. Gjithashtu, një rol i rëndësishëm i jepet atij, lidhur me përcaktimin e renditjes së punëve, përcaktimin e detyrave dhe të përgjegjësive për çdo pozicion që do t'i nënshtrohet procedurave të konkurrimit, si dhe përcaktimit të kritereve të veçanta që duhet të plotësohen për këto pozicione[3].

Pas një pune përgatitore të mbështetur edhe nga organizmat kryesore ndërkombëtare të interesuara për reformat në këtë fushë (Bashkimi Evropian dhe Banka Botërore), Kuvendi miratoi ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil". Kështu, u rikonfirmua Departamenti i Administratës Publike, si institucion që do të funksiononte në Këshillin e Ministrave (pjesë e strukturës së aparatit të Kryeministrisë), dhe Komisioni i Shërbimit Civil, si organ administrativ i pavarur[4].

Një sërë vendimesh të Këshillit të Ministrave, të cilat plotësuan të gjithë kuadrin ligjor, qartësuan rolet dhe kompetencat institucionale për realizimin e procedurave në shërbimin civil, si: rekrutimi, promovimi, largimi, vlerësimi i rezultateve vjetore, mbajtja e të dhënave personale në dosjet e personelit etj. Që prej vitit 1998, Departamenti i Administratës Publike u rrit gradualisht në numër, nga 4 në 18 punonjës. Kjo rritje sasiore, u shoqërua dhe me rritjen e cilësisë së punës dhe plotësimin e detyrimeve ligjore tepër të rëndësishme, të cilat ishin në funksion të programeve të qeverive në vite.

2 Ky grup, përbehet nga drejtuesit e drejtorive të personel-organizimit dhe të shërbimeve.

3 VKM-ja nr. 100, datë 04.02.1998, "Për procedurat e organizimit të konkurseve të kandidatëve për nëpunës civilë dhe rregullat për formën dhe përmbajtjen e njoftimit publik me anë të medias në këto konkurse".

4 Departamenti i Administratës Publike përfaqëson qeverinë në reformën për shërbimin civil, ndërsa KSHC-së i jepet roli i një arbitri administrativ të paanshëm mes institucioneve shtetërore dhe nëpunësve civilë.

Përmes Strategjisë së Komunikimit, të nisur që prej vitit 2001, edhe gjatë vitit 2003, Departamenti i Administratës Publike synoi zbatimin dhe përmirësimin cilësor të marrëdhënieve me publikun dhe institucionet e tjera. Reforma e pagave zbatohet si pjesë dhe në përputhje me strategjinë e buxhetit afatmesëm (MTF). Duke qenë se u vërejt një piramidë e përmbysur administrative, lidhur me ndarjet e pozicioneve specialiste për zbatimin e plotë të strukturës së re të pagave, Departamenti i Administratës Publike hartoi udhëzimet përkatëse për kategorizimin e pozicioneve të punës, duke përcaktuar kriteret kryesore, si: përshkrimi i punës, rëndësia e çdo pozicioni në raport me misionin e ministrisë dhe rëndësinë e çdo pozicioni brenda strukturave të brendshme të ministrisë përkatëse, duke përcaktuar përqindje fikse për çdo nivel.

Në vitin 2004[5], vlerësohet se *"Shqipëria ka bërë progres në përmirësimin e vlerësimit, rekrutimit dhe trajnimit të shërbimit civil dhe ka marrë masa për të përforcuar kuadrin ligjor."*

Në vitin 2005, në zbatim të programit të qeverisë, varësia funksionale e Departamentit të Administratës Publike ndryshoi. Kalimi nga Kryeministri, te Ministri i Brendshëm, ka synuar lehtësimin e qendrës së qeverisjes dhe atashimin e departamentit pranë ministrisë me të cilën ka afërsinë më të madhe funksionale. Gjatë këtij viti, përveç menaxhimit të përditshëm të shërbimit civil, u ndërmor për herë të parë një rishikim organizativo-funksional i institucioneve të administratës publike. Ky rishikim synoi racionalizimin e funksioneve, identifikimin e funksioneve të tepërta për çdo institucion e njësi përbërëse të tij dhe rritjen e efiçencës së strukturës së re.

Viti 2006, shënon një eksperiencë shtatëvjeçare të zbatimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", duke u bërë kështu një vit i rëndësishëm për konsolidimin e reformës në administratën publike.

Kështu, në zbatim të programit të qeverisë, Departamenti i Administratës Publike shquhet për ndërhyrjen e thellë në sistemin e pagave të nëpunësve të administratës publike. Reforma e pagave ka pasur si objektiva kryesorë të saj:

5 Raporti i Stabilizimit-Asociimit për vitin 2004, për Shqipërinë.

- krijimin e një sistemi unik pagash dhe shpërblimesh në administratën publike, përmes shtrirjes së sistemit të pagave të nëpunësve civilë në të gjitha institucionet e administratës publike;
- rregullimin e situatës së pagave, të shpërblimeve dhe të strukturave për institucionet e pavarura; përcaktimin e raportit të pagave për funksionarët e lartë shtetërorë, me pagën e Presidentit.

Në vitin 2007, Departamenti i Administratës Publike i kushton vëmendje tërheqjes në administratën publike të kapaciteteve të shkolluara jashtë vendit dhe sidomos atyre me kualifikime pasuniversitare.

Gjatë këtij viti, me propozimin e Departamentit të Administratës Publike dhe me mbështetjen e qeverisë shqiptare, u ndërmorën dy iniciativa të rëndësishme në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore: fillimi i punës për zbatimin e projektit "Rishikimi i implementimit të legjislacionit të shërbimit civil", ku zë vend të veçantë rishikimi i procedurave të pranimit në shërbimin civil, si dhe hartimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (SNRAP), në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Ndërkohë, një iniciativë tjetër e Departamentit të Administratës Publike është ajo për ndryshimin e udhëzimit, lidhur me përshkrimet e punës[6], ku DAP-i ka marrë një rol jo vetëm si administrator, por edhe si asistues i procesit në ndihmë të Ministrive të Linjës, duke bërë kështu një përmirësim të ndjeshëm të disa aspekteve teknike që lidhen me përshkrimin përgjithësues të punës dhe emërtesat tipike, sipas strukturës aktuale të pagave për këto emërtesa.

Viti 2008 ka qenë një vit i suksesshëm për realizimin e disa iniciativave të rëndësishme në fushën e reformave në administratën publike. Pas 14 vjetësh eksperiencë në shërbimin civil, Departamenti i Administratës Publike ka objektiva të qartë strategjikë. Hartimi i

6 Ndryshimi i Udhëzimit nr. 1, të Këshillit të Ministrave, "Për strukturën e renditjes së punëve në shërbimin civil, metodologjinë përkatëse dhe përshkrimin përgjithësues të rolit të Sekretarit të Përgjithshëm në këtë shërbim".

Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (SNRAP), në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), grupi teknik i ngritur për këtë qëllim me urdhër të Ministrit të Brendshëm, i kryesuar nga Departamenti i Administratës Publike dhe me mbështetjen e SIGMA-s e të Institutit të Studimeve Bashkëkohore (ISB), nënshkrimi i Marrëveshjes për Themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike, ReSPA[7], bashkëpunimi me Komisionin e Shërbimit Civil[8], e drejtojnë Departamentin e Administratës Publike drejt së ardhmes.

Në funksion të përgjegjësive dhe të rolit të rëndësishëm të reformës në administratën publike, DAP-i u riorganizua në një departament me tri drejtori: Drejtoria e Zhvillimit dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Zhvillimit Organizativ, Funksional dhe e Politikave të Pagave si dhe Drejtoria e Informatizimit të Administratës Publike. Një rol i rëndësishëm iu dha edhe ndërfaqes publike përmes funksionimit të *web*-it të DAP-it[9], si dhe komunikimit me publikun, ku jepen informacione të plota, të sakta, lidhur me menaxhimin e shërbimit civil ndër vite (raporte vjetore, të dhëna mujore, botime profesionale etj.)

7 Bashkëpunimi nëpërmjet Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA), është një iniciativë e nënshkruar zyrtarisht në 2 maj të vitit 2006, ku në praninë e Komisionit Evropian u nënshkrua Protokolli i Bashkëpunimit për Krijimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (faza 1) nga përfaqësuesit e vendeve anëtare të saj, përkatësisht: Republikës së Shqipërisë, Republikës së Bosnjës dhe të Hercegovinës, Republikës së Kroacisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Bashkimit Shtetëror të Serbisë dhe Malit të Zi, së bashku me Republikën e Malit të Zi dhe Republikën e Serbisë, si dhe të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, (UNMIK) që vepron në emër të Kosovës, në pajtim me rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

8 Komisioni i Shërbimit Civil, si institucioni që mbikëqyr e kontrollon zbatimin e tij për të gjitha institucionet e përfshira në fushën e veprimit të ligjit; Departamenti i Administratës Publike, si institucioni që menaxhon procedurat e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil për Kryeministrinë dhe aparatet e Ministrive të Linjës dhe udhëheq reformën në administratën publike, si dhe njësitë e personelit të institucioneve të pavarura. Gjatë vitit 2008, midis Komisionit të Shërbimit Civil dhe Ministrisë së Brendshme (Departamentit të Administratës Publike), u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi, e cila synon të rritë frymën e bashkëpunimit midis këtyre dy institucioneve, me synimin e zbatimit sa më rigoroz të legjislacionit të shërbimit civil. Marrëveshja parashikon gjithashtu, edhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm midis dy institucioneve, sipas fushave ku ato veprojnë.

9 www.pad.gov.al

Gjithashtu, në vijim të iniciativave të ndërmarra që prej janarit 2008, nëpunësve civilë / nëpunësve më kualifikime pasuniversitare, me grada dhe tituj shkencorë iu njoh e drejta e përfitimit të një shtese për kualifikimin përkatës, ku Departamenti i Administratës Publike[10] në kushtet e përputhshmërisë së kualifikimit / titullit shkencor me përshkrimin e punës së funksionarit / nëpunësit, miraton të drejtën e shpërblimit.

Gjatë viteve 2010–2012, në vazhdim të thellimit të reformës së administratës publike, u hartuan edhe dy akte shumë të rëndësishme ligjore: projektligji "Për nëpunësin civil", i cili është aktualisht në diskutim në Kuvend, si dhe projektligji "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", i cili është miratuar në shtator të vitit 2012 në Kuvendin e Shqipërisë.

Sot, Departamenti i Administratës Publike punon pareshtur për implementimin me sukses të legjislacionit të shërbimit civil, si dhe thellimin e reformës në administratën publike, me synimin e krijimit të një administrate profesionale, të mbështetur në merita, dhe të paanshme, të aftë të ofrojë shërbime cilësore dhe transparente ndaj publikut si dhe të përballojë sfidat gjithëpërfshirëse të integrimit të vendit në BE, nëpërmjet kapaciteteve të duhura të nëpunësve të administratës publike dhe të një sistemi modern të menaxhimit të burimeve njerëzore.

10 Sipas Udhëzimit nr. 1, datë 18.04.2008, "Për rregullat e përfitimit të shtesës së parashikuar në to", DAP-i bashkëpunon me Ministrinë e Arsimit e të Shkencës dhe Ministrinë e Financave.

# Historiku në vashdim

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**Këshilli i Ministrave**

**VENDIM**

**Nr. 443 Datë 5.9.1994**

**PËR**
**KRIJIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE**
**Këshilli i Ministrave**

V E N D O S I:

1. Pranë Këshillit të Ministrave krijohet Departamenti i Administratës Publike.
2. Departamenti i Administratës Publike, në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, i propozon Këshillit të Ministrave studimet, projektligjet dhe projektet e akteve nënligjore për strukturën, detyrat dhe funksionimin e administratës publike, në përputhje me programin e qeverisë dhe projektet e miratuara prej saj.
3. Departamenti, në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e tjera të administratës publike, harton politikën e përgjithshme të formimit, rekrutimit dhe proporcionit të nëpunësve të administratës publike, harton e propozon projektligjet dhe projektet e akteve nënligjore për këto probleme, si dhe ndjek e kontrollon vënien e tyre në jetë.
4. Departamenti bashkërendon punën me Ministrinë e Punës, të Emigracionit e të Përkrahjes Sociale dhe Ministrinë e Financave për hartimin e sistemit të pagave dhe shpërblimeve për administratën publike.
5. Departamenti koordinon dhe vë në zbatim asistencën teknike që jepet për administratën publike. Departamenti ngarkohet me detyrën e organizimit

e të bashkërendimit, të komunikimit brenda përbrenda administratës publike dhe zhdërvjelltësimit të saj.

6. Departamenti i realizon detyrat e tij nëpërmjet ndërlidhjes me të gjitha nivelet e strukturës organizative e funksionale të administratës publike. Për këtë ai bashkëpunon ngushtësisht me ministritë dhe institucionet e tjera të administratës publike, vë në dispozicion të Departamentit të dhënat që kërkohen lidhur me strukturën organizative e funksionale të aparateve të tyre, përbërjen e personelit, nivelin arsimor e profesional, të dhëna të tjera të domosdoshme për shërbimin e nëpunësve publikë dhe sugjerime të mundshme për përmirësime strukturore, funksionale etj.

7. Departamenti i realizon detyrat e tij nëpërmjet ndërlidhjes me të gjitha nivelet e strukturës organizative e funksionale të administratës publike. Për këtë ai bashkëpunon ngushtësisht me ministritë dhe institucionet e tjera të administratës publike, të cilat, nëpërmjet drejtorive ose personave të ngarkuar me problemet e administratës publike, vë në dispozicion të Departamentit të dhënat që kërkohen lidhur me strukturën organizative e funksionale të aparateve të tyre, përbërjen e personelit, nivelin arsimor e profesional, të dhëna të tjera të domosdoshme për shërbimin e nëpunësve publike dhe sugjerime të mundshme për përmirësime strukturore, funksionale etj.

8. Departamenti në mënyrë të vazhdueshme e sistematikisht ndjek zbatimin e ligjeve e të akteve nënligjore lidhur me administratën publike, duke bashkëpunuar për këtë me të gjitha ministritë e institucionet qendrore dhe strukturat e tjera të administratës publike.

9. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave të Departamentit të Administratës Publike caktohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe përballohen nga buxheti i miratuar për aparatin e Këshillit të Ministrave.

10. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 393, datë 3.9.1992 "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", në lidhjen II-4 shtohet lidhja II-4/8 "Pagat mujore dhe renditja e detyrave sipas klasave për punonjësit e Departamentit të Administratës Publike pranë Këshillit të Ministrave", që i bashkëngjitet këtij vendimi. Në lidhjen nr.1 "Për pagat mujore të titullarëve të organeve të larta shtetërore, institucioneve të tjera qendrore dhe personave të një rangu me ta", në pikën 6 shtohet emërtimi "Drejtor i Departamentit të Administratës Publike", kurse në pikën 2 shtohet emërtimi "Këshilltar i Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike".

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KUVENDI**

# LIGJ

## NR. 8549, datë 11.11.1999

## STATUSI I NËPUNËSIT CIVIL

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi:

## KREU I

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

Qëllimi dhe Objekti

1 Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të njëjta për kushtet dhe procedurat e pranimit në shërbimin civil, për mënyrën e fillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës, për zhvillimin e karrierës, për garantimin e të drejtave dhe përcaktimin e detyrimeve të nëpunësve civilë, me synim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional dhe eficient.

2 Ky ligj përcakton skemën e administrimit të shërbimit civil, si dhe rregullon marrëdhëniet juridike, ndërmjet nëpunësve civilë dhe institucioneve të administratës publike të nivelit qendror apo vendor të përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji.

3 Për çështje të cilat nuk rregullohen shprehimisht nga ky ligj, do të zbatohet Kodi i Punës dhe legjislacioni përkatës.

**Neni 2**

Përkufizimet dhe fusha e veprimit

1. "Nëpunësit Civilë" në kuptim të këtij ligji janë ata nëpunës të institucioneve të administratës publike të nivelit qendror apo vendor, të cilët ushtrojnë autoritetin publik, në detyra të natyrës drejtuese, organizuese, mbikëqyrëse apo ekzekutuese, përcaktuar sipas nenit 11 të këtij ligji.
2. "Institucionet e administratës publike të nivelit qendror apo vendor" në kuptim të këtij ligji janë: Administrata e Kuvendit, Administrata e Presidentit, Aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore të pavarura, bashkitë dhe qarqet.
3. Me "institucionet e administratës qendrore" në kuptim të këtij ligji, do t'i referohemi: aparatit të Këshillit të Ministrave dhe ministrive.
4. Me "institucione të pavarura" në kuptim të këtij ligji, do t'i referohemi institucioneve qendrore të pavarura, Administratës së Kuvendit, Administratës së Presidentit, bashkive dhe qarqeve.
5. Me "epror direkt" në kuptim të këtij ligji, do t'i referohemi: drejtorit të drejtorisë për klasat nga shef sektori deri specialist, sekretarit të përgjithshëm për klasat nga drejtor departamenti, deri në drejtor drejtorie dhe titullarit ose organit drejtues të institucionit për sekretarin e përgjithshëm.
6. Institucionet e administratës publike të nivelit qendror apo vendor, të cilat rregullohen me ligj të posaçëm, do t'i nënshtrohen dispozitave të këtij ligji, përveç rasteve kur ligji i posaçëm përmban dispozita të ndryshme nga ai.

**Neni 3**

Parimet e Shërbimit Civil

Shërbimi Civil është i ndërtuar dhe vepron mbi bazën e parimeve të profesionalizmit, të pavarësisë dhe integritetit, të paanësisë politike, të transparencës, të shërbimit ndaj publikut, të vazhdimësisë së karrierës, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

11
5.1.01

D. Personelit

4
5.1.2001

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE

**Nr. 10 Prot.** **Tiranë më 4 . 1 . 2001**

Lenda : **Miratimi i strukturës dhe organikës së Ministrise se Rendit Publik.**

**MINISTRISE SE RENDIT PUBLIK**

**TIRANE**

Mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 14.08.1995
"Për kompetencat për emërimin dhe largimin nga detyra të drejtorëve të drejtorive në ministri dhe institucione të tjera qëndrore dhe për ndryshimet në strukturat e tyre ",

**MIRATOJ :**

1. Struktura e Ministrise se Rendit Publik të jetë sipas skemës nr. 1 të bashkelidhur.
2. Organika e Ministrise se Rendit Publik të jetë sipas skemës nr.2 të bashkëlidhur.
3. Numri i punonjësve të Ministrise se Rendit Publik të jetë gjithsej 141 vete.

**KRYEMINISTRI**

**ILIR META**

Struktura dhe Organika e Ministrise se Brendshme-1, 2001




Struktura dhe Organika e Ministrise se Brendshme - 2, 2001

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KESHILLI I MINISTRAVE**
**MINISTRI I SHTETIT PRANE KRYEMINISTRIT**

Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit"

**Nr._______ Prot** **Tirane _______2002**

**Lenda:** *Kerkese per shpallje te vendit te lire te ne Sherbimin Civil*

**Drejtuar: Z. __________________**
**Drejtore e Departamentit te Administrates Publike**

Ne zbatim te ligjit nr. 8549 date 11.11.1999 "Statusi i Nepunesit Civil" si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 231 date 11.05.2000 "Per Pranimin ne Sherbimin Civil dhe Periudhen e Proves", kerkojme te shpallet ne gazete vendi vakant per pozicionin Drejtor i Njesise Antikorrupsion, sipas pershkrimit te punes bashkelidhur.

**Kerkesa te pergjithshme:**

- Te jete shtetas Shqiptar
- Te kete zotesi te plote per te vepruar
- Te jete ne kushte te mira shendetesore
- Te mos jete denuar me vednim te formes se prere per kryerjen e nje krimi
- Te mos jete marre ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga sherbimi civil per shkak te nje shkelje te rende disiplinore

**Pershkrimi i punes**

- Te organizoj dhe drejtoj punen e Njesise antikorrupsion ne drejtim te zbatimit me sukses te planit antikorrupsion te qeverise shqiptare
- Organizimi dhe kontrolli i punes se inspektoreve



- Monitorim i mikrosistemeve te ndryshmeper te evituar lindjen e elementeve korruptive
- Ndjekje e problemeve operative, te ngarkuara nga Ministri
- Kontrate me organizmat nderkombetare dhe shoqerine civile

**Kerkesa te vecanta:**

- Te kete mbaruar arsimin e larte ekonomik apo juridik
- Te kete pervoje ne profesion jo me pak se 6 vjet
- Te kete eksperience pune ne Organizatat Nderkombetare/Organizatat e huaja Joqeveritare apo ne pozicionet drejtuese te administrates publike
- Te zoteroje shume mire gjuhen angleze
- Te kete njohurite baze ne fushen e kompjuterit (programi Worlddhe Exel)
- Te kete aftesi te larta menaxhuese dhe drejtuese

**Kandidatet duhet te paraqesin keto dokumenta:**

- Kerkese per aplikim
- Curikulum Vitae (CV)
- Fotokopje e diplomes , listes se notave, librezes se punes
- Deshmi te gjuhes se huaj
- Nje leter rekomandimi (nese ka)
- Vertetim te gjendjes gjyqesore

Paga bruto eshte________________________

Testimi do te zhvillohet ne njohurite ne Kushtetuten e Republikes, Kodin e Procedurave administrative, njohurite mbi organizimin dhe funksionimin e administrates publike, institucionet te saj dhe marredhenie nderinstitucionale

**MINISTER**

____________________

Kërkesë për shpallje, 2002

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E BRENDSHME**
**Departamenti i Administratës Publike**

**Nr.____ prot** | **Tiranë, më ______2007**

**Lënda:** Mbi propozimin për disa ndryshime në strukturën dhe organikën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

**Drejtuar:** **Z.____________________**
**Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës**

**Për dijeni:** **Z. ____________________**
**Minister i Arsimit dhe Shkencës**

**TIRANE**

Në përgjigje Tuajës nr. ___, datë _______, me subjekt "Dërgohet projektstruktura e MASH", lidhur me projekturdhrin për disa ndryshime në strukturën dhe organikën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Departamenti i Administratës Publike parashtron komentet e mëposhtme:

1. Lidhur me propozimin për shkurtimin e pozicionit "Drejtor i Përgjithshëm", në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Parauniversitare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, sqarojmë se këto pozicione jane strukturuar duke marrë në konsiderate se:

Një Drejtori e Përgjithshme krijohet për të siguruar një hapësire menaxhuese të përshtatshme për Sekretarin e Përgjithshëm, i cili është lidhja midis kapaciteteve teknike të ministrisë për arritjen e objektivave politike. Hapësirat e mëdha menaxhuese nuk e lejojnë Sekretarin e Përgjithshëm të plotësojë këtë funksion të tij kryesor. Kjo për arsye se, ndikon mbi eficiencën dhe efektivitetin e punës, pasi dhe koha e shpenzuar në menaxhimin e marëdhënieve, influencon ne cilësinë dhe kohën e marrjes së informacionit të nevojshëm për vendimmarrje. Në manualin përkatës për strukturimin e institucioneve argumentohet se hapësira menaxhuese e Sekretarit të Përgjithshëm duhet të ketë jo më shumë se 4 deri në 5 vartës teknikë të nivelit të lartë

Nga ana tjetër, **Drejtoritë e Përgjithshme** përfshijnë dy ose më shumë drejtori, të cilat kane komplementaritet (jo ngjashmëri) në misionet e tyre dhe në kontributin që ato japin për arritjen e misionit të institucionit dhe objektivave të tij strategjikë.

Parë në këtë këndvështrim, jemi të mendimit që të mos ndryshohet niveli i organizimit të këtyre strukturave, për arsyet e sipërpërmendura.

2. Lidhur me ndryshimet e tjera të propozuara Departamenti i Administratës Publike, sugjeron rishikimin e propozimit për realizimin e ndryshimeve brenda numrit të miratuar të punonjësve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

Me respekt,

**DREJTOR**

______________________

Model kthim përgjigje shkrese për ndryshim strukture të Ministrisë së Arsimit, 2007

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E BRENDSHME**
**Departamenti i Administratës Publike**

**Nr.____ prot** **Tiranë, më ______2008**

**Lënda:** Lidhur me propozimin për disa ndryshime në strukturën dhe organikën e Ministrisë së Shëndetësisë

**Drejtuar:** **Z. ________________**
**Ministër i Shëndetësisë**

**Tiranë**

***I nderuar z. Ministër,***

Në përgjigje Tuajës _______, datë ________, me subjekt "Dërgohet për mendim projektstruktura dhe organika e Ministrisë së Shëndetësise" në lidhje me disa ndryshime në strukturën dhe organikën e Ministrisë së Shëndetësisë, Departamenti i Administratës Publike shprehet si më poshtë vijon:

Pas shqyrtimit të propozimit të paraqitur, konstatojmë se riorganizimi i propozuar parashikon një rritje të numrit të punonjësve nga 104 punonjës, miratuar me urdhrin aktualisht në fuqi, në 115 vetë, pra një shtesë prej 11 punonjësish.

Për këtë arsye, Departamenti i Administratës Publike shprehet që, për ndryshimet e kërkuara, të merret miratimi nga Ministria e Financave, lidhur me shtesën e numrit të punonjësve dhe mbulimin e tyre me buxhetin e nevojshëm, si institucioni përgjegjës, lidhur me efektet financiare të ndryshimeve të propozuara.

Departamenti i Administratës Publike, e konsideron të panevojshme shtesën prej 11 punonjësish të tjerë, ndërkohë që gjatë periudhës 2006-2007, numri i punonjësve të aparatit të kësaj ministrie, është rritur me 10 punonjës.

Nga ana teknike paraqesim komentet e mëposhtme:

Konkretisht, në propozim përveç disa ndryshimeve që gjejnë mbështetje, kërkohet gjithashtu:

1- Krijimi i Njësisë së Integrimit, pranë Drejtorisë së Integrimit, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun. Sqarojmë se, aktualisht brenda kësaj drejtorie

Adresa: [illegible] Tel/Fax: [illegible]
www.pad.gov.al

funksionon Sektori i Integrimit dhe Marrëdhenieve me Jashtë (1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë), i cili, mbështetur në përshkrimet aktuale të vendeve të punës, mbulon detyrat dhe përgjegjësitë që burojnë nga legjislacioni në fushën përkatëse. Në propozim kërkohet krijimi brenda drejtorisë i dy sektorëve, me nga 1 përgjegjës secili, ndarje e cila për mendimin tonë, përveçse krijon një rritje artificiale të numrit të punonjësve, nuk ka impakt në përmbushjen e funksioneve te drejtorisë. Pra e konsiderojmë të panevojshëm dhe të paargumentuar shtesën e një tjetër pozicioni "Përgjegjës sektori", në këtë drejtori.

2- Shtimi i një pozicioni "specialist" në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Edukimit në Vazhdim. Mbështetur në detyrat e strukturave ekzistuese dhe përshkrimet aktuale të vendeve të punës, jemi të mendimit se ky numër është plotësisht i mjaftueshëm për mbulimin e detyrave dhe realizimin e funksioneve te saj.

3- Riroganizimi i Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit Shëndetësor. Në propozimin e bërë kjo drejtori konceptohet e përbërë nga 1 drejtor, 1 përgjegjës dhe 2 specialistë, gjë që në kuptimin e përbërjes së një strukture, nuk e justifikon një hierarki të tillë dhe do të sillte mbivendosje funksionesh e detyrash.

4- Lidhur me krijimin e pozicionit "Përgjegjës Sektori", në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, sqarojmë se përgjegjësi i sektorit nuk mund të ketë të njëjtat përgjegjësi dhe kategori page me punonjësin në varësi të tij. Kjo për arsye se, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit, në Ministrinë e Financave, në lidhjen nr. 3, "Kategorizimi i pozicioneve të punës për funksionet e vecanta në Kryeministri dhe ministritë e linjës", të VKM nr. 475, datë 13.07.2007, është miratuar si funksion atipik emërtesa "Inspektor", përkatësisht kategoria III-a, dhe III-b. Për këtë arsye, shtesa e mësipërme është e panevojshme.

Sa më sipër, duke e konsideruar procesin e ristrukturimit jo thjesht si një çështje organizative, por një nevojë për të krijuar struktura funksionale dhe të qëndrueshme, Departamenti i Administratës Publike Publike sugjeron përcaktimin racional të nevojave për shtesë, pasi në të kundert, kjo do të çonte në një përdorim jo efiçent të burimeve në dispozicion dhe krijimin e hallkave të tepërta.

Departamenti i Administrates Publike shpreh angazhimin e tij te plotë për të rivleresuar ndryshimet e nevojshme dhe ndërmarrjen e hapave të mëtejshme për miratimin e projektvendimit.

Me respekt,

**DREJTOR**

_______________________

Model shkrese: Kthim përgjigje për ndryshim strukture të Ministrisë së Shëndetësisë, 2007

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E BRENDSHME**
**Departamenti i Administratës Publike**

---

**Nr._____ prot** **Tiranë, më______2008**

**Lënda:** Dërgohet projekturdhër për shqyrtim dhe miratim

**Drejtuar:** **Z. _________________**
**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

**TIRANË**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 4, të Ligjit nr. 8549, datë 11/11/1999, "Statusi i nëpunësit civil" dhe të nenit 7, të Ligjit nr. 9000, datë 30/01/2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", Departamenti i Administratës Publike, bazuar në propozimin e Ministrit të Drejtësisë, ka përgatitur projekturdhrin e Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë".

Bashkëlidhur projekturdhrin, relacionin përkatës, si dhe propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

Duke Ju falenderuar,

Me respekt,

**DREJTOR**

__________________________

Adresa: Sheshi Skenderbej, nr. 3, Tiranë, Shqipëri, Kutia Postare Nr. 1751 Tel/Fax: [illegible]
www.pad.gov.al

**RELACION**

**PËR**

**PROJEKTURDHRIN "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKES SË MINISTRISË SË DREJTËSISË"**

Në zbatim të nenit 7, të Ligjit nr. 9000, datë 30/01/2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", Ministri i Drejtësisë, ka propozuar disa ndryshime në strukturën dhe organikën e këtij institucioni, miratuar me urdhrin nr. 174, datë 16.10.2007, të Kryeministrit.

Konkretisht, propozimi konsiston në ndryshimet e mëposhtme:

1-Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit, e cila aktualisht përbëhet nga Drejtoria e Legjislacionit dhe Asistencës Ligjore dhe Drejtoria e Integrimit Europian dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, gjithsej 20 punonjës, si më poshtë:

a) Në Drejtorinë e Legjislacionit dhe Asistencës Ligjore, për ta përshtatur më mirë me detyrat funksionale të drejtorisë, propozohet shkrirja e Sektorëve të së Drejtës Publike, të Drejtës Penale dhe të Drejtës Civile dhe riorganizimi i tyre në Sektorin e Hartimit të Legjislacionit, Sektorin e Oponencës Ligjore dhe Sektorin e Analizës dhe Rekomandimeve Institucionale. Në këtë kontekst, *Sektori i Hartimit të Legjislacionit* do të hartojë projektet e ligjeve dhe akteve nënligjore në fushën e drejtësisë, *Sektori i Oponencës* do të përgatisë mendimet juridike për projektligjet dhe projektaktet e tjera normative të Këshillit të Ministrave, të ministrive dhe institucioneve qendrore dhe *Sektori i Analizës dhe Rekomandimeve Institucionale*, nëpërmjet analizës së legjislacionit në fuqi, do të identifikojë nevojat për ndryshime, boshllëqet ligjore dhe konfliktet ligjore, duke bërë propozime dhe rekomandime.

b) Drejtoria e Integrimit dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare riorganizohet në Drejtori të Integrimit dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare. Në këtë kuadër, Zyra e Integrimit Europian dhe Përqasjes së Legjislacionit riorganizohet në Sektorin e Integrimit, Përafrimit të Legjislacionit dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare. Kjo, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në marrëveshjet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë. Gjithashtu, brenda kësaj drejtorie përfshihet dhe Sektori i Zbatimit të Projekteve, i cili aktualisht funksionon në nivel drejtorie.

Si rezultat i këtij riorganizimi, numri i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit ndryshon, nga 20 punonjës aktualisht, në 23 vetë.

2-Riorganizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë, e cila aktualisht përbëhet nga Drejtoria e Bashkëpunimit Gjyqësor Ndërkombëtar,

Drejtoria e Organizimit Gjyqësor dhe Drejtoria për Profesionet e Lira dhe Institucionet e Varësisë, gjithsej 43 punonjës, si më poshtë:

a) Me kalimin e Sektorit të Gjendjes Gjyqësore, si strukturë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, propozohet shkrirja e Drejtorisë së Organizimit Gjyqësor dhe kalimi i Sektorit të Organizimit dhe Trajnimit të Gjyqësorit, në Drejtorinë e Inspektimit. Kjo, do të sigurojë një bashkëpunim dhe koordinim më të mirë të punës së këtij sektori me sektorët e tjerë të drejtorisë, lidhur me inspektimet në administratën gjyqësore, me trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve etj.

b) Drejtoria për Profesionet e Lira dhe Institucionet e Varësisë riorganizohet në Sektor të Profesioneve të Lira, brenda strukturës së Drejtorisë së Inspektimit. Gjithashtu, funksionet dhe detyrat e Sektorit të Inspektimit dhe Koordinimit me IEVP dhe Sektorit të Inspektimit dhe Koordinimit me ZQRPP dhe AKKP do të kryhen nga Sektori i Inspektimit për Institucionet e Varësisë, i cili do të funksionojë brenda Drejtorisë së Inspektimit.

c) Drejtoria e Bashkëpunimit Gjyqësor Ndërkombëtar, aktualisht e përbërë nga Sektori i Marrëdhënieve Juridiksionale dhe Sektori i Përkthimeve Zyrtare, riorganizohet në Sektor të Bashkëpunimit Ndërgjyqësor dhe Sektorin e Përkthimeve Zyrtare.

3-Krijimi i Drejtorisë së Informatizimit të të Dhënave, Statistikës dhe Bibliografisë, gjithsej 15 punonjës, të përbërë nga katër sektorë si më poshtë:

-Sektori i Trajtimit të Kërkesave për Dëmshpërblim;
-Sektori i Arkivit Gjyqësor;
të cilat janë detyrime që burojnë nga legjislacioni në fushën përkatëse si dhe

-Sektori i Informatizimit të të Dhënave;
-Zyra e Statistikës dhe Bibliografisë,
e cila aktualisht funksionon si sektor në Drejtorinë e Organizimit Gjyqësor. Kjo, në funksion të informatizimit të të gjitha të dhënave që lidhen me sistemin e drejtësisë si dhe unifikimit të formularëve statistikore për të gjitha të dhënat.

Si rezultat i këtij riorganizimi, numri i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë ndryshon, nga 43 punonjës aktualisht, në 33 vetë.

4-Në Drejtorinë Ekonomike, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve propozohet që, Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Shërbimeve, të riorganizohen në një sektor të vetëm.

5-Duke rivlerësuar rolin dhe ngarkesën e punës së Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun, në kuadër të gjithë veprimtarisë së institucionit, propozohet riorganizimi i kësaj strukture në nivel sektori, brenda Drejtorisë Ekonomike, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve. Kjo dhe për

arsye të vetë rolit mbështetës që luan kjo njësi, në raport me aktivitetet e drejtorive të tjera të përmbajtjes në ministri.

Si rezultat i këtij riorganizimi, numri i punonjësve të Drejtorisë Ekonomike, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve ndryshon, nga 34 punonjës aktualisht, në 32 vetë.

Ndryshimet e sipërpërmendura nuk reflektojnë ndryshim të numrit të punonjësve të institucionit.

Duke Ju falenderuar,

**DREJTOR**

____________________

Model shkrese:
Dërgim projekturdhri për miratim strukture dhe organike, 2008

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E BRENDSHME**
**Departamenti i Administratës Publike**

Nr.____ prot                                                    Tiranë, më ______2008

**Lënda:** Dërgohet projektudhër për shqyrtim dhe miratim

**Drejtuar:** Z. ___________________
**Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave**

**Tiranë**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 4, të Ligjit nr. 8549, datë 11/11/1999, "Statusi i nëpunësit civil" dhe të nenit 7, të Ligjit nr. 9000, datë 30/01/2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", Departamenti i Administratës Publike, bazuar në propozimin e Ministrit të Financave, ka përgatitur projektudhrin e Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Financave".

Bashkëlidhur projektudhrin, relacionin përkatës, si dhe propozimin e Ministrit të Financave.

Duke Ju falenderuar,

Me respekt,

**DREJTOR**

_______________________

Adresa: [illegible]    Tel/Fax: [illegible]
[illegible]

**RELACION**

**PËR**

**PROJEKTURDHRIN"PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË MINISTRISË SË FINANCAVE"**

Në zbatim të pikës 3, të nenit 7, të Ligjit nr. 9000, datë 30/01/2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", Ministria e Financave, ka dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike propozimin për disa ndryshime në strukturën dhe organikën e institucionit.

Konkretisht, propozimi konsiston në sa më poshtë:

1. Në zbatim të VKM nr. 503, datë 30/6/2005, propozohet kalimi i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, aktualisht brenda strukturës së aparatit të Ministrisë së Financave, si institucion buxhetor, në varësi të Ministrit të Financave.

2. Riorganizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit, aktualisht e përbërë nga dy drejtori, në Drejtori të Përgjithshme të Menaxhimit të Borxhit, të përbërë nga tre drejtori, përkatësisht, Drejtoria e Huamarrjes, Drejtoria e Strategjisë dhe Riskut dhe Drejtoria e Regjistrimit dhe Shërbimit të Borxhit, të cilat reflektojnë dhe tre funksionet bazë të drejtorisë së përgjithshme. Një riorganizim i tillë i menaxhimit të borxhit do të sigurojë financimin e nevojshëm dhe kontrollin e duhur për zvogëlimin e risqeve që shoqërojnë huamarrjen. Numri i punonjësve të drejtorisë së përgjithshme ndryshon, nga 18 punonjës aktualisht, në 22 vetë.

3. Riorganizimi i Njësisë së Financimeve dhe Kontraktimeve me Donatorë të Huaj në Drejtori të Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve. Në zbatim të VKM nr. 596, datë 5.9.2007 roli i njësisë amendohet, duke përfshirë dhe PMU-në për programin CARDS. Me qëllim monitorimin dhe menaxhimin financiar të projekteve me financim të huaj, propozohet ngritja e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve, të përbërë nga tre drejtori, përkatësisht Drejtoria e Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktimeve, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Monitorimit dhe Kontrollit EX-ANTE. Numri i punonjësve të Drejtorisë propozohet të jetë 15 punonjës gjithsej.

4. Riorganizimi i Drejtorisë së Kontabilitetit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Drejtori të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar, të përbërë nga 2 sektorë, përkatësisht, Sektori i Raportimit Financiar dhe Sektori i Kontabilitetit Publik, të cilat synojnë të reflektojnë dhe përmbushin funksionet bazë të drejtorisë. Numri i punonjësve të drejtorisë ndryshon, nga 8 punonjës aktualisht, në 9 vetë.

5. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit propozohet të krijohet Drejtoria e Harmonizimit dhe Menaxhimit Financiar. Kjo drejtori konceptohet e përbërë nga 1 drejtor dhe 3 specialistë. Numri i punonjësve të drejtorisë së përgjithshme ndryshon, nga 35 punonjës aktualisht, në 42 vetë.

6. Duke rivlerësuar ngarkesën e punës për çdo sektor në veçanti, propozohet shkurtimi i një pozicioni "specialist", në Sektorin e Statistikave dhe Parashikimeve Makroekonomike, në Drejtorinë e Makroekonomisë.

Gjithashtu, në projektorganikën e paraqitur, Ministria e Financave ka propozuar rritjen e kategorisë së pagës për disa pozicione "specialist" në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme. Departamenti i Administratës Publike, duke gjykuar në bazë të përshkrimit të punës së tyre, rëndësisë në raport me misionin e institucionit, si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 13/06/2000, të Këshillit të Ministrave, nuk i ka marrë në konsideratë pasi ato janë pjesë e shërbimeve mbështetëse të veprimtarisë së institucionit. Këto lloj shërbimesh janë të unifikuara në kategorinë e pagës, në të gjitha ministritë e linjës.

Ndryshimet propozuara në strukturën dhe organikën e aparatit të Ministrisë së Financave, reflekton një rritje të numrit të punonjësve, nga 216 punonjës aktualisht, në 231 vetë. Ky numër do të jetë brenda limitit të numrit të miratuar për sistemin e Ministrisë së Financave, në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

Duke Ju falenderuar,

**DREJTOR**

______________________

Model shkrese:
Dërgim projekturdhri për miratim strukture dhe organike, 2008

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI I MINISTRAVE**

**VENDIM**

Nr. 545, datë 11.08.2011

**PËR**

**MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, nenit 18 dhe 29, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24/03/2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", Ligjit nr. 9584, datë 17/07/2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj" dhe Ligjit nr. 10355, datë 02/12/2010, "Për buxhetin e vitit 2011", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave,

**KËSHILLI I MINISTRAVE**

**VENDOSI:**

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

**Lidhja nr. 3**

**Kategorizimi për pozicionet e veçanta të punës për funksionet e veçanta në Kryeministri, ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura**

| INSTITUCIONI | POZICIONI | KATEGORIA E PAGËS |
|---|---|---|
| **Kryeministria** | Jurist në Departamentin e Legjislacionit dhe Koordinimit | II-b |
| | Inspektor në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ & Antikorrupsionit | II-b |
| | Koordinator në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive & Koordinimit të Ndihmës së Huaj | II-b |
| | Koordinator në Departamentin e Shqipërisë Dixhitale | II-b |
| | Koordinator pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave | II-b |
| | Drejtor i Njësisë së Teknologjisë së Informacionit | II-a |
| | Drejtor i Njësisë së Bashkërendimit të Strategjive | II-a |
| **Ministria e Punëve të Jashtme** | Drejtor i Institutit të Diasporës | II-b |
| **Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave** | Kryeinspektor i Inspektoriatit të Mjedisit | III-a |
| | Inspektor në Inspektoriatin e Mjedisit | III-b |
| **Ministria e Drejtësisë** | Inspektor për Inspektimin gjyqësor.<br>Inspektor për inspektimin e prokurorisë.<br>Inspektor për inspektimin administrativ. | III-a |
| **Ministria e Brendshme** | Drejtor i Njësisë Antitrafik | II-a |
| | Koordinator në Departamentin e Administratës Publike | III-a |
| | Inspektor në Drejtorinë e Përgjithshme të Inspektimit | III-a |
| | Koordinator në Njësinë Antitrafik | III-a |
| | Koordinator në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Prokurimeve të Përqëndruara | III-a |
| **Ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura** | Inspektor në Drejtoritë e Auditimit të Brendshëm, apo sektorët e auditimit të brendshëm. | III-a |
| | | III-b |

| | | |
|---|---|---|
| **Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive** | Inspektor i Lartë | **II-a** |
| | Ndihmësinspektor i Lartë | **II-b** |
| **Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit** | Përgjegjës i studios së transmetimit | **III-a** |
| | Monitorues | **IV-a** |
| **Avokati i Prokurimeve** | Inspektor | **III-a** |
| **Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare** | Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit | **III-a** |
| **Autoriteti i Konkurrencës** | Inspektor i mbikqyrjes së tregut.<br>Inspektor i hetimit. | **III-a** |

Vendim pagash 1-3, 2011

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**Këshilli i Ministrave**

**V E N D I M**

**Nr.__474__, datë _16.6.2011_**

**PËR**

**PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE E TË PROCEDURËS QË DUHET TË NDIQET GJATË HARTIMIT DHE MIRATIMIT TË STRUKTURAVE ORGANIZATIVE TË INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", dhe të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 31.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e ministrit të Brendshëm Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

**I. Standardet, mbi të cilat mbështetet hartimi i strukturave organizative të institucioneve të administratës publike, në nivel qendror**

1. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen për institucionet e administratës publike, në nivel qendror, në të cilat përfshihen aparatet e Kryeministrisë dhe të ministrive, degët e ministrive, institucionet qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit dhe ministrave të linjës, dhe degët e tyre, administrata e prefektit, institucionet qendrore, të pavarura.

2. Rekomandohen drejtuesit e sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë, drejtuesit e universiteteve shtetërore, të njësive spitalore dhe të fondeve speciale të zbatojnë

1

të njëjtat standarde gjatë hartimit të strukturave për administratat e institucioneve të tyre.

2. Institucionet e administratës publike, në nivel qendror, organizohen mbështetur në parimin e shkallëzimit, sipas të cilit vartësit, në çdo nivel, duhet të ndjekin zinxhirin vendimmarrës dhe të komunikojnë me eprorët e tyre vetëm nëpërmjet eprorit më të afërt në hierarki.

3. Funksionet, që kryhen nga institucionet e administratës publike, në nivel qendror, grupohen në katër fusha kryesore:

    a) Funksione politikëbërëse;
    b) Funksione rregullatore;
    c) Funksione të ofrimit të shërbimeve;
    ç) Funksione të shërbimeve mbështetëse.

4. Funksionet politikëbërëse kryhen vetëm nga aparatet e Kryeministrisë e të ministrive dhe nuk mund të caktohen si funksione të institucioneve të tjera të administratës publike, në nivel qendror.

5. Funksionet rregullatore dhe funksionet e ofrimit të shërbimeve, si rregull, kryhen nga degët e ministrive dhe/ose institucionet, në varësi të tyre. Në rast se për funksionet përkatëse nuk ekziston një institucion varësie ose degë ministrie, funksioni mund të vendoset në aparatin e ministrisë.

6. Funksionet e shërbimeve mbështetëse, si rregull, kryhen nga vetë institucioni, ose dega e tij. Në rastet kur institucioni i varësisë ose dega janë shumë të vegjël dhe me numër personeli të kufizuar, funksionet e shërbimeve mbështetëse ose një pjesë e tyre kryhen për to nga institucioni qendror nga i cili varet institucioni i varësisë apo dega.

7. **Pozicionet e dedikuara për funksionet mbështetëse në çdo institucion nuk duhet të kalojnë 33% të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të institucionit.**

8. **Nëse aparati i ministrisë/institucionit qendror ofron shërbime mbështetëse për institucionet e varësisë, atëherë në përcaktimin e raportit të pozicioneve mbështetëse merret në konsideratë edhe numri i pozicioneve të institucionit të varësisë apo degës.**

9. Institucionet e pavarura kryejnë, si rregull, funksione rregullatore dhe të ofrimit të shërbimeve, me përjashtim të rasteve kur me ligj të veçantë parashikohet ndryshe.

10. Pozicionet, që kryejnë funksione të së njëjtës fushë, grupohen në sektorë, drejtori dhe drejtori të përgjithshme, në rast se plotësohet standardi numerik për krijimin e njësisë organizative respektive. Pozicionet, që kryejnë funksione të ngjashme, grupohen në të njëjtën njësi organizative.

11. Në aparatet e ministrive ka vetëm një drejtori të përgjithshme për çdo funksion kryesor, sipas përcaktimit të bërë në pikën 3, të këtij vendimi, me përjashtim të rastit kur një drejtori e përgjithshme është krijuar me një ligj të veçantë.

12. Departamentet janë njësi organizative të veçanta, të cilat mbulojnë një funksion të rëndësishëm vetëm të politikëbërjes dhe krijohen vetëm në Kryeministri, ndërsa në institucionet e tjera, në rastet kur përmenden në një ligj të veçantë.

13. Në aparatet e ministrive, sektorët nuk mund të krijohen si njësi të veçanta që raportojnë drejtpërdrejt te sekretari i përgjithshëm. Sektorët e veçantë vendosen në kuadrin e drejtorisë me të cilën kanë ngjashmërinë më të madhe të misionit.

14. Në institucionet e pavarura, njësia më e lartë organizative është drejtoria e përgjithshme, e cila krijohet vetëm në rastet kur plotësohen standardet numerike përkatëse.

15. Në institucionet e varësisë, njësia më e lartë organizative është drejtoria. Në rastin e institucioneve të mëdha, me më shumë se 50 pozicione pune, në institucionin e varësisë mund të krijohen pozicionet e zëvendëstitullarit, me kushtin që ky pozicion të jetë, në të njëjtën kohë, edhe drejtuesi i një drejtorie funksionale të institucionit.

16. Pozicioni i sekretarit të përgjithshëm krijohet vetëm në Kryeministri, aparatet e ministrive dhe në institucionet e pavarura, në rast se në këto të fundit anëtarët e emëruar në drejtimin e institucionit nuk janë të punësuar me kohë të plotë.

17. Degët e ministrive drejtohen nga titullari i degës, ndërsa njësia më e lartë organizative e saj është sektori.

18. Në degët e ministrive dhe në institucionet e varësisë, të cilat kanë një numër të reduktuar të stafit deri në 10 (dhjetë) pozicione, struktura e brendshme mund të jetë e sheshtë, me vetëm një pozicion drejtues dhe të gjitha pozicionet e tjera që i raportojnë atij.

19. Degët e ministrive dhe institucionet e varësisë kanë një varësi funksionale nga drejtoria e përgjithshme e cila mbulon fushën e veprimtarisë së tyre. Në rast se

për funksionin që ato kryejnë nuk ekziston një drejtori e përgjithshme specifike, atëherë ato i raportojnë drejtorisë së përgjithshme të politikëbërjes në ministri. Në rast se vlerësimi i pozicionit të punës për titullarin e institucionit të varësisë është i barabartë ose më i lartë se vlerësimi i pozicionit të punës për drejtorin e përgjithshëm në ministri, atëherë institucioni e ka varësinë funksionale nga sekretari i përgjithshëm i ministrisë.

20. Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçantë kur në të janë të paktën një pozicion shef sektori dhe dy vartës. Një sektor mund të krijohet edhe pa pozicionin e shefit, nëse është në kuadër të një drejtorie dhe ka të paktën dy nëpunës.

21. Një drejtori mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy sektorë të drejtuar nga një shef ose nëse ka të paktën 5 (pesë) punonjës.

22. Një drejtori e përgjithshme mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy drejtori.

23. Funksioni i auditimit të brendshëm grupohet në një njësi organizative që, në rastin e ministrive, i raporton nga ana funksionale ministrit, ndërsa nga ana administrative varet nga sekretari i përgjithshëm dhe, në rastet e institucioneve të pavarura, i raporton titullarit të institucionit. Njësitë e auditimit të brendshëm nuk krijohen në degët e ministrive dhe institucionet e varësisë, me përjashtim të rastit kur këto të fundit janë të organizuara me degë në rrethe dhe kanë numër të madh të stafit. Për këto institucione, funksioni i auditimit kryhet nga njësia e auditimit të brendshëm të ministrisë nga e cila varen ose sipas mënyrave të parashikuara në ligjin nr.9720 datë 23.4.2007, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

24. Në çdo institucion, i cili ka mbi 15 (pesëmbëdhjetë) pozicione pune, duhet të ketë të paktën një pozicion të dedikuar për funksionet e lidhura me financat e institucionit. Në rastet e institucioneve me më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) pozicione pune, ky funksion të kryhet nga institucioni qendror nga i cili varet institucioni. Në institucionet e vogla, pozicionit të ngarkuar me financat mund t'i ngarkohen edhe funksione të tjera shtesë.

25. Në institucionet, që kanë më shumë se 30 (tridhjetë) pozicione pune, duhet të ekzistojë një pozicion pune për menaxhimin e burimeve njerëzore. Në varësi të madhësisë së institucionit, ky pozicion mund të jetë i dedikuar ose të ketë përgjegjësinë edhe për kryerjen e funksioneve të tjera.

26. Funksioni i mbajtjes së magazinës së institucionit duhet të vendoset në një pozicion të ndryshëm nga ai i mbajtjes së financës së institucionit dhe në institucionet e vogla, ku nuk justifikohet ekzistenca e një pozicioni të veçantë pune, mund të vendoset në çdo pozicion tjetër pune.

27. Funksionet e marrëdhënieve me jashtë nuk organizohen si njësi organizative e veçantë, me përjashtim të rastit kur institucioni e ka këtë funksion një ndër misionet kryesore të punës së tij. Si rregull, ky funksion kryhet nga drejtuesit e njësive organizative të institucionit dhe nga titullari i tij.

28. Funksionet e marrëdhënieve me publikun nuk organizohen si njësi organizative e veçantë, me përjashtim të rastit kur misioni i institucionit e kërkon një funksion të tillë të veçuar. Si rregull, marrëdhëniet me publikun mbahen nga drejtuesit e njësive organizative të institucionit, ndërsa funksioni i zëdhënësit kryhet nga kabineti i titullarit të institucionit ose nga vetë ky i fundit.

## II. Procedura e hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike, në nivel qendror

29. Struktura organizative e institucioneve të administratës publike, në nivel qendror, ndryshohet në rastet kur:

a) ka pasur ndryshime të misionit të institucionit;
b) janë shtuar apo pakësuar funksionet e institucionit;
c) si rrjedhojë e analizave të kryera, rezulton se duhet të ketë një shpërndarje të ndryshme të burimeve të shtuara për kryerjen e funksioneve.

30. Për institucionet në fushën e ekzekutivit, ndryshimi i strukturës përgatitet për Kryeministrin nga Departamenti i Administratës Publike, në bazë të propozimit të marrë nga ministri propozues. Në rastet kur, mbështetur në një ligj të veçantë, struktura organizative miratohet nga një organ tjetër, merret, në mënyrë të detyrueshme, mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe i Ministrisë së Financave.

31. Në rastin e ndryshimit të strukturës së institucioneve të pavarura, Kuvendi kërkon mendimin e detyrueshëm të Departamentit të Administratës Publike dhe të Ministrisë së Financave.

32. Ministria e Financave jep mendimin e saj të detyrueshëm për kostot financiare të propozimit përkatës, në rastet kur ndryshimi i strukturës shoqërohet me

efekte financiare shtesë mbi buxhetin e miratuar ose edhe kur efektet shtesë mbulohen nga fondet e lira, në dispozicion të institucionit.

33. Institucioni, i cili propozon ndryshimin e strukturës, dërgon në Departamentin e Administratës Publike ose në Kuvend, në rastin e institucioneve të pavarura, të dhënat e mëposhtme:

a) Arsyet e hollësishme të nevojës për ndryshime;
b) Efektet financiare që shoqërojnë ndryshimet e kërkuara;
c) Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi;
ç) Analizat sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara;
d) Një raport për pasojat që mund të ketë ristrukturimi mbi nëpunësit e institucionit dhe shpenzimet e personelit, si dhe një parashikim për sistemimin e nëpunësve, pozicionet e të cilëve preken, si pasojë e ristrukturimit.

34. Departamenti i Administratës Publike nuk shqyrton dhe nuk përgatit për Kryeministrin asnjë propozim, që nuk paraqitet në përputhje me pikën 34, të kreut II, të këtij vendimi, dhe që nuk shoqërohet me mendimin e Ministrisë së Financave në rastet e përcaktuara në pikën 32, të kreut II, të këtij vendimi.

35. Departamenti i Administratës Publike mund të kërkojë sqarime shtesë nga institucioni propozues për ndryshimin e strukturës ose mund të bëjë komente për propozimin, përpara se ta dërgojë për miratim te Kryeministri.

36. Në rast se ka qëndrime të kundërta ndërmjet Departamentit të Administratës Publike dhe institucionit propozues për kërkesat e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "d", të pikës 33, të këtij vendimi, institucioni është i detyruar të reflektojë komentet dhe sugjerimet e Departamentit të Administratës Publike. Në rast se vazhdon të ketë qëndrime të kundërta ndërmjet dy institucioneve, sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave organizon një takim të përbashkët për bashkërendimin e punës ndërmjet të dyja institucioneve për kërkesat për pozicionet përkatëse.

37. Departamenti i Administratës Publike i paraqet Kryeministrit projekturdhrin për miratimin e strukturës së institucionit, të shoqëruar me relacionin përkatës, ku përcaktohen shkaqet dhe arsyet që kanë çuar në ndryshimin e strukturës dhe objektivat që parashikohen të arrihen.

38. Urdhri për miratimin e strukturës hyn në fuqi menjëherë, por fillon të prodhojë efektet financiare jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi, periudhë në të cilën duhet të përfundojnë të gjitha veprimet për sistemimin e punonjësve ekzistues në strukturën e re.

39. Në rastin e pozicioneve të shërbimit civil në Kryeministri dhe aparatet e ministrive, vendimi për sistemimin e një nëpunësi në një pozicion tjetër apo kalimin e tij në listën e pritjes, merret bazuar në kriteret e përcaktuara në pikat 7-10, të vendimit nr.360, datë 14.7.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për lirimin nga shërbimi civil", dhe pas një procedimi administrativ individual, të kryer në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë për çdo nëpunës, pozicioni i të cilit preket nga ristrukturimi.

40. Institucioni vendos sipas pikës 39, të kreut II, të këtij vendimi, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit të ndryshimeve në strukturë nga Kryeministri.

41. Vendimi për sistemimin e një nëpunësi në një pozicion tjetër apo kalimi në listën e pritjes hyn në fuqi vetëm pas dhënies së mendimit pozitiv nga Departamenti i Administratës Publike.

42. Departamenti i Administratës Publike shqyrton vendimin e institucionit dhe del me një mendim brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së tij. Në rast se vendimi nuk rezulton të jetë dhënë në përputhje me rregullat e procedimit administrativ, sipas Kodit të Procedurave Administrative, nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikat 7-10, të vendimit nr.360, datë 14.7.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për lirimin nga shërbimi civil", apo nuk përputhet me planin për sistemimin e punonjësve, për të cilin është rënë dakord përpara dërgimit për miratim të strukturës, Departamenti i Administratës Publike del me një mendim negativ.

43. Në rast të mendimit negativ të Departamentit të Administratës Publike, institucioni fillon procedimin administrativ nga e para. Pikat 40-42, të kreut II, të këtij vendimi, zbatohen edhe në këtë rast.

44. Deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, nëpunësi civil konsiderohet se vazhdon të jetë në të njëjtin pozicion pune që kishte para ristrukturimit.

45. Në rastin e pozicioneve, që nuk i përkasin shërbimit civil në institucionet qendrore, në fushën e ekzekutivit, risistemimi i punonjësve në strukturën e re kryhet mbështetur në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës për

pozicionet përkatëse, por përfundon brenda afatit të parashikuar në pikën 38, të kreut II, të këtij vendimi.

46. Fillimi i prodhimit të efekteve financiare të strukturës së re fillon, sipas rastit, në çastin:

a) e konfirmimit nga Departamenti i Administratës Publike të propozimit për ripozicionimin e të gjithë punonjësve në strukturën e re;

b) e lëshimit të urdhrit nga titullari i institucionit për njësinë e financës, për rastet e institucioneve të pavarura ose të punonjësve që nuk janë subjekt i legjislacionit për shërbimin civil.

47. Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Kryeministria, për institucionet në varësi të qeverisë, janë përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të parashikimeve për sistemimin e punonjësve në strukturën e re të miratuar.

48. Në rastin e krijimit të një institucioni për herë të parë, rregullat e parashikuara në kreun II, të këtij vendimi, zbatohen në mënyrë korresponduese.

**III. Dispozita transitore**

49. Brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për institucionet në fushën e ekzekutivit, dhe 2 (dy) vjetëve, për institucionet e tjera, strukturat organizative duhet të përshtaten sipas standardeve të përcaktuara në kreun I, të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**SALI BERISHA**

MINISTRI I BRENDSHËM

BUJAR NISHANI

NR PROT 1909/1
DATE 8.7.2011

GJITHË MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE
TË TJERA QENDRORE
DEPARTAMENTIT TE ADMINISTRATES
PUBLIKE
QENDRES SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LEZHJA

Sekretari i Përgjithshëm

—1239—
22.10.12

# LETER INTERESI

Cel:

e-mail:

Tirane, Albania

Data : 22.10.2012

DREJTUAR : DEPARTAMENTIT TE ADMINISTRATES PUBLIKE ,

DREJTORISE SE HUAMARRJES NE DREJTORINE E PERGJITHSHME TE MENAXHIMIT TE BORXHIT PRANE MINISTRISE SE FINANCAVE .

Te nderuar zoterinj,

Une e nenshkruar: pasi u njoha me vendin vakant per :

Specialist prane Drejtorise se Huamarrjes ne Drejtorine e Pergjithshme te Menaxhimit te Borxhit prane Ministrise se Financave ,shpreh interesin tim per pjesemarrje ne kete konkurs.

Mendoj se kualifikimet e mia ne fushen e ekonomise dhe drejtesise si dhe eksperienca e deritanishme plotesojne kerkesat e percaktuara pershtaten me pozicionin vakant.

Duke shpresuar ne mirekuptimin Tuaj mbetem ne pritje te njoftimit .

Me Respekt

Leter interesi per te marre pjese ne konkurs, 2012

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E BRENDSHME**
**Departamenti i Administratës Publike**

**Nr._____ prot** Tiranë, më ___/___/2012

**Lënda:** Kthim përgjigje shkresës Nr. ___ dt.

**Drejtuar:** **Z. ________________**
**Sekretar i Përgjithshem**
**Ministria e Financave**

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr. _______ dt. _________, "Kërkesë për lidhje të kontratës së përkohshme", Departamenti i Administratës Publike shprehet dakord për emërimin e përkohshëm të:

- znj. ____________ në pozicionin Specialist në Sektorin e Analizave, në Drejtorinë ___________________, në Ministrinë e Financave.

Ky emërim miratohet në zbatim të Urdhrit Nr. 174, datë 01. 10. 2010, të Kryeministrit, "Për marrjen e disa masave për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në ministritë dhe aparatin e Këshillit të Ministrave", për të siguruar vazhdimësinë në punë, dhe do të zgjasë deri në përfundimin e procedurave të pranimit në shërbimin civil.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR**

____________________

Koncepton:

Miraton:

Adresa: [illegible] Tiranë, Shqipëri, [illegible] Tel/Fax: [illegible]
www.[illegible]

# PERSHKRIMI I PUNES

**1. EMRI/MBIEMRI**

**MINISTRIA:** MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES

**DREJTORIA PERGJITHESHME : RREGULLATORE**

**SHKALLA: 19**

**TITULLI I PUNES: DREJTOR I PERGJITHSHEM**

**2. POZICIONI ORGANIZATIV**




**3. QELLIM I I PUNES**

Te siguroje ne kohe keshillim profesional Ministrit dhe Sekretarit te Pergjithshem, per hartimin dhe ekzekutimin e reformes Rregullatore, ne perputhje me programet e Qeverise, si dhe te ndikoje ne rritjen cilesore te sherbimeve rregullatore te ofruar nga Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, mbeshtetur ne strategjine kombetare te zhvillimit, ne sektorin energjetik, minerar dhe industrial.

**4. PERGJEGJESITE KRYESORE**

- Ka pergjegjesi te plote per organizimin e punes, koordinimin dhe menaxhimin e

kontributeve profesionale te specialisteve te Drejtorise se Standarteve Elektro-Energjetike, Drejtorise se Standarteve Minerare dhe Industriale dhe Drejtorise se Tregut te Brendshem.

- Te siguroje ne kohe e cilesi, keshillim profesional dhe mbeshtetje ligjore per formulimin dhe zbatimin e praktikave administrative, lidhur me kontratat koncensionare, partneritetit shtet-privat, si dhe mbrojtjen e konsumatorit dhe ndihmes shteterore.

## 5. DETRAT KRYESORE

- Te bashkerendoje veprimtarite e strukturave perberese te Drejtorise se Pergjithshme Rregullatore, per zbatimin e legjislacionit ne fuqi dhe ne perputhje me programin e Qeverise per zhvillimin ekonomik te vendit.
- Te koordinoje punen per lehtesimin e procedurave te licensimit ne te gjitha fushat qe mbulon METE.
- Te koordinoje dhe te siguroje bashkepunim te vazhdueshem dhe efikas me institucionet e varesise, ministrite e Linjes dhe organet e pushtetit vendor.
- Te koordinoje punen per sigurimin e nje partneriteti te qendrueshem te sektorit publik me sektorin privat, nepermjet nxitjes se marreveshjeve koncensionare, si dhe kontrollit te vazhdueshem te tyre.
- Te koordinoj punen per pergatitjen e nje kuadri ligjor, per krijimin e nej sistemi te mirrfillte te mbikqyrjes se tregut ne shkalle vendi.
- Udheheq koordinimin e punes me te gjitha strukturat publike te kontrollit te tregut per mbrojtjen e shendetit, sigurise dhe interesave ekonomike te konsumatoreve.

- Te bashkepunoje dhe te ndjek procesin e rivleresimit te marredhenieve, midis institucioneve dhe hallkave kryesore, si dhe paraqitjen e propozimeve ( per skema me efikase), lidhur me ristrukturimin e metejshem te sektoreve qe mundesojne realizimin e reformes rregullatore per fushat qe mbulon METE.

- Perfaqson institucionin e METE –s ne marredheniet me te tretet.

## 6. PERGJEGJESIA PER ORGANIZIMIN E PUNES MENAXHIMI E STAFIT DHE BURIMEVE

- Organizon, drejton dhe mbikqyr punen per zbatimin e procedurave dhe afateve te percaktuara ne ligj, per realizimin ne kohe dhe cilesi te detyrave te miratuara ne Rregulloren e Brendshme te METE-s .
- Nënshkruan korrespondencën që lidhet me anën tekniko-administrative të shqyrtimit të ceshtjeve te drejtorise.
- Mban lidhje dhe siguron një bashkëpunim të vazhdueshëm me sektorët e tjerë të drejtorisë si dhe të Ministrisë;
- Merr masa për njohjen, zbatimin dhe përmirësimin e legjislacionit që lidhet me drejtorine;
- Raporton dhe përgjigjet për veprimtarinë e drejtorisë përpara Ministrit, Zëvendësministrit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme te Politikave.

## 6. VENDIMMARRJA

- Mban lidhje dhe siguron një bashkëpunim të vazhdueshëm me sektorët e tjerë të drejtorisë si dhe të Ministrisë;
- Merr masa për njohjen, zbatimin dhe përmirësimin e legjislacionit që lidhet me drejtorinë;
- Raporton dhe përgjigjet për veprimtarinë e drejtorisë përpara Ministrit, Zëvendësministrit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Drejtorit te Drejtorisë së Përgjithshme te Politikave.

## 6. VENDIMMARRJA

Mbeshtetur ne aktet ligjore dhe nenligjore, Statusin e nepunesit Civil, Drejtoria e Pergjithshme Rregullatore, merr vendime per vleresimin e punes se stafit, si dhe masa disiplinore ne se konstatohen shkelje te procedurave gjate ushtrimit te detyres, ose mosrealizimi i tyre.

## 7. KONTAKTET DHE PERFAQESIMI

- Bashkepunon dhe bashkerendon punen me Drejtorite e tjera ne Ministri, per problemet qe kane te bejne me fushen e veprimtarise se drejtorise.
- Merr pjese ne grupet e negocimit te projekteve te reja.
- Bashkepunon me AKBN, SHGJSH, RISHM, Ministrite e Linjes, Organet e Pushtetit Vendor, organizatat e biznesit, venas dhe te huaja dhe institucionet e tjera, lidhur me problematiken qe ndjek Drejtoria e Pergjithshme Rregullatore.

## 8. NJOHURITE, AFTESIA DHE EKSPERIENCA

- Te kete mbaruar arsimin e larte.
- Te kete eksperience pune .
- Perbene avantazh eksperienca e punes ne administrate publike.
- Titujt, gradat shkencore dhe kualifikimet jane nje perparesi.
- Te kete aftesi te mira komunikimi dhe pune ne grup.
- Te zoteroje shume mire gjuhen angleze (gjuhe te tjera te komunitetit europian jane perparesi)

**Analisti i punes** ..............................................................

**Punonjesi qe kryen punen** ................................................

**Aprovuar nga drejtuesi i drejtperdrejte**................................

Model përshkrim pune, 2012

## PERSHKRIMI I PUNES

**1. EMRI/MBIEMRI**

**MINISTRIA:** MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
**TITULLI I PUNES:** SEKRETAR I PERGJITHSHEM
**KLASA I - SHKALLA: 22**

**2. POZICIONI ORGANIZATIV**




**3. QELLIMI I PUNES**

1. Te siguroje ne kohe dhe ne menyre profesionale Ministrit keshillim dhe mbeshtetje per formulimin dhe zbatimin e politikave te ministrise, mbeshtetur ne programet Qeverise dhe objektivat bazuar ne Strategjine Kombetare te saj.
2. Te menaxhoje ministrine, nepermjete ushtrimit te funksioneve nepermjet bashkerendimit te punes me strukturat e institucionit, ne menyre te tille qe formulimi dhe zbatimi i politikes te jete i mirekoordinuar dhe veprimtaria e saj te jete, sa me eficente dhe efektive nga pikepamja ekonomike dhe sherbimeve te ofruara.

**2.DETYRAT KRYESORE**

1. Sekretari i Pergjithshem, nepermjet ushtrimit te funksioneve dhe te bashkerendimit te punes se
2. strukturave te institucionit, kujdeset dhe siguron qendrueshmerine dhe vazhdimesine e veprimtariveperkatese te ministrise me institucionet e tjera.
3. Sekretari i Pergjithshem organizon dhe bashkerendon punen me te gjitha strukturat e ministrise, per te siguruar zbatimin e politikave te miratuara ne fushen e veprimtarise se saj, ne perputhje me kerkesat e parashikuara ne ligj dhe aktet e tjera nenligjore, si dhe urdherat apo detyrat e marra nga ministri,.

4. Sekretari i Pergjithshem merr masa per shfrytezimin e frytshem te burimeve njerezore, te mjeteve financiare e burimeve materiale te ministrise.
5. Sekretari i Pergjithshem eshte pergjegjes per ndjekjen dhe mbikeqyrjen e te gjitha ceshtjeve per menaxhimin e burimeve njerezore te institucionit dhe ne menyre te vecant, per zbatimin e dispozitave te ligjit "Statusi i nepunesit civil" dhe te ceshtjeve te tjera, lidhur me personelin.

6. Bashkepunon, sekretarin e Pergjithshem te Keshillit te Ministrave, si dhe Departamentin e Administrates Publike, ne perputhje me aktet normative dhe me udhezimet e nxjerra nga Keshilli i Ministrave.
7. Sekretari i Pergjithshem eshte pergjegjes per vleresimin dhe parashikimin e nevojave per trajnim, si dhe ben planifikimet per trajnimin e stafit te ministrise.

8. Sekretari i Pergjithshem eshte pergjegjes per grumbullimin dhe perditesimin e te dhenave personale te punonjesve te ministrise, per te plotesuar Regjistrin Kombetar te Administrates Publike.

9. Sekretari i Pergjithshem ndjek zbatimin e rregullave te etikes dhe te rregullores se brendshme te institucionit nga punonjesit, njofton ministrin per rastet e shkeljeve, si dhe rekomandon masat e nevojshme.

10. Sekretari i Pergjithshem ndjek procesin e pergatitjes se projektakteve normative te fushes se veprimtarise se ministrise, mbeshtetur ne programet vjetore, te miratuara nga Keshilli i Ministrave.

11. Sekretari i Pergjithshem ka per detyre permiresimin e standardeve per te gjitha sherbimet e ofruara nga ministria.

12. Pergatit analiza dhe ben propozime per mbarevajtjen e punes ne ministri.

13. Ne perputhje me urdhrat dhe detyrat e ngarkuara nga ministri, si dhe pergatit raporte per veprimtarine e institucionit apo per ceshtje te vecanta.
14. Sekretari i Pergjithshem perfaqeson ministrine ne marredhenie me tretet, ne perputhje me delegimet dhe autorizimet e dhena nga ministri.
15. Pervec detyrave dhe pergjegjesive te pergjithshme sekretari Pergjithshem kryen edhe detyra te tjera, te ngarkuara nga ministri.

**4. PERGJEGJESITE KRYESORE**

1. Ka pergjegjesi te plote per organizimin e punes, koordinimin dhe menaxhimin e personelit ne institucion.

2. Te koordinoje kontributet profesionale te gjithe nepunesve, per formulimin e politikave, ne zbatim prioriteteve dhe misionit te METE –s.

3. Te siguroj ne kohe e cilesi, keshillim profesional dhe mbeshtetje ligjore per formulimin dhe zbatimin e praktikave administrative qe kane te bejne me politikat qe ndjek dhe zhvillon ministria, per monitorimin, mireadministrimin dhe zhvillimin e te gjithe drejtorive.

**5. PERGJEGJESIA PER ORGANIZIMIN E PUNES, MENAXHIMI I STAFIT DHE BURIMEVE**

Organizon, drejton dhe mbikqyr punen per zbatimin e procedurave e afateve të përcaktuara në ligj, per realizimin ne kohe dhe cilesi te detyrave te percaktuara ne rregulloren e brendshme te METE –s

**6. VENDIMMARRJA**

Merr pjese ne menyre te drejteperdrejte ne procesin e vendimmarrjes, per rekrutimin dhe pergatitjen e nje stafi sa me eficent, bazuar ne parimet e profesionalizmit, integritetit dhe ndershmerise, me synim realizimin ne kohe e cilesi te sherbimeve te ofruara nga ministria .

**7. KONTAKTET DHE PERFAQESIMI**

1. Kontakte te drejteperdrejta me Ministrin dhe Zevendesministrat.
2. Kontakte te drejteperdrejta me struktura homologe ne Keshillit te Ministrave, DAP dhe Ministrit e tjera.
3. Kontakte te drejteperdrejta me te gjithe nivelet e drejtorive te pergjithshme dhe drejtorive ne Ministri.
4. Perfaqeson Ministrine me autorizim te ministrit ne aktivitete brenda dhe jashte vendit.
5. Merr pjese ne grupet e negocimit te projekteve te reja.
6. Mban kontakte dhe bashkepunon ne menyre te vazhdueshme me institucionet e varesise.

**8. NJOHURITE, AFTESIA DHE EKSPERIENCA**

1. Te kete Diplome te nivelit te Dyte ( DND) ose Diplome te Integruar te Nivelit te Dyte ( DIND), apo te barazvlefshme me to, sipas legjislacionit te arsimit te larte, ne shkencat Juridike, Ekonomike dhe Inxhinjerike
2. .Perben avantazh diplome pasuniversitare ne nje nga fushat e veprimtarise se ministrise
3. Eksperienca ne pune perbene avantazh.
4. Nivel i larte komunikimi dhe aftesi prezantuese, njohese.
5. Te njohe kerkesat e zhvillimit te politikave sipas misionit te ministrise.
6. Te njohe dhe te perdore teknologjine e informacionit
7. Deshmi te mbrojtjes se nje gjuhe te huaj te KE

**9. Analisti i punes :**

**10 Aprovuar nga drejtuesi i drejtperdrejte Sekretar i Pergjithshem**

Model përshkrimi pune (Sekretar i Përgjithshëm), 2012

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E BRENDSHME**
**Departamenti i Administratës Publike**

[illegible]

Nr.____ prot                                                                                    Tiranë, më ___/___/2012

**Model shkrese emërimi**

**Lënda:** **Emërim**

**Drejtuar:** Z. ______________

Z. ______________
**Sekretar i Përgjithshëm**

Z. ______________
**Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave**

**TIRANE**

Në përputhje me nenin 13, pika 7, të ligjit Nr 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", Z. ________________ emërohet nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin __________, në Drejtorinë e Integrimit dhe Projekteve, në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

**DREJTOR**

______________________

2871

Adresa: Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë Shqipëri, Kutia Postare Nr. 1751 Tel/Fax: +355 4 2 [illegible]
www.pad.gov.al

Model shkrese: Emërim, 2012

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E BRENDSHME**
**Departamenti i Administratës Publike**

Nr.____ prot                                                                 Tiranë, më ___/___/2012

**Lënda:** Lidhur me konfirmimin e znj. _______________, në pozicionin Specialist, në Sektorin e Buxhetit, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave

**Drejtuar:** **Znj. _______________**

**Znj. _______________**
**Sekretar i Përgjithshëm**
**Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave**

**Tiranë**

Departamenti i Administratës Publike, pasi u njoh me vendimin për konfirmimin e znj. _______________ si nëpunës civil në pozicionin Specialist, në Sektorin e Buxhetit, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe pasi verifikoi procedurat ligjore në marrjen e këtij vendimi, në përfundim të periudhës së provës, në bazë të rezultateve të vlerësimit të punës, miraton vendimin e konfirmimit.

**DREJTOR**

_______________

**Konceptoi:**

**Miratoi:**

Adresa: [illegible] Tiranë Shqipëri, Kutia Postare Nr. 1791          Tel/Fax: +355 4 [illegible]
www.pad.gov.al

Model shkrese: Konfirmim, 2012

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Departamenti i Administratës Publike

Nr.____ prot                                                            Tiranë, më __/__/2012

**Lënda:** Lirim nga detyra

**Drejtuar:** Z. ____________________
**Sekretar i Përgjithshëm**
**Ministria e Financave**

**Tiranë**

Në mbështetje të nenit 21, pika 1 gërma "b" të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i Nëpunësit Civil" si dhe VKM Nr. 360, datë 14.07.2000, "Për lirimin nga Shërbimi Civil", miratojmë lirimin nga shërbimi civil dhe shkëputjen nga lista e pritjes, të z. Lek Mandreja, në pozicionin __________ në Drejtorinë e Përgjithshme të __________ në Ministrinë e Financave, lirim i cili bëhet për shkak të mbushjes së moshës së pensionit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR**

____________________

Konceptoi

Miratoi

Adresa: Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë, Shqipëri, Kutia Postare Nr. [illegible]    Tel/Fax: [illegible]
www.pad.gov.al

Model shkrese: Lirim nga detyra, 2012

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E BRENDSHME**
**Departamenti i Administratës Publike**

---

Nr.____ prot                                                    Tiranë, më ___/___/2012

**Lënda:** Lirim nga shërbimi civil

**Drejtuar:** **Z. ______________**
**Sekretar i Përgjithshëm**
**Ministria e Financave**

Tiranë

Në mbështetje të nenit 21, pika 1 gërma "a" të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i Nëpunësit Civil", si dhe të VKM Nr. 360, datë 14.07.2000, "Për lirimin nga Shërbimi Civil", miratojmë lirimin nga shërbimi civil të znj. ______________, në pozicionin Specialist në Drejtorinë ____________________, në Ministrinë e Financave, lirim i cili bëhet me kërkesën e saj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR**

______________________

**Konceptoi:**

**Miratoi:**

---

Adresa: Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë, Shqipëri, Kutia Postare Nr. 1751   Tel/Fax: +355 4 2230337, 2251241
www.pad.gov.al

Model shkrese: Lirim nga shërbimi civil, 2012

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME
Departamenti i Administratës Publike

Nr.____ prot                                                                 Tiranë, më __/__/2012

**PËR REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK ORGANIZUAR NGA DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA NË MINISTRINË E DREJTËSISË**

Departamenti i Administratës Publike në përputhje me nenin 13 të Ligjit Nr. 8549 datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", si dhe pikën 12 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 231 datë 11.05.2000 "Për pranimin në Shërbimin Civil dhe Periudhën e Provës" ka zhvilluar verifikimin paraprak të kandidatëve për pozicionin:

- **2 Specialistë, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit**

Plotësojnë kushtet për të hyrë në testim:

1. ____________________
2. ____________________
3. ____________________
4. ____________________
5. ____________________

Nuk plotësojnë kushtet për të hyrë në testim:

1. ____________________ (Nuk ka arsimin e kërkuar)
2. ____________________ (Nuk ka arsimin e kërkuar)

**TESTIMI PËR POZICIONIN E MËSIPËRM DO TË ZHVILLOHET NË DATËN 13.01.2011, DITËN E ENJTE NË ORËN 10.00 NË MINISTRINË E DREJTËSISË**

**ANKESAT PËR REZULTATET E MËSIPËRME TË BËHEN BRENDA DY DITËVE PRANË DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE**

**DREJTOR**

____________________

Adresa: Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë, Shqipëri, Kutia Postare Nr. 1791                Tel/Fax: +355 4 2251241, 2228937
www.pad.gov.al

Model shkrese: Paraseleksionim, 2012

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E BRENDSHME**
**Departamenti i Administratës Publike**

Nr._____ prot                                                  Tiranë, më ___/___/2012

***Lënda*:** Për lëvizjen paralele në pozicionin ____________ në Ministrinë e Financave

**Drejtuar:** **Z. _________________**
**Sekretar i Pergjithshëm**
**Ministria e Financave**

**Tiranë**

Në përputhje me nenin 15 te ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i Nëpunësit Civil" dhe bazuar në Vendimin Nr.342, datë 14.07.2000, të Këshillit të Ministrave "Për Levizjen Paralele dhe ngritjen në detyrë të Nëpunësit Civil" dhe Vendimin Nr.231, datë 11.05.2000, të Këshillit të Ministrave "Për Pranimin në Shërbimin Civil dhe Periudhën e Provës", Departamenti i Administratës Publike mori në shqyrtim kërkesën për lëvizje paralele në pozicionin ____________, në Ministrinë e Financave të z/nj. ____________.

Departamenti i Administratës Publike, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, konstatoi plotësimin e rregullave për zbatimin e lëvizjes paralele dhe kërkesave të veçanta, sipas përshkrimit të punës të pozicionit të sipërpërmendur.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 7 dhe 8, të Vendimit nr. 342, të Këshillit të Ministrave datë 14.07.2000 "Për Lëvizjen Paralele dhe ngritjen në detyrë të Nëpunësit Civil", ju dërgojmë kandidaturën e mësipërme për të marrë aprovimin tuaj në lidhje me lëvizjen paralele në pozicionin __________, në Ministrinë e Financave.

Lutemi sa më shpejt mendimin tuaj (brenda datës 19.04.2012), me qëllim që Departamenti i Administratës Publike të vazhdojë me procedurat e mëtejshme të konkurimit, në rast refuzimi nga ana juaj.

**DREJTOR**

**Blerta SELENICA**

Konceptoi:

Miratoi:

Adresa: [illegible]                                                  Tel/Fax: [illegible]

[illegible]

Model shkrese: Levizje paralele, 2012

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E BRENDSHME**
**Departamenti i Administratës Publike**

**Nr.____ prot** **Tiranë, më __/__/2012**

***Model shkrese:***

***shtesa e pagës për kualifikimin, gradat dhe titujt shkencorë***

**Lënda:** **Kthim përgjigje për shtesën për titujt dhe gradat shkencore**

**Drejtuar:** **Z. ________________**
**Sekretar i Përgjithshëm**
**Këshilli i Ministrave**

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës suaj nr.____, datë _____, si dhe në zbatim të Udhëzimit nr.1, datë 16/03/2012, të Departamentit të Administratës Publike, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, "Për zbatimin e Vendimit nr.343, datë 11/08/2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të nivelëve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të Kabineteve, në Kryeministri, aparatet e Ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të Ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", të ndryshuar", Departamenti i Administratës Publike miraton të drejtën e shtesës së pagës, për gradën shkencore "Doktor" për:

- znj. ______ në pozicionin *Jurist* në Departamentin e ____________ në Këshillin e Ministrave.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR**

____________

Konceptoi

Miratoi

Model shkrese: Shtesa në pagë për grada dhe tituj shkencor, 2012

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E BRENDSHME**
**Departamenti i Administratës Publike**

Nr.____ prot                                                                 Tiranë, me ______2011

**Lënda:** Kthim pergjigje tuajës nr.______, datë _________

**Drejtuar:** **Z. ________________**
**Ministrër i Brendshëm**

**Për dijeni:** **Z. __________________**
**Ministër i Drejtësisë**

**Tiranë**

*I nderuar zoti Ministër,*

Departamenti i Administratës Publike, në përgjigje të shkresës tuaj nr. _____ datë ___________, pas marrjes së miratimit nga Ministria e Drejtësisë, në zbatim të nenit 17. "Transferimi i detyrueshëm", të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i Nëpunësit Civil", si dhe pasi verifikoi të dhënat për nëpunësin e propozuar për transferim të detyrueshëm me kërkesat e pozicionit të punës, miraton transferimin e detyrueshëm, për:

Z. _________, nga, aktualisht në pozicionin _____________, në Ministrinë e Drejtësisë, në pozicionin ______________ në Ministrinë e Brendshme.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR**

______________________

Konceptoi:

Miratoi:

**Adresa: [illegible], nr. 3, Tiranë, Shqipëri, Kutia Postare Nr. 1751** **Tel/Fax: [illegible]**
**[illegible]**

Model shkrese: Transferim i detyrueshem, 2011

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E BRENDSHME**
**Departamenti i Administratës Publike**

**Nr._____ prot** — *Tiranë, më ___/___/2012*

***Model shkrese: pezullim nga shërbimi civil***

**Lënda:** Kthim përgjigje tuajës nr. ____, datë ______

**Drejtuar:** Z. ______________
Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Drejtësisë

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës suaj nr. ____, me subjekt "Kërkesë për pezullim", në zbatim të Ligjit nr. 8549, datë 11/11/2009, "Statusi i nëpunësit civil", neni 22, pika 2 (c), Departamenti i Administratës Publike miraton *pezullimin nga shërbimi civil për z.* ______, aktualisht në pozicionin ______ në Ministrinë e Drejtësisë, për shkak të emërimit në pozicionin Këshilltar i Ministrit të Drejtësisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR**

________________

Konceptoi

Miratoi

Model shkrese: Pezullim nga shërbimi civil, 2012

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Departamenti i Administratës Publike

Nr.____ prot                                                   Tiranë, më __/__/2012

**Model shpallje ne gazete te fituesit te konkursit**

**Lënda:** **Lidhur me shpalljen në gazetë të fituesit në Institucionin tuaj**

**Drejtuar:** **Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse**
**Ministria e Shëndetësisë**

Departamenti i Administratës Publike, me kërkesën tuaj, si dhe në përputhje me nenin 13, pika 6 të ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i Nëpunësit Civil" si dhe pikën 20 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 231, datë 11.05.2000 "Për pranimin në Shërbimin Civil dhe Periudhën e Provës", ka shpallur fituesin e konkursit për pozicionin:

- Drejtor i Përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse

në gazetat "________" dhe "________", **në formatin 1/10 të faqes dhe pa ngjyra.**

Pagesa e faturës për shpalljet e mësipërme të bëhet sipas këtij formati.

**DREJTOR**

________________

Konceptoi:

Miratoi:

Adresa: Sheshi Skenderbej, nr. 3, Tirane, Shqiperi, Kutia Postare Nr. 1751    Tel/Fax: +355 4 2 251241, 2 230937
www.pad.gov.al

Model shkrese: Shpallje në gazetë e fituesit, 2012

**SHTOJCA A**

**FORMULAR PER VLERESIMIN VJETOR**

**31.10.2011 - Nentor 2012**

**Seksioni A**

**Gjeneralitetet e Punonjesit**

**Emri:**

**Vendi i Punes:** **Koordinator (per Politikat e Rekrutimit dhe Konfirmimit)**

**Datelindja :**

**Data e fillimit te punes ne postin aktual :** **per pozicionin Koordinator (per Politikat e Rekrutimit dhe Konfirmimit)**

**Data e fillimit te punes ne sherbimin civil:**

---

**Seksioni B**

**Qellimi i Pergjithshem i Punes:**

Te marre pjese dhe te kontriboje ne formulimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve te pranimit ne sherbimin civil si dhe zbatimi konkret i procedurave te pranimit ne sherbimin civil

| **Objektivat e Punes** (sipas rendesise) | Tregoni nivelin e vleresimit për çdo objektiv 1- 4 |
|---|---|
| **1.** Pjesemarrja ne hartimin e procedurave per permiresimin e procesit te pranimit ne baze te ndryshimeve qe do ti ndodhin kesaj procedure me miratimin e ligjit te ri. | 2 |
| **2.** Sigurimi i zbatimit te legjislacionit te sherbimit civil persa i perket procesit te rekrutimit, zbatimit te procedures se ngritjes ne detyre dhe periudhen e proves, pergatitja e praktikes shkresore per konfirmimin si nepunes civil. | 1 |
| **3.** Ndjekja e ecurise se menaxhimit te Burimeve Njerezore ne Ministrite ne ndjekje dhe asistimi per problematika te ndryshme. | 1 |
| **4.** Pjesemarrja ne Komitetin *ad hoc* te testimit dhe pergatitjen e praktikes shkresore te emerimit pas zhvillimit te konkurimit. Ndjekja e ecurise se menaxhimit te Burimeve Njerezore ne Ministrite ne ndjekje dhe asistimi per problematika te ndryshme. | 1 |

**Seksioni Ç**

**Niveli i Aftesive Themelore.**

Tregoni nivelin e arritur per çdo aftesi 1-4.
Aftesitë e patestuara duhet të shenohen me x.

| | |
|---|---|
| **Drejtimi** | / |
| **Gjykimi** | 1 |
| **Puna në grup** | 2 |
| **Shfrytezimi i Burimeve** | 1 |
| **Vetenxitja** | 1 |
| **Shpirti Krijues** | x |
| **Vet-Organizimi** | 1 |
| **Aftësia komunikuese me shkrim** | 1 |
| **Aftësia komunikuese me gojë** | 1 |
| **Cilesia e Sherbimit** | x |
| **Aftesia Teknike** | 1 |

Seksioni D

**Vleresimi i pergjithshem i eprorit**

**(i) Zyrtari Raportues**

Komente te pergjithshme qe tregojne ndonjë përparësi të veçantë të punonjësit dhe ndonjë fushë ose aftesi ku duhet të bëhen permiresime.

....................................................................................................................................
....................................................................................................................................
....................................................................................................................................
....................................................................................................................................
....................................................................................................................................
.................................................................

Kam vleresuar punonjesin sipas kerkesave te Udhezimit te Vleresimit dhe mendoj qe niveli i pergjithshem i mbarëvajtjes në punë është

| / |
|---|

**[1-shume mire; 2-mire; 3-kenaqshem; 4-jo mjaftueshëm]**

**Emri/Firma**............................ **Shkalla**...................
**Vendi i Punes**......................... **Data**..........................

**(ii) Komente te bera nga Zyrtari Kunderfirmues.**

....................................................................................................................................
....................................................................................................................................
....................................................................................................................................
....................................................................................................................................

Mendoj se Raporti i Vleresimit nuk eshte bere ne perputhje me standartet e kerkuara / eshte ne perputhje me Udhezimin e Vleresimit. Jam i kenaqur qe vleresimi eshte i drejte dhe i sakte.

**Emri/Firma**............................ **Shkalla**......................
**Vendi i Punes**......................... **Data**.............................

**Seksioni E**

**Vertetim marrje njoftimi**

Kam lexuar dhe kam marre nje kopje te ketij vleresimi dhe jam ne dijeni se mund te bej ankese nepermjet eprorit tim te drejtperdrejte brenda 10 diteve.

**Emri/Firma**......................... **Data**.........................

Formular vlerësimi vjetor, 2012

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E BRENDSHME**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"     Tel: 04 22 359-37

***Njoftim për vend të lirë pune***

Në zbatim të ligjit Nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", **Departamenti i Administrates Publike** shpall konkurimin për 1 vend të lirë në pozicionin **Koordinator për Strategjine në Njesine e Bashkerendimitte Strategjive ne Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj** në Këshillin e Ministrave.
Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në Shërbimin Civil në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

**KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT**

- Të ketë mbaruar studimet e larta për financë, përbëjnë avantazh studimet dhe kualifikimet pasuniversitare të nivelit master/doktoraturë (për nivelin e diplomave referojuni Udhëzimit nr. 4 dt. 17.02.2010)
- Të ketë jo më pak se 2-vjet eksperiencë pune
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze
- Të përdorë programet bazë të punës në kompjuter
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe menaxhuese

**Paga e pozicionit** është në kategorinë II – b
**Paraqitja e dokumenteve**:
Kandidati duhet të paraqesë brenda **datës 22.11.2011 në Kutinë Postare Nr.1751** këto dokumenta: kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, të librezës së punës, certifikateve të kualifikimit, dëshmive të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore si dhe të paktën një letër rekomandimi, një numër telefoni për tu kontaktuar si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit. (Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit).
**KONKURIMI** është i hapur për nëpunësit civilë të të njëjtës klasë me procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë, nëse vendi nuk plotësohet nga këta kandidatë, konkurimi zhvillohet me kandidatët jashtë Administratës Publike, sipas procedurave të shërbimit civil.
Pas verifikimit paraprak, **me datë 25.11.2011**, në selinë e Këshillit të Ministrave do të shpallet lista e konkurentëve dhe data kur do të zhvillohet konkurimi. Konkurimi do të bazohet mbi njohuri të përgjithshme mbi programin e qeverise, si dhe Strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2007-2013 (www.km.gov.al), njohuri për menyren e funksionimit te fondit te zhvillimit te rajoneve, praktikat ndërkombetare dhe prirjet ne fushen e planifikimit strategjik dhe politikave zhvillimore, Ligjin nr. 9131 dt. 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike" si dhe Ligji nr. 9367 dt. 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", Ligji nr. 8503 dt. 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare", Ligji nr. 9049 dt. 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, te detyrimeve financiare te te zgjedhurve dhe te disa nepunesve publike".
**Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, rezultatet e verifikimit paraprak si dhe datat kur do të zhvillohen testimet, mund t'i gjeni në adresën e Ëeb Site të Departamentit të Administratës Publike <u>www.pad.gov.al</u>**

Adresa: Skenderbej, nr. 3, Tirane, Shqiperi, Kutia Postare Nr. 1751     Tel/Fax: +355 4 2 251241, 2 230937
www.pad.gov.al

Njoftim për vend të lirë pune

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Departamenti i Administratës Publike

Nr.____ prot                                                    Tiranë, më __/__/2012

**Lënda:** Propozohen kandidatët për pozicionin: 2 Specialistë, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në Ministrinë e Drejtësisë

**Drejtuar:** Z. ____________________
Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Drejtësisë

**Për dijeni:** **Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse**

Në përputhje me Vendimin Nr. 231 dt. 11. 05. 2000, "Për Pranimin në Shërbimin Civil dhe Periudhën e Provës" të Këshillit të Ministrave, në datën 10.04.2012, u zhvillua testimi i kandidatëve për vendin e lirë:

- **2 Specialistë, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit,** në Ministrinë e Drejtësisë

Komiteti *Ad Hoc* për testimin e pozicionit të mësipërm, përbëhej nga:

1. Znj. ____________________ Kryetar
2. Z. ____________________ Anëtar
3. Znj. ____________________ Anëtar
4. Znj. ____________________ Anëtar
5. Znj. ____________________ Anëtar

Në përfundim të testimit rezulton se:
Kandidatët me rezultatin më të mirë për pozicionin **2 Specialistë, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit** janë:

1. ____________________ 66 pikë
2. ____________________ 60 pikë
3. ____________________ 54 pikë
4. ____________________ 37 pikë

Adresa: Sheshi Skanderbej, nr. 3, Tiranë, Shqipëri, Kutia Postare Nr. [illegible]    Tel/Fax: +355 4 [illegible]

Bashkëlidhur është procesverbali i testimit të kandidatëve.

Lutemi të zgjidhet nga eprori direkt, kandidati me i përshtatshëm dhe brenda 3 (tre) ditëve, na dërgoni emrin e personit të zgjedhur .
Përzgjedhja bëhet pas zhvillimit të detyrueshëm të intervistës me kandidatët e propozuar nga komiteti ad-hoc.

Vendimi i eprorit direkt duhet të merret pas zhvillimit të intervistës me kandidatët e propozuar, ai duhet të jetë i motivuar dhe të bazohet në parimet e barazisë, mirëbesimit dhe mosdiskriminimit. Vendimi i eprorit direkt jepet pas verifikimit të vërtetësisë së dokumentave në bazë të të cilave është kryer procesi i konkurimit.

Është detyrë e çdo institucioni (eprorit direkt dhe drejtorisë së personelit) që përpara çdo përzgjedhjeje të vërë në dispozicion të kandidatit Ligjin Nr.9131,datë 08.09.2003,"Për rregullat e etikës në administratën publike" dhe ti shpjegojë detyrimet që rrjedhin prej tij (si pjesë e termave të punësimit të çdo punonjësi të administratës publike), si dhe të sigurojë shmangien e konfliktit të interesave,përpara kryerjes së përzgjedhjes.

Për këtë qëllim duhet të nënshkruhet proces-verbali përkatës nga eprori direkt, kandidati i përzgjedhur dhe njësia e burimeve njerëzore dhe një kopje e tij të depozitohet në dosjen e personelit të nëpunësit, ndërsa një tjetër të dërgohet në Departamentin e Administratës Publike, bashkëlidhur vendimit të eprorit direkt për përzgjedhjen e kandidatit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**D R E J T O R**

________________________

Konceptoi:

Miratoi:

**Adresa: Sheshi Skanderbej, nr. 3, Tirana, Shqiperi, Kutia Postare Nr. 1791** **Tel/Fax: +355 4 2251341, 2228927**
www.pad.gov.al

Perzgjedhja e kandidatëve, 2012

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Departamenti i Administratës Publike

## SHPALLJE E REZULTATIT TE KONKURIMIT

Ne perputhje me nenin 13, pika 6 te ligjit Nr. 8549, date 11.11.1999, "Statusi i Nepunesit Civil" si dhe piken 20 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 231, date 11.05.2000 "Per pranimin ne Sherbimin Civil dhe Periudhen e Proves", **NE TESTIMET E ZHVILLUARA PER POZICIONET NE MINISTRINE E SHENDETESISE jane shpallur keto fitues**:

- znj. ________________ eshte fitues i konkursit per **SPECIALIST I PROMOCIONIT SHENDETESOR NE DREJTORINE E SHENDETIT PUBLIK**
- z. ________________ eshte fitues i konkursit per **DREJTOR I DREJTORISE SE PLANIFIKIMIT FINANCIAR**
- z. ________________ eshte fitues i konkursit per **DREJTOR I DREJTORISE SE PLANIFIKIMIT DHE STANDARTEVE SPITALORE**

Adresa: Sheshi Skenderbej, nr. 3, Tirane, Shqiperi, Kutia Postare Nr. 1751 Tel/Fax: +355 4 2 251241, 2 230937
www.pad.gov.al

# KREU I PARE

## Buletini
## i
## Prokurimit Publik

Per me shume informacion
www.app.gov.al

Afati i fundit per pranimin e dokumenteve,data: 20.06.2012 ora 09.00
Vendi: Autoritetit Portual Durres. – www.app.gov.al

## MINISTRIA E BRENDSHME

Autoriteti kontraktor, adresa, nr. tel: Ministria e Brendshme, Sheshi "Skënderbej", Nr.3, Tel 355 4 2254 366 Tirane

Lloji i procedurës se prokurimit: Procedure e hapur

Objekti i prokurimit: "Zhvillimin e mëtejshëm dhe mirëmbajtjen e aplikacionit të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore HRMIS"

Fondi limit total : fondit 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë, pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Afati për kryerjen e shërbimeve : Nga data e lidhjes se kontratës deri me date 31.12.2013.

Data e zhvillimit te tenderit: 22.06.2012 Ora: 11:00
Vendi: www.app.gov.al

Afati i fundit për pranimin e dokumenteve: 22.06.2012 Ora: 11:00

## GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR KAVAJE

Autoriteti Kontraktor: Gjykata e Rrethit Gjyqsor KavajeAdresa: Bulevardi "Josif Budo" Tel/Fax0552 4 2653

Lloji i procedurës së prokurimit : Tender i Hapur

Objekti i prokurimit: "Lyerje te godines se Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kavaje"

Fondi limit: 1083334(njemilion e tetedhjete e tremije e treqind e tridhjete e kater) leke.

Afati për kryerjen e shërbimit: Nga data e lidhjes se kontrates deri me 31.08.2012.

Data e zhvillimit te tenderit: 22.06.2012 ora 11:00
Vendi: www.app.gov.al

Afati i fundit për pranimin e dokumentave: 22.06.2012 ora 11:00
Vendi: www.app.gov.al

*Per me shume informacion*
*www.app.gov.al*

# KREU I PARE

## Buletini
## i
## Prokurimit Publik

Per me shume informacion
www.app.gov.al

Afati i fundit per pranimin e dokumentave eshte data 05.09.2012 ora 10.00.
Vendi: Prokurim elektronik ne faqen e internetit te APP www.app.gov.al

**MINISTRIA E BRENDSHME**

Autoriteti kontraktor, adresa, nr. tel: Ministria e Brendshme, Sheshi "Skënderbej", Nr.3, Tel 355 4 2254 366 Tirane

Lloji i procedurës se prokurimit: Procedure e hapur

Objekti i prokurimit: "Zhvillimin e mëtejshëm dhe mirëmbajtjen e aplikacionit të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore HRMIS"

Fondi limit total : fondit 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë, pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Afati për kryerjen e shërbimeve : Nga data e lidhjes se kontratës deri me date 31.12.2013.

Data e zhvillimit te tenderit: 31.08.2012 Ora: 11:00
Vendi: www.app.gov.al

Afati i fundit për pranimin e dokumenteve: 31.08.2012 Ora: 11:00
Vendi: www.app.gov.al

**AUTORITETI PORTUAL DURRËS**

Autoriteti kontraktor: Autoriteti Portual Durrës, Adresa: Lagja nr.1 Rruga Tregtare Durrës. Telefon/Faks052 23384 / 052 23115

Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur

Objekti i prokurimit: KALIMI I SHERBIMIT TE MIREMBAJTJES SE INFRASTRUKTURES ENERGJITIKE DHE ASAJ ELEKTRIKE OPERATOREVE PRIVAT

Fondi Limit: Per nje vit 39,990,000 Lek, dhe per pese vjet 199,950,000 Lek, neto pa TVSH. Nga fondet e vete institucionit

Afati i ekzekutimit: 60 muaj

Data e zhvillimit të tenderit: 03-09-2012 ora 10:00
Vendi: Autoriteti Portual Durrës

Afati i fundit per pranimin e dokumenteve,data: 03-09-2012 ora 10:00

*Per me shume informacion*
*www.app.gov.al*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E BRENDSHME**
**Departamenti i Administratës Publike**

# NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të ligjit Nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", **Departamenti i Administratës Publike** shpall konkurrimin për 1 vend të lirë në pozicionin **Inspektor në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm** në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në Shërbimin Civil në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 «Statusi i nëpunësit civil».

## KËRKESA TË VECANTA PËR KANDIDATËT

- Të ketë mbaruar Arsimin e Lartë në një nga degët ekonomi, financë, kontabilitet, drejtësi (për nivelin e diplomave referojuni Udhëzimit nr. 4 dt. 17.02.2010)
- Të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune në auditim apo në fusha të tjera, si financë, kontabilitet apo fusha të tjera të lidhura
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze
- Të përdorë programet bazë të punës në kompjuter
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup

**Paga e pozicionit** është në kategorinë III-b

**Paraqitja e dokumenteve**
Kandidati duhet të paraqesë brenda **datës 03.01.2013 në Kutinë Postare Nr.1751 të** Departamentit të Administratës Publike, këto dokumenta: kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, të librezës së punës, certifikatave të kualifikimit, dëshmive të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore të paktën një letër rekomandimi si dhe një numër telefoni për t'u kontaktuar si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit. (Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit)
**KONKURIMI** është i hapur për nëpunësit civil të të njëjtës klase me procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë, nëse vendi nuk plotësohet nga këta kandidatë, konkurimi zhvillohet me kandidatët jashtë Administratës Publike, sipas procedurave të shërbimit civil.
Pas verifikimit paraprak, **me datë 07.01.2013** në selinë e **Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave** do të shpallet lista e konkurrentëve, që do të vazhdojnë më tej konkurimin si dhe data kur do të zhvillohen testimi me shkrim dhe intervista me gojë. Konkurimi do të bazohet në njohuritë mbi Legjislacionin për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Kodin e Procedurave Administrative, Legjislacionin e Prokurimit Publik, Ligjin nr.9367 dt. 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" si dhe Ligjin nr.9131 dt. 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike", Ligjin nr.8503 dt. 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare».

**Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, rezultatet e verifikimit paraprak si dhe datat kur do të zhvillohen testimet, mund t'i gjeni në adresën e Web Site të Departamentit të Administratës Publike www.pad.gov.al**

Komunikimi i jashtëm është faktori kyç në perceptimin që publiku ka për çdo institucion.. Ky komunikim bazohet në një agjendë të qartë për mjetet që do të përdoren në krijimin dhe në mbajtjen e marrëdhënieve të mira me publikun e interesuar përmes shpërndarjes së informacionit dhe transparencës. Faqja zyrtare në internet që çdo institucion ka, përben mjetin thelbësor për përçimin e këtij informacioni prej këtij institucioni drejt publikut. Çdo vendim apo ligj apo çfarëdolloj informacioni tjetër tashmë publikohet në kohë reale.





albania
Kreu
Tema
Profilet
Lajmet
KALENDARI I AKTIVITETEVE
DHJETOR, 2012
PROFILET
BULETINI INFORMATIV


QBZ
Informacione
Aktivitete të QBZ-së
Njoftime
Vendet
Organizimi
Drejtoria
Departamente
Album fotografik
Lidhje të tjera
Kuvendi i Shqipërisë
Presidenti
Këshilli i Ministrave
Ministria e Drejtësisë
Këshilli i Lartë i Drejtësisë
Gjykata e Lartë
Gjykata Kushtetuese
Gjykata e Strasburgut
Prokuroria e Përgjithshme
Gjykata e Tiranës
Botime
Kushtetuta
Kodet
Përmbledhëse legjislative
Fletoret Zyrtare
Fletorja Zyrtare e fundit
Akte ligjore në anglisht
Certifikata elektronike
Arkiva elektronike e QBZ-së
Arkiva elektronike
Ndihmë
Fletore Zyrtare
Viti 2012
Viti 2011
Viti 2010
Viti 2009
Viti 2008
Viti 2007
Viti 2006
Viti 2005
Viti 2004
Viti 2003
Viti 2002
Viti 2001
Viti 2000
QBZ
Kontakti


DEPARTAMENTI I ADMINISTRATES PUBLIKE
DEPARTMENT OF PUBLIC ADMINISTRATION
DAP
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE


DEPARTAMENTI I ADMINISTRATES PUBLIKE
DEPARTMENT OF PUBLIC ADMINISTRATION
DAP
HOME | DAP | VENDE VAKANTE | REGJISTRI QENDROR | TRAJNIME | PUBLIKIME | KUADRI LIGJOR | ARKIVA | KONTAKT
Institucionet
PORTALI I VENDEVE VAKANTE NE ADMINISTRATEN PUBLIKE

Rrjetet sociale janë tashmë një risi dhe platforma mjaft të fuqishme për shoqërinë tonë. Të qenurit pjesë e këtyre rrjeteve si institucion, ka rritur mjaft interesin e publikut në trajtimin e shumë çështjeve që lidhjen me shërbimin civil, diskutimin e projektligjeve apo dhe publikimin e trajnimeve të ndryshme. Këto rrjete sociale, ku institucioni ynë, Departamenti i Administratës Publike tashmë është pjesë, ka ndihmuar në krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve të mira me publikun e interesuar përmes shpërndarjes së informacionit në kohë reale.




INSTITUTI I TRAJNIMIT TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE
Kryesore
Rreth Nesh »
Raporte / Arkiva
Publikime
Trajnime
Na Kontaktoni
Instituti i Trajnimit të Administratës Publike
Trajnime që lidhen me Procesin e Integrimit Europian
Trajnime mbi SPI-në
Trajnime në lidhje me projekt buxhetin afat mesëm dhe buxhetin vjetor
Trajnime në mbështetje të strategjisë së decentralizimit
Trajnime të përgjithshme
Strategjia 2011 - 2013
SHKARKO
No Events


INSTITUTI I TRAJNIMIT TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE
Kryesore
Rreth Nesh
Raporte / Arkiva
Publikime
Trajnime
Na Kontaktoni
English
Vizioni i ITAP-it
Trajnime
November 2012
today
Mon
Tue
Wed
Thu
Fri
Sat
Sun

**Botime periodike të Departamentit të Administratës Publike**





DAP

# DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Revista Nr.1 / Tetor 2009

**STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE (SNRAP) 2009 - 2013 NË KUADËR TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM**


DAP

SHËRBIMI CIVIL NË RAJON
NË NJË KËNDVËSHTRIM TË RI

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
Revista Nr.3 / Dhjetor 2009



DAP

# ROLI DHE ZHVILLIMI I E-GOV NË SHQIPËRI

*pjesa I*

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Revista Nr.4 / Korrik 2010


ROLI DHE ZHVILLIMI I E-GOV NË SHQIPËRI

*pjesa II*

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATES PUBLIKE**

Revista Nr.5 / Shtator 2010



DISA ASPEKTE TË RËNDËSISHME NË LIDHJE ME PUNËSIMIN

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Revista Nr.6 / Dhjetor 2010


DAP
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT
TË SHËRBIMIT CIVIL
Revista Nr. 7
2011 (1)

DAP

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

# PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIT PUBLIKË

Revista Nr. 8

2011 (2)


DAP
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
ADMINISTRATA SHQIPTARE DREJT KOMUNIKIMIT
EFEKTIV PËRMES MARRËDHËNIEVE PUBLIKE
Revista Nr. 9
2011 (3)


DAP
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE, MJET PËR AVANTAZH KONKURRUES
Revista Nr. 10
2011 (4)


DAP
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
ADMINISTRATA PUBLIKE NË VËMENDJEN E STUDENTËVE
Revista Nr. 11
2011 (5)


DAP
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
RRITJA E KAPACITEVE
NË ADMINISTRATËN PUBLIKE
Revista Nr. 11
2012 (1)

# Pasqyra e lëndës


- Deklarata e Shpalljes së Pavarësisë ..........7
- Kanuni i përtashëm i administratës civile të Shqipërisë .......................................25
- Rregullore e jetëshkrimeve, 1921............31
- Dëftesë jetëshkrimi ......................................33
- Rregullore mbi botimin dhe shpërndarjen e gazetës zyrtare/ Mbi sjelljen e nëpunësve /Shpallje vendi të lirë punë, 1922 ..............................34
- Ligji i administratës civile të shtetit shqiptar, 1922. ..............................................37
- Shpallja e masës disiplinore/ Ligj për gjykimin e nëpunësve/ Mbi udhëtimet e nëpunësve, 1922 ..........................................38
- Për klasifikimin e rrogave/ Për orarin zyrtar dhe jetëshkrimin e nëpunësve, 1922.......................................39
- Shpallje e një vendi pune të lirë / Rregullorja e shtetit civil, 1922 ................41
- Mbi etikën e nëpunësve, 1922 .................42
- Mbi dialektin e përdorur në komunikimin zyrtar, 1923 ..........................43
- Shpallje emërimi dhe shpallje konkursi, 1923 ..............................................44
- Ligje, dekretligje e Rregullore, 1925.......55
- Ligji i administratës Civile e Republikës Shqiptare, 1928 ...................82
- Rregullore e përgjithshme e ceremonisë, 1928 ...................................... 107
- Ligji organik i Ministrisë së Punëve të Brendshme, 1928 ................................. 108
- Ligj mbi shtimin e tre inxhinierëve, 1927-1928 .................................................. 109
- Rregullore mbi zbatimin e ligjit të pensioneve, 1928. ............................... 114
- Bisedimet e senatit, 1928 ...................... 117
- Vepra penale që lidhen me administratën publike, 1928. ................ 127
- Projektligj mbi gjendjen juridike dhe rregullimin hierarkik të nëpunësve civilë, 1931............................ 164
- Dekretligj mbi krijimin e Kryeministrisë së Mbretërisë Shqiptare, 1931. ............ 165
- Kontratat që lidhen nga administrata shtetërore, 1936. ...................................... 170
- Të ardhurat e shtetit, 1936. ..................... 171
- Shpenzimet e shtetit, 1936...................... 172
- Krijimi i drejtorisë së bashkive dhe komunave në Ministrinë e Brendshme, 1936........................................ 173
- Fletore zyrtare, 1936. ............................... 174
- Konkurs për kryetar komune, 1936. .........175
- Vendimet e këshillit të shtetit, 1937. 189
- Dekretligj mbi krijimin e drejtorisë së emigracionit pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, 1937. ................. 191
- Ligji mbi rregullimin e zyrave te administratës qendrore të Ministrisë se Arsimit, 1938. ........................................ 195
- Shpallje konkursi për vend vakant, 1938. ............................................... 196
- Shpallje konkursi për katër atashetë në ministrinë e punëve të jashtme, 1938. ..........................................`197
- Model jetëshkrimi..................................... 199
- Kopje dokumentesh që përmbajnë emërime në pozicione publike............. 202
- Qarkore mbi funksionimin e drejtorisë se personelit, 1945. .................................. 203
- Qarkore mbi funksionimin e drejtorisë së personelit, 1945. .................................. 204
- Vendim i këshillit ministrial, 1945.205
- Model shkrese nga Kryeministria, 1945.................................................................. 206
- Model shkrese i Ministrisë së Financave, 1945.................................... 207
- Vendim i këshillit ministerial, 1945. ..........208
- Vendim i këshillit ministerial, 1945. ..........208
- Qarkore për organizimin e punës në aparatin shtetëror, 1948..................... 213
- Qarkore për disiplinën në punë, 1948. ............................................. 214

- Qarkore për organizimin e punës në aparatin shtetëror, 1948....................217
- Material nga Arkivi Qendror i Shtetit, 1949............................................218
- Firmosja e akteve nga titullarët, 1949..............219
- Rregullore për orarin zyrtar, 1949. .......221
- Sugjerime për projekt-rregulloren, 1949.......................223
- Udhëzim mbi mbajtjen e dosjes së kuadrit, 1949............................................232
- Shkresë mbi kategorizimin e degëve të Ministrisë, 1949...................................233
- Organika e Ministrisë së Industrisë dhe Minierave, 1954................................241
- Organika e Ministrisë së Tregtisë, 1954............................................242
- Skema e Ministrisë së Industrisë Ndërtimit, 1954........................................245
- Skema e Ministrisë së Industrisë dhe Minierave, 1954................................247
- Organika e Ministrisë së Financave, 1954. .......................................253
- Mbi nomeklaturën e kuadrit, 1956. ..........254
- Pasqyrë mbi shkurtimin e personelit, 1960. .......................................255
- Projekt-vendim mbi nomeklaturën e kuadrit, 1960...........................................267
- Departamenti i Administratës Publike gjatë 18 viteve të saj.................269
- Vendimi për krijimin e Departamenti të Administratës Publike.........................279
- Ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil".........................281
- Struktura dhe organika e Ministrisë se Brendshme, 2001. ...............................284
- Kërkesë për shpallje konkursi, 2002............286
- Model kthim përgjigje shkrese për ndryshim strukture në Ministrinë e Arsimit, 2007...........................................288
- Model kthim përgjigje shkrese për ndryshim strukture në Ministrinë e Shëndetësisë, 2007..................................290
- Model shkrese: Dërgim projekturdhri për miratim strukture e organike, 2008. .........294
- Model shkrese: Dërgim projekturdhri për miratim strukture e organike, 2008............297
- Vendim pagash, 2011. ............................300
- Vendim për përcaktimin e standardeve dhe miratimin e strukturave organizative të institucioneve të administratës publike, 2011. .................309
- Letër interesi për të marrë pjesë në konkurs, 2012. ....................................310
- Model shkrese: Lidhje kontrate të përkohshme, 2012. ..............................311
- Model përshkrim pune, 2012................314
- Model përshkrim pune (Sekretar i Përgjithshëm), 2012. ...........317
- Model shkrese: Emërim, 2012...............318
- Model shkrese: Konfirmim, 2012. .........319
- Model shkrese: Largim nga detyra, 2012........................320
- Model shkrese: Lirim nga shërbimi civil, 2012. ..............321
- Model shkrese: Paraseleksionim, 2012. ...........................322
- Model shkrese: Lëvizje paralele, 2012..............................323
- Model shkrese: Shtesa në pagë për grada dhe tituj shkencorë, 2012......................................324
- Model shkrese: Transferim i detyrueshëm, 2011. ..........325
- Model shkrese: Pezullim nga shërbimi civil, 2012. ........326
- Model shkrese: Shpallje ne gazetë e fituesit, 2012.......... 327
- Formular vlerësimi vjetor, 2012.............331
- Njoftim për vend të lirë pune, 2012............332
- Përzgjedhja e kandidaturave, 2012..........334
- Shpallje rezultati të konkurrimit, 2012.............335
- Buletini i Prokurimit Publik. ....................338
- Faqet zyrtare ne internet te institucioneve kryesore..........................340
- Botime periodike te Departamentit të Administratës Publike.........................349